

**RAPORT I MONITORIMIT TË
ZBATIMIT TË BUXHETIT VITI 2020
BASHKIA SHKODER**

Shkurt 2021

HYRJE.....	4
REALIZIMI I BUXHETIT TË VITIT 2020	15
REALIZIMI I TE ARDHURAVE TE BASHKISË NGA BURIMET E VETA VENDORE PËR VITIN 2020.	18
Realizimi i të ardhurave vendore	20
Realizimi i të ardhurave sipas Njësive Administrative	24
Të ardhura nga taksat vendore	29
Të ardhura nga taksat e ndara	32
Të ardhura nga tarifrat	33
Të ardhura të tjera	36
REALIZIMI I SHPENZIMEVE TË BUXHETIT TË VITIT 2020	38
Shpenzimet nga transfertat e pakushtezuar dhe të ardhurat e veta vendore	47
Transfertat e pakushtezuar sektoriale	57
Transfertat e kushtëzuar	61
Shpenzimet nga fondet e trashëguara	63
Detyrimet e prapambetura	64
FUNKSIONI 1: SHËRBIME TË PËRGJITHSHME PUBLIKE.....	65
Programi 01110: Planifikim, menaxhim dhe administrim	65
Programi 01170: Gjendja Civile	95
FUNKSIONI 03: RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE	101
Programi 03140: Shërbimet Policore Vendore	101
Programi. 03280: Emergjencat Civile	110
FUNKSIONI 4: ÇËSHTJET EKONOMIKE	121
Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik	121
Programi 04160: Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi	136
Programi 04220: Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve	140
Programi 04240: Menaxhimi i infrastruktures së ujitjes dhe kullimit	147
Programi 04260: Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	154
Programi 04520: Rrjeti rrugor rural	164
Programi 04570: Transporti publik dhe lëvizshmëria	176
Programi 04760: Zhvillimi i Turizmit	182
FUNKSIONI 05: MBROJTJA E MJEDISIT	196
Programi 05100: Menaxhimi i mbetjeve	196
Programi 05200: Menaxhimi i ujërave të zeza	202
Programi 05320: Programet e Mbrojtjes së Mjedisit	209
Programi 05630: Ndërgjegjësimi Mjedisor	213

FUNKSIONI 06: STREHIMI DHE KOMODITETET E KOMUNITETIT	217
Programi 06140: Urbanistika	217
Programi 06260: Zhvillimi i komunitetit	221
Programi 06330: Furnizimi me ujë	228
Programi 06440: Ndriçimi i rrugëve	234
FUNKSIONI 07: SHËNDETËSIA	240
Programi 07220: Shërbimet e kujdesit parësor	241
FUNKSIONI 8: ARGËTIMI, KULTURA DHE FEJA.....	247
Programi 08130: Sport dhe argëtim	247
Programi 08220: Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	256
FUNKSIONI 09: ARSIMI.....	276
Programi 09120: Arsimi baze parashkollor	276
Programi 09230: Arsimi i mesem i pergjithshem	286
Programi 09240: Arsimi mesem Profesional	294
FUNKSIONI 10: MBROJTJA SOCIALE	301
Programi 10140: Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara	301
Programi 10220: Sigurimi shoqëror	306
Programi 10430: Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	310
Programi 10660: Strehimi social	340

Hyrje.

Gjatë vitit 2020, Bashkia Shkodër u perball me gjendjen e jashtëzakonshme për shkak të pandemisë që përfshiu të gjithë globin.

Në zbatim të ligjit 15/2016 për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive si dhe në zbatim të Urdhërave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.132, datë 8.3.2020, “Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura” dhe nr.156, datë 10.3.2020, “Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”,

- Kryetari i Bashkisë Shkodër nxori urdherin me nr 230 datë 09.03.2020 për “ Mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike, anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura, mbylljen e institucioneve arsimore për parandalimin e përhapjes së COVID-19”.
- Keshilli i Ministrave me vendimin nr 243 date 24.3.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore“ shpalli gjendjen e fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë, për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, e cila perfundoi me 23 qershor, sipas Vendimit të Kuvendit nr. 18/2020, datë 23.4.2020 “Për dhënien e pëlqimit për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, Keto përcaktuan kufizimin e të drejtave të garantuara nga nenet 37, 38, 41, pika 4, 49 dhe 51 të Kushtetutës deri në masën që konsiderohet e domosdoshme për të arritur ruajtjen e shëndetit të shtetasve.

Për përballimin dhe lehtësimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore u morën masat e jashtëzakonshme si vijon:

- Dezinfektimi i të gjitha ambienteve administrative dhe institucioneve të varësisë të gjithë Bashkisë Shkodër
- Dezinfektimi i depove të ujit të pijshëm dhe stacioneve të pompave, në qytet dhe Njesite Administrative,
- Dezinfektimi i rrugëve kryesore të qytetit, të gjitha pusëtave të kanaleve të ujërave të zeza dhe të bardha, në të gjithë qytetin, hapësirave publike, tregjeve dhe hapësirave të tyre, të gjitha institucioneve arsimore publike përfshirë: shkolla, kopshte dhe çerdhe.
- Vendosja e tuneleve dezinfektues në hyrje të tregjeve Rus, Zdralej dhe të Tregut të Shitjes me Shumicë Fruta Perime, në Dobraq.

Në zbatim të VKM Nr.236, datë 19.3.2020 “Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga covid-19” dhe Vendimit nr. 2, datë 24.03.2020 të Komisionit qendror për Ofrimin e Asistencës, Bashkia Shkodër u përball me një fluks të madh kërkesash nga familje dhe individë për pako ushqimore dhe joushqimore.

Pranë Bashkisë Shkodër, u regjistruan kërkesa nga familje dhe individë:

- Familje/individë në nevojë, pa ndihmë, grupe të marxhinalizuara, me vështirësi të renda ekonomike Sociale:
- Pensionistë, të cilët nuk kanë familjarë në moshë aktive pune në njësinë administrative ku jetojnë,

- Persona me aftësi të kufizuar, të cilët nuk kanë familjarë në moshë aktive pune në njësinë administrative ku jetojnë,
- Familje /individë në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike të cilët nuk kanë asnjë të ardhur tjetër përveç ndihmës ekonomike
- Familje, familjeve/individëve në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike të cilët kanë mbi 5 anëtarë,
- Asistenca ndaj familjeve/individëve në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike nga fondet e bashkive ,
- Asistenca ndaj familjeve/individëve në nevojë, me shumë anëtare, që mund të kenë të ardhura nga pensioniste që janë kryefamiljarë, apo kryefamiljar që kka punuar me ditë/në të zezë, por që nuk kanë asnjë të ardhur tjetër pasi nuk kanë mundësi për të mbuluar jetesën, apo nuk kanë mundësi ta sigurojnë atë për shkak të izolimit.

Listat e personave në nevojë të perditesuara çdo javë, janë dërguar për konfirmim pranë Komisionit Qendror të Ofrimit të Asistencës .

Për më tepër, bashkëpunimi i afërt me organizata të ndryshme (UNICEF, UNDP, Fundjavë Ndryshe, Foodbank, Mirësia, Shpresë për Botën, etj.) ka bërë të mundur mbulimin më të gjërë të familjeve në nevojë me pako ushqimore dhe higjienike me rreth 3000 pako. Nga Rezervat e Shtetit janë siguruar 543 pako ushqimore.

Gjithashtu, u realizuan dy dhurimeve financiare, nga UNICEF, me vlerë 2,333,600 lekë, që iu shpërndanë 553 familjeve në nevojë sipas numrit të anëtarëve dhe nga EorlDVision me vlerë 250,000 lekë, që iu shpërndanë 50 familjeve në nevojë.

Stafi i bashkisë ka punuar sipas organizimit të posaçëm me urdhëra sipas drejtorive. Te gjithë punonjesit ne kontakt me publikun jane pajisur me maska, doreza dhe mjete mbrojtëse.

Grupet e punës që kanë bërë shpërndarjen e pakove ushqimore dhe joushqimore në të gjithë territorin e bashkisë, kanë qenë në shërbim të vazhdueshëm, në kushtë emergjence.

Çdo ditë është raportuar për punën e bërë, pranë institucionit të Prefektit Qarkut (Komisionit të Mbrojtjes Civile), Agjencisë së Mbështetjes së Vetqeverisjes Vendore, etj.

Në mbështetje të nenit 65, të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”.

*“Bashkitë, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të këtij ligji, mbështeten në parashikimin minimal prej **4 për qind të totalit të buxhetit vjetor të tyre, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit”.***

Buxheti i shtetit (Ministria e Mbrojtjes) kishte për detyrë të akordonte **4 për qind të totalit të buxhetit vjetor të Bashkive,** , për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile.

Meqenëse qeveria nuk akordoi asnjë lek, sipas ligjit të mësipërm, Bashkia Shkodër vazhdoi punën me fondet e veta dhe njëkohësisht, bëri edhe një rishpërndarje të fondeve te veta të Bashkisë Shkodër, të trashëguara nga viti 2019, si diferenca prokurimi, në shtesë të Programit të mbrojtjes civile, aktiviteti "Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile" në shumën prej 35,927,823 lekë, me VKB nr 18, datë 23.04.2020.

Bashkia Shkodër arriti, me fondet e veta, të parashikuara për vitin 2020, të tejkalojë fondin prej 4% sipas nenit 65 të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”. Ky fond vazhdon të përdoret me qëllim zvogëlimin e rrisht nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile.

Për arrijten e synimeve për një zhvillim të qëndrueshëm strategjik, gjate 5 viteve të fundit është punuar shumë, në drejtimet:

- **Përgatitja e dokumentave strategjike dhe planeve vendore.**

- Strategjia Territoriale për Zhvillim, Bashkia Shkodër.
- Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Planit të Shkodrës.
- Plani i Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Shkodër.
- Plani Lokal i Mbrojtjes së Biodiversitetit.
- Plani i veprimit për zhvillimin e komunitetit lokal Rom dhe Egjiptian.
- Plani Social Vendor i Bashkisë Shkodër.
- Plani i veprimit për barazinë gjinore 2018 - 2020 të Bashkisë Shkodër.
- Plani i Veprimit për Fëmijët në Situate Rruge
- Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta dhe Urbane.
- Plani i Veprimit për Përmirësimin e Shërbimit të Kullimit.
- Plani Lokal për Veprimin e Zhurmave në Mjedis.

Jemi në përfundim të hartimit të Planit për administrimin e shërbimit në sistemin e arsimit parashkollor në Bashkinë Shkodër.

Në përmbushje të vizionit të strategjisë së zhvillimit, janë 5 objektiva strategjike, të cilët synojnë të specifikojnë fokusin e zhvillimit të Bashkisë gjatë viteve të ardhshme. Është synuar që objektivat strategjike të jenë të prekshme, specifike dhe të monitorueshme, për të siguruar zbatueshmërinë e tyre. Për këtë arsye, janë përcaktuar edhe disa tregues monitorimi e vlerësimi për secilin objektiv strategjik, të cilët mund të detajohen dhe përmirësohen gjatë punës që Bashkia do të kryejë për zbatimin e kësaj strategjie.

Procesi i ecursisë së arrijteve të objektivave zhvillimore të Bashkisë Shkodër mbështetet në dy elemente kryesore:

- monitorimi i Strategjisë Territoriale të Zhvillimit të Bashkisë Shkodër.
- monitorimi i realizimit të buxhetit vjetor.

Sa më sipër, monitorimi i zbatimit të projekteve u bë duke u mbështetur në një shkallë vlerësimi prej tre vlerash kryesore:

- E ulët - Programet që kanë më pak se 10% të projekteve të zbatuara janë vlerësuar me ecuri të ulët zbatimi (ngjyrë të kuqe).
- E mesme - Programet që kanë nga 11% deri në 50% të projekteve të zbatuara janë vlerësuar me ecuri të mesme zbatimi (ngjyrë të verdhë).
- E mirë - Programet që kanë mbi 51% të projekteve të zbatuara janë vlerësuar me ecuri të mirë zbatimi. (ngjyrë të jeshile).

Për të adresuar 5 objektivat strategjike të planifikuara në këtë plan janë parashikuar 198 projekte.

Nga 198 projekte të monitoruara, të cilat kanë një afat zbatimi 2015-2030, konstatohet se:

- 65 % e projekteve janë vlerësuar me ecuri të ulët zbatimi, rreth 123 projekte;

- 28 % e projekteve janë vlerësuar me ecuri të mesme zbatimi, rreth 60 projekte;
- 7 % e projekteve janë vlerësuar me ecuri të lartë zbatimi, rreth 15 projekte.

Monitorimi i Strategjisë Territoriale të Zhvillimit të Bashkisë Shkodër është një mekanizëm tepër i vlefshëm për të treguar nëse burimet në dispozicion janë të mjaftueshme, janë përdorur me efektivitet dhe nëse po bëhet ajo që është planifikuar. Si rrjedhojë, Bashkia Shkodër ka përgjegjësinë e garantimit, që plani i zhvillimit ekonomik të përmbushë objektivat e deklaruara dhe me efektivitet kostoje për dy arsye kryesore, marrjen e vendimeve dhe vendosjen e përgjegjshmërisë.

Sa më sipër Bashkia Shkodër ka fokusuar përpjekjet e saj në drejtim të garantimit të barazisë në shërbime dhe në akses ndaj qytetarëve dhe vizitorëve bazuar në një sistem policentrik të zhvillimit. Jo pa qellim objektivat e strategjisë së zhvillimit kanë shërbyer si bazë për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2019-2020, duke realizuar kështu një lidhje integrale të objektivave dhe planit të veprimit të strategjisë së zhvillimit me projektet e parashikuara në secilin nga programet buxhetore të Bashkisë Shkodër. Mbi bazën e këtij parimi është bërë ndarja e burimeve të disponueshme për secilin program buxhetor. Secili program buxhetor është i lidhur me një grup aktivitete të matëshme, duke treguar qellimin, aktorët përgjegjës, rezultatet e pritshme, treguesit dhe buxhetin përkatës.

Objektivat e Planit të Përgjithshëm Vendor kanë shërbyer si bazë për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm, duke realizuar kështu një lidhje integrale të objektivave dhe planit të veprimit të strategjisë së zhvillimit me projektet e parashikuara në secilin nga programet buxhetore të Bashkisë Shkodër. Mbi bazën e këtij parimi është realizuar kuadri logjik i PBA-së dhe është bërë ndarja e burimeve të disponueshme për secilin program buxhetor. Monitorimi i ecurisë së zbatimit bëhet duke u mbështetur në informacionet për gjendjen e zbatimit dhe të financimit të projekteve të strategjisë.

Duke e konsideruar zbatimin e buxhetit vjetor si një proces të rëndësishëm, Bashkia Shkodër ka ngritur një sistem menaxhimi efikas për përdorimin e fondeve publike. Paisja e një sistemi të tillë kërkon transparencë, llogaridhënie, shërbesa me etikë dhe përgjegjshmëri, ndërhyrje me efikasitet, dhe qeverisje me pjesëmarrje. Këto mjete kanë shërbyer dhe do të vijojnë të shërbejnë si udhërrëfyes në punën tonë për përmbushjen e funksioneve dhe kompetencave të përcaktuara në ligj dhe në akte nënligjore.

- **Përmirësime të vazhdueshme për transparencën, luftën ndaj korrupsionit, administrimit me eficiencë të financave vendore për shërbime publike dhe investime vendore.**

Zyra me 1 ndalesë - Kemi zbatuar sistemin e ri të integruar të administrimit të dokumentacionit dhe informacionit për ofrimin e Shërbimeve administrative për banorët e Shkodrës, kudo ata ndodhen. Ky sistem konsiston në konsolidimin e shërbimeve administrative të ofruara përmes Zyrave të Integruara me Një Ndalesë në Bashkinë Qendër dhe në Njësitë Administrative, gjithsej 16 të tilla me 83 shërbime të ofruara. Kësisoj kemi standartizuar shërbimin, shkurtuar kohën e përgjigjes dhe të

ofrimit të shërbimit, kemi luftuar korrupsionin, kemi rritur transparencën dhe përmirësuar vendimarrjen gjithpërfshirëse.

Platforma Transparenca e Buxhetit - Nisma jonë fillon që në vitin 2016 si një raportim të aktiviteteve të realizuara për të gjithë qytetarët e Bashkisë Shkodër në kohë reale, muaj pas muaji dhe vit pas viti. Në instrument është përfshirë viti 2016 – 2020. Të dhënat lidhur me angazhimet buxhetore për shërbime dhe investime, të ardhurat sipas njësive dhe llojit, planin dhe shpenzimet faktike sipas projekteve dhe aktiviteteve, të treguara qartë përmes treguesit në hartën territoriale, në vendin ku ato ndodhin, kontratat specifike me subjektet, organizatat, partnerët me të cilët ofrojmë shërbimet apo zbatojmë investimet, përfshirë dokumentacionin faktues lehtësisht të lexueshëm dhe të aksesueshëm për gjithcka më sipër, janë të paraqitura në këtë platform, ku me trek lëviz mund t'i kthesh përgjigje pyetjes dhe interesit përkatës për atë që Bashkia Shkodër realizon.

Sistemi i integruar i Taksave dhe Tarifave Vendore (SiTTV): Përmes sistemit Bashkia Shkodër prej tre vitesh bën të mundur administrimin automatik të të dhënave dhe detyrimeve financiare për bizneset dhe individët. Automatizimi në llogaritjen dhe pagesën e detyrimeve përmes ngritjes së sistemit, ka ndihmuar për një performancë më të mirë të Bashkisë Shkodër në mbledhjen e të ardhurave, por mbi të gjitha ka ndihmuar biznesin duke rritur besueshmërinë e tij për transparencën në punën e Bashkisë.

Platforma Taksat e Mia. Nëpërmjet kësaj platforme, qytetari mjafton të zgjedhë njësinë administrative dhe të plotësojë të dhënat personale dhe informohet menjëherë për detyrimet e veta vjetore.

Programi i Transparencës i Bashkisë Shkodër: Transparenca dhe llogaridhënia janë dy parime të rëndësishme të Bashkisë Shkodër. Në programin e transparencës publikojmë të gjithë informacionin mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë, menxhimin financiar, trajtimin e kërkesave për informacion, shërbimet publike që ofron bashkia, pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje, legjislacionin dhe aktet e brendshme rregullatore në mënyrë të tillë që të jetë i aksesueshëm dhe lehtësisht i kuptueshëm nga individët dhe grupe të caktuara të shoqërisë, duke respektuar kufizimet e arsyeshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë.

Transparenca dhe llogaridhënia janë të lidhura me njëra-tjetrën, ku transparenca e autoriteteve të qeverisjes vendore përfaqëson një hap të parë drejt llogaridhënies së kryetarit dhe këshillit bashkiak dhe ndërtimit të besimit me komunitetin. Detyrimet ligjore që rrjedhin nga Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, dhe Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” u garantojnë qytetarëve akses në qeverisje dhe kushtet e duhura për të ushtruar të drejtat e tyre qytetare. Nëpërmjet Programit të transparencës, Bashkia Shkodër vendos në dispozicion të qytetarëve një kategori të gjerë informacionesh, mënyrat dhe afatet e publikimit të tyre si dhe procedurat për të aksesuar e përdorur ato.

Çdo vit, Bashkia Shkodër është vlerësuar me çmimet e para nga insitucione publike dhe organizata të shoqërisë civile, për administrimin e mirë, effiçient dhe me transparencë, për vendimarrje të konsultuar dhe gjithpërfshirëse, për zhvillimin e praktikave inovative në administrimin vendor.

Instituti për Politika Publike dhe Mirëqeverisje ka vlerësuar Indeksine e Performancës së Bashkive për Shqipërinë në vitin 2020

Në renditjen e përgjithshme të Matjes së Indeksit të Performancës, ku u matën performancat e bashkive bazuar në 35 indikatorë, të cilët janë të grupuara në 4 kategori: Bashkia për Qytetarët, Bashkia për Biznesin, Administrimi Bashkiak dhe Transparenca, Bashkia Shkodër renditet si bashkia me performancën më të lartë.

Organizata Aleanca Alpeve Shqiptare në bashkëpunim me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), ka prezantuar në tryezën konsultuese për prezantimin e raportit të monitorimit “Vlerësimi i Transparencës dhe Llogaridhënies në Bashkinë Shkodër”. U permend me kenaqësi qe Bashkia Shkoder, pertej hapave pozitive, synon perfeksionimin e saj. Ky raport është hartuar në kuadër të projektit “Monitorimi Qytetar i Transparencës dhe Llogaridhënies në nivelin e qeverisjes vendore”, i cili zbatohet nga IDM dhe mundësohet nga ‘Programi i shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën’, financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA). Ne kuader te marredhenies bashkepunuese bashki - shoqeri civile, u prezantua nje draft raport final per monitorimin ne bashkine Shkoder per periudhen Shtator - Tetor 2020.

Bashkia Shkoder - Keshilli Bashkiak, ne kuader te konkursit te praktikave te mira, edicioni 2020, ka fituar çmimin e parë, per permiresimin e informimit dhe konsultimit publik per aspekte te financave publike , rritjen e trasparences dhe perdorimit te mjeteve te teknologjise se informacionit.

Bashkia Shkoder ka marre pjese ne konkursin kombetar të praktikave te mira 2020, ku mori çmimin e publikut Bashkise Shkoder ne praktikat e mira ne administrimin e mbetjeve urbane.

- **Përmirësimi i mjedisit për biznesin**

Rritja ekonomike dhe hapja e vendeve të reja të punës në ekonomitë në zhvillim, varen nga dy faktorë kryesorë: tërheqja e investitorëve të huaj dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Klima e favorshme e biznesit është thelbësore për tërheqjen e investimeve të huaja dhe për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Në këtë kuadër, politikat e zhvillimit të Bashkisë Shkodër janë fokusuar në zhvillimin e një ekonomie për qytetin dhe zonat rurale, sipas parimit të plotësueshmërisë ndërmjet qytetit dhe zonave rurale.

Këtë vit, në kushtet e krijuara nga pandemia Covid-19, Bashkia Shkodër, për t’i ardhur sadopak në ndihmë biznesit dhe qytetarëve të Shkodrës, propozoi pranë Këshillit Bashkiak, Projekt-Vendimin “Për disa ndryshime në VKB Nr.1 datë 22.01.2016 “ Për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Shkodër, të ndryshuar, Propozimi ishte për përjashtimin nga taksa dhe tarifa vendore për një periudhë 3-mujore viti 2020, për të gjitha kategoritë e taksapaguesve individë,

familje, persona fizik dhe juridik, ambulant, OJF, Institucione publike në territorin e Bashkisë Shkodër.

Pas propozimeve të bëra nga ana e këshilltarëve, Këshilli Bashkiak miratoi VKB nr 25 datë 26.06.2020 “Për disa ndryshime në VKB nr 1 datë 22.1.2016 “ Për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Shkodër”, të ndryshuar,

- **Aktivitetet stimuluese për nxitjen e zhvillimit të biznesit.**

Që në fillim të vitit 2016, administrimi i Bashkisë Shkodër ka stimuluar nxitjen dhe zhvillimin, lehtësimin e biznesit në kushtet të vështirësive ekonomike që po kalon Shqipëria:

- a) Nëpërmjet politikave fiskale, shpërndarjen e drejtë të ngarkesës tatimore;
 - *Ulje deri në 30% të taksës së pronës (ndërtesës dhe tokës bujqësore);*
 - *Mundësimi në e shlyerjes së detyrimit me këste, çdo muaj per bizneset dhe familjet;*
 - *Përcaktimin e nivelit të tarifës sipas llojit të aktivitetit;*
 - *Përcaktimin e nivelit të tarifës sipas vendndodhjes gjeografike, duke lehtësuar bizneset në zonat më pak të zhvilluara (Taksa dhe tarifa të reduktuara deri në 50 % per subjektet që ushtrojnë aktivitet në Njësi Administrative).*
 - *Perjashtimi nga detyrimet tarifore të bizneseve gjatë periudhës së pandemisë.*
- b) Krijimit të platformës elektronike ‘Taksat e mia’, ofrimit të shërbimeve online në të gjitha njësitë administrative.
- c) Krijimit dhe funksionimit të platformës “Tregu i Punës Shkodër”. Për herë të parë në vendin tonë u krijua dhe po funksionon platforma e përbashkët “Tregu i Punës Shkodër”, projekt i realizuar me financim të qeverisë austriake (projekti SEED).
- d) Nxitjes dhe mbështetjes së bashkëpunimit të biznesit vendore nëpërmjet iniciativave financiare. Bashkëpunimi me zonën e përmirësimit të biznesit BID Shkodër. Bashkëpunimi me zonën e përmirësimit të biznesit BID Shkodër në rrugën “13 Dhjetori” dhe “28 Nëntori”. Nga ky bashkëpunim përfitojnë 120 biznese.
- e) Bashkëpunimi i përvitshëm me artizanët, pjesë e shoqatës së artizaneve. Aktivitetet organizohen mbi bazën e një kalendari të mirë përcaktuar dhe janë 17 të tilla, gjithsej 65 ditë. Iniciativa të tilla jo vetëm ndikojnë në ruajtjen e trashëgimisë kulturore por ndikojnë edhe në zhvillimin ekonomik.
- f) Zbatimi i start up për të rinjtë në kuadër të projektit Yes Future/Programi IADSA pranë qendrës rinore ATELIE.
- g) Bashkëpunimi me bizneset prodhuese, promovimi i trashëgimisë kulturore dhe produkteve vendore.

- **Ofrimi i shërbimeve sociale dhe të integrimit përmes krijimit të sistemit dhe rrjetit të Qendrave Komunitare “Për familjen”.**

Projektimi dhe krijimi i qendrave komunitare “Për Familjen” është një risi. Ndërtimi i tyre u projektua dhe filloi të krijohej që nga qershor 2015 duke u bazuar në eksperiencat e zhvilluara në territorin tonë pas viteve ‘90 nga donatorët e ndryshëm, për të mbështetur individët e familjet e tyre në nevojë dhe duke besuar fort në domosdoshmërinë e mbështetjen e familjes si qeliza bazë e shoqërisë.

Për herë të parë në Bashkinë Shkodër janë ngritur 12 qendrat komunitare "Për familjen" të shtrira në 5 lagjet e qytetit, në disa njësi administrative si dhe shërbimi lëvizës në njësitë administrative të tjera.

Të gjitha objektet në të cilat janë krijuar qendrat komunitare "Për Familjen" janë në pronësi e administrim të plotë të Bashkisë së Shkodrës, e cila gjithashtu financon të gjitha kostot operative (uje, energji, mirëmbajtje, etj). Qendrat e bashkisë Shkodër janë hapur dhe kemi ftuar, mirëpritur dhe po bashkëpunojmë shumë mirë me donatorët dhe Organizata jofitimprurëse, duke realizuar Marrëveshje të bashkëpunimit për ofrimin e shërbimeve, marrëveshje të cilat janë transparente dhe të aprovuara në Këshillin Bashkiak.

Bashkia e Shkodrës është shpallur fituese e konkursit kombëtar të Praktikave më të mira 2018 me modelin "Qendra Komunitare "Për Familjen".

Bashkia Shkodër klasifikohet në vendin e parë ndër 61 bashkitë, për modelin e ndërtuar të shërbimeve sociale multisektoriale të qëndrueshme dhe të standartizuara pranë komunitetit, në mbështetje dhe fuqizim të familjes si qeliza bazë e shoqërisë.

Në zbatim të ligjit nr.139/2015, "Për Vetqeverisjen Vendore", i ndryshuar, ligjit nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 9970, datë 24. 07. 2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri", i ndryshuar, ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 "Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare", i ndryshuar; si dhe të VKM nr. 334, datë 17.02.2011 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij", ligjit "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Udhëzimet për aplikimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor, Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike 2014 – 2020, Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2016-2020, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 – 2020; Bashkia Shkodër përmes programeve sociale ofron informim, këshillim, orientim, mbrojtje e fëmijëve, shërbime për fëmijët dhe familjen, fuqizimi ekonomik, programe prindërimi, fuqizim komunitetit, ri-integrim në shkollë dhe mbështetje familjare për nevojat arsimore të fëmijëve, ofron shërbime për familjet në vështirësi socio-ekonomike, vulnerabël ndaj fenomenit të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe gjithashtu trajton dhe mbështet viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, duke ofruar shërbime sipas nevojave specifike të secilit rast.

• **Bujqësia dhe zhvillimi rural**

Rreth 41 % e popullsisë në Bashkinë Shkodër jeton në zonat rurale. Bujqësia, blegtoaria apo pylltaria janë sektorët kyç për përdorimin e tokës dhe menaxhimin e burimeve natyrore në zonat tona rurale. Fale sipërfaqeve të mëdha të kultivueshme dhe kushteve të mira klimatike ky sektor ofron mundësi të mëdha për tërheqjen e investimeve duke marrë parasysh produktet me cilësi të lartë dhe veçanërisht produktet autoktone tipike të zonës. Mbështetja me investime në rrjetin rrugor rural dhe promovimi i praktikave të mira kanë qenë në fokus të punës

Infrastruktura bujqësore është një tregues me rëndësi kur analizohet performanca e sektorit të bujqësisë. Nga të dhënat e raportuara nga Ministrisë së Bujqësisë në nivel qarku, rezulton se pavarësisht se qarku zotëron kapacitete të burimeve ujore të mjaftueshme për përballuar ujitjen të pothuaj se 100% të tokës bujqësore, aktualisht infrastruktura ekzistuese, mbulon ujitjen e një sipërfaqeje të caktuar toke bujqësore në nivel qark.

- **Rrjeti ujitës**

Në nivel bashkie, Bashkia Shkodër ka trashëguar një rrjet ujitës prej 213 km i cili në pjesën dermuese të saj ka nevojë emergjente për ndërhyrje rehabilitimi. Duke parë si nevojë prioritare zhvillimin e prodhimeve bujqesore dhe blegtorale, Bashkia Shkodër ka venë në fokus vënien në eficiencë të rrjeteve kullues dhe ujitës. Për këtë, me kapacitetet e veta, që nga 2016 janë realizuar një serë ndërhyrjesh për rehabilitim të pjesshëm të segmenteve ujitëse, kryesisht në fshatrat Trush, Berdicë, Nj.A. Berdicë, Guri i Zi-Juban Nj.A. Guri i Zi, Bardhaj-Bleran dhe Grudë e Re, Nj.A. Rrethina, me një gjatësi totale prej rreth 62.3 km. Këto ndërhyrje kanë bërë të mundur përmirësimin e ujitjes në këto zona por janë të pamjaftueshme për ti quajtur krejtësisht funksionale pas nevojiten ndërhyrje të mëtejshme. Ndërhyrja në rehabilitimin e rrjetit tejet të amortizuar kërkon investime mjaft të mëdha të cilat janë të papërballueshme nga buxheti i bashkisë, për këtë arsye në mënyrë të vazhdueshme është kërkuar mbështetja nga pushteti qendror me financime (megjithese kemi aplikuar me projekte te gatëshme zbatimi), nga ana e qeverise mbeshtetja ka munguar totalisht, edhe ne raport me njesite e tjera vendore keto preferenciale.

Ndërhyrja në rrjetin ujites nga ana e qeverisë me fonde duke financuar projekte zbatimi shihet si emergjencë.

- **Kanalet kulluese**

Bashkia Shkodër ka trashëguar një rrjet kanalesh kulluese me një gjatësi prej 729.8 km kanale të dyta dhe të treta. Me gjithë punën mjaft të madhe të bërë nga ana e Bashkisë Shkodër për pastrimin e kanaleve të dytë dhe të tretë (janë ndërhyrë dhe pastruar gjatë këtyre viteve nga 2016-2020 rreth 445 km kanale të dyta dhe të treta në të gjitha njësitë administrative), pastrimi i kanaleve kulluese mbetet prioritet për shkak të gjatësisë së madhe të rrjetit kullues, rrjet i cili është shumë e veshtirë të mbulohet me pastrim vetëm nga mjetet në dispozicion të Bashkisë Shkodër. Gjithashtu, në funksion të kanaleve kulluese janë dhe tombinot dhe veprat e artit. Bashkia Shkodër ka vendosur dhe parashikuar vendosjen e një numri të konsiderueshëm të këtyre tombinave me buxhetin e saj, por nevojat për këto janë shumë më të mëdha së mundësitë financiare të Bashkisë Shkodër.

- **Regjistrimi i pronave**

Një detyrë që ligji u përcakton Bashkive, është dhe përcjellja e dokumentacionit pranë zyrave hipotekore, për regjistrimin e pronesisë mbi token bujqësore. Ky aspekt është vlerësuar së tepermi nga ana e bashkise, pasi çertifikimi i tokës bujqësore vazhdon të mbetet shqetësim. Kjo i vjen ne ndihmë drejtpersedrejti nevojës së Investimeve, procedurave të shitblerjes së tokes, e cila ndikon direkt ne rritjen e fermave dhe kapaciteteve të tyre prodhuese. Madhësia mesatare e një ferme është 1.1 hektar, gjë e cila kushtezon mjaft mekanizimin dhe rritjen e prodhimit në sasi dhe cilesi.

Nga ana e bashkisë gjatë viteve 2016-2020 janë përpunuar, saktësuar, përcjellë për çertifikim, sipas ligjit, pranë zyrës vendore të ASHK (ish ZVRPP) rreth 4120 dosje të banorëve. Rreth 1650 praktika të tjera janë përcjellë për paisje me Aktin e Marrjes se Tokes ne Pronësi.

Nga ana ASHKvërehet zvarritje dhe sorollatje e qytetarëve me pretekstet nga më të ndryshmet dhe të pababazuara në ligj, gjë e cila sjell kosto financiare dhe të tjera shtesë për qytetarët.

- **Subvencionimi i bujqësisë**

Nga informacioni që disponojmë subvencionimi i fermave bujqësore dhe blegtorale është në nivelet minimale, thuajse i papërfillshëm. Megjithatë territori i bashkisë është i larmishëm me shtrirje nga bregdeti deri në alpe, gjë e cila mundëson kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore dhe sidomos të varieteteve autoktone si shega, ulliri, qepa, lakra, duhani, etj, të njohura edhe të kërkuara në tregun vendas dhe atë të huaj. Për këtë është i nevojshëm subvencionimi u këtyre kulturave tipike në uljen e kostos së mbjelljes dhe prodhimit: impute bujqësore, farëra, fidane, plehra, pesticide, karburant pa akcize, etj, në kontrollin dhe sigurinë e cilësisë së këtyre imputeve, sidomos të farërave, plehrave dhe pesticideve. Ngritja e pikave të grumbullimit, ruajtjes, perpunimit dhe marketimit të këtyre varieteteve.

Prioritet duhet të ketë edhe subvencionimi mbi sasinë e prodhimit. Mbrojtja e produktit, vendas nga futja e produkteve të huaja të pakontrolluara dhe të dyshimta betet shumë shqetësuese. Vemendje e shtuar duhet të ketë dhe subvencionimi i arrorëve në zonat malore, gjë e cila nuk ekziston.

Si një ndër zonat më të mëdha blegtorale, ndihmesa e familjeve që mbarshtrajnë blegtori është mjaft e vogël nga ana e qeverisë. Subvencionimi duhet të zgjerohet me heqjen e kufirit minimal të numrit të krerëve dhe gjithashtu heqjen e kufirit maksimal. Subvencionimi në këtë fushë duhet të shtrihet në rritjen e kapaciteteve stallore: ndertimin e stallave moderne, paisjeve stallore, etj duke lehtësuar procedurat, të cilat në shumicën absolute të rasteve nuk arrihen të plotësohen nga fermerët.

Të gjitha këto janë sugjerime të kërkuara nga vetë fermerët, gjatë takimeve dhe dëgjësive publike.

- **Bashkëpunimi me shoqërinë civile**

Bashkia e Shkodrës ka një traditë të bashkëpunimit të vazhdueshëm me organizatat e shoqërisë civile. Një nga objektivat e Bashkisë Shkodër është partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurëse, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti për ofrimin e shërbimeve shoqërore për shtetasit në nevojë. Procedurat e ndjekura për dhënien e granteve nga Bashkia Shkodër ndaj organizatave të shoqërisë civile janë: transfertë, prokurim me vlerë të vogël dhe aktivitete artistike si dhe rastet e perjashtimit nga detyrimet tarifore.

Vetëm gjatë 3 viteve të fundit të bashkëpunimit edhe në kuadër të mbështetjes së BE përmes metodologjisë ReLoad Bashkia Shkodër ka kryer shërbime publike në një partneritet të ngushtë me organizatat, duke mbështetur kështu me grante me një vlerë totale prej 74,3 milion lekë. Bashkia Shkodër ka përjetësuar në aktivitetin e saj rreth 15 marrëveshje në vit, me qëllim realizimin e shërbimeve në fusha të ndryshme si shërbimi social, zhvillimi ekonomik, turizmi, kultura, mjedisi, etj.

- **Rrjeti ujësjetel kanalizime**

Përgjatë këtyre 5 viteve Bashkia Shkodër ka investuar me fondet e saj dhe përmes asistencës teknike të bashkëpunimeve me KfW dhe SECO, GIZ dhe BE, në përmirësimin e rrjetit të ujësjetel kanalizime, duke integruar në një rrjet të vetëm edhe fshatra apo zona informale të qytetit. Bashkia Shkodër dhe territori i bashkisë ka veçori për sa i përket rrjetit të ujësjetel dhe kanalizimeve, duke marrë parasysh këtu shtrirjen territoriale që ka nga alpet në Veri - në bregdetin e Velipojës, duke përfshirë këtu edhe liqenin e Shkodrës, lumin Buna e Drin. Këto veçori territoriale kanë kërkuar edhe studime dhe plane të detajuara për ndërhyrjet, si dhe për masat që duhen marrë për përmirësimin e rrjetit. Për sa i përket rrjetit të kanalizimeve dhe

impianteve të përpunimit të ujrave të zeza, Bashkia Shkodër ka në funksionim dy impiante të depurimit të ujrave të zeza: për fshatin turistik bregdetar Velipojë si dhe fshatin Shirokë pranë liqenit të Shkodrës.

- **Projektimi, përmirësimi i kushteve të qendrave shëndetësore parësore në territor dhe mirë administrimit të infrastrukturës së ndërtuar**

Punë është bërë në drejtim të krijimit të kushteve të përshtatshme për komunitetin për marrjen e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor. Vlerësimi i kushteve infrastrukturore të qendrave shëndetësore, ristrukturimi i tyre dhe planifikimi e projektimi i ndërhyrjeve ka qënë prioritare për Bashkinë Shkodër. Bashkia e Shkodrës tashmë ka krijuar një database të qendrave shëndetësore parësore të gatshme, me të dhënat aktuale dhe nevojat për ndërhyrje.

- **Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete sportive dhe zhvillimit të sportit në komunitet**

Organizim i përvitshëm i aktiviteteve sportive dhe zhvillimi i sportit në komunitet ku të rinjtë dhe të rejtat e Shkodrës, shoqatat e klubet sportive nga vendi ose nga rajoni kanë garuar në mes tyre duke zhvilluar traditën.

- **Ruajtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore**

Gjallërimi i jetës kulturore nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve artistike dhe kulturore përgjatë gjithë vitit. Për vitin 2020 ka patur një reduktim të numrit të aktiviteteve kulturore të miratuara nga bashkia për promovimin e kulturës së zonës dhe kulturës kombëtaresi rrjedhojë e situatës COVID-19..

- **Ofrimit të shërbimeve cilësore për zhvillimin e procesit mesimor;**

Sigurimi i mjediseve dhe objekteve cilësore për zhvillimin e procesit mesimor në sistemin parauniversitar dhe parashkollor. Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar.

- **Vlerësimi i partnerëve për zhvillim**

Komuniteti i donatorëve dhe agjensive zbatuese të projekteve për zhvillim kanë qënë një partner i rëndësishëm në menaxhimin e sfidave administrative, ekonomike, sociale, mjedisore të territorit tonë.

Shkodra dhe komuniteti i saj, si një qender e rëndësishme e trashëgimisë dhe përfaqësimit të vlerave kombëtare, por edhe në raportin e marrëdhënieve me mikun, vlerëson dhe respekton kontributet dhe vlerat që vendet partnere kanë transferuar dhe përçuar nëpërmjet projekteve të zhvillimit, si nëpërmjet përthithjes dhe përdorimit afatgjatë të tyre, por edhe nëpërmjet përforcimit të ndjenjës së miqësisë dhe respektit për vendet dhe insitucionet mike. Kështu vleresojmë bashkëpunimin me mjaft vendet evropiane dhe SHBA, duke filluar nga organizmat si Komuniteti European, OSBE, USAID, UNDP, Banka Boterore dhe banka të tjera evropiane për zhvillim, dhe shtetet mike si: Gjermania, Italia, Austria, Zvicra, Britania e Madhe, Spanja, Norvegjia, Holanda, Suedia, Danimarka, Hungaria etj.

Shembuj bashkëpunim:

- a) *Modeli i krijimit të agrobiznesit me USAID e cila ka për qëllim mbështetjen e sipërmarresit me mjetet e nevojshme për të nxitur risinë, krijuar vende pune dhe ndërtuar ekonomi të zhvilluara.*

- b) *Bashkia Shkoder ka qënë e angazhuar maksimalisht me KfW, SECO si dhe të tjerë partner që kanë kontribuar në përmirësimin e rrjetit ujësjelles kanalizime. Marrëveshja për financimin e zgjerimit të rrjetit KUZ dhe të ujit të pijshëm në qytetin e Shkodrës dhe Rrethina, për financimin e impiantit të ujërave të zeza për qytetin, është ndër arritjet më të mëdha të këtij mandati qeverisës vendor.*
- c) *Bashkëpunimi me BERZH për projektin e Zhvillimit dhe Investimeve në bregun perëndimor të liqenit Shkodër.*
- d) *Anëtarësimi në forumin e qyteteve që lagen nga deti Adriatik dhe Jon, FAIC*
- e) *Bashkëpunimi me Hungarian Eatertechnology Cooperation për çështje që kanë të bëjnë me ujësjellës kanalizime.*
- f) *Bashkëpunimi me Bashkinë e Strasburgut, pjesë e rrjetit europian të solidaritetit - Klubi i Strasburgut në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.*
- g) *Bashkëpunimi me Bashkinë e Triestes në kuadër të projektit Yes Future.*
- h) *Bashkëpunimi me rajonin Emilia Romagna në kuadër të projektit DEAR.*
- i) *Bashkëpunimi me rajonin Friuli Venezia Giulia për liqenin e Shkodres, etj.*

Realizimi i buxhetit të vitit 2020

Realizimi i buxhetit të vitit 2020, është bërë, duke respektuar nenin 64 të ligjit 139/2015 “ Per veteqeverisjen vendore “, i ndryshuar, ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 “ Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar , ligjin nr 68/2017 date 27.4.2017 “ Per financat e veteqeverisjes vendore “, ligjin nr. 10296 date 8.7.2010 “Per menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, ligjin 88/2019 datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22 date 30.07.2018 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njesive të qeverisjes vendore”, nr. 9 date 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”; nr. 2 datë 20.01.2020 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”; dhe VKB nr.26 dt 30.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2020 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2020-2022 të Bashkisë Shkodër” të ndryshuar .

Bashkia Shkoder, administron dhe menaxhon fondet, sipas programeve të miratuara, si më poshtë:

Funksioni 1 SHËRBIME TË PËRGJITHSHME PUBLIKE

Programi - 01110: Planifikim menaxhim administrim

Programi - 01170: Gjendja civile

Funksioni 3 RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE

Programi - 03140: Sherbimet policise vendore

Programi - 03280: Mbrojtje nga zjarri dhe mbrojtja civile”

Funksioni 4 ÇESHTJE EKONOMIKE

Programi - 04130: Mbeshtetje për zhvillim ekonomik

Programi - 04160: Sherbimet e tregjeve, akreditimi dhe inspektimi

Programi - 04220: Sherbimet bujqesore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatorit

Programi - 04240: Menaxhimi i infrastruktures se ujitjes dhe kullimit

Programi - 04260: Administrimi i pyjeve dhe kullotave

Programi - 04520: Rrjeti rrugor rural

Programi - 04570: Transporti publik

Programi - 04760: Zhvillimi i turizmit

Funksioni 5 MBROJTJA E MJEDISIT

Programi - 05100: Menaxhimi i mbetjeve

Programi - 05200: Menaxhimi i Ujrvetezeza dhe kanalizimeve

Programi - 05320: Programet e mbrojtjes se mjedisit

Programi - 05630: Ndergjegjesimi mjedisor

Funksioni 6 STREHIMI DHE KOMODITETET E KOMUNITETIT

Programi - 06140: Planifikim urban vendor

Programi - 06260: Sherbimet Publike vendore

Programi - 06330: Furnizimi me uje

Programi - 06440: Ndricim rruges

Funksioni 7 SHENDETESIA

Programi - 07220: Sherbimet e kujdesit paresor

Funksioni 8 ARGETIMI KULTURA DHE FEJA

Programi - 08130: Sport dhe argetim

Programi - 08220: Trashegimia kulturore, eventetartistike dhe kulturore

Funksioni 9 ARSIMI

Programi - 09120: Arsimi baze perfshire arsimi parashkollor

Programi - 09230: Arsimi i mesem i pergjithshem

Programi - 09240: Arsimi profesional

Funksioni 10 MBROJTJA SOCIALE

Programi - 10140: Kujdesi social per personat e semure dhe me aftesitekufizuara

Programi - 10430: Kujdesi social per familjet dhe femijet

Programi - 10661: Strehimi social

Burimet e financimit te buxhetit të Bashkisë, vijnë nga dy burime:

Nga burimet e veta vendore, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, te ardhurat nga tarifat vendore, te ardhura te tjera, donacione, grante nderkombetare dhe te ardhura qe trashegohen.

Nga burimet qendrore, ku përfshihen transferta e pakushtëzuar, transferta e pakushtëzuar sektoriale për funksionet e transferuara dhe transferta e kushtëzuar.

Buxheti i vitit 2020 , ne total ne 000/leke me te gjitha burimet e financimit te realizuara, paraqitet si me poshte:

Nr	TE HYRAT DHE FINANCIMET	Financim i planifikuar ne fillim te vitit	Financim i planifikuar i korrigjuar	Financim i realizuar	Diferenca
I	TE ARDHURAT E VETA	816,621	795,759	659,020	-136,739
1	Të ardhura nga taksat vendore	397,063	397,063	233,917	-163,146
2	Të ardhura nga taksat e ndara	89,735	89,735	126,722	36,987
3	Te ardhura nga tarifat vendore	312,635	289,439	274,154	-15,285
4	Të ardhura të tjera	17,188	19,522	24,227	4,705
II	GRANTE NDERKOMBETARE	758	758	758	0
III	TRANSFERTAT	2,077,343	2,155,355	2,155,355	0
1	Transferte e Pakushtezuar	648,181	648,181	648,181	0
2	Transferte e Pakushtezuar Sektoriale	373,193	373,193	373,193	0
3	Transferte e kushtezuar	1,055,969	1,133,981	1,133,981	0
IV	TE TRASHEGUARA	74,596	246,395	246,395	0
1	Transferte e pakushtezuar	30450	42041	42041	0
2	Transferte Specifike				0
3	Te ardhura	43,099	203,307	203,307	0
4	Donacione	1,047	1,047	1,047	0
	TOTALI	2,969,318	3,198,267	3,061,528	-136,739
	Grante Nderkombetare me llogari jashte thesari		10,815	10,815	0
	TOTALI VITI 2020	2,969,318	3,209,082	3,072,343	-136,739
1	Transferte e pakushtezuar	144,508	132,917	132,917	0
2	Transferte Specifike	46,441	46,441	46,441	0
4	Te ardhura	455,987	284,514	284,514	0
5	Donacione	9,273	9,273	9,273	0
	TE TRASHEGUARA	656,209	473,145	473,145	0
	TOTALI	3,625,527	3,682,226	3,545,488	-136,739

Realizimi i te ardhurave te Bashkisë nga burimet e veta vendore për vitin 2020.

Të ardhurat e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, te ardhurat te tjera, donacione, sponsorizime dhe grante ndërkombetare me skemë të plotë thesari.

Në ndryshim nga vitet e mëparshme, viti 2020 ishte një vit i cili për shkak të pandemisë COVID-19 që përfshiu të gjithë globin, krijoi problematika të mëdha në financa, në zhvillim ekonomikor dhe në jetët e humbura.

Bashkia Shkodër, si çdo njësi tjetër vendore dhe institucion publik i Republikës së Shqipërisë, u gjend në këtë situatë të jashtëzakoshme të pandodhur më parë, që në muajt e parë të vitit 2020.

Në kuadër të masave të marra për përballimin e situates së krijuar nga shfaqja e rasteve të para me corona virus në Shqipëri, Kryetari i Bashkisë Shkodër në mbështetje të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar pika II neni 8, ushtrimi i autoritetit në interes publik vendor, të ligjit 15/2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive" si dhe në zbatim të urdhërave të Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.132, datë 8.3.2020, “Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura” dhe Urdhëravetë Ministrin të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.156, datë 10.3.2020, “Përmarrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, nxori urdhërin me nr.230 datë 09.03.2020 “Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike, anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura, mbylljen e institucioneve arsimore dhe parandalimin e përhapjes së COVID-19”

Me VKM nr.243, datë 24.3.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore” u shpall gjendja e fatkeqësisë natyrore në Shqipëri, Vendim i Kuvendit nr. 18/2020, datë 23.4.2020 Për dhënien e pëlqimit për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, Akt normativ Nr. 11, datë 27.3.2020 për një shtesë në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, “Pë sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, Akt normativ Nr.10, datë 26.3.2020 për një ndryshim në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, VKB nr.16, datë 3.4.2020 “Për miratim rezolute”, Bashkia Shkodër propozoi pranë Këshillit Bashkiak , Projekt-Vendimin “Për disa ndryshime në VKB Nr.1 datë 22.01.2016 “për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Shkodër, të ndryshuar, në kushtet e krijuara nga pandemina Covid-19:

Ky projekt vendim, edhe pas ndryshimeve të propozuara nga ana e këshilltarëve, u miratua nga Këshilli Bashkiak Shkodër, me Vendimin nr.25, datë 26.06.2020.

Në këtë VKB u vendos:

1. Të përjashtohen nga tarifat vendore (pastrim, gjelbërim, ndriçim publik), për një periudhë 3 mujore të vitit 2020, për të gjitha bizneset me xhiro vjetore deri në 14 milion lekë, ambulancat dhe OJF, në territorin e Bashkisë Shkodër dhe Njësitë Administrative.
2. Të përjashtohen nga tarifat vendore (pastrim, gjelbërim, ndriçim publik), për një periudhë 3 mujore të vitit 2020, kategoritë si më poshtë vijon:
 - Invalidët e punës, të verbërit, të sëmurët paraplegjik dhe tetraplegjik (kryefamiljarë) pa persona madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit/bashkëshortes.

- Kryefamiljarëpensionistë pa persona madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit/bashkëshortes)
 - Kryefamiljarët gra, me minimumi një fëmijë në ngarkim (nën 22 vjeç) në territorin e Bashkisë Shkodër dhe Njësitë Administrative
3. Shtyerjen e afatit të pagesave të taksave dhe tarifave vendore deri me datë 30 tetor 2020, për të gjitha kategoritë e taksapaguesve

Në vijim të VKB nr 25, datë 26.06.2020, “Për disa ndryshime në VKB nr.1, datë 22.01.2016 “Për taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër”tëndryshuar”dhe VKB nr. 32 datë 30.7.2020 “Për një ndryshim në VKB nr.26 datë 30.12.2019për miratimin e buxhetit të vitit 2020 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2020-2022 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar, u ndryshua edhe plani i të ardhurave duke u pakësuar në shumën **23,196 mijë lekë**,sipas tabelës si më poshtme:

TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE	Plani fillestar 2020	Efektifinanciar sipas VKB 25, dt.26.6.2020	Plani i korrigjuar 2020
Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave	167,867	16,915	150,952
Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Familje	73,692	4,902	68,790
Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Institucione	512	0	512
Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Biznesi	93,663	12,013	81,650
Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik	39,443	3,680	35,763
Të ardhura nga tarifë për ndriçimin publik nga Familje	23,879	1,668	22,211
Të ardhura nga tarifë ndriçimi publik nga Institucione	125	0	125
Të ardhura nga tarifë ndriçimi publik nga Biznesi	15,439	2,012	13,427
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin	21,648	2,601	19,047
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga Familje	9,536	774	8,762
Të ardhura nga tarifë gjelbrimi nga Institucione	160	0	160
Të ardhura nga tarifë gjelbrimi nga Biznesi	11,952	1,827	10,125
TOTAL	228,958	23,196	205,762

Pavarësisht situatës së vështirë të krujuar nga pandemia COVID-19, Bashkia Shkodër me burimet e veta arriti të menaxhojë situatën dhe të ofrojë shërbimet e duhura ndaj qytetarëve në gjithë territorin e saj.

Kategorizimi i të ardhurave

- Taksat vendore:
 - Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, për ndërtesa, troje dhe toka bujqësore
 - Taksa e ndikimit në infrastrukturë
 - Taksa e fjetjes në hotel
 - Tatimi thjeshtuar mbi fitimin, biznesi vogël nga 5-8 milion, agjent DRT Shkodër
 - Taksa e tabelës për qëllime reklamimi ose identifikimi
- Taksat e ndara:

- Taksa vjetore e e qarkullimit te mjeteve
 - Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë, agjent tatimor ASHK
 - Taksa e rentës minerare
 - Tatimi mbi të ardhurat personale
- Tarifat vendore
- Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave
 - Tarifa për ndriçimin publik
 - Tarifa për gjelbrimin
 - Tarifa të shërbimit administrativ
 - Tarifa për parkimin e mjeteve e liçensuara dhe vendparkime publike
 - Tarifat e shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri
 - Tarifa për zënien e hapësirave publike
 - Tarifa të institucioneve të arsimit, kultures, sportit, etj
- Të ardhura të tjera:
- Të ardhura nga Institucionet e arsimit, kulturës, sportit etj.
 - Të ardhura nga kundravajtjet administrative
 - Të ardhura nga dhënia me qira e asetëve
 - Të ardhura nga sekuestre dhe zhdëmtime
 - Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e shërbimeve
 - Grante nga ndihma nderkombetare
 - Te ardhura nga donacione/sponsorizime
 - Të ardhura te tjera (komision si agjent tatimor).

Realizimi i të ardhurave vendore

Të ardhurat nga Burimet e Veta Vendore	/mijë lekë	Plan	Fakt
Të ardhura nga taksat		397,063	233,917
Të ardhura nga taksat e ndara		89,735	126,722
Të ardhura nga tarifat		289,439	274,154
Të ardhura nga burime të tjera vendore		20,280	24,985
Totali		796,517	659,778

Sistemim asfaltim rruga Drini në Zues- Zbatim, supervizim, kolaudim	3,196	2,173
Sistemim - Asfaltim i rruges Vukatanë – Guri i Kuq, (Loti 1).- Zbatim, supervizim, kolaudim	969	703
Investime ne bashkefinancim me Fondin Shqiptar te Zhvillimit (FSHZH) dhe Fondin e Zhvillimit te Rajoneve (FZHR)	6,131	30
Supervizim Rr.Pjeter Gjoka	11	-
Rrjeti rrugor rural/Investime	425,881	243,269
F.V Kufizues shpejtesie (bumpe gome)	2,100	1,690
Permiresim i sinjalistikes rrugore horizontale dhe vertikale	8,411	-
Blerje material per sinjalistike ujore	800	-
Transporti publik/investime	11,311	1,690
Rikualifikim urban I sheshit ne fshatin Zogaj	900	567
Zhvillimi i turizmit /Projekte	900	567
Blerje kazanesh etj	7,500	7,176
Ndertim xhepa kazanesh	500	459
Menaxhimi mbetjeve	8,000	7,635
Pergatitja e PDV per zonat e parashikuara ne PPV	1,668	-
Projektim, rivleresimi, realizimi dhe monitorimi I Sistemit te Adresave Bashkia Shkoder	500	-
Planifikimi Urban/Projekte	2,168	-
Rikonstruksion I godinave ne pronesi te njesive te veteqeverisjes vendore per strehim social(ndertim I ri,godina sociale,me kontenier 1+1 dhe 2+1)- Zbatim	14,978	9,456
Strehimi	14,978	9,456
Ndertim parcela te reja	4,000	4,000
Sherbime publike vendore/ investime	4,000	4,000
Investim ndricim rruge dytesore+mbikqyrje+kolaudim	8,000	7,738
Zevendesimi shtyllash zinkat, ndricuesve te demtuar zinkat dhe I kapakeve te shtyllave	1,800	1,762
Investim ndricim rruge kryesore	8,000	7,816

Ndricim rruges /Investime	17,800	17,316
Rikonstruksion I godines Kopshti Guerile	2,609	2,577
Arsimi baze perfshire arsimin parashkollor	2,609	2,577
Rikonstruksion I objektit te ish shkolles veterinare- Projektim	950	949
Arsimi profesional/Projekte	950	949
Kolaudim Rik.Shk Skenderbeg	22	-
Supervizim shk.Skenderbeg	182	-
Rikonstruksion I objektit te ish shkolles veterinare	14,050	-
Arsimi profesional/Investime	14,254	-
Rehabilitim dhe ndertim I kendeve te lojrave ne parqet dhe lulishtet	317	317
Kujdesi social per familjet dhe femijet/investime	317	317
Rikonstruksion I godinave ne pronesi te njesive te veteqeverisjes vendore per strehim social(Rikonstruksion I ish konviktit te shkolles veterinare)	19,035	5
Strehimi social	19,035	5
TOTALI Bashkia Qender me burimet e veta	588,339	317,308
Modelimi I qyteteve te drejta-Integrimi I Axhendes 2030brenda politikave ne kohen e flukseve te medha te migrimit dhe refugjateve,udhehequr dhe zbatuar nga autoritetet lokale, CSO-LOA/2017/388-138	1,127	460
Kujdesi social per familjet dhe femijet/Projekte/Donator	1,127	460
Implementimi i dokumentacionit te integruar te qenderzuar per te gjithë bashkine Shkoder ne platformen Microsoft 365,Azure Active Directory dhe Mail Server bazuar ne Cloud	50	-
Programi Planifikim Menaxhim Administrim/Donator	50	-
Zbatimi i projekteve teknike per mbrojtjen e tokes bujqesore nga erozioni	174	-
Programi Menaxhimi i infrastruktures se kullimit dhe ujitjes/Investime	174	-
Modelimi I qyteteve te drejta-Integrimi I Axhendes 2030brenda politikave ne kohen e flukseve te medha te migrimit dhe refugjateve,udhehequr dhe zbatuar nga autoritetet lokale, CSO-LOA/2017/388-138	185	-
Rehabilitim dhe ndertim I kendeve te lojrave ne parqet dhe lulishtet	1,265	1,265
Blerje pajisje TIK	95	94
Kujdesi social per familjet dhe femijet/Projekte/Donator	1,545	1,359
Zbatimi i projektit sipas specifikave te programit Horizon 2020, marreveshjes grant nr 769072 PARK4SUMP	1,811	42
Rrjeti rrugor rural/projekte/ Donator	1,811	42
Totali BASHKIA Qender me donator	4,707	1,861
Të tjera pajisje zyre	500	400

Blerje Pajisje TIK te Muzeut Historik, Vendin e Deshmise dhe Kujteses dhe DEK	110	98
Zhvillimi dhe pasurimi i fondit te biblotekes, blerje libra, revista dhe periodik.	1,125	829
Blerje dhe vendosje ndriçues në formë spoti I bardhë x 60 copë, shina spoti të bardha 65 m/l, bashkues këndor për shina 10 copë, Tel 2.5 30 m/l, Montim	300	223
Fshesë me korrent	20	14
Trashëgimi kulturore, evente artistike dhe kulturore /investime	2,055	1,565
TOTALI Drejtoria ekonomike e kulture	2,055	1,565
Instalim I ngrohjes qendrore ne shkollen "Ismail Qemali"- Projektim	356	356
Ndërtim fushe sportive shkolla 9-vjecare "Gjergj Vat Martini "- Nj.A Velipoje - Projektim	277	277
Rikonstruksion fasada shkolla Seit Tagani Trush- Projektim	60	57
Arsimi baze perfshire arsimin parashkollor/Projekte	693	690
Blerje pajisje orendi per mobilim	900	370
Blerje paisje operacionale	600	598
Blerje vegla pune (shtese)	577	177
Ndërtim fushe sportive shkolla 9-vjecare "Gjergj Vat Martini "- Nj.A Velipoje	7,754	5,488
Blerje pajisje sistemi sigurimit	400	210
Rikonstruksion fasada shkolla Seit Tagani Trush- Zbatim, Supervizim, Kolaudim	2,445	1,823
Arsimi baze perfshire arsimin parashkollor/Investime	12,676	8,665
Rikonstruksion I terraces se shkolles "Mehmet Shpendi" NJA Shale	136	136
Arsimi I mesem I pergjithshem /Projekte	136	136
Blerje pajisje orendi per mobilimin e klasave	2,178	2,178
Blerje paisje operac	206	200
Rikonstruksion shkolla e mesme "Jordan Misja"- faza e II	26,000	25,972
Blerje automjeti	2,500	-
Rikonstruksion I terraces se shkolles "Mehmet Shpendi" NJA Shale	4,318	-
Blerje pajisje sistemi sigurimit	400	360
Arsimi I mesem I pergjithshem /Investime	35,602	28,709
TOTALI Drejtoria Ekonomike e Arsimit	49,107	38,200
Blerje pajisje TIK	100	93
Blerje orendi dhe pajisje zyre	100	100
Instalime teknike, pajisje, instrumente dhe vegla pune	100	100

Blerje prozhektorë për ndriçimin e fushës së stërvitjes së Pallatit të Sportit "Qazim Dervishi"	100	94
Blerje pajisje pastrimi- fshesë me korent profesionale	70	70
Rikonstrukcion terren sportiv (salla e ndeshjeve lojëra me dorë 700 m2)	1,030	942
Sport dhe argetim	1,500	1,399
TOTALI Sportklub Vllaznia	1,500	1,399
Blerje pajisje orendi	500	425
Rikonstrukcion i pjesshëm i kopshtit" Haxhi Hajdari" Golem	3,000	2,359
Arsimi baze perfshire arsimin parashkollor/Investime	3,500	2,784
Blerje pajisje orendi	350	348
Kujdesi social per personat e semure dhe me aftesi te kufizuar	350	348
Totali Drejtoria Kopshte Cerdhe	3,850	3,132
Rikonstrukcion I rrjetit kryesor te ujesjellesit dhe ndertim I rrjetit te brendshem te ujesjellesit ne fshatrat	35,989	8,585
TOTALI Ndermarrja Ujesjelles Kanalizime Shkoder sh.a	35,989	8,585
Blerje Pajisje TIK	400	398
TOTALI Drejtoria MZSH- Programi Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	400	398
Blerje pompa sperkatje	300	167
Programi Menaxhimi i infrastruktures se kullimit dhe ujitjes	300	167
Blerje kamion per sherbimin pyjor	1,167	-
Administrimi i pyjeve dhe kullotave / Investime	1,167	-
Totali Drejt Sherb Bujqesore	1,467	167
TOTALI INVESTIMEVE	687,414	372,617

Transferta e pakushtezuar sektoriale

Risi e 4 viteve te fundit ishte transferimi i disa funksioneve me burim financimi transferten e pakushtezuar sektoriale.

Funksionet e reja, që u transferuan në Bashki ishin:

Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar

Në transfertën e pakushtezuar sektoriale të vitit 2020, janë akorduar fondet për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor si dhe fondet për personelin ndihmës të arsimit parauniversitar.

Për Arsimin parashkollor (kopshtet e fëmijëve, edukatorë dhe punonjësit mbështetës) në fillim të vitit janë alokuar 118 244 mijë lekë për paga dhe sigurime shoqërore.

Për punonjësit e shërbimeve mbështetëse në arsimin bazë, arsimin 9-vjeçar dhe Qendra kulturore e fëmijëve janë alokuar gjithsej 46 581 mijë lekë për paga dhe sigurime shoqërore.

Për punonjësit e shërbimeve mbështetëse në arsimin e mesëm, janë alokuar gjithsej 24 189 mijë lekë për paga dhe sigurime shoqërore.

Bashkia Shkoder, për të perballuar pagat dhe sigurimet shoqërore të këtij funksioni të ri, ka parashikuar që në fillim të vitit, fond edhe nga të ardhurat e bashkisë .

Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MNZSH)

Në transfertën specifike të vitit 2020, janë fondet për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin. Në këto fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Shuma e alokuar është 34 441 mijë lekë.

Rrugët rurale

Në transfertën e pakushtezuar sektoriale të vitit 2020, janë alokuar fondet për rrugët rurale të transferuara nga qarku në bashki. Për këtë funksion për vitin 2020 I janë akorduar 18 580 mijë lekë.

Administrimi i pyjeve

Në transfertën e pakushtezuar sektoriale të vitit 2020, janë planifikuar fondet për Shërbimin Pyjor. Në këtë fond përfshiheshin fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Për këtë funksion për vitin 2020 janë alokuar 10 372 mijë lekë.

Ujitja dhe Kullimi

Në transfertën e pakushtezuar sektoriale të vitit 2020, janë planifikuar fondet për ujitjen dhe kullimin. Në këtë fond përfshiheshin fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Për këtë funksion për vitin 2020 i janë alokuar 26 734 mijë lekë.

Konviktet e arsimit parauniversitar

Në transfertën e pakushtezuar sektoriale të vitit 2020, Bashkisë Shkodër i janë akorduar fonde për konviktet e arsimit parauniversitar. Në këtë transfertë janë të përfshira: fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës dhe edukator), shpenzimet operative dhe shpenzimet për investime. Fondi i alokuar për këtë funksion për vitin është 57 888 mijë lekë .

Qendrat e Shërbimeve Sociale


Në transfertën e pakushtezuar sektoriale të vitit 2020 të Bashkisë Shkodër i janë akorduar fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit dhe shpenzime operative për qendrën “Shpresa” Shkodër. Shuma e alokuar për këtë qendër është 36164 mijë lekë.

Realizimi i transfertes pakushtezuar sektoriale ne total per periudhen 12 M te viti 2020 paraqitet si me poshte:


PROGRAMI	TOTALI		Paga dhe sigurime		Shp.Operative		Transferime		000/leke Investime		Realizimi %	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt		
I I I	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	37,286	32,661	31,345	28,901	5,519	3,526	422	235	-	-	88%
I I	Menaxhimi i infrastruktures se kullimit dhe ujitjes	35,590	26,341	15,131	11,550	20,458	14,792	1	-	-	-	74%
I I I	Administrimi i Pyjeve dhe kullotave	16,497	8,703	13,711	6,847	2,779	1,856	8	-	-	-	53%
I V	Rrjeti rrugor rural	28,563	23,361	-	-	28,563	23,361	-	-	-	-	82%
V	Arsimi baze perfshire arsimin parashkollor	166,091	164,777	165,701	164,387	-	-	390	390	-	-	99%
V I	Arsimi parauniversitar (mesem-pergjithshem)	93,550	81,160	48,347	43,371	42,276	34,982	327	208	2,600	2,600	87%
V I I	Kujdesi social per personat e semure dhe me aftesi te kufizuara	42,055	41,046	-	-	860	-	41,195	41,046	-	-	98%
TOTALI		419,632	378,049	274,235	255,055	100,456	78,516	42,342	41,878	2,600	2,600	90%

Ne totalin e shpenzimeve me burim financimi transferten e pakushtezuar sektoriale realizimi ne total eshte 90.1 %. Jane realizuar pagat me rreth 93 %, shpenzimet operative me rreth 78.2 % dhe transferime me rreth 98.8 % dhe investimet ne 100 %.

Emertimi	Plani Korrigjuar	Likuidimi ne thesar	Realizimi ne %	Obligime me fature/kontrate	000/leke	
					Totali realizimit	Realizimi ne %
Paga dhe Sigurime	274,235	255,055	93.0%		255,055	93%
Shpenz.Operative	100,456	74,886	74.5%	3,630	78,516	78%
Transferime	42,342	39,915	94.3%	1,963	41,878	99%
Investime	2,600	100	3.8%	2,500	2,600	100%
Totali	419,633	369,956	88.2%	8,093	378,049	90%



Ne transferten specifike, peshen me te madhe specifike prej 67.5 %, e zene pagat e punonjesve.




Transferta e kushtëzuar

Transferta e kushtëzuar përbëhet nga fondet e deleguara për mbulimin e shërbimit të Gjendjes Civile, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, fondet për mbështetje me ndihmë ekonomike për familjet në nevojë dhe për personat me aftësi ndryshe, që zene edhe 88.3 % të totalit të transfertes së kushtëzuar të planifikuar dhe konkretisht në shumën 1 000 812 mijë leke , bursat e nxënësve konviktore të shkollave të mesme profesionale, ushqimi për fëmijët me aftësi ndryshe të shkollës “3 dhjetori” si dhe investime.

Realizimi i fondeve të alokuara nga transferata e kushtëzuar, paraqitet si më poshtë:

Emertimi	000/leke		
	Planifikuar sipas buxhetit 2020	Alokuar viti 2020	Fakti realizimit viti 2020
QKB- Shërbime të ofruara për bizneset, sipas sistemit të regjistrimit të biznesit	1,739	1,738	1,531
Gjendja civile- Akte të regjistruara dhe dokumente të leshuara	14,920	22,237	17,091
Trajtim ushqimor për konviktet dhe pagese kuote financiare (bursa)	4,978	13,715	10,350
Rikonstruksion i godinave në pronësi të njesive të veteqeverisjes për strehim social, Bashkia Shkoder	43,196	59,689	59,689
Akordimi i fondeve për Ndihmen Ekonomike	135,000	148,360	147,709
Akordimi i fondeve PAK	815,000	852,452	851,059
Trajtim ushqimor- Nxenes që regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm të lartë në institucionet arsimore publike	0	2,300	386
Trajtim ushqimor- Fëmijë në nevojë që përfitojnë shërbim arsimor çilesor	4,200	4,200	1,259
Projekti "Jeto me sportin", rikualifikim I terreneve sportive në shkollën "Oso Kuka", Bashkia Shkoder; "Ana Malit" Oblike; dhe "At Gjon Kama" Guri Zi	3,229	3,229	3,229
Shpronësime	0	18,853	10,116
Emergjencja civile. Minimizimi i riskut Dhenie fondi financiar familjeve, banesat e të cilëve janë demtuar nga fatkeqësi të ndryshme	33,707	7,209	7,033
TOTALI	1,055,969	1,133,980	1,109,451

Realizimi i shpenzimeve me burim financimi transferatën e kushtëzuar në total është 97.84 %. Shpenzimet për paga janë realizuar në masën 98.33 % , shpenzimet operative janë realizuar 30.04 % , transferatat me 99.16 % dhe investimet 89.32 % .



Ne transferten e kushtezuar , peshen me te madhe specifike prej 90 %, e zene transferimet kryesisht fondi i ardhur per pagesen e ndihmes ekonomike, paaftesise dhe invaliditeti




Shpenzimet nga fondet e trashguara


Shpenzimet e trashguara ne 12 M te vitit 2020 jane realizuar ne shumen 185 675 mije leke.

000/leke

Emertimi	Plani Korrigjuar	Likuidimi ne thesar	Realizimi ne %	Obligime me fature/kontrate	Totali realizimit	Realizimi ne %
Paga dhe Sigurime	101,701	12,693	12.48%		12,693	12.48%
Shpenz.Operative	135,169	54,081	40.01%	25,792	79,873	59.1%
Subvencione	15,000	10,000			10,000	66.7%
Transferime	25,057	10,058	40.14%	3,734	13,792	55.0%
Investime	196,219	98,843	50.37%	68,719	167,562	85.4%
Totali	473,146	185,675	39.24%	98,245	283,920	60.0%



Perqindjen me te larte te realizimit te shpenzimeve te trashguara e ze zeri investime me 85.4 % realizim .



Detyrimet e prapambetura

Udhëzimi i Ministrise se Financave dhe Ekonomise nr.37, datë 06.10.2020, “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, “Detyrime të prapambetura ndaj palëve të treta”, nënkupton të gjitha llojet e detyrimeve financiare të NJVQV-ve, të pa paguara brenda 60 ditëve kalendarike (30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit e procesimit të pagesës në degën e thesarit) nga data e pagesës së specifikuar në kontrate, faturë ose sipas ligjit.

Bashkia Shkodër me shkresën nr 1786/1, datë 25.02.2021, ka raportuar për stokun e detyrimeve të prapambetura dhe ka vetëm një vlerë prej 3,199, 930 lekë stok të regjistruar në sistemin informatik të qeverisë, i cili është likuiduar në fillim të vitit 2021.

Raporti i kësaj shume mbi totalin e shpenzimeve rezulton të jetë 0.19%.

Sipas ligjit nr. 68, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, janë katër nivele të ndryshme të rasteve të vështirësive financiare të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Bashkia Shkodër është bashki që nuk ka detyrime, e ka nivelin e stokut të paperfillshem dhe është në gjendje shumë të mirë financiare.

Bashkia Shkoder

Rasti i vështirësisë ku ndodhet njësia e vetëqeverisjes vendore				
	Probleme financiare	Vështirësi financiare	Vështirësi serioze financiare	Pa aftësi paguese
Situata Normale e gjendjes fiannciare	Stoku i detyrimeve/Shpenzime > 15%	Stoku i detyrimeve/Shpenzime > 25%	Stoku i borxhit afatgjat dhe detyrimeve/Shpenzime > 80%	Stoku i borxhit afatgjat dhe detyrimeve/Shpenzime > 130%
Situata Normale e gjendjes financiare	0	0	0	0

FUNKSIONI 1: SHËRBIME TË PËRGJITHSHME PUBLIKE

Programi 01110: Planifikim, menaxhim dhe administrim

Ky program përfshin institucione dhe konkretisht:

1. Aparatin e Bashkisë
2. Gjendja Civile

Realizimi i qëllimeve dhe objektivave të politikës së programit

Qëllimi i programit të Planifikimit, Menaxhimit dhe Administrimit për Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse është:

I. Strukturë menaxhuese cilësore, duke krijuar mundësinë dhe lehtësinë për perthithjen e burimeve njerëzore profesionale dhe në funksion të zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

II. Përfshirja e qytetarëve, grupeve të interesit, komunitetit në përgjithësi, në proceset vendimmarrëse me qëllim krijimin ose përmirësimin e politikave publike, procedurave dhe praktikave lokale në favor të krijimit mirëqenies së qytetarëve.

III. Dixhitalizmi i administratës publike. Shtimi dhe promovimi i shërbimeve elektronike për qytetarët, biznesin dhe administratën. Rritja e transparencës dhe përmirësimi i shërbimeve në administratën publike vendore, ku qytetarët të kenë mundësinë që të aplikojnë dhe përfitojnë shërbimin në çdo Njësi Administrative, lagje dhe Bashki qendër dhe përmes web-it për të gjitha shërbimet që sot ofrohen nga Bashkia e Shkodrës.

Objektivat e programit buxhetor për 12 mujorin 2020 kanë qenë:

01. Organe përfaqësuese vendore të mbështetura për funksionimin e tyre.

02. Burime Njerëzore të trajnuara dhe të kualifikuara për kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësi.

03. Shërbimet mbështetëse për administratën vendore, sigurimi, planifikimi e zhvillimi të njësisë, menaxhimin e financave të administratës vendore dhe të burimeve njerëzore, funksionimin e proceseve të përgjithshme të brendshme dhe komunikimin me publikun.

04. Përbushje detyrimesh për ndjekje dhe përfaqësim procese gjyqësore, shlyerje e detyrimesh që rrjedhin nga vendime gjyqësore të formës së prerë. Rregjistrim i pronave të transferuara me VKM për transferimin në pronësi ose përdorim të pronave të paluajtshme publike, shtetërore dhe rregjistrim pronave që fitohen nga shpronësimet si edhe zbatimi i ligjit për transferimin e komisionit për agjentin tatimor.

Në këtë program buxhetor Bashkia planifikon shpenzime buxhetore për zhvillimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme për personelin, shërbime të përgjithme publike, si: shërbimet e prokurimit, mbajtja dhe ruajtja e dokumenteve dhe arkivave të njësisë, ndërtesave në pronësi apo të zëna nga njësi, zyrave të printimit dhe IT etj, shpenzime për ofrimin e shërbimeve që

mbështesin veprimtarinë e kryetarit, këshillit dhe komisioneve të këshillit, bazat e të dhënave vendore apo shërbime që lidhen me prodhimin dhe përhapjen e informacionit publik.

O1. Organe përfaqësuese vendore të mbështetura për funksionimin e tyre.

- *Mbështetje për funksionimin e organeve të zgjedhura vendore (Këshilli i Bashkisë dhe Kryetarët e fshatrave).* Është realizuar shpërblimi në mënyrë korrekte dhe në kohë i anëtarëve të Këshillit bashkiak dhe kryetarëve të fshatrave të Njësive Administrative në përmbushje të funksioneve që ata kryejnë. Është përmirësuar komunikimi me qytetarët, rritja e përfshirjes së tyre në vendimmarrje dhe matja e performancës së kryerjes së detyrave dhe funksioneve të këshillit bashkiak.

- *Anëtarësimi në Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë.* Është realizuar pagesa në mënyrë korrekte dhe në kohë i kuotizacionit vjetor për arësye të mbrojtjes së interesave të përbashkëta të Bashkive të Shqipërisë, me qëllim decentralizimin dhe demokratizimin e vërtetë të qeverisjes sipas parimeve të Kartës Europiane të Autonomisë Vendor.

- *Kuota e anëtarësisë për financimin e buxhetit të Këshillit të qarkut .* Është realizuar pagesa e kuotës së anëtarësisë për financimin e buxhetit të qarkut në zbatim të nenit 38, të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

O2. Burime Njerëzore të trajnuara dhe të kualifikuara për kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësi.

Për të përmirësuar punën e stafit të bashkisë një ndër detyrat kryesore është edhe *rekrutimi i burimeve njerëzore* me punonjës të kualifikuar për përmbushje detyrave dhe funksioneve përkatëse të çdo pozicioni të lirë pune në mënyrë transparente, me profesionalizëm dhe në bazë të meritave, aftësive profesionale, pavarësisë dhe integritetit, vazhdimësisë së karrierës, përgjegjësisë dhe korrektesës në zbatimin e ligjeve.

Kjo procedurë është realizuar përmes konkursit të hapur në zbatim të Ligjit Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Për krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional dhe efficient, ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore (planifikuese dhe menaxhuese) një ndër detyrat kryesore është edhe trajnimi i punonjësve në përputhje me ligjin në fuqi.

Në kuadër të trajnimeve për punonjësit e qeverisjes vendore nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASP), e cila njihet me ligj si autoriteti i vetëm për dhënien e trajnimeve të njohura dhe të certifikuara për këtë grup. Të gjitha veprimtaritë trajnuese për njësitë e qeverisjes vendore duhet të kalojnë përmes ASPA.

Për vitin 2020 për shkak të Covid-19, të gjitha trajnimet janë zhvilluar on line nga ASPA. Punonjësit i kanë zhvilluar këto trajnime sipas një kalendari trajnimesh dhe sipas konfirmimeve të eprorëve. Trajnimet në të cilat punonjësit kanë marrë pjesë lidhen me trajnime profesionale nga ASPA, trajnimet nga ofrues të tjerë si Projekti Bashkitë për Evropën; UNDP Albania; Giz Albania; Ambasada Suedeze, etj

Një ndër synimet kryesore e këtij programi është edhe *rritja e qëndrueshmërisë së administratës civile* duke siguruar shpenzime efikase për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore të nëpunësve të administratës vendore. Është realizuar shpërblimi në mënyrë sistematike dhe korrekte për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore të administratës vendore në mbështetje të përmbushjes së detyrave dhe funksioneve me profesionalizëm, korrektësi dhe transparencë.

O3. Shërbimet mbështetëse për administratën vendore, sigurimi, planifikimi e zhvillimi të njësisë, menaxhimin e financave të administratës vendore dhe të burimeve njerëzore, funksionimin e proceseve të përgjithshme të brendshme dhe komunikimin me publikun.

Janë krijuar kushte normale pune dhe në përmirësim të vazhdueshëm për administratën në funksion të rritjes së performancës së saj në ofrimin e shërbimit ndaj qytetarit. Është realizuar sigurimi i shërbimeve bazë (ujë, energji elektrike, ngrohje, komunikim postar, shërbime te printimit dhe publikime në media), furnizimi i vazhdueshëm me kancelari, letër dhe bojë për printera, fotokopje dhe shtypshkrime për punonjësit për përmbushje të kushteve fizike normale për administratën vendore gjatë kryerjes së funksioneve dhe detyrave të tyre të përditshme . Janë përmirësuar kushtet e punës për punonjësit e shërbimit të pastrimit, nëpërmjet sigurimit të vazhdueshëm me materialet bazë të pastrimit. Është siguruar mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit duke realizuar vlerësimin e gjendjes teknike të mjeteve të transportit në serviset e licensuara dhe përcaktimi i mjeteve, që duhet të riparohen dhe të kthehen apo të mbahen në gjendje pune, si dhe përcaktimi i mjeteve që duhet të nxirren jashtë përdorimit nga komisioni. Është realizuar identifikimi i nevojave për karburant, pjesë këmbimi dhe nevojat për shërbimin e mirëmbajtjes së këtyre automjeteve, përgatitja e preventivave dhe dokumentacioneve përkatëse të nevojshme për prokurim. Janë zbatuar procedurat e prokurimit sipas specifikimeve teknike të paracaktuara dhe më pas monitorimi i këtyre shpenzimeve. Gjithashtu është realizuar blerja e karburantit, shërbimi i mirëmbajtjes të mjeteve të transportit, pagesa në afate e siguracioneve, taksave të qarkullimit dhe kolaudit të automjeteve etj.

Është realizuar mbështetja me paisje funksionale zyre, mirëmbajtja e objekteve ndërtimore administrative, sigurimi i ndërtesave dhe inventarit të tyre ekonomik, lyerja e ambjenteve të punës sipas kërkesave në godinën qendër dhe Nj.A, shërbimii mbrojtjes nga zjarri i ambjenteve duke siguruar rimbushjen e fikëseve të zjarrit, organizimi i pritje përcjelljeve për aktivitete të organizuara nga Bashkia Shkodër për blerje dhurata, kafe etj.

Është bërë i mundur aksesin në internet për Bashkinë qendër, Njësitë Administrative, 5 Lagjet dhe Qendrat Komunitare, pajisje TIK multifunksionale të mirëmbajtura, informimi i qytetarëve përmes mediave vizive për përfitimin e shërbimeve nga Bashkia Shkodër

O4. Përmbushje detyrimesh për ndjekje dhe përfaqësim procese gjyqësore, shlyerje detyrimesh që rrjedhin nga vendime gjyqësore të formës së prerë. Rregjistrim i pronave të transferuara me VKM për transferimin në pronësi ose përdorim të pronave të paluajtshme publike, shtetërore dhe

rregjistrim i pronave qe fitohen nga shpronësimet si edhe zbatimi i ligjit për transferimin e komisionit për agjentin tatimor.

Janë zbatuar me rigorozitet dispozitat ligjore në fuqi, sa i takon ndjekjes së të gjitha shkallëve të gjyqimit për të gjithë proceset gjyqësore me efekte financiare, është realizuar përgatitja e dokumentacionit për regjistrim për pronat dhe dërgimi i dokumentacionit për aplikim në ASHK Shkodër për regjistrim.

Realizimi i të ardhurave të planifikuara në këtë program :

Realizim tarifë shërbimi administrativ (arkiv) Janar- Dhjetor 2020				mijë lekë
Nr	Llojet e te ardhurave	Plani viti 2020	Realizimi viti 2020	% e realizimit
1	Tarifa të shërbimit administrativ (arkiv)	20	33	165%


Rezultatet e programit “ Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”

Programi P01110	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Transferta	Investime	Totali
Plani fillestar 2020	215,341	59,634	1,187	6,300	282,462
Plani i rishikuar 2020	215,194	59,634	1,394	6,300	282,462
Realizimi viti 2020	185,855	42,409	1,369	3,079	232,712
% e realizimit	86.3%	71.1%	98.2%	48.9%	82.3%

Realizimi i shpenzimeve korente dhe kapitale për këtë program,duke e krahasuar me planifikimin është në total 82.3%,sipas zërave kryesorë si më poshtë:

Shpenzimet e personelit	86.3%
Shpenzimet e tjera operative	71.1%
Shpenzimet kapitale	48.9%
Transferta	98.2%

Gjithsej 82.3%



Një nga faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara është situata e krijuar nga pandemia.

Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

Periudha e Raportimit: 01.01.2020-31.12.2020

Kodi i Programit	1110	Emertimi i programit:	Planifikim, Menaxhim, Administrim						Komente
Qelimi 1	Strukture menaxhuese cilësore, duke krijuar mundësinë dhe lehtësinë për perthithjen e burimeve njerëzore profesionale dhe në funksion të zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë së Shkodrës për orfrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.II. Përfshirja e qytetarëve, grupeve të interesit, komunitetit në përgjithësi, në proceset vendimmarrëse me qëllim krijimin ose përmirësimin e politikave publike, procedurave dhe praktikave lokale në favor të krijimit mirëqenies së qytetarëve. III. Dixhitalizimi i administratës publike do të jetë gjithmonë një nga prioritetet tona në kuadër të programit të administratës vendore. Shtimi dhe promovimi i shërbimeve elektronike për qytetarët, biznesin dhe administratën. Rritja e transparencës dhe përmirësimi i shërbimeve në administratën publike vendore ku qytetarët të kenë mundësinë që të aplikojnë dhe përfitojnë shërbimin në çdo Njësi Administrative, lagje dhe Bashki qendër dhe përmes web-it për të gjitha shërbimet që sot ofrohen nga Bashkia e Shkodrës.							
**Treguesit e performancës/Produktet:								
Objektivat e politikës:		Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhës	Niveli i planifikuar ne vitin korent	Niveli i rishikuar ne vitin korent	Niveli faktik ne fund te vitit korent	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	
<i>Objektivi 1</i>	O1. Organe përfaqësuese vendore të mbështetura për funksionimin e tyre.	1	nr anëtarëve të këshillit vendor dhe nr kryepleqve të mbështetur për realizimin e funksioneve dhe përgjegjësiive ligjore. Vendimarrje bashkiake e konsultuar me publikun. Numri i konsultimeve të realizuara kundrejt totalit të vendimeve për të cilat konsultimi parashikohet me ligj (në %) Bashkia angazhon qytetarët në vendimarrje. Numrit total i mbledhjeve të KB të hapura për qytetarët kundrejt numrit total të mbledhjeve bashkiake (në %); Rritja e konsultimit me publikun. Numri i vendimeve bashkiake që janë marrë mbas	135	135	135	127	94%	

			konsultimit me publikun (në %)						
		2	Realizimi i mbrojtjes se interesave të përbashkëta të Bashkive të Shqipërisë, me qëllim decentralizimin dhe demokratizimin e vërtetë të qeverisjes sipas parimeve të Kartës Europiane të Autonomisë Vendor përmes anëtarësimit në SHBSH	1	1	1	1	100%	
		3	Permbushja e detyrimit ne baze te ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore	1	1	1	1	100%	
Objektivi 2	O2. Burime Njerezore të trajnuara dhe të kualifikuara për kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësi. Burime Njerezore të trajnuara dhe të kualifikuara për kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësi. O2. Burime Njerezore të trajnuara dhe të kualifikuara për kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësi. O3. Shërbimet mbështetëse për administratën vendore sigurimi planifikimi e zhvillimi të njësisë, menaxhimin e financave të administrates vendore dhe të burimeve njerëzore, funksionimin e	4	Rritja e qëndrueshmërisë së administratës civile. Numri i punonjësve që kanë qëndruar në punë kundrejt numrit total të punonjësve (raporti në %)	97%	94%	94%	92%	98%	
		5	Përmirësimi i punës së stafit të bashkisë. Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë (raporti kundrejt totalit të punonjësve të bashkisë)	4%	0%	0%	0%	#DIV/0!	

	procese të përgjithshme të brendshme dhe komunikimin me publikun								
		6	Rritja e kapaciteteve / burimeve njerëzore të bashkisë. Raporti i personave të trajnuar kundrejt totalit të punonjësve të bashkisë	26%	3.8	3.8	10%	3%	
Objektivi 3	O3. Shërbimet mbështetëse për administratën vendore sigurimi planifikimi e zhvillimi të njësisë,	7	Nr. dhe llojet e shërbimeve mbështetëse bazë: -Sigurimi i furnizimit të vazhdueshëm me ujë, energji elektrike për zyrat dhe ambientet e Godines Qendrore të Bashkisë, 10 Njesive	23	23	16	16	100%	

<p>menaxhimin e financave të administrates vendore dhe të burimeve njerëzore, funksionimin e proceseve të përgjithshme të brendshme dhe komunikimin me publikun O3. Shërbimet mbështetëse për administratën vendore sigurimi planifikimi e zhvillimi të njësisë, menaxhimin e financave të administrates vendore dhe të burimeve njerëzore, funksionimin e proceseve të përgjithshme të brendshme dhe komunikimin me publikun</p>		Administrative dhe 5 Lagjeve, -sherbime postare,telefonie - furnizime çdo vit me kancelari,leter bojera,shtypshkrime per 16 drejtori dhe 10 Nj A . -sherbime pastrimi i perditshem i ambjenteve te punes ne bashki qender i , NJ A						
	8	Nr. i automjeteve ne gjendje pune ne funksion te sherbimit te transportit ne qendër , njësi administrative etj. Sasia në litra e karburantit të konsumuar Pagesa taksa,siguracione,kontrolle teknike për automjete,mirembajtje tyre	7	7	7	6	86%	
			1	1	1	1	100%	
	9	- pritje percjellje per nr persona ,perfaqesues dhe institucione vendase dhe te huaja	950	250	250	51	20%	
	10	dite/dieta per person ne vit;	173	180	180	32	18%	
	11	nr I pajisjeve sipas llojit; - mbështetje me paisje funksionale zyre: kondicionere,rafte,tavolina, karrike, sipas kërkesave dhe rinovim i tyre çdo vit	16	34	34	3	9%	
	12	nr. I ndertesave administrative,sherbim mbrojtje nga zjarri per nr. ambjente,rimbushje e pervitshme e fikseve te zjarrit,sigurimi I ndertesave dhe inventarit te tyre ekonomik çdo vit,mirembajtje e objekteve çdo vit,lyerje e ambjenteve te punes me boje ne godinen qender 10 Nj.A dhe 5 lagje	16	16	16	16	100%	
	13	Shërbim Interneti për Institucionin e Bashkisë së Shkodrës	21	21	21	25	119%	

14	nr.i komponente te pajisjeve TIK multifunksionale te mirembajtura Nr i pajisjeve TIK te reja te prokuruar	38	40	40	48	120%	
15	nr.i njesive admisnitrative qe ofrojne sherbime elektronike nr.i sherbimeve administrative elektronike qe mund te aplikohen online 1 spot sensibilizues per perfitimin e sherbimeve elektronike permes mediave vizive dhe internetit Nr i bizneseve te regjistruar ne sistem ne varesi te situates se verifikuar Nr i individeve (kryefamiljareve) te regjistruar ne sistem ne varesi te situates se verifikuar 1 Pakete Fiskale e konfiguruar ne sistem Nr i faturave elektronike te leshuara per bizneset dhe individet ne sistem ne varesi te situates se verifikuar nr.i programeve buxhetore Nr i aktiviteteve te gjeolokalizuar sipas programeve buxhetore dhe shtrrjes territoriale nr.i njesive administrative te gjeolokalizuar me te ardhurat vendore vjetore te parshikuara dhe realizuara nr.i moduleve per perllogaritjen automatike te detyrimeve vendore vjetore nr. i moduleve per sugjerime online Nr i perfituesve i sherbimeve sociale Nr i ofruesve te sherbimeve sociale Nr i formulareve per plotesim online	69	83	83	70	84%	
16	nr.i module elektronike online ne shërbim të qytetarëve	8	8	8	11	138%	

		17	Nr i kioskave informative elektronike per vetesherbim Nr i sistemeve elektronike te integruara per ofrim informacioni permes kioskave Nr i sherbimeve elektronike qe perfitohen online permes kioskave Nr i njesive administrative ku do te implementohen kioskat informative	0	-	-	0	#DIV/0!	
		18	Sistem GIS	0	1	1	0	0%	
	O4. Përbushje detyrimesh për ndjekje dhe përfaqësim procese gjyqësore ,shlyerje e detyrimesh qe rrjedhin nga vendime gjyqësore te formes se prere.	19	- Numri i pronave që fitohen nga shpronësimet - Aplikime të statuseve juridike - Nr pronave qe duhet te dergohen per regjistrim sipas VKM	12	597	597	309	52%	
	Rreegjistrim i pronave	20	nr i procese gjyqësore ne ndjekje	0	20	20	139	695%	

	<p>transferuara me VKM për transferimin në pronësi ose përdorim të pronave të paluajtshme publike, shtetërore dhe rregjistrim pronave që fitohen nga shprehjet. Zbatimi i ligjit për transferimin e komisionit për agjencitë tatimore</p>	<p>21</p>	<p>Permbushja e detyrimit në bazë të ligjit</p>	<p>1</p>	<p>1</p>	<p>1</p>	<p>1</p>	<p>100%</p>	
--	---	-----------	---	----------	----------	----------	----------	-------------	--

Realizimi i produkteve

ANEKSI nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit te treguesve te performances/produkteve te programit"

Emri i Grupit	Kodi i Grupit
Programi	Planifikim Menaxhim Adminstrim	Kodi i Programit	1110

Kodi	ne 000/leke	Njësia matese	Sasia Faktike (sipas vitit paraardhes)	2019	I	Sasi (sipas planit te vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit te vitit korent)	II	Kosto per Njese (sipas planit te vitit korent)	Sasia (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	III	Kosto per Njese (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Sasia Faktike (ne fund te vitit korent)	2020	IV	Kosto per Njese Faktike (ne fund te vitit korent)	Luhatjet ne Koston per Njese			Komente
																		V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III	
1	nr anëtarëve të këshillit vendor dhe nr kryepleqve të mbështetur për realizimin e funksioneve dhe përgjegjësiive ligjore. Vendimarrje bashkiake e konsultuar me publikun. Numri i konsultimeve të realizuara kundrejt totalit te vendimeve për	numer	135	15,957	118	143	18,327	128	143	18,327	128	127	14,695	116	-2	-12	-12				

	të cilat konsultimi parashikohet me ligj (në %) Bashkia angazhon qytetarët në vendimarrje. Numrit total i mbledhjeve të KB të hapura për qytetarët kundrejt numrit total të mbledhjeve bashkiake (në %); Rritja e konsultimit me publikun. Numri i vendimeve bashkiake që janë marrë mbas konsultimit me publikun (në %)																	
2	Realizimi i mbrojtjes së interesave të përbashkëta të Bashkive të Shqipërisë, me qëllim decentralizimin dhe demokratizimin e vërtetë të qeverisjes sipas parimeve të Kartës Europiane të Autonomisë Vendor përmes anëtarësimit në SHBSH	tarife	1	500	500	1	1,000	1,000	1	1,000	1,000	1	1,000	1,000	500	0	0	
3	Permbushja e detyrimit në bazë të ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore	tarife	1	100	100	1	100	100	1	100	100	1	100	100	0	0	0	
4	Rritja e qëndrueshmërisë së administratës civile. Numri i punonjësve që kanë qëndruar në punë kundrejt numrit total të punonjësve (raporti në %)	numer/punonjës	271	183,652	678	271	215,372	795	271	215,372	795	250	186,068	744	67	-50	-50	per shkak te pandemie nuk jane bere rekrutime
5	Përmirësimi i punës së stafit të bashkisë. Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë (raporti kundrejt totalit	procedura	8	0	0	10	200	20	10	200	20	9	130	14	14	-6	-6	

	të punonjësve të bashkisë)																	
6	Rritja e kapaciteteve / burimeve njerëzore të bashkisë. Raporti i personave të trajnuar kundrejt totalit të punonjësve të bashkisë	numer									28						0	trajni me on line
7	Nr. dhe llojet e shërbimeve mbështetëse bazë: -Sigurimi i furnizimit të vazhdueshëm me ujë,energjii elektrike për zyrat dhe ambientet e Godines Qendrore të Bashkisë,10 Njesive Administrative dhe 5 Lagjeve, -shërbime postare,telefonie - furnizime çdo vit me kancelari,leter bojera,shtypshkrime për 16 drejtorit dhe 10 Nj A . -shërbime pastrimi i përditshëm i ambienteve të punës në bashki qendër i , NJ A .	njesi administr,l agje	23	13,081	569	23	16,390	713	16	16,190	1,012	16	11,233	702	133	-11	-310	
8	Nr. i automjeteve në gjendje pune në funksion të shërbimit të transportit në qendër , njësi administrative etj. Sasia në litra e karburantit të konsumuar Pagesa taksa,siguracione,kontrolle teknike për automjete,mirembajtje tyre	copë	7	6,542	935	7	4,055	579	7	4,055	579	6	3,738	623	-312	44	44	

9	- pritje percejllje per nr persona ,perfaqesues dhe institucione vendase dhe te huaja	persona	950	2,813	3	250	1,500	6	250	1,500	6	51	661	13	10	7	7
10	dite/dieta per person ne vit;	dite/bileta jashte shteti	173	545	3	180	1,000	6	180	1,000	6	32	86	3	0	-3	-3
11	nr I pajisjeve sipas llojit; - mbështetje me paisje funksionale zyre: kondicionere,rafte,tavolina, karrike, sipas kërkesave dhe rinovim i tyre çdo vit	copë	16	198	12	34	500	15	34	500	15	3	131	44	31	29	29
12	nr. I ndertesave administrative,sherbim mbrojtje nga zjarri per nr. ambjente,rimbushje e pervitshme e fikseve te zjarrit,sigurimi I ndertesave dhe inventarit te tyre ekonomik çdo vit,mirembajtje e objekteve çdo vit,lyerje e ambjenteve te punes me boje ne godinen qender 10 Nj.A dhe 5 lagje	nr.ndertesa	10	791	79	10	800	80	10	800	80	10	785	79	-1	-2	-2
		m2	360	1,727	5	2,600	1,684	1	2,600	1,684	1	480	1,519	3	-2	3	3
13	nr i njësive administrative me akses në internet nr.i stemeve te Informacionit Web Based	njesi administr,l agje, qendra komunitare	21	1,176	56	21	2,100	100	21	2,100	100	25	0	0	-56	-100	-100
14	nr.i komponente te pajisjeve TIK multifunksionale te mirembajtura Nr i pajisjeve TIK te reja te prokuruar	nr.paisje	38	2,878	76	40	3,318	83	40	3,318	83	48	3,200	80	4	-3	-3
15	1 spot sensibilizues per perfitimim e sherbimeve	sherbim	69	4,333	63	83	4,858	59	83	4,858	59	70	2,852	34	-28	-24	-24

	elektronike permes mediave vizive dhe internetit Nr i bizneseve te regjistruar ne sistem ne varesi te situates se verifikuar Nr i individeve (kryefamiljareve) te regjistruar ne sistem ne varesi te situates se verifikuar 1 Pakete Fiskale e konfiguruar ne sistem Nr i faturave elektronike te leshuara per bizneset dhe individet ne sistem ne varesi te situates se verifikuar nr.i programeve buxhetore Nr i aktiviteteve te gjeolokalizuar sipas programeve buxhetore dhe shtrjtes territoriale nr.i njesive administrative te gjeolokalizuar me te ardhurat vendore vjetore te parshikuara dhe realizuara nr.i moduleve per perllogaritjen automatike te detyrimeve vendore vjetore nr. i moduleve per sugjerime online Nr i perfituesve i sherbimeve sociale Nr i ofruesve te sherbimeve sociale Nr i formulareve per plotesim online																	
16	nr.i module elektronike online në shërbim të qytetarëve	module	8	290	36	8	300	38	8	300	38	11	300	27	-9	-10	-11	

17	Nr i kioskave informative elektronike per vetesherbim Nr i sistemeve elektronike te integruara per ofrim informacioni permes kioskave Nr i sherbimeve elektronike qe perfitohen online permes kioskave Nr i njesive administrative ku do te implementohen kioskat informative	sherbim	1	0	0	0	-	#DI V/0 !	0	-	0	0	0	#DI V/0 !	#DIV/0!	#DIV/0!	#DI V/0!
18	Sistem GIS	sherbim	1	0	0	1	800	800	1	800	800	0	0	#DI V/0 !	#DIV/0!	#DIV/0!	#DI V/0!
19	- Numri i pronave që fitohen nga shpronësimet - Aplikime të statuseve juridike - Nr pronave qe duhet te dergohen per regjistrim sipas VKM	aplikime	12	48	4	220	1,003	5	597	1,203	2	309	1,021	3	-1	-1	1
20	nr i procese gjyqsore ne ndjekje	proçese				20	9,099	455	20	9,099	455	139	5,137	37	37	-418	-418
21	Permbushja e detyrimit ne baze te ligjit	tarife	1	75	75	1	56	56	1	56	56	1	56	56	-19	0	0
	Totali			234,705			282,462			282,462			232,712				

Për vitin 2020 në programin “ Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përbushjes së objektivave të përcaktuara për vitin 2020 janë parashikuar dhe realizuar aktivitetet si më poshtë :

Aktivite/Projekte	Buxheti fillestar 2020 në mijë lekë	Buxheti i korrigjuar 2020 në mijë lekë	Realizimi 2020 në mijë lekë
P01110.O1.A1 Mbështetje për funksionimin e organeve të zgjedhura vendore (Këshilli i Bashkisë dhe Kryepërqendër)	18,327	18,327	14,695
P01110.O1.A2 Anëtarësimi në Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë	1,000	1,000	1,000
P01110.O1.A3 Kuota e anëtarësisë për financimin e buxhetit të qarkut	100	100	100
P01110.O2.A1 Vazhdimësia e menaxhimit efektiv e administratës së Bashkisë së Shkodrës në funksion të përbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësisë të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.	215,372	215,372	186,068
P01110.O2.A2 Rekrutimi i burimeve njerëzore në funksion të përbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.	200	200	130
P01110.O2.A3 Trajnimi i burimeve njerëzore të Bashkisë së Shkodrës	-	-	-
P01110.O3.A1 Mbështetja dhe ofrimi i shërbimeve bazë për funksionimin administratës së Bashkisë së Shkodrës	9,090	9,090	7,744
P01110.O3.A2 Shërbim me kancelari dhe shtypshkrime për Administratën e Bashkisë së Shkodrës	5,500	5,300	2,339
P01110.O3.A3 Shërbim higjieno-sanitar për Administratën e Bashkisë së Shkodrës	800	800	783
P01110.O3.A4 Shërbime mbështetëse bazë të mirëmbajtjes (materiale hidraulike, elektrike etj)	1,000	1,000	366
P01110.O3.A5 Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e administratës së Bashkisë së Shkodrës	4,055	4,055	3,738

P01110.O3.A6 Blerje automjete në funksion të administratës	-	-	-
P01110.O3.A7 Organizimi i pritjeve të perfaqësuesve të institucioneve vendase dhe të huaja .	1,500	1,500	661
P01110.O3.A8 Udhëtime e dieta për administratën vendore në funksion të kryerjes së shërbimeve në punë	1,000	1,000	86
P01110.O3.A9 Blerje vegla pune	300	300	0
P01110.O3.A10 Blerje pajisje zyre për administratën e Bashkisë së Shkodrës	200	200	131
P01110.O3.A11 Sigurimi i ndërtesave administrative të Bashkisë së Shkodrës.	800	800	785
P01110.O3.A12 Shërbim i mirëmbajtjes për godinat administrative të Bashkisë së Shkodrës	1,684	1,684	1,519
P01110.O3.A13 Shërbim Interneti për Institucionin e Bashkisë së Shkodrës	2,100	2,100	realizuar
P01110.O3.A14 Mirëmbajtje Pajisje Informatike	318	318	251
P01110.O3.A15 Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)	3,000	3,000	2,948
P01110.O3.A16 Mirëmbajtje e Sistemeve të Integruar të informacionit të Bashkisë Shkodër	2,858	2,858	2,852
P01110.O3.A18 Sistem Informacioni i Integruar për Menaxhimin Financiar të Bashkisë Shkodër dhe Institucioneve e Varësive	2,000	2,000	Ne proces prokurimi
P01110.O3.A19 Mirëmbajtje e faqes zyrtare web ëëë.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj	300	300	300
P01110.O3.A21. Sistem Informacioni GIS i të dhënave vendore dhe i integruar me sistemet e tjera të informacionit si SiZIN, SiTTV, Sistemin e Informacionit të Shërbimeve	800	800	pa realizuar
P01110.O4.A1 Shërbimi për regjistrimin e pronave në pronësi të Bashkisë Shkodër	1,003	1,203	1,021
P01110.O4.A2 Detyrime dhe kompensime legale	9,099	9,099	5,137
P01110.O4.A3 Pagesat e komisionit si agjent tatimor	56	56	56
TOTALI	282,462	282,462	232,712

Aparati i Bashkisë ka si objektiv formalizimin, përmirësimin e punës, shërbimeve administrative dhe rritjen e transparencës.

Për vitin 2020 në programin “ Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjes së objektivave të përcaktuara për vitin 2020 janë analizuar si më poshtë aktivitetet :

P01110.O1.A1 Mbështetje për funksionimin e organeve të zgjedhura vendore (Këshilli i Bashkisë dhe Kryetarët e fshatrave).

U siguria mbështetje për funksionimin e organeve të zgjedhura vendore. Është realizuar shpërblimi mujor në mënyrë sistematike dhe me korrektësi për anëtarët e këshillit bashkiak dhe kryetarëve të fshatrave të Njësive Administrative.

P01110.O1.A2 Anëtarësimi në Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë

Është realizuar pagesa e kuotës së anëtarësisë në shoqatën e Bashkive të Shqipërisë sipas kushteve të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme për pagesën e kuotizimit vjetor, konform dhe aktmarrëveshjes së bërë midis Shoqatës së Bashkive dhe Bashkisë Shkodër .Pagesa e kuotës së anëtarësisë është një detyrim që ka Bashkia Shkodër , parashikuar në Statusin e Shoqatës, neni 14 dhe në ligjin organik nr.139/2015” Për vetqeverisjen Vendore”, neni 9, pikal.5(c).

P01110.O1.A3 Kuota e anëtarësisë për financimin e buxhetit të qarkut

Në zbatim të udhëzimit Nr.2, datë 06. 02. 2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” të ardhurat e qarqeve nga kuota e njësive vendore, kuotat e miratuara nga këshilli i qarkut bëhen pjesë e buxhetit të njësive të qeverisjes vendore. Mes njësive të qeverisjes vendore dhe këshillit të qarkut mbahet një akt-marrëveshje për detyrimin vjetor ndaj këshillit të qarkut. Mbi bazën e titullit për arketim që lëshon këshilli i qarkut bëhet transferim i brendshëm nga njësia vendore në favor të këshillit të qarkut nëpërmjet strukturës përgjegjëse për thesarin në sistemin informatik financiar të qeverisë. Ky aktivitet është realizuar për vitin 2020.

P01110.O2.A1 Vazhdimësia e menaxhimit efektiv e administratës së Bashkisë së Shkodrës në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësi të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Kemi realizuar sigurimin e mbështetjes së funksionimit të administratës së Bashkisë Shkodër përmes realizimit në kohë të shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli u bazua tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar. Paga, shtesat mbi pagat e punonjësve bëhen sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165 datë 02.03.2016 ”Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, VKM nr. 717, datë 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore” të ndryshuar; VKM nr. 187, datë 8.3.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të

kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit” i ndryshuar.

Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore u bazua në zbatim të ligjit Nr. 7703, datë 11. 05. 1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit Nr. 7870, date 13. 10. 1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

P01110.O2.A2 Rekrutimi i burimeve njerëzore në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve Ky aktivitet synon rekrutimin e burimeve profesionale për të qenë pjesë e administratës vendore përmes procedurave të përcaktuara me ligj, në mënyrë transparente, me profesionalizëm dhe në bazë të meritave, aftësive profesionale, pavarësisë dhe integritetit, vazhdimësisë së karrierës, përgjegjësisë dhe korrektesës në zbatimin e ligjeve. Këto rekrutime realizohen me procedurën e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese dhe pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Kjo procedurë realizohet përmes konkursit të hapur në zbatim të Ligjit Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, VKM Nr. 242, datë 18/03/2015, VKM Nr. 243, datë 18/03/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”. Është dërguar plani vjetor i pranimitme vendimin nr.70, datë 17.02.2020. Procedurat nuk janë realizuar në fillim të vitit, por në muajin gusht. Janë zhvilluar procedurat e konkurimit për vendet vakante në shërbimin civil për shkak të masave për parandalimin e përhapjes së COVID-19 referuar urdhërit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.222, datë 01.04.2020.

P01110.O2.A3 Trajnimi i burimeve njerëzore të Bashkisë së Shkodrës.

Ky aktivitet synon që nëpunësit civilë për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë të mund të kryejnë trajnime në institucione të tjera trajnuese me iniciativën e tyre, për detyrën që ata kryejnë, me propozimin e përbashkët të eprorit e të drejtuesit të njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit dhe me miratimin e titullarit të institucionit. Gjatë vitit 2020 për shkak të të masave për parandalimin e përhapjes së COVID-19, nga ASPA janë realizuar trajnime on line për njohuri sipas fushës si dhe nga Projekti Bashkitë për Evropën, UNDP Albania, Giz Albania, Ambasada Suedeze etj

P01110.O3.A1 Mbështetja dhe ofrimi i shërbimeve bazë për funksionimin administratës së Bashkisë së Shkodrës.

Është përmirësuar funksionimi normal i të gjithë administratës së Bashkisë së Shkodrës nëpërmjet ofrimit të shërbimeve mbështetëse bazë si ujë, energji elektrike, ngrohje, komunikim postar, shërbim telefonie etj.

P01110.O3.A2 Shërbim me kancelari dhe shtypshkrime për administratën e Bashkisë së Shkodrës.

Është mundësuar sigurimi dhe furnizimi i vazhdueshëm me kancelari, letër, bojë, shtypshkrime etj.

Sasia e materialeve të kancelarisë dhe shtypshkrimeve është plotësuar çdo vit sipas nevojave të Bashkisë Shkodër. Si pasojë e rritjes së kapaciteteve, rritjes së numrit të personelit, blerjes së pajisjeve të reja multifunksionale TIK dhe shtimit të volumit të punës, kërkohet vazhdimisht

planifikim shpenzimi për materiale të domosdoshme kancelarie për kryerjen dhe ofrimin e shërbimeve. Rritja e kërkesës për materiale të kancelarisë dhe blerjeve të dokumentacionit (shtypshkrime të ndryshme, fotokopjime, libërlidhja e buxhetit) është domosdoshmëri për mbarëvajtjen e punës në Bashkinë Shkodër. Duke plotësuar këto nevoja përmes këtij shërbimi, është rritur performanca në punë e administratës së Bashkisë. Sigurimi dhe furnizimi i vazhdueshëm me kancelari, letër, dhe bojëra për printera e fotokopje dhe shtypshkrime i ka mundësuar punonjësve përmbushjen e detyrave dhe objektivave.

P01110.O3.A3 Shërbim higjeno-sanitar për administratën e Bashkisë së Shkodrës

Është realizuar procedura e dizinfektimit të ambjenteve të Bashkisë Shkodër, Njësi Administrative dhe Qendrave Komunitare pranë Bashkisë Shkodër për parandalimin e përhapjes së COVID-19.

Janë krijuar dhe siguruar në vazhdimësi ambjentet e punës sipas standarteve higjeno – sanitare në funksion të përmbushjes së kushteve të punës.

P01110.O3.A4 Shërbime mbështetëse bazë të mirëmbajtjes (materiale elektrike, hidraulike etj)

Janë siguruar në vazhdimësi shërbimet mbështetëse bazë për mirëmbajtjen dhe furnizimin me materiale elektrike, hidraulike etj.

P01110.O3.A5 Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e administratës së Bashkisë së Shkodrës.

Është realizuar blerja e karburantit dhe furnizimi sistematik me karburant i mjeteve të transportit për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të përditshme të administratës vendore të Bashkisë Shkodër sipas nevojave në Bashkinë qendër , Njësi Administrative etj . Është realizuar shërbimi i riparimit për të gjitha automjetet, shlyerja e të gjitha sigurimeve, taksave të qarkullimit dhe kolaudimit vjetor të mjeteve të transportit në shërbim të administratës .

P01110.O3.A6 Blerje automjete në funksion të administratës është dërguar kërkesa për procedurë n e prokurimit.Në vijim të informacioneve të dhëna nga Njësia e Prokurimit, ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik" i ndryshuar, VKB nr 63, datë 28.12.2020, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2021 - 2023 të Bashkisë së Shkodrës", dhe shkresës së Titullares nr.867 prot. datë 18.01.2021 për disa procedura, të cilat nuk janë kryer gjatë vitit 2020 është përfshirë që ky aktivitet të realizohet gjatë vitit 2021..

P01110.O3.A7 Organizimi i pritjeve të përfaqësuesve të institucioneve vendase dhe të huaja Realizuar në vazhdimësi shërbimi për organizimin e pritje përcjelljeve të përfaqësuesvetë institucioneve vendase dhe të huaja, me qëllim vendosjen e marrëdhënieve dypalëshe me shumë institucione homologe të huaja, në nivel lokal, rajonal etj

P01110.O3.A8 Udhëtime e dieta për administratën vendore në funksion të kryerjes së shërbimeve në punë.

Realizuar në vazhdimësi shërbimi për udhëtime e dieta për administratën vendore në funksion të kryerjes së shërbimeve në punë, i cili është i domosdoshëm në rritjen e standartit të plotësimi të kushteve të punës ndaj administratës si dhe anasjelltas, në rritjen e eficiencës së administratës për dhënien e kontributit dhe përfaqësimin e duhur të institucionit në takime pune, seminare, ëorkshop-e brenda dhe jashtë vendi. Për realizimin e këtyre lëvizjeve bëhet

gjatë gjithë vitit rimbursimi i shpenzimeve dhe dietave për administratën vendore në masën financiare që ligji e parashikon.

P01110.O3.A9 Blerje vegla pune. Nuk është realizuar për arsye se është zhvilluar procedura e prokurimit dhe operatorët e ofruar janë tërhequr.

P01110.O3.A10 Blerje pajisje zyre për administratën e Bashkisë së Shkodrës.. Është bërë identifikimi dhe klasifikimi i kërkesave për pajisje të reja zyre të nevojshme dhe për vitin 2020 janë blerë 3 kondicionerë për zyrat e administratës .

P01110.O3.A11 Sigurimi i ndërtesave administrative të Bashkisë së Shkodrës dhe inventarit të tyre ekonomik.Bashkia Shkodër ka detyrim ligjor për sigurimin nga zjarri dhe rreziqet e tjera të pronave dhe inventarit të saj ekonomik . Ky shërbim është kryer për 11 objekte bashkë me inventarin ekonomik të tyre sindërtesa e Bashkisë Qendër, magazinave dhe Njësi Administrative. Sigurimet e ndërtesave reduktojnë barrën financiare dhe lehtësojnë vazhdimësinë e institucionit duke ulur kostot publike në rast të ndodhjes së fatkeqësive.

P01110.O3.A12 Shërbim i mirëmbajtjes për godinat administrative të Bashkisë së Shkodrës. Ndërtesa e Bashkisë Qendër dhe e Njësi Administrative duhet të jetë në kushte fizike normale të pranueshme për administratën, me qëllim kryerjen e detyrave të përditshme si edhe për qytetarët të cilët paraqiten në ato ambjente për të marrë shërbimin e nevojshëm. Mirëmbajtja e këtyre ambjenteve është një nevojë e domosdoshme për të mbajtur në kushte normale të pranueshme në vazhdimësi këto ndërtesa. Për vitin 2020 janë realizuar punime heqje, vendosje dhe restaurim grila druri, dritare duralumini etjgodina e Bashkisë qendër, shtrim pllaka, patinim ,vendosje dyersh dhe lyerje zyrat e taksave si dhe instalime elektrike godina e Nj.A Rrethina.

P01110.O3.A13 Shërbim Interneti për Institucionin e Bashkisë së Shkodrës

Është realizuar ofrimi i shërbimit të internetit në të gjithë Bashkinë Shkodër (Bashkinë Qendër, Njësitë Administrative dhe Lagje).Bashkia Shkodër ka implementuar një sistem të qendëruar të marrjes së shërbimit të internetit në Bashkinë Qendër, Njësitë Administrative, Lagje dhe Qendra Komunitare. Zgjidhja e implentuar ofron 99.99% shërbimin në çdo kohë në çdo pikë të tij. Sistemi siguron konfidencialitetin dhe sigurinë e informacionit që trasmetohet në linjat e komunikimit. Të gjithë pikat e furnizuara të Bashkisë Shkodër kanë akses në internet 24/7 pa kufizim në komunikim. Ky shërbim ka rritur shpejtësinë në komunikim të të dhënave, ka ulur kostot operative për komunikimin e informacionit, ka garantuar mirëfunksionimin e sistemeve të bazuara në platforma web që Bashkia ka implementuar dhe ka shtrirë në të gjithë njësitë e saj administrative, si: Sistemi i Integruar i Zyrës me Një Ndalesë (SiZ1N), Sistemi i Integruar i Taksave dhe Tarifave Vendore (SiTTV), Sistemi i qendëruar kombëtar i shërbimeve të Ndhmës Ekonomike, Sistemi i Dixhitalizimit të Arkivave, e-Lejet, portali i Transparencës së Buxhetit, sistemi i integruari

menaxhimit të Shërbimeve Sociale dhe Strehimit, faqja zyrtare e internetit eëë.bashkiashkoder.gov.al, menaxhimi i dokumentacionit dhe punës së përditshme të administratës vendore në rrugë elektronike, transparente dhe në kohë, etj.

P01110.O3.A14 Mirëmbajtje pajisje informatike.Ky aktivitet është realizuar gjatë vitit.

Nevoja e administratës për përdorimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) ka qenë dhe është e domosdoshme. Është bërë vazhdimisht një rivlerësim i pajisjeve ekzistuese TIK në Bashkinë Qendër, Njësitë Administrative të saj, Lagjeve dhe

Qendrave Komunitare,ku janë kryer procedura kalimi në inventar nga njëra drejtori në tjetrën, janë nxjerrë jashtë përdorimi pajisjet që nuk plotësojnë specifikimet teknike minimale të miratuara nga AKSHI, dhe një pjesë të konsiderueshme të këtyre pajisjeve i është kryer shërbimi i mirëmbajtjes. Ndërkohë nevoja e mirëmbajtjes së pajisjeve është e vazhdueshme dhe duhet të parashikohet çdo vit. Disa pajisje TIK, kryesisht pajisje multifunksionale printer/skaner/fotokopje në varësi të karakteristikave dhe specifikimeve teknike që mbartin e kanë të nevojshme përsëritjen e mirëmbajtjes së tyre në intervale të caktuara kohore. Ky shërbim i siguar sistematikisht çdo vit nga buxheti i bashkisë Shkodër, ka mbështetur administratën vendore me një infrastrukturë optimale pajisjesh të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit.

P01110.O3.A15 Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK). Ky aktivitet është realizuar gjatë vitit.Nevoja e administratës për përdorimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) ka qenë dhe është e domosdoshme. Gjatë këtyre viteve është bërë sistematikisht një rivlerësim i pajisjeve ekzistuese TIK në Bashkinë Qendër, Njësitë Administrative të saj, Lagjet dhe Qendrat Komunitare, ku janë kryer procedura kalimi në inventar nga njëra drejtori në tjetrën, janë nxjerrë jashtë përdorimi pajisjet që nuk plotësojnë specifikimet teknike minimale të miratuara nga AKSHI, dhe një pjesë të konsiderueshme të këtyre pajisjeve i është kryer shërbimi i mirëmbajtjes. Pajisje të reja TIK janë prokuruar nga buxheti i Bashkisë çdo vit, ndërkohë që nevojave për ripërtëritje të pajisjeve ekzistuese TIK ka qenë vazhdimisht e nevojshme dhe është bërë gradualisht nga viti në vit. Kjo nevojë vjen si rezultat i programeve të licensuara që duhet të përdorim në zbatim të Rregulloreve të AKSHI-t për Komunikimet Elektronike, asaj të Blerjeve të Pajisjeve TIK dhe plotësimit të standarteve minimale teknike, si dhe asaj të ofrimit të Shërbimeve të Përqendruara në Administratën Publike.

Kështu, Bashkia ka mundësuar pajisje të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në gjendje optimale funksionimi në mbështetje të punës së administratës vendore dhe në mbështetje të sistemeve të informacionit të implementuara dhe që do të implementohen në të ardhmen në Bashkinë Shkodër.

P01110.O3.A16 Mirëmbajtje e Sistemeve të Integruara të Informacionit të Bashkisë Shkodër.Ky aktivitet është realizuar gjatë vitit.Një tjetër iniciativë inovative e Bashkisë Shkodër është ajo e përfshirjes së qytetarëve në buxhetim përmes përdorimit të platformës online Transparenca e Buxhetit, një instrument Open Data i realizuar për herë të parë dhe të vetme në Shqipëri. Ky instrument on-line informon publikun për të ardhurat vjetore të saj, shpenzimet dhe investimet, si dhe llogaritjen e taksave dhe tarifave vjetore të qytetarëve dhe bizneseve, si dhe i fton ato të shprehen on-line për kërkesa apo pakënaqësi të mundshme t'i drejtohen zyrave përkatëse përgjegjëse në Bashki për zgjidhjen.

Ndërkohë, rreth 3 vite më parë Bashkia Shkodër ka implementuar një sistem informacioni për Shërbimet Sociale. Qëllimi kryesor i implementimit të këtij sistemi është ofrimi i mundësisë për të populluar një bazë të dhënash të saktë me informacione mbi institucionet që ofrojnë shërbime sociale, si dhe mbi përfituesit që janë të regjistruar pranë këtyre institucioneve, në nivel vendor.

Bashkia Shkodër ka arritur ofrimin e shërbimeve administrative elektronike aty ku qytetari dhe biznesi ndodhet, duke mundësuar që qeverisja vendore të shkojë drejt qytetarit në kohë të

shkurtër, në mënyrë cilësore dhe transparente. Ka rritur llogaridhënien financiare dhe ka mundësuar pjesëmarrjen e qytetare në vendimmarrje.

P01110.O3.A18 Sistem Informacioni i Integruar për Menaxhimin Financiar të Bashkisë Shkodër dhe Institucioneve të Varësive. Ky aktivitet është aulluar pasi asnjë ofertues nuk ka plotësuar kriteret .Po vijohet me rishpalljen e procedurës.

P01110.O3.A19 Mirëmbajtje e faqes zyrtare web ëëë.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj.Ky aktivitet është realizuar gjatë vitit.Bashkia Shkodër zotëron faqe zyrtare interneti nën domain-in ëëë.bashkiashkoder.gov.al. Kjo faqe është 24/7 on-line dhe aktualisht është një faqe e nivelit të 3të në përputhje me rregulloren e AKSHI-t për faqet zyrtare në administratën publike. Në faqe janë të integruar disa module që mundësojnë pjesëmarrjen e qytetarëve dhe demokracinë vendore në kuadër të mirëqeverisjes elektronike vendore. Moduli i Librarisë Ligjore i implementuar dhe i integruar në faqe, bën të mundur që bashkia të ndajë më qytetarët të gjithë projekt-vendimet dhe vendimet e Këshillit të Bashkisë përmes një moduli të menaxhueshëm në web nga Sekretaria e Këshillit të Bashkisë. Moduli e-Pjesëmarrje i implementuar dhe i integruar në faqe, mundëson krijimin e vazhdueshëm të sondazheve me tematika të ndryshme dhe marrjen e mendimeve nga qytetari, lehtësisht i menaxhueshëm nga punonjësit e bashkisë. Moduli i SiZIN, i integruar në faqen web, bën të mundur gjurmimin e kërkesave për shërbim të qytetarëve (tregon se në cilin status të aplikimit ndodhen shërbimet) që aplikohen në Zyrën e Integruar me Një Ndalesë në Bashkinë Qendër apo Njësitë Administrative, direkt nga portali zyrtar on-line. Shkarkimi i formularëve on-line, informacioni i detajuar i regjistrimit të kërkesave, raportet e auditimit, raportet financiare, buxheti dhe realizimi i tij, paketa fiskale, transparenca e buxhetit, raportimi online, forumi online, etj. në kuadër të programit të transparencës janë një tjetër mjet i përfshirjes së qytetarit përmes këtij portaliweb. Aktualisht faqja zyrtare e internetit e Bashkisë Shkodër është e një niveli të lartë informimi dhe përfshirëse e qytetarëve.

P01110.O3.A21 Sistem Informacioni GIS i të dhenave vendore dhe i integruar me sistemet e tjera tëinformacionit si SiZIN, SiTTV, Sistemin e Informacionit të Shërbimeve.Ky aktivitet nuk është realizuar për arsye të mospërbushjes së kapaciteteve teknike të parashikuara,

01110.O4.A1 Shërbimi për regjistrimin e pronave në pronësi të Bashkisë Shkodër (Rregjistrim i pronave të transferuara me VKM për transferimin në pronësi ose perdorim të pronave të paluajtshme publike,shteterore dhe rregjistrimi i pronave që fitohen nga shpronësimet)

Rregjistrimi i pronave që fitohen nga shpronësimi:

- **Zbatimi I VKM nr. 790, datë 11.12.2019 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit "Sistemim blloqe banimi, rruga "Shaban Bushati", në Bashkinë Shkodër.**
 1. Hedhja e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar.
 2. Regjistrimi në ASHK, Drejtoria Vendore Shkodër.
 3. Përgatitja e plan riveimeve për pjesët takuese të Bashkisë dhe pjesës së mbetur.
 4. Aplikimi në portalin e - Albania

5. Përgatitja e urdhër shpenzimeve,
6. Ndjekja e procedurës.

Zona Kadastrale	Nr. pasurisë	Data e aplikimit	Nr. kërkesës	Nr. faturës për arkëtim
8591	4/1072	14.02.2020	2550	201

Zbatimi i VKM nr. 833, datë 20.11.2019 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private , që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksion i Rrugës Shkodër- Velipojë (Segmenti Harku i Bërdicës - Baks), Shkodër

1. Hedhja e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar.
2. Regjistrimi në ASHK, Drejtoria Vendore Shkodër.
3. Përgatitja e plan rievimeve për pjesët takuese të Bashkisë dhe pjesës së mbetur.
4. Aplikimi në portalin e - Albania
5. Përgatitja e urdhër shpenzimeve.
6. Ndekja e procedurës.

Zbatimi i Urdhërit Nr. 676, datë 21.08.2020 "Për ngritjen e komisionit të vlerësimit paraprak të pasurive pronë private që shpronësohet për efekt investimi publik për objektin "Ndërtimi i rrugës Shëngjin- Baks – Rrjoll, segmenti nga Km 7+310 deri në Km 12+420".

1. Hedhja e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar.
2. Dërgimi i gjurmës në ASHK, Drejtoria Vendore Shkodër, për marrje informacioni për statusin juridik të pasurive që preken nga shpronësimi.
3. Aplikimi në portalin e - Albania
4. Përgatitja e urdhër shpenzimeve.
5. Ndjekja e procedurës.
6. Përgatitja e Hartave në formatin dëg.
7. Përgatitja e plan rievimeve mbështetur në Ligjin nr. 110/2018 "Për kadtren" dhe VKM nr. 669, datë 07.08.2013 "Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese gjeodezike shqiptare (KRGHSH-2010), si metadatë", të ndryshuar.

Zbatimi i vendimit Nr. 9, datë 26.2.2020 "Për saktësimin e të dhënave dhe ndryshimin e fushës së përdorimit, të pjesshëm të VKB nr. 51, datë 14.04.2009 "Miratimin e listës së pjeshshme të pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohen për transferimin në pronësi të Bashkisë Shkodër, miratuar me VKM Nr. 421, datë 02.06.2010,të ndryshuar, sipas lidhjes 1, të pronave me numër rendor 55, 60, 61, 62, 63, 69, 71, 72, 107, 224, 246 sipas formularëve për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore' dhe Udhëzimeve ASHK.

1. Kërkesë për marrje statusi juridik të 3 muajve të fundit për pasuritë për të cilët kërkohet ndryshimi i fushës së përdorimit.

2. Aplikimi në portalin e - Albania
3. Përgatitja e urdhër shpenzimeve.
4. Ndjekja e procedurës.
5. Përgatitja e Hartave në formatin dëg.
6. Përgatitja e plan rievimeve mbështetur në Ligjin nr. 110/2018 “Për kadastrën” dhe VKM nr. 669, datë 07.08.2013 “Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese gjeodezike shqiptare (KRGHSH-2010), si metadatë”, të ndryshuar.

Në total janë realizuar 25 aplikime për 67 pasuri të paluajtshme pronë private për shpronësim.

Numri i pronave të përfituara nga shpronësimet , kundrejt numrit të pronave për regjistrim është 97%

Treguesi/Indikator	Plani 2020	Realizimi viti 2020
Numri i pronave të miratuara me VKM Shpronësime	67	67
Numri i pronave dërguar ne ASHK për konfirmim statusi juridik, kartela pasurie+ HTR.	310	217
Numri i aplikimeve në ASHK referuar VKM-ve	220	25

P01110.O4.A2 A2 Detyrime dhe kompensime legale:

Spektori Juridik ka perfaqësuar institucionin, Bashkinë Shkoder në 139 procese gjyqësore civile, administrative , në të cilën ka qënë palë përfaqësuese në proces.

Ka realizuar likuidimin e detyrimeve ndaj të tretëve, të cilat rrjedhin nga procese gjyqësore me vendim të formës së prerë, konkretisht 7 likuidime .

Ka realizuar shpenzime gjyqësore për depozitimin e kërkesë padive/ankimeve/rekurseve/tërheqje vendimesh gjyqësore .

	Realizimi
-Numri proceseve gjyqësore ne ndjekje	7-detyrime të ardhura nga zyra përmbartimore; 13-kërkesë padi te ngritura, nga ku: 1-padi në lidhje me komisionerin, 1-padi në lidhje me përmbartuesin Saimir Dogjani 1-padinë lidhje me Zyrën Përmbartimore Shkodër, 3-padi në lidhje me vleren e debitoreve në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së, 3- padi ne lidhje me Inspektoratin Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, 1-padi në lidhje me Furnizuesi i Shërbimit Universal, OSHEE Group (Tirane dhe Shkoder),

	1-padi në lidhje me Prefektin i Qarkut Shkodër, Këshilli i Bashkisë, Shkodër, 1-padi në lidhje me Shoqërinë “Ndërkomunale Bushat” sh.a 1-padi në lidhje me Drejtorine Rajonale eTatimeve Shkodër 139- procese gjyqësore në ndjekje.
--	--

P01110.O4.A3. Pagesat e komisionit si agjent tatimor(Transferim komisioni 1%) është realizuar, kjo në zbatim të ligjit për transferimin e komisionit për agjentin tatimor, që llogaritet në përqindje të shumës së tatimit që kanë arkëtuar dhe transferuar në buxhetin e Bashkisë Shkodër për llogari të Administratës Tatimore Qendrore. (Drejtoria Rajonale Tatimore)

Njësia e Auditit

Për vitin 2020, janë realizuar 8 auditime, nga ku janë përfunduar 7 auditime dhe në proces 1 auditim nga viti 2020 ,si më poshtë:

Nr	Subjektet	Niveli vlerësimit te riskut	Llojet e auditimeve	Objektet të pa audituara mbi 2-vjet	Realizimi
1	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndjekjes Investimeve të Infrastrukturës	I mesem	Përputhshmëri	✓	✓
2	Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit	I lartë	I kombinuar	✓	✓
3	Projekti “Europe for citizens programme2007-2013 NO.549435-EFC-1-20013-EFCNTT’- Ish - Komuna Dajç	I lartë	Pëputhshmeri	✓	✓
4.	Projekti “Legend-IPA Adriatic” – Administruar nga Ish - Drejtoria e Koordinimit te Projekteve dhe Marredhenieve Nderkombetare,	I lartë	Pëputhshmeri	✓	✓
5	Drejtoria Juridike	I lartë	I kombinuar	✓	✓
6	Policia Bashkiake	I lartë	I kombinuar	✓	✓
7	Drejtoria e Turizmit	I lartë	Përputhshmëri	✓	✓
8	Shtëpia e Femijes 6-18 Vjeç	I mesem	Kombinuar	✓	Proçes

Janë lënë Gjetje dhe Rekomandime sipas subjekteve të audituara përkatësisht:

	Gjetje	Rekomandime
Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndjekjes Investimeve të Infrastrukturës	15	15

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit	8	8
Projekti “Europe for citizens programme 2007-2013 NO.549435-EFC-1-20013-EFCNTT”- Ish - Komuna Dajç	8	8
Projekti “Legend-IPA Adriatic” – Administruar nga Ish - Drejtoria e Koordinimit të Projekteve dhe Marredhenieve Nderkombetare.	4	4
Drejtoria Juridike	10	10
Policia Bashkiake	17	17
Drejtoria e Turizmit	14	14
Shtëpia e Femijes 6-18 Vjeç	Proçes	Proçes

NJËSIA E PROKURIMEVE

Gjatë periudhës 01.01.2020 - 31.12.2020 Bashkia Shkodër ka realizuar në total 187 procedura prokurimi nga të cilat si organ qendror blerës 3 procedura, të deleguara 17 procedura dhe 13 procedura me fondin e miratuar me VKB me nr. 18, dt. 23.04.2020 “Për një ndryshim në VKB nr. 26, dt. 30.12.2019 “Për miratimin e buxhetot të vitit 2020 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2020-2022 të Bashkisë Shkodër” për marrjen e masave të veçanta për pandeminë e COVID 19.

Vlera totale e prokuruar për këtë periudhë për Bashkinë Shkodër është **858,698,926** lekë pa tvsh ndërsa vlera e kontraktuar është **afërsisht 692,028,491** lekë pa tvsh.

Lloji i procedurës	Numri
Kërkesë për propozim	71
Procedura të hapur	16
Shërbim konsulence	1
Negocim pa botim paraprak	12
Blerje dinamika	0
Blerje me vlerë të vogël dhe nën 100 mijë lekë	54
Procedura për emergjencën	13
<i>si organ qendror blerës</i>	3
<i>të deleguara</i>	17
Totali	187

Procedura prokurimi për janar-dhjetor 2020	
Numri total i procedurave të publikuara	229
Numri total i procedurave të fituara konkurruese	187
Numri total i procedurave të anuluar	30
Numri total i procedurave me negociim pa shpallje	12
Numri total i procedurave të parealizuara	18

Lloji i procedurës	Vlera totale e kontraktuar
Kërkesë për propozim	313,350,346 leke pa tvsh
Procedurë të hapur	247,383,201 leke pa tvsh
Sherbim konsulence	3,721,250 leke pa tvsh

Negocim pa botim paraprak	115,481,676 leke pa tvsh
Blerje me vlerë të vogël	12,092,017 leke pa tvsh
Totali	692,028,490 leke pa tvsh

Të gjitha kontratat janë depozituar brenda afatit pranë Degës së Thesarit Shkodër.

Problematikat kryesore gjatë zbatimit të kontratave janë hasur në kontratat e puneve publike, ku ka patur shtyrje të fillimit të punimeve për shkak të kushteve atmosferike .Disa kontrata për investime publike filluan në periudhën e dimrit, për shkak të shtyrjes se prokurimeve për situatën e pandemisë.

Programi 01170: Gjendja Civile

Qëllimi i programit 01170: Gjendja Civile është sigurimi i një shërbimi sa më cilësor ndaj komunitetit për funksionet e deleguara

Objektivi i programit është :

O1. Shërbime te deleguara të mbështetura për funksionimin e tyre.

Përshkrimi i programit Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të gjendjes civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore.


Zbatimi i buxhetit për shërbimet e deleguara (Gjendjes civile) bazohet tek ligji nr. 10129, datë 11.05.2009, "Për gjendjen civile", të ndryshuar; dhe VKM nr. 1299, datë 16.12.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës, të organikës dhe të numrit të punonjësve të shërbimit të gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/ komuna dhe në degët e qarqeve" i ndryshuar .

Pagat i referohen VKM nr. 187, datë 8.3.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, Gjykatën e lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit" i ndryshuar.

Programi P01170	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Transferta	Investime	Totali
Plani fillestar 2020	14,920	0	0	0	14,920
Plani i rishikuar 2020	14,950	672	6,615	0	22,237
Realizimi viti 2020	14, 879	672	1,540	0	17,091
% e realizimit	99.5%	100%	%	0%	77%

Realizimi i shpenzime korente dhe kapitale per kete program,duke e krahasuar me planifikimin është 77%, sipas zërave kryesorë si me poshtë:

Shpenzimet e personelit	99.5%
Shpenzimet e tjera operative	100 %
Transferta	23.2%
Gjithsej	77 %



Për vitin 2020 janë përditësuar të dhënat e shtetasve me vërtetësi dhe në kohë reale, është realizuar rregjistrimi i akteve të mbajtura nga shërbimi i gjendjes civile (lindje, martesë, vdekje) si dhe të shërbimeve tjera të ofruara nga Gjendja Civile.

mijë lekë

Nr	Llojet e te ardhurave	Plani viti 2020	Realizimi viti 2020	% e realizimit
1	Te ardhurat per taksen e akteve dhe pulles	320	248	77.5%

Realizimi i treguesve të performances (shih aneksin 4)

Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

Periudha e Raportimit: 01.01.2020-31.12.2020

Kodi i Programit	1170	Emertimi i programit:	Gjendja Civile					Koment e
Qellimi 1	Sigurimi i një shërbimi sa më cilësor ndaj komunitetit për funksionet e deleguara						
**Treguesit e performancës/Produktet:							
Objektivat e politikës:	Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhes	Niveli i planifikuar ne vitin korent	Niveli i rishikuar ne vitin korent	Niveli faktik ne fund te vitit korent	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	
Objektivi 1	O1. Shërbime te deleguara të mbështetura për funksionimin e tyre.	1	Përmirësimi i shërbimit të Gjendjes Civile Numri i dokumentave të prodhuar / rritja në % kundrejt vitit të kaluar	1%	1%	1%	1%	100%
		2	Rritja e të ardhura të arkëtuara nga prodhimi i dokumentave të prodhuara	-14%	-4%	-4%	-4%	100%

Realizimi i produkteve

ANEKSI nr.3 "Raporti permblledhes i realizimit te treguesve te performances/produkteve te programit"

Emri i Grupit	Kodi i Grupit
Programi	Gjendja Civile	Kodi i Programit	1170

Kodi	ne 000/leke	Njësia matese	Sasia Faktike (sipas vitit paraardhes)	2019			2020			Luhatjet ne Koston per Njesi			Komente					
				I	II	III	IV	V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III								
	Emertimi i Treguesit te Performances/P roduktit		Shpenzi met (sipas vitit paraardhes)	Kosto per Njesi (sipas vitit paraardhes)	Sasia (sipas planit te vitit korent)	Shpenzi met (sipas planit te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te vitit korent)	Sasia (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Shpenzi met (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Sasia Faktike (ne fund te vitit korent)	Shpenzi met Faktike (ne fund te vitit korent)	Kosto per Njesi Faktike (ne fund te vitit korent)					
1	Përmirësimi i shërbimit të Gjendjes Civile; Numri i dokumentave të prodhuar / rritja në % kundrejt vitit të kaluar; Rritja e të ardhura të arkëtuara nga prodhimi i dokumentave të prodhuara	nr/punonjes	22	14,531	660	22	14,920	678	22	22,237	1,011	22	17,091	777	116	99	-234	
	Totali			14,531			14,920			22,237			17,091					

Për vitin 2020 në programin 01170 “ Gjendja Civile ” në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjes së objektivave të përcaktuara për vitin 2020 është përmirësuar shërbimi i Gjendjes Civile.

P01170.O1.A1 Shërbimet e deleguara Gjendja Civile. Është realizuar dhe përmirësuar ritja e të ardhurave të arkëtuara nga prodhimi i dokumentave dhe realizuar shkurtimi i kohës së marrjes së shërbimi

Aktivitete/Projekte	Buxheti fillestar 2020 në mijë lekë	Buxheti i korrigju ar 2020 në mijë lekë	Realizimi 12-mujori 2020 në mijë lekë
P01170.O1.A1 Shërbimet e deleguara Gjendja Civile	14,920	22,237	17,091

FUNKSIONI 03: RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE

Programi 03140: Shërbimet Policore Vendore

Ky program përfshin institucione dhe konkretisht:

1. Policia Bashkiake

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit:

-Qëllimi i programit të Policise Bashkiake është:

Shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të bashkisë, në përputhje me dispozitat ligjore. Parandalimin e kundërvajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të bashkisë dhe keshillit bashkiak brenda juridiksionit vendor dhe në përputhje me përcaktimet ligjore

-Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për 12-mujorin e vitit 2020 kanë qënë:

O1. Polici vendore e trajnuar dhe e kualifikuar për kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësi.

O2. Rritja e qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të njësisë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi

	LLOJET E TË ARDHURAVE	Plan viti 2020	Realizimi viti 2020	% e realizimit
1	Te ardhura nga kundravatjet administrative(gjobat)	7345	12100	165%


Programi P 03140	Paga Sigurime	+ Shpenzime Operative	Subvencioni	Transferta	Investime	Totali
Plani fillestar 2020	18,468	1,950	0	0	0	20,418
Plani i rishikuar 2020	18,418	1,950	0	0	0	20,418
Realizimi 12-mujorit 2020	15,597	1,054	0	50	0	15,597
% e realizimit	84%	54%				76%

Realizimi i shpenzimeve per paga,shpenzime operative, transferime dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është 76 %, sipas zërave kryesorë si më poshtë:

Shpenzimet e personelit 84%

Shpenzimet e tjera operative 54%

Gjithsej 76%



Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

Periudha e Raportimit: 12 Mujor

Kodi i Programit	3140	Emertimi i programit:	Sherbimet e Policise Vendore						Komente
Qellimi 1			Shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të bashkisë, në përputhje me dispozitat ligjore. Parandalimin e kundërvajtjeve admini-strative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të bashkise dhe keshillit bashkiak brenda juridiksionit vendor dhe në përputhje me përcaktimet ligjore					
			**Treguesit e performancës/Produktet:					
Objektivat e politikës:	Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhes	Niveli i planifikuar ne vitin korent	Niveli i rishiku ar ne vitin korent	Niveli i faktik ne fund te vitit korent	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit		
Objektiv i 01	Polici vendore e trajnuar dhe e kualifikuar për kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësi ve.							
		1		5%	4%	4%	5%	113%

			<p>Punonjësit e policisë bashkiake gëzojnë statusin sipas ligjit</p> <ul style="list-style-type: none"> Raporti midis punonjësve me status të oficerit të policisë bashkiake kundrejt numrit total të punonjësve të policisë Bashkiake <p>Punonjësit e policisë bashkiake janë të kualifikuar</p> <ul style="list-style-type: none"> Numër punonjësish të trajnuar, ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar 						
	
<i>Objektiv i O2</i>	<p>Rritja e qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të njësisë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi</p>	2	<p>Punonjësit e policisë bashkiake gëzojnë statusin sipas ligjit</p> <ul style="list-style-type: none"> Raporti midis punonjësve me status të oficerit të policisë bashkiake kundrejt numrit total të punonjësve të policisë Bashkiake <p>Punonjësit e policisë bashkiake janë të kualifikuar</p> <ul style="list-style-type: none"> Numër punonjësish të trajnuar, ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar 	40	48	48	32	67%

		3	Numri i rasteve problematikave të zgjidhura kundrejt rasteve të raportuara/konstatuara (në %)	86	86	86	93	108%
		4	Numri i akteve të ekzekutuara kundrejt akteve të nxjerra (në %)	14	40	40	57	143%	
		5	Nr kamera te vendosura ne pika strategjike te qytetit	41				#DIV/0!

ANEKSI nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit te treguesve te performances/produkteve te programit"

Emri i Grupit	Kodi i Grupit
Programi	Kodi i Programit	3140

Kodi	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Njësia matese	Sasia Faktike (sipas vitit paraardhës)	Shpenzimet (sipas vitit paraardhës)	I		II		III		IV		Luhatjet ne Koston per Njesi			Komente		
					Kosto per Njesi (sipas vitit paraardhës)	Sasia (sipas planit te vitit korrent)	Shpenzimet (sipas planit te vitit korrent)	Kosto per Njesi (sipas planit te vitit korrent)	Sasia (sipas planit te rishikuar te vitit korrent)	Shpenzimet (sipas planit te rishikuar te vitit korrent)	Kosto per Njesi (sipas planit te rishikuar te vitit korrent)	Sasia Faktike (ne fund te vitit korrent)	Shpenzimet Faktike (ne fund te vitit korrent)	Kosto per Njesi Faktike (ne fund te vitit korrent)	V = IV - I		V = IV - II	V = IV - III
1	Vazhdimësia e menaxhimit efektiv te Policise Bashkiake në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësive të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.	numër	21	15,298	728	24	18,468	770	24	18,468	770	22	14,543	661	-67	-108	-108
2	Pajisje me Uniforma për Policinë Bashkiake	numër	24	467	19	24	800	33	24	800	33			#DI V/0 !	#DI V/0 !	#DI V/0 !	#DI V/0 !
3	Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e policise Bashkiake			555	#DI V/0 !		1,110	#DI V/0 !		1,110	#DI V/0 !		1,054	#DI V/0 !	#DI V/0 !	#DI V/0 !	#DI V/0 !

4	Blerje dokumentacioni shtypshkrime në funksion	numër	30	4	0	30 0	40	0	300	40	0	0	0	#DI V/0 !	#DI V/0 !	#DI V/0 !	#DI V/0 !	
5	Furnizim vendosje kamera sigurie per ambiente publike	nr kamera	41	6,61 4	161			#DI V/0 !			#DI V/0 !			#DI V/0 !	#DI V/0 !	#DI V/0 !	#DI V/0 !

Realizimi i buxhetit per vitin 2020 per periudhen 12-mujore për perballimin e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19 .

Gjate ketij 12-mujori janë vendosur gjithsej 229 masa administrative me vlerë 740.000 lekë nga të cilat janë arkëtuar 469.511 lekë. Policia Bashkiake menjehere pas shfaqjes së rasteve të para të pandemisë COVID-19, në zbatim të detyrimeve ligjore të dala për perballimin e kësaj situate është angazhuar maksimalisht në sigurimin e zbatimit të rregullave kufizuese dhe distancimin social në tregje dhe ambjete të tjera të ushtrimit të aktiviteteve tregtare, sportive, publike, kulturore,etj.

Janë organizuar shërbime të përbashkëta me policinë e shtetit dhe struktura të tjera ligjzbatuese, për kontrollin e levizjes së mjeteve dhe personave gjatë periudhës së izolimit gjatë pandemisë si dhe kontrollin e zbatimit te masave kufizuese te vendosura nga organet kopetente, si dhe është angazhuar maksimalisht në bashkëpunim me shërbimet sociale, për identifikimin e personave apo familjeve në nevojë emergjente për ndihmë, si dhe shpërndarjen e ndihmave nëpër banesa sipas grafikuat të përcaktuar etj.

Ka siguruar zbatimin e urdhërit të Kryetares për rregjimin e lëvizjes brenda institucionit të Bashkisë duke respektuar rregullat e vendosura për mbrojtjen nga virusi, covid-19.

Për vitin 2020 në Programin " Shërbimet e Policisë Vendore " në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, janë parashikuar 4 aktivitete.

-Aktivitetet janë realizuar si me poshtë:

P03140.O1.A1 Vazhdimësia e menaxhimit efektiv te Policise Bashkiake në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësive të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Per 12 mujorin e vitit 2020 janë realizuar pagesa per pagat+sigurime shoqërore dhe shëndetësore për 22 punonjës të policisë bashkiake me vlere 15,597 mije leke

P03140.O2.A1 Pajisje me Uniforma për Policinë Bashkiake.

Eshte realizuar si blerje, por në proces likuidimi.

P03140.O2.A2 Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e policise Bashkiake.

Në funksion të policisë bashkiake është një automjet, i cili per 12 mujorin e vitit 2020 ka pasur nevojë për furnizim karburanti, shërbim të kontrollit teknik, pagesën e taksave dhe siguracionit pergjat kësaj periudhe, të cilat janë realizuar në vleren 1,054 mije lekë.

P03140.O2.A3 Blerje dokumentacioni shtypshkrime në funksion të policise bashkiake.

Nuk është realizuar.

Aktiviteti	Buxheti fillestar në 000/Lekë	Buxheti korigjuar në 000/Lekë	i Realizimi 12-mujori 202 në 000/Lekë
P03140.O1.A1 Vazhdimësia e menaxhimit efektiv te Policise Bashkiake në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave	18,468	18,468	14,543

dhe përgjegjësi të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.			
P03140.O2.A1 Pajisje me Uniforma për Policinë Bashkiake	800	800	Realizuar Në proces likuidimi
P03140.O2.A2 Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e policisë Bashkiake	1,110	1,110	1,054
P03140.O2.A3 Blerje dokumentacioni shtypshkrime në funksion të policisë bashkiake	40	40	Jo realizuar
Totali	20,418	20,418	15,597

Programi. 03280: Emergjencat Civile

Ky program përfshin institucione dhe konkretisht:

2. Aparatin e Bashkisë
3. MZSH

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit:

-Qëllimi i programit të Emergjencave Civile është:

Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe menaxhimi i tyre, duke siguruar mbrojtjen e jetës së njerëzve, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit nëpërmjet sistemit të mbrojtjes civile.

-Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për 12-mujorin e vitit 2020 kanë qënë:

O1. Strukturat për planifikimin, menaxhimin dhe përballimin e emergjencave civile.

O2. Shërbim i përmirësuar i MZSH me prioritet parandalimin e ngjarjeve.

Realizimi i buxhetit të vitit 2020 për periudhën 12-mujore për përballimin e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19.

Bashkia Shkodër menjëherë pas shfaqjes së rasteve të para të pandemisë nga COVID-19, në zbatim të urdhërit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.1303 prot. datë 09.03.2020 “Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike, anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura, mbylljen e institucioneve arsimore dhe parandalimin e e përhapjes së COVID-19” ka marrë masa për përballimin e situatës.

Në zbatim të vendimit nr.84 datë 12.03.2020 “Për miratimin e rishpërndarjes së fondeve të zërave të shpenzimeve korente, brenda të njëjtit program për vitin 2020” është realizuar shpenzimi me objekt:

“Blerje material dezinfektuese “ me vlerë 754,800 lekë.

Me këtë shpenzim është realizuar blerja e materialeve dezinfektuese për dezinfektimin dhe higjenizimin e rrugëve, trotuarëve e shesheve publike.

Me urdhër nr.230 datë14.04.2020 të kryetares së bashkisë, “Për furnizimin dhe administrimin e materialeve dezinfektuese prane magazinës së Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a” është realizuar shërbimi për dezinfektimin dhe higjenizimin e institucioneve publike e shëndetësore (poliklinikë, spitale, qendra shëndetësore). Shërbimi është realizuar me mjetet e punonjësit e UK sh.a Shkodër gjatë gjithë periudhës së pandemisë.

Në zbatim të VKM nr.243, datë24.03.2020 “Për shpalljen e gjëndjes së fatkeqësisë natyrore”, vendimit nr.87 datë 25.03.2020 “Për miratimin e rishpërndarjes së fondeve të zërave të shpenzimeve korente, brenda të njëjtit program për vitin 2020” është realizuar shpenzimi me objekt:

“Blerje produkte ushqimore dhe joushqimore për shtresat në nevojë” me vlerë 4,915,000 lekë.

Bashkia Shkodër ruan rezervat e saj ushqimore në rast të emergjencave civile (tërmet, përmytje, apo situata të tjera të paparashikuara) ndaj ka qënë e mundur ndërhyrja e menjëhershme në familjet në nevojë, sapo kanë filluar të shfaqen rastet e para të koronavirusit në Shqipëri dhe kanë filluar kufizimet e para datë 11.03.2020, ndërhyrje me 500 pako rezervë.

Këshilli i Ministrave me Vendim Nr. 243, dt. 24.03.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore” ka shpallur gjendjen e fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë, për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19. Ministria e Mbrojtjes me shkresën Nr. 1650, dt. 24.03.2020, “Kërkesë për marrjen e masave urgjente për përdorimin e fondeve për mbrojtjen civile”, ka dërguar vendimin e Komisionit Qendror për Ofrimin e Asistencës Nr. 2, dt. 24.03.2020 “Për përcaktimin e masës së produkteve ushqimore dhe jo-ushqimore minimale dhe llojet e procedurave të asistencës ndaj shtresave në nevojë”, duke dhënë orientimin që të përdoren fondet e planifikuara nga Bashkitë për mbrojtjen civile.

Në vazhdimësi, me Vendim Nr. 87, me Nr. 5073/3 Prot., dt.25.03.2020, është miratuar nga Bashkia Shkodër rishpërndarja e fondit të zërave të shpenzimeve korente, brenda programit “Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile” me burim financimi transfertë e pakushtëzuar, për shkak të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Kjo rishpërndarje është kryer nga aktiviteti “Zvogëlimi i riskut nga fakeqësitë dhe mbrojtjen civile” dhe fondi prej 4,915,000 lekë është përdorur për blerjen e produkteve ushqimore dhe jo-ushqimore për shtresat në nevojë sipas referencës përkatëse në Vendimin Nr. 2 të lartpërmendur, i cili në shtojcën 1 të tij përcakton edhe masën minimale të produkteve për një periudhë dy-javore. Gjithsej ky fond ka mbuluar pako per 839 familje në nevojë.

Bashkia Shkodër ka planifikuar fondin 4 % në buxhetin e vitit 2020, në mbështetje të nenit 65, të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”:

*“Bashkitë, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të këtij ligji, mbështeten në parashikimin minimal prej **4 përqind të totalit të buxhetit vjetor të tyre, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit**”.*

Me VKB nr. 26 datë 30.12.2019 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2020 dhe të programit buxhetor afatmesëm përfundimtar të Bashkisë Shkodër për vitin 2020-2022” është miratuar në Programin 03280 "Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile", zëri "Transferime", në kërkesën buxhetore P03280.O1.A1."Struktura e mbrojtjes civile dhe organizimi i strukturave vullnetare në Bashkinë Shkodër", aktiviteti "Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile", një fond prej 58,622,000 Lekë, i cili përfaqëson 4 % të totalit të buxhetit vjetor.

Me VKB nr. 26 datë 30.12.2019, sipas shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nr 23198/1, datë 24.12.2019, Bashkia ka parashikuar 1.7% me fondete veta në shumën 24,915 mijë lekë për mbrojtjen civile dhe po vazhdon punën për përballimin e situatës së krijuar nga COVID-19 me fondet e veta të parashikuara.

Meqenëse fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit, nuk ishin alokuar, i është propozuar Këshillit të Bashkisë që nga fondet e veta të Bashkisë Shkodër, të trashëguara nga viti 2019, si diferenca prokurimi, të rishpërndahen në:

1. Shtesë të Programit 03280 "Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile", zëri "Shpenzime operative", në kërkesën buxhetore P03280.O1.A1."Struktura e mbrojtjes civile dhe organizimi i strukturave vullnetare në Bashkinë Shkodër", aktiviteti "Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile" në shumën prej 35,927,823 lekë;
2. Shtesë të Programit 04980 “Fond rezervë dhe kontingjence” për t’i paraprirëçdo të papriture për periudhën në vazhdim, në shumën prej 25,751,000 lekë;

Me vendimin nr.18 datë 23.04.2020 “Për një ndryshim ne VKB nr. 26 dt.30.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2020 dhe programit afatmesëm përfundimtarë 2020-2022 të

Bashkisë Shkodër , brenda të njëjtit program për vitin 2020” me fondet e trashëguara prej 61,678,823 lekë është miratuar shtesa në buxhet në:

Programin 03280 “Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile” me vlerë 35,927,823 lekë.

Programin 04980 “Fond rezervë dhe kontigjence” me vlerë 25,751,000 lekë.

Në zbatim të VKB së mësipërm janë realizuar shpenzimet ne programin 03280 në objektet si më poshtë:

“FV Tunel dezinfektues për tregun e merkatës Rus e Zdalej(Për situaten COVID-19)” me vlerë 672,000 lekë. (Programi 03280 “Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile”)

Me këtë shpenzim është realizuar blerja e dy tuneleve dezinfektues të cilët janë vendosur në hyrje të merkatës Rus e Zdalej dhe shërbejnë për dezinfektimin e qytetarëve gjatë hyrjes dhe daljes në merkatë.

“FV Tunel dezinfektues për tregun e shitjes me shumicë në Dobrac(Për situaten COVID-19)”

Në zbatim të urdhërit të KEC të Prefekturës së Qarkut Shkodër është realizuar vendosja e një tuneli dezinfektues në hyrje të tregut të shitjes me shumicë në Dobrac merkatës që shërben për dezinfektimin e qytetarëve gjatë hyrjes dhe daljes në këtë treg. Kjo është realizuar në bashkëpunim mes Bashkisë Shkodër dhe Ministrisë së Brendëshme.

“Dezinfektues për tunel dezinfektimi (Për situaten COVID-19)” me vlerë 960,000 lekë. (Programi 03280 “Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile”)

Me këtë shpenzim është realizuar blerja e materialeve dezinfektuese për furnizimin gjatë gjithë periudhës të dy tuneleve me material dezinfektues, për të parandaluar përhapjen e Covid-19 nëpërmjet dezinfektimit të qytetarëve gjatë hyrjes dhe daljes në merkatë.

“Blerje produkte ushqimore dhe detergjente për situatë emergjente” me vlerë 5,219,313 lekë. (Programi 03280 “Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile”)

Me këtë vlerë është realizuar blerja e produkteve ushqimore dhe detergjente për situatë emergjente, për blerjen e produkteve ushqimore dhe jo-ushqimore për shtresat në nevojë sipas referencës përkatëse në Vendimin Nr. 2 të lartpërmendur, i cili në shtojcën 1 të tij përcakton edhe masën minimale të produkteve për një periudhë dy-javore. Shpërndarja e tyre është në process sipas nevojave.

Për më tepër, bashkëpunimi i afërt me organizata të ndryshme (UNICEF, UNDP, Fundjavë Ndryshe, Foodbank, Mirësia, Shpresë për Botën, etj.) ka bërë të mundur mbulimin më të gjërë të familjeve në nevojë me pako ushqimore dhe higjienike me rreth 3000 pako. Nga Rezervat e Shtetit janë siguruar 543 pako ushqimore.

Gjithashtu, ka përfunduar procesi i dy dhurimeve financiare nga UNICEF me vlerë 2,333,600 i shpërndarë 553 familjeve në nevojë sipas numrit të anëtarëve dhe nga EorlVision me vlerë 250,000 i shpërndarë 50 familjeve në nevojë.

“Blerje tubacione dhe rakorderi për lidhjen me ujë të pijshëm të banorëve në lagjen Mark Lula (Blloku nr.1 dhe Blloku nr.2) për rritjen e higjenës nga rreziku i infektimit nga COVID-19)” me vlerë 2,672,808 lekë. (Programi 03280 “Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile”)

Me financim të Bashkisë Shkodër i cili ka përfunduar vitin e kaluar është realizuar investimi me objekt “Furnizimi me ujë të pijshëm të banorëve në lagjen Mark Lula (Blloku nr.1 dhe Blloku nr.2. Me këtë investim është realizuar shtrimi I tubacionit të rrjetit kryesor në të dy blloqet si dhe vendosja e bokseve kryesore për furnizimin e banorëve.

Në situatën e krijuar nga pandemia për vënien në funksion të rrjetit, dërgimin e ujit të pijshëm në banesat e qytetarëve dhe lidhjen e kontratave mes furnizuesit UK Shkodër sh.a. dhe klientëve kërkohej investim shtesë. Në situatën e krijuar nga pandemia u pa e domosdoshme përmirësimi I kushteve të higjenës nëpërmjet furnizimit me ujë të pijshëm pa ndërprerje për banorët.

Në këto kushte është bërë një vlerësim nga specialistët e bashkisë dhe UK Shkodra sh.a. për një zgjidhje sa më të shpejtë dhe ekonomike. UK Shkodra sh.a. ka marrë përsipër realizimin e te gjitha punimeve për furnizimin me ujë të pijshëm pa ndërprerje për banorët dhe lidhjen e kontratave të furnizimit me klientët.

Me reduktimin e kostot për makineri e fuqi punëtore në masën 30% të shpenzimeve, u bë rivlerësim nga specialistët nga ku vlera e materialeve të nevojshme për blerje tubacione dhe rakorderi për lidhjen me ujë të pijshëm të banorëve është 2,672,808 lekë.

Ky shpenzim është vlerësuar emergjent pasi do të përfitojnë furnizimin me ujë të pijshëm pa ndërprerje rreth 500 familje dhe rrjedhimisht do të shërbejë për rritjen e higjenës nga rreziku i infektimit nga COVID-19”.

“F.V. Mbrojtëse plexiglass për Zyrën me Një Ndalesë në kuadër të pandemisë COVID-19” me vlerë 93,624 lekë. (Programi 03280 “Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile”)

Me këtë shpenzim është realizuar shërbimi për “F.V. Mbrojtëse plexiglass për Zyrën me Një Ndalesë” të Bashkisë Shkodër në kuadër të masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit nga kontaktet e drejtpërdrejta mes punonjesve të bashkisë dhe qytetarëve që i’u ofrohet shërbimi.

“F.V. Mbrojtëse plexiglass për Zyrat me Një Ndalesë të Njërive Administrative dhe zyra të ndihmës ekonomike dhe PAK në kuadër të pandemisë COVID-19” me vlerë 108,000 lekë. (Programi 03280 “Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile”)

Me këtë shpenzim është realizuar shërbimi për “F.V. Mbrojtëse plexiglass për Zyrat me Një Ndalesë të Njërive Administrative dhe zyra të ndihmës ekonomike dhe PAK në kuadër të pandemisë COVID-19” në kuadër të masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit nga kontaktet e drejtpërdrejta mes punonjesve të bashkisë dhe qytetarëve që i’u ofrohet shërbimi. Situate e realizimit të buxhetit në zbatim të vendimit nr.18 datë 23.04.2020 “Për një ndryshim në VKB nr. 26 dt.30.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2020 dhe programit afatmesëm përfundimtarë 2020-2022 të Bashkisë Shkodër , brenda të njëjtit program për vitin 2020” është si më poshtë:

Programin 03280 “Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile”

Plani: në vlerë 35,927,823 lekë.

Fakti: në vlerë 9,725,745 lekë

Gjëndje për t’u përdorur për situata të emergjente 26,202,078 lekë.

Programin 04980 “Fond rezervë dhe kontigjence”

Plani: në vlerë 25,751,000 lekë. Kjo shumë është e papërdorur dhe mbetet gjëndje për t’u përdorur për situata të paparashikuara.

Realizimi i të ardhurave të planifikuara

mijë lekë

LLOJET E TË ARDHURAVE		Plan viti 2020	Realizimi viti 2020	% e realizimit
1	Nga tarifat e shërbimeve që kryen struktura e MKZ	1,999	1,314	65,7

Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e të ardhurave të planifikuara

Realizimi i Buxhetit të planifikuara


mijë

lekë

Programi P.03280	Paga Sigurime	Shpenzime Operative	Subvencioni	Transferta	Investime	Totali
Plani fillestar 2020	36,512	6,791	0	61,677	1,400	106,380
Plani i korrigjuar 2020	36,277	47,634		30,499	1,400	115,810
Realizimi 12-mujorit 2020	32,025	13,116	0	7,404	398	52,943
% e realizimit	88.3	27.5		24.3	28.4	45.7

Realizimi i shpenzimeve për paga, shpenzime operative, transferime dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është 45.7 %, sipas zërave kryesorë si më poshtë:

Shpenzimet e personelit	88.3%
Shpenzimet e tjera operative	27.5%
Transferime	24.3%
Shpenzime kapitale	28.4%
Gjithsej	45.7%



Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara

Shpenzimi për blerje dhe rimbushje fikse zjarri nuk është realizuar për pamjaftueshmëri fondet për efekt të rritjes së nevojave dhe rritjes së çmimit në treg. Ky shpenzimi është transferuar për në vitin 2021.

Nuk është realizuar kontrolli sistematik vjetor për certifikimin për MZSH i objekteve të Bashkisë.

Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit									
Periudha e Raportimit:									
Kodi i Proqramit	3280	Emertimi i programit:	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile						Koment e
Qellimi 1	<p>Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe menaxhimi i tyre, duke siguruar mbrojtjen e jetës së njerëzve, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit, nëpërmjet sistemit të mbrojtjes civile.</p> <p>1. Përafri me standartet europiane të organizimit të mbrojtjes civile. 2. Sigurimi I mbrojtjes civile në të gjithë territorin. 3. Parandalimi.</p> <p>4. Informim public për reziqet dhe aktivitetet e organeve vendore përgjegjëse për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera. Garantimin e shërbimit të zjarrfikësve në nivel lokal dhe administrimi i strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;</p>							
**Treguesit e performancës/Produktet:									
Objektivat e politikës:	Kodi i Treguesit te Performance s/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhes	Niveli i planifikuar ne vitin korent	Niveli i rishikuar ne vitin korent	Niveli faktik ne fund te vitit korent	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	
Objekti vi O1	Strukturat për planifikimin, menaxhimin dhe përballimin e emergjencave civile	1	Zone e ndikuar nga fatkeqesite (Nj. A)	7	7	7	7	100%
		2	Familje te trajtuara ,e shperblim per fatkeqesi natyrore	19	37	37	3	8%
		3	Numri I kontrolleve sistematike vjetore per certifikimin për MZSH i objekteve të Bashkisë.	200	190	190	0	0%
		4	Rritja e numrit të ofruar të pajisjeve dhe kolaudimi i fikësve të zjarrit në institucione: (rritja vjetore në %)	22%	11%	11%	0	0%
Objekti vi O2	Shërbim I përmirësuar I MZSH me prioritet parandalimin e ngjarjeve.	5	Numri i stacioneve të MZSH që ka bashkia	1	1	1	1	100%

6	Numri total i rasteve të menaxhuara	477	650	650	403	62%
7	Të ardhurat nga tarifat për shërbimin ndaj të tretëve (pajisja me çertifikata, , etj) në mijë Lekë	1,535	1,944	1,944	1,314	68%
8	Koha e daljes nga stacioni në sekonda:					#DIV/0!
9	diten	60	60	60	60	100%
10	naten	45	45	45	45	100%
11	Numri i thirrjeve nga popullata drejt Shërbimit Zjarrfikës	504	494	494	528	107%
12	Efiçienca buxhetore në ofrimin e shërbimit MZSH	79.8 leke/rast te menaxhua	64.8 leke/rast te menaxhua	64.8 leke/rast te menaxhua	91 leke/rast te menaxhua	#VALUE!

ANEKSI nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit te treguesve te performances/produkteve te programit"																			
Emri i Grupit	Bashkia Shkodër	Kodi i Grupit	141																
Programi	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	Kodi i Programit	3280																
	ne 000/leke				I			II			III			IV	Luhatjet ne Koston per Njesi			Komente	
Kodi	Emertimi i Treguesit te Performances /Produktit	Njësi a mates e	Sasia Faktike (sipas vitit paraardhes)	Shpenzimet (sipas vitit paraardhes)	Kosto per Njesi (sipas vitit paraardhes)	Sasia (sipas planit te vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te vitit korent)	Sasia (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Sasia Faktike (ne fund te vitit korent)	Shpenzimet Faktike (ne fund te vitit korent)	Kosto per Njesi Faktike (ne fund te vitit korent)	V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III		
1	Instrumenta menaxhues për emergjencat civile	lekë	1,362	7,601	6	1,517	63,222	42	1,517	72,652	48	3	15,936	5,312	5,306	5,270	5,264	
2	Plotësimi i dokumentacionit ligjor teknik për masat MZSH dhe çertifikimi për MZSH i të gjitha objekteve të vartësi të Bashkisë.	copë	185	1,000	5	190	1,000	5	190	1,000	5			#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	

3	Ofrimi i shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimit	nr i rasteve të menaxhuara	477	38,033	80	650	41,758	64	650	41,758	64	403	36,609	91	11	27	27
4	Blerje paisje të zyrës së MZSH	copë			#DIV/0!	1	400	400	1	400	400	1	398	398	#DIV/0!	-2	-2	
				46,634			106,380			115,810			52,943					

Për vitin 2020 në Programin "Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile" në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përbushjen e objektivave të përcaktuara, janë parashikuar 4 aktivitete.

-Aktivitetet janë analizuar si me poshtë:

P.03280.O1.A2. Përballimi i ndihmave të menjëherëshme për familjet me raste fatkeqësie

P.03280.O1.A3. Plotësimi i dokumentacionit ligjor teknik për masat MZSH dhe çertifikimi për MZSH i të gjitha objekteve në varësi të Bashkisë

P.03280.O2.A1. Shërbimi i Mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi

P.03280.O2.A2. Rikonstruksion i godinës së MZSH

Aktiviteti	Buxheti në mijë mijë lekë	Buxheti i korigjuar mijë lekë	Realizimi 12 2020 në mijë kë L
P.03280.O1.A1. Struktura e mbrojtjes civile dhe organizimi i strukturave vullnetare në Bashkinë Shkodër.	58,622	60,843	8,743
P.03280.O1.A2. Përballimi i ndihmave të menjëherëshme për familjet me raste fatkeqësie	3,000	10,209	7,193
P.03280.O1.A3. Plotësimi i dokumentacionit ligjor teknik për masat MZSH dhe çertifikimi për MZSH i të gjitha objekteve në varësi të Bashkisë	2,600	2,600	
P.03280.O2.A1. Shërbimi i Mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi	42,158	42,158	37,007
Totali	106,380	115,810	52,943

FUNKSIONI 4: ÇËSHTJET EKONOMIKE

Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit ka për qëllim rritjen ekonomike nëpërmje tërheqjes së investitorëve të huaj dhe zhvillimi i NVM-ve. Kjo arrihet nga forcimi i bashkëpunimit ndërmjet pushtetit vendor, bizneseve dhe punëkërkuësve, me qëllim promovimin e forcës aktive të punës, promovimin e produkteve dhe shërbimeve të bizneseve sipas sektorëve të ndryshëm të ekonomisë. në mbështetje të biznesit, si institucion realizojmë panairin e Punës dhe të Biznesit cdo vit brenda ambjenteve të Bashkisë si një mënyre shumë efektive për të venë përballë njeri tjetrit të gjithë aktorët e interesuar në proces. Qëllimi është krijimi i një netëorë-kë që lidh aktorët e interesuar, shkëmben informacionet me synim zbutjen e papunësisë.

Gjithashtu organizimi i panairëve në njësitë administrative nga ana jonë me qëllim promovimin e vlerave artistike – kulturore dhe të produkteve të territorit të njësisë administrative të Bashkisë si dhe në mbështetje të biznesit po hap gjithnjë me shumë mundësinë e bashkëpunimit ndërmjet tyre.

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit

Bashkia Shkodër gjatë vitit 2020 në programin 04130 “Mbështetja për zhvillim ekonomik” ka qëllim të programit të saj këto funksione zhvillimi:

- Hartimi i planeve dhe programeve për zhvillimin ekonomik lokal
- Ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe i rrjetit të tregtisë
- Mbështetje për zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panairë e reklama në vende publike
- Publikimi i broshurave informative, krijimit të portaleve me profil ekonomik.
- Dhënia e granteve dhe ndihmave financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël dhe të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi.

Objektivat për përmbushjen e këtyre funksioneve për 12-mujorin e vitit 2020 janë:

O1. Mbështetja për përmirësimin e klimës për zhvillimin e biznesit nëpërmjet ngritjes së strukturave të dedikuara, bashkëpunimit me institucionet të specializuara dhe aktorët e interesuar për hartimin e strategjive dhe planëve ekonomike zhvillimore lokale.

O2. Promovimi i produkteve vendore dhe fuqisë së punonjësve të specializuar për tregun lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

O3. Hartimi dhe publikimi i materialeve informative dhe promovionale për nxitjen e investimeve vendase dhe të huaja.

O4. Nxitja dhe mbështetja e bashkëpunimit të biznesit vendor, nëpërmjet incentivave financiar, për zhvillimin dhe fuqizimin e tyre.

Përmbledhje e veprimtarisë së realizuar gjatë vitit 2020.

Bashkia Shkodër ka tashmë të konsoliduar vizionin e saj në drejtim të zhvillimit të integruar territorial e cila garanton barazinë në shërbime dhe në akses për të gjithë qytetarët bazuar në një sistem policentrik zhvillimi. Në përmbushje të këtij vizioni, janë hartuar 5 objektiva strategjike, të cilët synojnë të specifikojnë fokusin e zhvillimit të Bashkisë gjatë viteve të ardhshme. I gjithë procesi shoqërohet me ‘monitorimin dhe vlerësimin’ e tij, si mekanizëm tepër i vlefshëm për të treguar nëse burimet në dispozicion janë të mjaftueshme, janë përdorur me efektivitet dhe nëse po



bëhet ajo që është planifikuar. Monitorimi i ecurisë së zbatimit bëhet çdo fund vit fiskal. Objektivat e strategjisë kanë shërbyer si bazë për hartimin e programit buxhetor afatmesëm 2020 – 2022 dhe buxhetit vjetor 2020. Mbi bazën e këtij parimi janë hartuar aktivitetet dhe ka nisur puna për zbatimin e tyre.

Rritja ekonomike dhe hapja e vendeve të reja të punës në ekonomitë në zhvillim, varen nga dy faktorë kryesorë: tërheqja e investitorëve të huaj dhe zhvillimi i NVM-ve. Klima e favorshme e biznesit është thelbësore për tërheqjen e investimeve të huaja dhe për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Në këtë kuadër, politikat e zhvillimit të Bashkisë Shkodër janë fokusuar në zhvillimin e një ekonomie të gjallë për qytetin dhe zonat rurale sipas parimit të plotësueshmërisë ndërmjet qytetit dhe zonave rurale. Bashkia Shkodër gjatë viteve të fundit ka ndërmarrë disa nisma në drejtim të:

- Përmirësimit të kushteve për fillimin dhe zhvillimin e biznesit.
- Thjeshtimit dhe reduktimit të procedurave administrative.
- Forcimit të bashkëpunimit institucional me qëllim promovimin e fuqisë punëtore të kualifikuar.

Vlen të përmenden disa nisma në drejtim të forcimit të bashkëpunimit ndërmjet pushtetit vendor, bizneseve dhe punëkërkesve, me qëllim promovimin e forcës aktive të punës dhe promovimin e produkteve dhe shërbimeve të bizneseve sipas sektorëve të ndryshëm të ekonomisë. Gjithashtu kujdes i veçantë është treguar për integrimin e brezave të rinj në ekonomi dhe krijimin e mundësive për iniciativa të ndryshme.

- a) Funksionimi i platformës **“Tregu i Punës Shkodër”** - Për herë të parë në vendin tonë është krijuar platforma e përbashkët **“Tregu i Punës Shkodër”**, me financim të qeverisë austriake (projekti Seed). Një instrument i cili sjellë sëbashku të gjithë aktorët përgjegjës për çështjet e punësimit, duke ofruar mbështetje në drejtim të aksesit në shërbimet e punësimit, edukimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional. Kjo platformë është pjesë integrale e faqes web të bashkisë.
- b) Nxitja dhe mbështetja e bashkëpunimit të biznesit vendore nëpërmjet iniciativave financiare.
 - Bashkëpunimi me zonën e përmirësimit të biznesit BID Shkodër. Bashkëpunimi me zonën e përmirësimit të biznesit BID Shkodër në rrugën 13 Dhjetori dhe 28 Nëntori. Nga ky bashkëpunim përfitojnë 120 biznese. Po ashtu në mbështetje të biznesit dhe investitorëve vendas dhe të huaj, me shumë interes është realizimi i botimeve dhe materialeve promocionale si: Profili i Bashkisë, Profili i Bizneseve, broshura Investo në Shkodër. Të gjithë këto dokumenta janë realizuar në bashkëpunim me bizneset që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Bashkisë Shkodër.
- c) Mbështetja e bizneseve për aplikime në programet dhe skema të ndryshme financiare. Me qëllim mbështetjen dhe lehtësimin e bizneseve për aplikime në programet dhe skema të ndryshme financiare, Bashkia Shkodër ka ndërmarrë organizimin e një sërë sesionesh informuese me rreth 100 biznese, në bashkëpunim edhe me Delegacionin e Bashkimit

Evropian si dhe me ambasadat e ndryshme, të cilët lançojnë thirrje për projekt propozime me qëllim mbështetjen e sipermarrjeve të reja, të tilla si IPARD, CHALLENGE FUND, etj.

- d) Bashkëpunimi i përvitshëm me artizanët, pjesë e shoqatës së artizaneve. Aktivitetet organizohen mbi bazën e një kalendarit të mirë përcaktuar dhe janë 17 të tilla, gjithsej 65 ditë. Iniciativa të tilla jo vetëm ndikojnë në ruajtjen e trashëgimisë kulturore por ndikojnë edhe në zhvillimin ekonomik.
- e) Bashkëpunimi me bizneset prodhuese, promovimi i trashëgimisë kulturore dhe produkteve vendore. Njohja e territorit dhe promovimi i vlerave të tij në funksion të zhvillimit ekonomik dhe social është një nga prioritetet kryesore të politikave zhvilluese të Bashkisë Shkodër. Integrimi i këtyre elementeve me ofertën turistike, përfaqësojnë një potencial të rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të territorit. Jo pa qëllim Bashkia Shkodër realizon 11 aktivitete promovuese në 11 njësi administrative: ***Të promovohen vlerat e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe produkteve vendase të 11 njësive administrative por mbi të gjitha të kthehet vemendja*** ndaj këtyre zonave, të cilat mbartin vlera të medha të trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Theksojmë faktin se Bashkia Shkodër vit pas viti rrit numrin e bashkëpunëtorëve në nisma të tilla, përmendim këtu bashkëpunimin me Drejtorinë Rajonale të Bujqësisë Shkodër dhe donatorë të huaj. Gjithashtu duke marrë në konsideratë potencialin natyror që territori i Bashkisë Shkodër disponon, ku bujqësia, blegtoria apo pylltaria përbëjnë sektorin kyç të përdorimit të tokës dhe menaxhimit e resurseve natyrore në zonat tona rurale, Bashkia Shkodër e sheh me shumë prioritet zhvillimin e metejshëm të këtij sektori dhe integrimin e tij me ofertën turistike dhe e konsideron një pikë të fortë për zhvillimin e mëtejshëm të agroturizmit dhe eko-turizmit.

Për shkak të situatës së shkaktuar nga Covid 19, këtë vit janë realizuar 6 aktivitete promovuese të vlerave dhe burimeve natyrore të 11 njësive administrative të Bashkisë Shkodër. Me panairin “Vjeshtë në Shkodër” kemi përmbyllur edhe për këtë vit panairin e organizuar në Njësitë Administrative të Bashkisë Shkodër. Edhe pse një situatë e pazakontë për shkak të pandemisë, të gjithë bashkë ia dolëm të vazhdojmë traditën e mirë të krijuar, për promovimin e vlerave njerëzore, natyrore dhe të territorit.

- f) Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile. Një nga objektivat e Bashkisë Shkodër është partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurese. Bashkia Shkodër ka shpallur thirrjen e tretë për projekt propozime në kuadër të Programit Reload. Për vitin 2020 u realizua thirrja e tretë për projekt propozime (me fonde të vetë bashkisë). Në këtë thirrje aplikuan 9 OSHC nga të cilat 4 u shpallën fituese. Vlera e projekteve të fituara për organizatat e shoqërisë civile ishte 6,630,500 lekë. Një tjetër thirrje për projekt propozime është realizuar në kuadër të situatës së shkaktuar nga pandemia Covid 19. Fituese ishte Projekti “Aksion Anti Covid-19”, financuar nga Programi Reload në partneritet me Bashkinë Shkodër dhe zbatuar nga Shoqata The Door. Bashkia Shkodër mori çmimin e parë nga Programi ReLOaD/UNDP për menaxhimin e shpalljes së thirrjeve drejtuar ODHC-ve.

- g) Pjesmarrje në programet dhe projektet e financuara nga Bashkimi Europian dhe shoqata nderkombetare është një tjetër fokus i veprimtarisë sonë. Për vitin 2020 janë realizuar 6 projekte nga të cilat 3 janë aplikime në kuadër të thirrjeve të IPA dhe programe të tjera të financuara nga BE dhe 3 janë projekte që po zbatohen nga bashkia, të të financuara nga BE. Gjithashtu anëtarësimi në forumin e qyteteve që lagen nga deti Adriatik dhe Jon, FAIC është parë me prioritet nga Bashkia Shkodër, si një mundësi e mire për të promovuar territorin tonë.
- h) Organizimi i aktiviteteve informuese dhe promovuese mbi programet dhe projektet e Bashkimit Europian është fokusuar në zhvillimin e aktiviteteve me tema të ndryshme duke filluar nga aktivitetet informuese dhe promovuese për politikën e BE-së dhe ditët e BE-së; Bashkëpunimi me shoqërinë civile në kuadër të shpalljes së thirrjes së hapur për projekt propozime, ekpozitë me krijime letrare me pjesmarrjen e nxënësve të shkollave të 7 njësive administrative të Bashkisë Shkodër; Përgatitja e videove për javën e Evropës; Takime me të rinjtë mbi procesin e integritit evropian dhe rolin e tyre në këtë proces; Kampi veror për fëmijët në vështirësi sociale – ekonomike; Shëndeti i fëmijeve tanë është parësor për ne! Aktivitete për promovimin e biodiversitetit të larmishëm dhe tërheqjen e turistëve të natyrës, dhe jo vetëm, pranë Liqenit të Shkodrës. Promovimi i burimeve dhe ofertës turistike të Shkodrës, sporteve të ujit dhe argëtimit të turistëve; Dorëzimi i cmimit nga Programi ReLOaD/UNDP; [Ndarja e cmimeve në kuadër të Javës së Evropës](#); Njohja me funksionet e sektorit për integrimin evropian, etj. Njëkohësisht janë informuar 190 qytetarë. Kërkesat e qytetarë janë të lidhura me mundësitë e përfitimit nga programet e studimit dhe financimit të projekteve.
- i) Kemi konsoliduar shërbimet administrative të ofruara përmes Zyrave të Integruara me Një Ndalesë. Pranë kësaj zyre ofrohet edhe shërbimi i QKB, i cili është pjesë e veprimtarisë së punës tonë, me qëllim mbështetjen e bizneseve.
- j) Vëmendje të veçantë i është dhënë bashkëpunimit me sektorin privat për krijimin e hapsirave të reja publike për tregtim. Përmendim këtu rastin e ndërtimit të tregut në Zdrall dhe sistemimit të 70 shitës.

Realizimi i buxhetit të planifikuar

Programi	Paga +	Shpenzime	Subvencionë	Transferta	Investime	Totali
04130	Sigurime	operative				



Plani fillestar 2020	1,653	1,356	0	3,906	0	6,915
Plani rishikuar 2020	i 1,653	786	0	4,476	0	6,915
Realizimi viti 2020	1,445	94	0	2,785	0	4,323
% realizimit	87.4	12	0	62.2	0	63

Realizimi i shpenzimeve korente dhe kapitale për kete program krahasuar me planifikimin është në total 63 % sipas zerave me poshte:

Paga dhe sigurime 87.4 %

Shpenzime operative 12 %

Transferta 62.2 %

Anëksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit
 Periudha e Raportimit: 01.01.2020-31.12.2020

Kodi i Programit	4130	Emertimi i programit:	Mbështetja për zhvillim ekonomik						Komente
Qellimi 1	Synojmë që zhvillimi lokal i udhëhequr nga komuniteti të mobilizojë dhe të përfshijë komunitetet dhe organizatat lokale për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të Strategjisë Europë 2020 për rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, duke nxitur kohezionin territorial dhe duke arritur objektiva të caktuara politikash.							
			**Treguesit e performancës/Produktet:					
	Objektivat e politikës:	Kodi i Treguesit të Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit të Performances**/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhës	Niveli i planifikuar në vitin korent	Niveli i rishikuar në vitin korent	Niveli faktik Në fundte vitit korent	% e Realizimit të Treguesit të Performances/Produktit	
Objektivi O1	Mbështetja për përmirësimin e klimës për zhvillimin e biznesit nëpërmjet ngritjes së strukturave të dedikuara, bashkëpunimit me institucione të specializuara dhe aktorët e interesuar për hartimin e strategjive dhe planëve zhvillimore lokale.	1	Numri i projekteve të aplikuara sipas programeve të financuara nga BE dhe Organizata të tjera ndërkombëtare	3	9	9	6	67%	Ka përfunduar faza e vlerësimit të projekteve. Kanë aplikuar 9 prej të cilave 6 kanë qenë fitues të procesit
Objektivi O2	Promovimi i produkteve vendore dhe fuqisë së punonjësve të specializuar për tregun lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.	2	Panaire me produkte dhe shërbime vendore të organizuara në Bashkinë Shkoder	8	10	10	7	70%	Proces i penguar nga pandemia
		3	Permiresimi i shërbimeve për biznesin të ofruara pranë zyrës së QKB	1	1	1	1	100%	Likujduar në masën e parashikuar detyrimet mujore.
Objektivi O3	Hartimi dhe publikimi i materialeve informative dhe promocionale për nxitjen e investimeve vendase dhe të huaja.	4	Publikime & Botime për zhvillim ekonomik.	0	1	1	0	0%	Proces i penguar nga pandemia
Objektivi O4	Nxitja dhe mbështetja e bashkëpunimit të biznesit vendor nëpërmjet incentiveve financiare, për zhvillimin dhe fuqizimin e tyre.	5	Iniciativa të mbështetura financiarisht për përmirësimin e klimës së biznesit	1	2	2	1	50%	Realizuar pjesërisht

Anëksi nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit të treguesve të performances/produkteve të programit"

Emri Grupit	Bashkia Shkoder	Kodi i Grupit	141
--------------------	-----------------	----------------------	-----

Programi	Mbështetja për zhvillim ekonomik	Kodi i Programit	4130
-----------------	----------------------------------	-------------------------	------

Kodi	Emertimi i Produktit	Njësi amate se	Sasia Faktike (sipas vitit paraardhes)	Shpenzimet (sipas vitit paraardhes)	I			II			III			IV			Luhatjet në Koston për Njësi			Komente
					Kosto për Njësi (sipas vitit paraardhes)	Sasia (sipas planit të vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit të vitit korent)	Kosto për Njësi (sipas planit të vitit korent)	Sasia (sipas planit të vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit të vitit korent)	Kosto për Njësi (sipas planit të vitit korent)	Sasia Faktike (Në fund të vitit korent)	Shpenzimet Faktike (Në fund të vitit korent)	Kosto për Njësi Faktike (Në fund të vitit korent)	V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III			
1	Numri i projekteve të aplikuara sipas programeve të financuara nga BE dhe Organizata të tjera ndërkombëtare.	Numer projektesh	3	1,268	423	9	936	104	9	936	104	6	83	14	-409	-90	-90	Ne proces, eshte zhvilluar faza e vleresimit dhe jane perzgjedhur projektet fituese. Jane lidhur kontratat per 5 projektet fituese dhe 4 prej tyre janë likuiduar. Financiarisht eshte likujduar fatura e regjistrimit te Brandit dhe pagesa e anëtarësimit ne FAIK.		

2	Panaire me produkte dhe sherbime vendore të organizuara në Bashkinë Shkoder	nr paniaresh	8	1,924	241	10	2,440	244	10	2,440	244	7	1,877	268	28	24	24	Jane zhvilluar 7 aktivitete nga 10 te parashikuara, ka përfunduar procesi I likuidimit te tyre	
3	Permiresimi i shërbimeve per biznesin të ofruara prane zyres se QKB	dite	1	1,238	1,238	1	1,739	1,739	1	1,739	1,739	1	1,531	1,531	293	-208	-208	Realizuar sipas planifikimit	
4	Publikime & Botime per zhvillim ekonomik	nr botimesh	0	0	0	1	200	200	1	200	200	0	0	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	Aktiviteti I perealizuar	
5	Iniciativa te mbeshtetura financiarisht per permiresimin e klimes se biznesit	numer	1	1,600	1,600	2	1,600	800	2	1,600	800	1	833	833	-767	33	33	Aktiviteti I realizuar, pagesa është në process likuidimi	
				6.030					6.915					6.915					4,324

Gjatë 12 mujorit të vitit 2020 është punuar për përmbushjen e objektivave nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Buxhetin e Bashkisë Shkodër për Programin 04130 “Mbështetja për zhvillim ekonomik”

Tabela e produkteve dhe realizimi i tyre nga pikpamja financiare.

Aktiviteti	Buxheti fillestar në 000/Leke	Buxheti korigjuar në 000/Leke	Realizimi Viti 2020 në 000/Leke
P04130.O1.A1. Monitorimi dhe Vlerësimi i strategjise se zhvillimit të Bashkisë Shkodër	0	0	Realizuar
P04130.O1.A3. Krijimi i instrumentit financiar për forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve nëpërmjet aplikimeve në bazë projekti për ofrimin e shërbimeve cilësore në komunitet (ReLoad)	536	536	Realizuar
P04130.O1.A4. Pjesmarrje në programet dhe projektet e financuara nga Bashkimi Europian, Organizata të tjera ndëkomëtare si dhe anëtaresimi në shoqata nderkombetare.	400	400	83
P04130.O1.A5. Organizimi i aktiviteteve informuese dhe promovuese mbi programet dhe projektet e Bashkimit Europian nëpërmjet Kendit të BE Shkoder,	0	0	Realizuar
P04130.O1.A6. Informimi në menyre periodike për publikun dhe grupet e tjera të interesit për procesin e Integritimit Evropian, Kendi BE Shkoder,	0	0	Realizuar
P04130.O2.A1. Organizimi i një panairi pune dhe bizneseve në Bashkinë Shkodër	300	300	0
P04130.O2.A2. Panairi i produkteve agroperpunuese sipas njësive administrative	700	700	660
P04130.O2.A3. Panair i promovimit të vlerave dhe produkteve të territorit (për Njësitë Administrative)	1,440	1,440	1,217
P04130.O2.A4 Shërbimet e deleguara të QKB	1,739	1,739	1,531
P04130.O3.A1 Botimi i profilit të bizneseve të Bashkise Shkoder në anglisht	200	200	0
P04130.O3.A2. Ristrukturimi dhe pasurimi i faqes web të Bashkise	0	0	Realizuar
P04130.O4.A1. Bashkëpunimi me Zonën e permirësimit të biznesit (BID) në rrugën 13 Dhjetori dhe 28 Nëntori	1,600	1,600	833

P04130.O4.A3. Mbështetja dhe lehtësimi i bizneseve për aplikime në programet dhe skema të ndryshme financiare.	0	0	Realizuar
Totali	6,915	6,915	4,323

Përshkrimi i aktiviteteve

P04130.O1.A1. Monitorimi dhe Vlerësimi i strategjisë së zhvillimit të Bashkisë Shkodër

Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor konsiderohet si një instrument i rëndësishëm për zhvillim, i cili përfshin identifikimin dhe shfrytëzimin kryesisht të burimeve vendore, ideve dhe aftësive për të stimuluar rritjen dhe zhvillimin ekonomik. Ky proces shoqërohet me monitorimin dhe vlerësimin e tij, si mekanizëm tepër i vlefshëm për të treguar nëse burimet në dispozicion janë të mjaftueshme, janë përdorur me efektivitet dhe nëse po bëhet ajo që është planifikuar. Si rrjedhojë, Bashkia Shkodër ka përgjegjësinë e garantimit, që plani i zhvillimit ekonomik të përmbushë objektivat e deklaruara dhe me efektivitet kostoje për dy arsye kryesore, marrjen e vendimeve dhe vendosjen e përgjegjshmërisë. Qëllim është të monitorojë dhe vlerësojë Planin e Përgjithshëm Vendor, të raportojë mbi bazën e alokimit faktik të burimeve financiare dhe të matë rezultatet e arritura në raport me rezultatet e planifikuara.

Objektivat e Planit të Përgjithshëm Vendor kanë shërbyer si bazë për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2021 - 2023, duke realizuar kështu një lidhje integrale të objektivave dhe planit të veprimit të strategjisë së zhvillimit me projektet e parashikuara në secilin nga programet buxhetore të Bashkisë Shkodër. Mbi bazën e këtij parimi është realizuar kuadri logjik i PBA-së dhe është bërë ndarja e burimeve të disponueshme për secilin program buxhetor. Prandaj monitorimi i ecurisë së zbatimit u bë mbështetur në informacionet për gjendjen e zbatimit dhe të financimit të projekteve të strategjisë deri në prill të vitit 2020. Burimet kryesore të informacionit për mbledhjen e të dhënave zyrtare janë: informacioni i siguruar nga drejtoritë dhe drejtoritë e varësisë dhe raportimi i zbatimit dhe monitorimit të buxhetit të vitit 2018, 2019 dhe raportimi 4 mujor i vitit 2020 të Bashkisë Shkodër. Për zbatimin e suksesshëm të strategjisë procesi i saj do të marrë në konsideratë realizimin e projekteve specifike si dhe dinamikën dhe nevojat në territor. Është përgatitur raporti vjetor i monitorimit për vitin 2020.

P04130.O1.A3. Krijimi i instrumentit financiar për forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve nëpërmjet aplikimeve në bazë projekti për ofrimin e shërbimeve cilësore në komunitet (ReLoad)

Pjesëmarrja në Programet Europiane është projektuar për t'u mundësuar shteteve, njohjen me metodat dhe politikat e Bashkimit Europian (BE). Anëtarësimi në Bashkimin Europian (BE) konsiderohet si një sfidë, por gjithashtu integrimi europian është prioriteti kryesor për Shqipërinë dhe një rol të rëndësishëm luan edhe qeverisja vendore. Shqipëria përfiton nga Programet Europiane dhe në këtë kuadër edhe njësitë e qeverisjes vendore kanë të drejtë të përfitojnë nga financimi i fondeve të BE-së. Shkalla e përfitimit të fondeve të BE-së në nivel vendor varet nga angazhimi i njësisve vendore në këtë proces. Duke marrë në konsideratë rëndësinë e bashkëpunimit

ndërkufitar dhe rajonal, Bashkia Shkodër shpreh angazhimin e saj për marrjen pjesë në Programet e BE-së me qëllim rritjen e shërbimeve publike për qytetarët me standarde europianë. Konkretisht Bashkia Shkodër është shpallur fituese në thirrjen lançuar nga Programi Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD). Ky Program është një iniciativë rajonale tre-vjeçare e financuar me fonde të Bashkimit European nga Instrumentet e Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA) dhe zbatohet nga UNDP në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor. Referuar kushteve të Programit ReLOaD, Bashkia Shkodër merr përsipër përgjegjësinë e bashkëfinancimit në masën 22% të vlerës së projekti ReLOaD. Bashkëfinancimi do të programohet i ndarë në dy vite buxhetore për periudhën e kohëzgjatjes së projektit 2018 – 2020. Bashkia Shkodër angazhohet që gjatë periudhës kohore 2018 – 2020 të organizojë tre thirrje publike, nga të cilat, dy të parat do të financohen nga shuma e alokuar e grantit (fondet e PNUD dhe 22% bashkëfinancimi i bashkisë) dhe thirrja e fundit do të financohet nga fondet e vetë bashkisë. I gjithë procesi do të konsultohet me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile. Për tre thirrjet e organizuara do të zbatohet Metodologjia LOD. në muajin Mars të vitit 2020 u hap thirrja e treta e projektit. Thirrja u realizua mbi bazën e dokumentave strategjike dhe prioritetëve që Bashkia Shkodër ka. Ka perfunduar faza e parë e vlerësimit të projekteve, nderkohe qe projektet kane kaluar edhe fazën të dyte vlerësimi. Në përfundim të procesit të vlerësimit të projekteve, u shpallen 5 fitues për projektet me të mira aplikuese. Nga këto 5 projekte, 4 janë përfunduar, ndërsa një është në proces, për shkak të situatës së shkaktuar nga pandemia COVID-19. Gjithashtu është realizuar Projekti ‘‘Aksion Anti Covid-19’’, financuar nga Programi Reload në partneritet me Bashkinë Shkodër dhe zbatuar nga Shoqata The Door.

P04130.O1.A4. Pjesmarrje në programet dhe projektet e financuara nga Bashkimi European dhe Organizata të tjera ndëkomëtare.

Procesi i integritimit evropian është sfida dhe prioriteti kryesor për Shqipërinë, ku pa dyshim një rol të rëndësishëm në këtë proces luan edhe qeverisja vendore. Mjetet me të cilin BE mbështet Shqipërinë në rrugën e saj drejt anëtarësimit janë programet e BE-së. Në këtë kuadër njësitë e qeverisjes vendore kanë të drejtë të përfitojnë nga financimi i fondeve të BE-së. Shkalla e përfitimit të fondeve të BE-së në nivel vendor varet nga angazhimi i njërive vendore në këtë proces. Prandaj është me shumë rëndësi që qeverisja vendore të fokusojë prioritetet e saj edhe në drejtim të forcimit të bashkëpunimit rajonal dhe ndër-rajonal duke aplikuar në programe të ndryshme të BE-së.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e bashkëpunimit ndërkufitar dhe rajonal, Bashkia Shkodër shpreh angazhimin e saj për marrjen pjesë në Programet e BE-së me qëllim rritjen e shërbimeve publike për qytetarët me standarde të përafuara europianë. Konkretisht Bashkia Shkodër është aplikuese në disa nga programet e financuara nga BE-së dhe një ndër specifikat e thirrjeve për projekte është edhe bashkëfinancimi. Kështu për projektet e shpallura fituese nga Bashkimi European, Bashkia Shkodër merr përsipër bashkëfinancimin e projekteve fituese sipas specifikave të programeve të BE-së. Në këtë kuadër lind e nëvojshme parashikimi i një fondi për bashkëfinancim në zërat e buxhetit vjetor dhe afatmesëm.

Nga kjo fishe është bere kesti i dyte i pageses për rregjistrimin të Markes Zyrtare të Bashkise Shkoder “ Shkodra Tourist Official Brand” produkt ky i “Mandarina Project” financuar nga fondet e BE nëpermjet projektit RELOAD.

P04130.O1.A5. Organizimi i aktiviteteve informuese dhe promovuese mbi programet dhe projektet e Bashkimit European nepermjet Kendit te BE Shkoder

Janë realizuar 42 aktivitete. Zhvillimi i aktiviteteve dhe temat e trajtuara për vitin 2020 kanë qënë të ndryshme duke filluar nga aktivitetet informuese dhe promovuese për politikat e BE-së dhe ditët e BE-së; Bashkëpunimi me shoqërinë civile në kuadër të shpalljes së thirrjes së hapur për projekt propozime, ekpozitë me krijime letrare me pjesmarrjen e nxënësve të shkollave të 7 njësive administrative të Bashkisë Shkodër; Përgatitja e videove për javën e evropës; Takime me të rinjtë mbi procesin e integritit evropian dhe rolin e tyre në këtë proces; Kampi veror për fëmijët në vështirësi social – ekonomike; Shëndeti i femijeve tanë është parësor për ne! Aktivitete për promovimin e biodiversitetin të larmishëm dhe tërheqjen e turistëve të natyrës, dhe jo vetëm, pranë Liqenit të Shkodrës. Promovimi i burimeve dhe ofertës turistike të Shkodrës, sporteve të ujit dhe argëtimit të turistëve; Dorëzimi i cmimit nga Programi ReLOaD/UNDP; Ndarja e cmimeve në kuadër të Javës së Evropës; Njohja me funksionet e sektorit për integritin evropian, etj.

P04130.O1.A6. Informimi në menyre periodike për publikun dhe grupet e tjera të interesit për procesin e Integritit Evropian, Kendi BE Shkoder

Projekti “Bashkitë për në Evropë”, i mbështetur nga Bashkimi European, synon fuqizimin e pushtetit vendor në Shqipëri gjatë procesi të integritit. Në kuadër të këtij projekti është ngritur zyra e çështjeve të BE-së pranë 61 bashkive. Kjo zyrë luan një rol të rëndësishëm në promovimin e parimeve të BE-së në nivel vendor si dhe sherben si një urë për absorbimin e fondeve/programeve të BE. Ketu behet informimi në mënyrë periodike i publikut dhe i grupeve të tjera të interesit për procesin e integritit evropian, për politikat e BE-së dhe mundësitë për përfitim nga asistenca e Bashkimit Evropian, nëpërmjet këndit të Bashkimit Evropian, i cili është krijuar dhe funksion brenda bashkisë.

Në këtë kuadër zyra e çështjeve të BE-së Shkodër do të sigurojë dhënien e informacionit të nevojshëm për publikun dhe grupet e tjera të interesit për procesin e integritit evropian, për politikat e BE-së dhe mundësitë për përfitim nga asistenca e Bashkimit Evropian. Njëkohësisht do të bëjë shpërndarjen e materialeve promovuese mbi fondet, programet dhe projektet e BE-së. Përgjithësisht kërkesat e qytetareve në këtë periudhe kanë qënë të lidhura me mundësitë e financimit të projekteve.

Edhe pse kemi hasur veshitësi gjate kesaj periudhe është kryer onlinë mbatja e kontakteve me OSHC-te mbi sqarimet në lidhje me procesin e monitorimit te thirrjes se III-te per projektet qe jane në zbatim, si dhe mbatja e kontakteve me projektin ‘Bashkite per në Evrope’ dhe raportimi në lidhje me informacionin e kerkuar mbi aksesin në fondet e BE nga Bashkia Shkoder.

Rreth 190 qytetarë janë drejtuar pranë Këndit të BE për marrje informacioni.

Kërkesat e qytetarë janë të lidhura me mundësitë e përfitimit nga programet e studimit dhe financimit të projekteve.

P04130.O2.A1. Organizimi i një panairi punë dhe bizneseve në Bashkinë Shkodër

Rajoni i Shkodrës, është i prekur nga një numër i lartë i të papunëve. Në Universitetin e Shkodrës si dhe në shkollat profesionale çdo vit diplomohen një numër i konsiderueshëm studentësh, të cilët kanë vështirësi të integrohen në tregun e punës. Nga ana tjetër në Bashkinë e Shkodrës operojnë një numër relativisht i mirë i aktivitetëve ekonomike të sektorëve të ndryshëm të cilët gjithashtu herë pas here kanë vështirësi në gjetjen e punonjësve e sidomos të atyre të kualifikuar. Kjo gjë ndodh nga mungesa e informacionit si për vendet e punës së disponueshme por gjithashtu edhe për mundësitë që kanë bizneset për të punësuar punonjës të kualifikuar. Për këtë arsye, Bashkia Shkodër realizon panairin e punës me pjesëmarrjen e aktorëve të rëndësishëm në këtë proces ku mund të përmendim Zyren Rajonale të Punësimit Shkoder, Qendren e Formimit Profesional, Universitetin e Shkodrës, shkollat e mesme profesionale dhe bizneset që kanë aktivitet në Shkodër e më gjërë. Ky panair synon të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të tregut të punës, nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit dhe shkëmbimit midis autoriteteve vendore, institucionëve, partnerëve socialë dhe të sektorit privat, në një partneritet lokal të qëndrueshëm për punësim. Ky aktivitet është realizuar çdo vit gjate javes se dyte apo të trete të muajit dhjetor. Kete vit gjithashtu është i parashikuar në këtë periudhe të vitit.

Për shkak të situatës së shkaktuar nga pandemia COVID-19, panairi i punës dhe bizneseve nuk është realizuar.

P04130.O2.A2. Panairi i produkteve agroperpunuese sipas njësive administrative

Bashkia Shkodër për shkak të pozicionimit gjeografik dhe resurseve natyrore që disponon ka potenciale të madhe për zhvillimin ekonomik. Baza ekonomike është blegtoria, sidomos në zonën malore të saj, ndërsa në zonën fushore përparësi ka bujqësia, kryesisht drithërat e bukës. Përveç tyre, produkte të tjera tipike të zonës janë të lidhura me vreshtarinë, ullishtat dhe frutat/perimet. Po ashtu, afërsia me liqenin ka nxitur edhe peshkimin. Sektori i agropërpunimit është një ndër sektorët e ekonomisë e cila gërsheton potencialet e burimeve natyrore, pozitën gjeografike, traditën e rajonit por gjithashtu edhe interesin në rritje të aktorëve dhe partnerëve të rëndësishëm për rajonin. Si e tillë vërehet praninë e bizneseve agro perpunuese të lidhura drejtpërdrejt me tregtinë. Por përtej mundësive që vendi ofron ky sektor ndeshet me disa problematika që kanë të bëjnë kryesisht me investimet për modernizimin e teknologjisë, standardizimin, konkurrueshmërinë, nxitjen e promovimit të markave rajonale, kapacitetet menaxhuese etj. Në këtë kuadër me qellim zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse bashkia ka parashikuar organizimin e panairove të produkteve agropërpunuese. Në këtë panair prezantohen të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Shkodër me produktet vendase, me pasuritë e tyre kulturore dhe ushqimin tradicional. Ky aktivitet është zhvilluar zakonisht në muajt e sezonit të vjeshtës, në kete periudhe është planifikuar dhe per kete vit. Aktualisht është në proces puna pergatitore per organizimin e ketij aktiviteti.

Kjo traditë do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme me më shumë prodhues e më shumë prodhime vendase pasi është gjithmonë në rritje edhe kërkesa e fermerëve për të marre pjese në panair.

Me panairin “Vjeshtë n’Shkodër” kemi përmbyllur edhe për këtë vit panairët e organizuara në Njësitë Administrative të Bashkisë Shkodër.

P04130.O2.A3. Panair i promovimit të vlerave dhe produkteve të territorit (për Njësitë Administrative)

Territori i ri i Bashkisë Shkodër, si nga morfologjia e territorit dhe burimet natyrore ashtu dhe nga mënyra e zhvillimit është një territor shumë i larmishëm dhe dinamik. Si i tillë përveç potencialeve të shumta natyrore, paraqet edhe potenciale të trashëgimisë materiale dhe shpirtërore të zonës. Qyteti, rrethinat dhe malësitë e bashkisë Shkodër janë dalluar për prodhimet artizanale si punimet prej thupre, bakri, argjendi e druri, qëndisimat, qilimat, etj. Gjithashtu e gjithë zona është karakterizuar nga veshje tradicionale funksionale për çdo ceremoni dhe për jetën e përditshme. Një larmi tejet të madhe edhe në shkallë vendi paraqet bashkia për sa i përket pasqyrimin të shpirtit njerëzorë përmes këngës. Po ashtu Bashkia e re është dalluar për një numër të madh prodhimesh tradicionale me bazë burimet dhe kushtet natyrore të saj. Në këtë kuadër janë parashikuar panairë në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Shkodër. Aty prezantohen pasuritë e tyre kulturore, veshje, grupe folklorike dhe ushqim tradicional. Keto panairë të organizuara edhe në vitet paraardhese janë vlerësuar si një mundësi shumë e mirë për të promovuar vlerat kulturore, pasuritë natyre që vendi ka por edhe produktet e sektorit të agrobiznësit. Ky aktivitet konsiston në dy drejtime: organizimin e aktivitetit artistik të vlerave kulturore të zonave (promovimin e veshjeve tradicionale, këngë dhe valle të zonave) si dhe organizimin e panairit të produkteve të territorit. Organizimi i këtyre panairëve është parashikuar të shpendahet përgjate muajve të vitit. Deri në fund të muajit gusht janë organizuar tre aktivitete.

Në fund të vitin 2020 u realizuan gjashtë panairë në Njësitë Administrative të Bashkisë Shkodër.

P04130.O2.A4 Shërbimet e deleguara të QKB

Pagesa e punonjësve të QKB pranë institucionit tonë bëhet në mbështetje të nënit 8, pika 1 dhe 2; dhe nënit 9, pika 2, të ligjit nr 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznësit” .

Në zbatim ligjit, Bashkia Shkodër ka lidhur me QKB-në, marrëveshjen e bashkëpunimit nr 6074 date 25.05.2016 ku në nënin 5 pika 1 përcaktohet:

“Niveli i pagave dhe shpërblimeve të nëpunësve në sportelet e shërbimit, pranë njësisë së qeverisjes vendore , përcaktohen me vendim të këshillit bashkiak duke marrë në konsideratë fondin e deleguar nga QKB –ja për këtë qëllim.

Keto funksionë të deleguara tashme kryhen nga Bashkia dhe gjithashtu me Vendimin e Keshillit Bashkiak “ Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe të institucionëve të varësisë”. Janë përcaktuar disa nivele page në kategorinë e pozicionit ku paguhen nëpunësit e sporteleve të shërbimit të QKB-së.

Aktualisht janë dy punonjës që ofrojnë shërbimin pranë zyrës së QKB në Bashkinë Shkodër. Permiresimi i vazhdueshëm i shërbimit është një nga pikat e forta të QKB dega Shkodër. Sot cdo kerkese procesohet brenda 24 oreve dhe ka perfunduar procesi i likuidimit të pagave dhe sigurimeve shoqerore për muajt e pare të vitit. Ka perfunduar gjithashtu procedura e prokurimit per blerjen e kancelarise si dhe eshte lidhur kontrata.

P04130.O3.A1 Botimi i profilit të bizneseve të Bashkisë Shkodër në anglisht

Me ndarjen e re territoriale, territori i Bashkisë Shkodër është zgjeruar, duke rritur kështu edhe gamën e produkteve që ofron zona. Duke marrë parasysh kërkesat në rritje të tregut ndërkombëtar për këto produkte që ofron territori jonë, lind nëvoja për rritjen e imazhit të këtyre produkteve të prodhuara në territorin tonë dhe të destinuara për tregjet rajonale e me gjerë.

Hartimi i Profilit të Bizneseve të Bashkisë Shkodër u realizuar në vitin 2018 ku ofrohet një përmbledhje të historive të suksesit disa bizneseve prodhuese, duke bërë një historik të shkurtër që nga krijimi i tyre e deri në ditët tona, e gjitha kjo e pasuruar edhe me llojet e produkteve që këto ndërmarrje prodhojnë. U zgjodhën biznese me një historik të konsoliduar në sektorin prodhues. Nga hartimi i këtyre profileve u botua një katalog, i cili ofron një panoramike të sipërmarrjeve lokale dhe produkteve të tyre, duke i dhënë mundësinë çdokujt të njohë më mire prodhimet apo shërbimet që ato ofrojnë, kapacitetin e prodhimit etj. Ketë vit Profilin e Bizneseve të Bashkisë Shkodër do e sjellim me informacion të rifreskuar dhe në gjuhën angleze me qëllim promovimin e bizneseve tona prodhuese edhe në tregun ndërkombëtar. Aktualisht jemi në procesin e mbledhjes së informacionit të ri dhe rifreskimit të atij ekzistues.

Botimi nuk është realizuar për shkak se nuk është arritur të merret informacioni i plotë, si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19.

P04130.O3.A2. Ristrukturimi dhe pasurimi i faqes web të Bashkisë

Bashkia Shkodër nëpërmjet faqes së saj të internetit ofron informacionë të ndryshme për shërbime ndaj qytetarëve, bizneseve si dhe informacionë të ndryshme informative statistikore dhe social kulturore. Kjo faqe web është pasuruar dhe më tej në lidhje me rikonceptimin e strukturës së informacionit dhe shërbimeve që ofron ndaj të bërit biznes në Shkodër. Procesi i pasurimit të faqes web të Bashkisë Shkodër është i vazhdueshëm gjatë gjithë vitit.

P04130.O4.A1. Bashkëpunimi me Zonën e përmirësimit të biznesit (BID) në rrugën 13 Dhjetori dhe 28 Nëntori

Qëllimi i këtij bashkëpunimi është mbështetja e biznesit të vogël për t'u konsoliduar, nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të zonës së përmirësimit të biznesit, për ta kthyer atë në një vend tërheqës për vizitorin. Nga ky bashkëpunim përfitojnë rreth 120 biznese. Në zbatim të programit të bashkëpunimit, me qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e klimës së biznesit në zonë është në proces të vazhdueshëm komunikimi dhe bashkëpunimi me përfaqësues të zonës BID.

Është realizuar aktiviteti, por diferenca e vlerës së mbetur është në proces likuidimi, sepse përkon me aktivitetin e fundvitit dhe likuidimi përfundim në janar të vitin 2021.

P04130.O4.A3. Mbështetja dhe lehtësimi i bizneseve për aplikime në programet dhe skema të ndryshme financiare.

Bizneset ekzistuese në Shkodër kanë hasur vështirësi për të aplikuar në programet dhe në skemat e ndryshme financiare qeveritare. Kjo ka ardhur si rezultat i mungesës së informacionit dhe gjithashtu vështirësive që hasin në plotësimin e dokumentacionit ligjor, sipas udhëzimeve të përcaktuara nga ministria e linjës apo edhe nga rregulloret e programeve të ndryshme. Programet mbështetëse dhe instrumentat financiare qeveritare janë një mënyrë e mirë për rritjen e

konkurrencës në sektorin e bujqësisë dhe industrisë ushqimore, në rritjen e qëndrueshmërisë ekonomike të zonave malore të disavantazuara, rritjen e ekonomisë lokale nga njëra anë dhe nga ana tjetër përforcimi i marrëdhënieve ekonomike me Bashkimin Europian, mbrojtjen e mjedisit, nxitjen e transportit të qëndrueshëm dhe të infrastrukturës publike etj. Në këte kuader Bashkia Shkoder jep asistencen e saj për plotësimin e dokumentacionit për aplikim për ato subjekte qe kanë nevojë si dhe i mban të informuar ato për thirrje të ndryshme që hapen gjatë vitit.

Bashkia Shkodër ka ndërmarrë organizimin e sesioneve informuese me rreth 30 biznese, në bashkëpunim me Ambasadën Suedeze në kuadër të programit CHALLENGE FUND.

Programi 04160: Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit

Bashkia Shkodër gjatë vitit 2020 në programin 04160 “Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi” ka fokusuar përpjekjet e saj në 1 funksion zhvillimi

- Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi

Objektivat për perbushjen e ketyre funksionëve per 12-mujorin e vitit 2020 janë:

O1. Sistemimi dhe ngritja e tregjeve të shitjes me shumicë dhe pakicë në territorin e Shkodrës

Realizimi i buxhetit të planifikuar per programin :Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi

Programi 04160	Paga + Sigurime	Shpenzime operative	Subvencionë	Transferta	Investime	Totali
Plani fillestar 2020	0	1,500	0	0	0	1,500
Plani rishikuar 2020	0	1,500	0	0	0	1,500
Realizimi viti 2020	0	144	0	0	0	144
% realizimit	0	9.6	0	0	0	9.6

Realizimi i shpenzimeve korentë dhe kapitale per ketë program krahasuar me planifikimin është në total 9.6 % sipas zerave me poshtë:

Shpenzime operative 9.6 %

Si rezultat i situates se krijuar nga COVID-19 dhe eshte shtyre ne kohe mirembajtja e vendeve te shitjes ne Markaton e Rusit.

Realizimi i treguesve të performancës

Anëksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

Periudha e Raportimit: 01.01.2020-31.12.2020

Kodi I Programit	4160	Emertimi programit:	Shërbimet e tregjeve, akreditimi dhe inspektimi					Komente	
Qellimi 1	Synojmë që zhvillimi lokal i udhëhequr nga komuniteti të mobilizojë dhe të përfshijë komunitetet dhe organizatat lokale për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të Strategjisë Europë 2020 për rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, duke nxitur kohezionin territorial dhe duke arritur objektiva të caktuara politikash.							
			**Treguesit e performancës/Produktet:					
	Objektivat e politikës:	Kodi i Treguesit të Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhes	Niveli i planifikuar r në vitin korent	Niveli i rishikuar në vitin korent	Niveli faktik Në fundte vitit korent	% e Realizimit të Treguesit të Performances/Produktit	
Objektivi O1	Sistemimi dhe ngritja e tregjeve të shitjes me shumicë dhe pakicë në territorin e Shkodrës.	1	Mirembajtja e tregjeve ekzistuese	1	1	1	1	100%	Likujduar ne masen e parashikuar detyrimet mujore per FSHU

Realizimi i produkteve

Anëksi nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit të treguesve të performances/produkteve të programit"

P08220.O1.A3	Materiale promocionale për rrjetin muzeal.	60	60	60
P08220.O1.A4	Blerje paisje për Vendin e Dëshmisë dhe Kujtesës	-	-	-
P08220.O1.A5	Publikime promocionale, fletpalosje e guidë për Vendin e Dëshmisë e Kujtesës	150	150	90
P08220.O1.A6	Cikël takimesh dhe bisedash mbi historinë dhe të kaluarën e Shqipërisë dhe Shkodrës në veçanti	70	70	9
P08220.O1.A7	Mirëmbajtje ndërtesës së VDK	300	300	192
P08220.O1.A8	Dita Ndërkombëtare e Muzeumeve.	30	30	-
P08220.O2.A1	Zhvillimi dhe pasurimi i fondit të bibliotekës	1,040	1,040	744
P08220.O2.A2	Administrimi dhe menaxhimi i Degës ekonomike të kulturës	22,600	22,600	15,434
P08220.O2.A3	Periodiku Gegnia	438	438	346
P08220.O2.A4	Festivali letrar i Shkodrës	50	50	43
P08220.O2.A5	Mbështetje për funksionimin e Galerisë së Arteve Shkodër.	340	340	254
P08220.O2.A6:	Të shkruajmë për fëmijë.	30	30	-
P08220.O3.A1	Ditët e Kosovës.	-	-	-
P08220.O3.A2	Mbështetje për menaxhimin e Teatrit Migjeni	5,651	5,651	4,677
P08220.O3.A3	Administrimi dhe Menaxhimi i Teatrit "Migjeni"	22,857	22,857	20,823

P08220.O3.A4	Administrimi dhe menaxhimi I Qendrës kulturore Pjetër Gaci	3,671	3,671	3,076
P08220..O3.A5	Orkestra Frymore Honorare vjetore	4,532	4,532	3,502
P08220.O3.A6	Takim ndërkombëtar bandash frymore në Shkodër.	1,500	1,500	-
P08220.O3.A7	Çmimi “Pjetër Gaci”	1,309	1,309	775
P08220.O3.A8	“Ahengu Shkodran”	478	478	313
P08220.O3.A9	“Honorare " Grupi i Valleve”	720	720	551
P08220.O3.A10	Festivali i Këngës Qytetare “Luleborë”.	3,500	3,500	2,975
P08220.O3.A11	“Koncert – Premierë i Orkestrës Frymore”	234	234	174
P08220.O3.A12	“Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Këngës Qytetare”	320	320	238
P08220.O3.A14	Festival burimor	200	200	-
P08220.O3.A15	Dita ndërkombëtare e Jazz-it	200	200	-
P08220.O3.A16	Pjese Teatrore 1	1,500	1,500	1,190
P08220.O3.A17	Pjese Teatrore 2	2,150	2,150	1,800
P08220.O3.A18	Pjese Teatrore 3	1,200	1,200	-
P08220.O3.A19	Variete	1,000	1,000	-
P08220.O3.A20	Shfaqje për fëmijë+Teatri i kukllave	1,000	1,000	255
P08220.O3.A21	Pranverë me këngë.	650	650	506
P08220.O3.A22.	Festival teatri me shkollat e mesme.	300	300	255
P08220.O3.A23.	Honorare aktorë të teatrit të kukullave.	500	500	425
P08220.O3.A24	Dita e Luleve 6 Maj	500	500	-
P08220.O3.A25	Ndërmendje	1,080	1,080	-
P08220.O3.A26	Aktivitete me rastin e 2 Prillit	270	270	18
P08220.O3.A27	Festival Jazz-i.	1,900	1,900	1,900

P08220.O3.A28	Koncertet e Verës	600	600	-
P08220.O3.A29	Karnavalet	500	500	500
P08220.O3.A30	Shkodra n'fest	520	520	-
P08220.O3.A31	Festa e Muzikës	500	500	-
P08220.O3.A32	Festa trashëgimisë kulturore	800	800	800
P08220.O3.A33	Honorare anëtarët e këshillit kulturor artistik	200	200	117
P08220.O3.A34	Lëvizja e Postribës	30	30	20
P08220.O3.A35	Ekspozita “Salloni i vjeshtës ”	535	535	315
P08220.O3.A36	Cmimi Idromeno.	322	322	71
P08220.O3.A37	“Personazh i ftuar”- Ekspozitë personale e një personaliteti të artit pamor shqiptar të ftuar nga Galeria e Arteve e Shkodrës.	210	210	59
P08220.O3.A38	Takimet publike -bisedat publike mbi artin dhe ëorkshop me artistë të rinj	232	232	143
P08220.O3.A39	Aktivitete artistike në partneritet individë dhe shoqata kulturore.	86	86	57
P08220.O3.A40	Rikonstruksion I sallave ekspozuese të Galerisë së Arteve Shkodër.	-	-	-
P08220.O3.A41	Muzeu I Arteve Pamore " Lin Delija "	-	-	-
	Totali	87,665	87,665	62,962

Përshkrimi i aktiviteteve:

P08220.O1 .A1: "Java e Pavarësisë" Ekspozitë me karakter historik dhe artistik

Bashkia Shkodër në bashkëpunim me institucionet e saj të varësisë, çdo vit organizon kalendarin e aktiviteteve që do të zhvillohen gjatë javës së pavarësisë.

Këtë vit, të gjëndur në një situatë të pazakontë, në pandemi globale, disa nga aktivitetet e parashikuara nuk u realizuan.

Nën respektimin e të gjitha masave për parandalimin e përhapjes së COVID-19, gjatë kesaj jave arritëm të realizonim vëtëm këto aktivitete:

25 nëntor 2020, ekspozita “Arti për të mos harruar”, në Vëndi i Dëshmisë dhe Kujtesës;

26 nëntor 2020, “Miku i vogël i librit”, në bibliotekën “Marin Barleti”;

28 nëntor 2020, Ceremonia zyrtare e festës së flamurit.

P08220.O1.A2: Mbështetje për funksionimin dhe shërbimin në vazhdimësi të Muzeut Historik.

Me datë 6 Mars 2020 në Muzeun Historik, banesa “Oso Kuka” u zhvillua ekspozita etnografike me karakter social ‘Përballje me të brendshmen’.

Janë 14 objekte të ekspozuar për herë të parë. Objektet i përkasin zonës së Shkodrës, qytet e fshat dhe i përkasin fillimit të mesit të shek. XX. të prodhuara për t’u përdorur në mënyrë tradicionale. Tipari i tyre kryesor është veshja e tyre direkt në trup, poshtë rrobave të sipërme dhe si rrjedhojë për syrin e njeriut ishin të padukshme. Ato janë të kuruara si në formë të prerjes dhe në detaje të qëndisura të cilat krijojnë një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me shikuesin. Këto veshje vijnë në ekspozim si ndërlidhje paralele mes të padukshmes fizike dhe të padukshmes si ndjenjë apo përjetim në brendësinë e femrës.

P08220.O1.A3: Materiale promocionale per rrjetin muzeal

Janë përgatitur dhe botuar 500 copë fletëpalosje për të gjithë rrjetin muzeal të Bashkisë Shkodër

P08220.O1.A4: Blerje paisje për Vendin e Dëshmisë dhe të Kujtesës.

Këtë vit në Vendin e Dëshmisë dhe të Kujtesës u realizua blerja e një laptopi dhe një aparati fotografik, pajisje të cilat janë të nevojshme për muzeun dhe promovimin e aktiviteteve që realizon gjatë vitit si dhe për një cilësi të lartë të ruajtjes së materialeve fotografike të muzeut.

P08220.O1.A5: Publikime promocionale, fletëpalosje e guide per Vendin e Dëshmisë e Kujtesës

Në vitin 2020 janë realizuar fletëpalosje, broshura informative dhe guidë mbi aktivitetin e Vendit të Dëshmisë dhe Kujtesës. Këto materiale sollën rritje të promovimit të aktivitetit të këtij muzeu të vecante në të gjithë Shqipërinë, gjë që solli dhe realizimin e një dokumentari për këtë muze në emisionin “Te njohim Shqipërinë” nga një televizion i mirënjohur kombëtar.

P08220.O1.A6: Cikël takimesh dhe bisedash mbi historinë dhe të kaluarën e Shqipërisë dhe Shkodrës në veçanti.

Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës prej disa vitesh, ka futur në axhendën e tij të aktiviteteve organizimin e disa cikle bisedash me të rinjtë me tematikë të kaluarën komuniste. Fokusi i këtyre takimeve është njohja me historinë e komunizmit të nxënësve dhe studentëve.

Këtë vit për shkak të pandemisë u realizuan vetëm 2 cikle bisedash të ndara në janar-shkurt, ku lektor folës ishin vuajtes direkt të regjimit komunist të cilët dëshmuuan eksperiencat e tyre të vuajtjeve me të rinjtë pjesëmarrës. Periudha e pandemisë pengoi vazhdimin e këtij aktiviteti.

P08220.O1.A7: Mirëmbajtje ndërtesës VDK

Këtë vit në godinen e Vendit të Dëshmisë dhe Kujtesës, u bë izolimi i plote i tarracës për ta mbrojtur nga lagështira dhe dëmtimet që mund të sjellin forcat natyrore si dhe u realizua lysterja e godinës.

P08220.O1.A8: Dita Ndërkombëtare e Muzeumeve

18 Maj është dita ndërkombëtare e muzeumeve. Çdo vit Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Muzeun Historik, organizojnë aktivitete të ndryshme në promovim të trashëgimisë tonë kulturore. Këtë vit për shkak të pandemisë u realizua me materiale te prezantuara ne hapsirat on line të ketij institucioni.

P08220.O2.A1 : Zhvillimi dhe pasurimi i fondit të bibliotekës

Biblioteka Marin Barleti, duke u bazuar ne kërkesat e lexuesve dhe botimet e reja te shtepive botuese te ndryshme ka hartuar listat e librave per tu blere sipas reparteve të bibliotekës. Janë blere 335 tituj te rinj , ne 930 kopje. Nga stafi i bibliotekes ka perfunduar dhe përpunimi fizik e katalogimi i të gjitha kopjeve të blera.

Per te promovuar me shume Bibliotekën “Marin Barleti”, janë zhvilluar jashte buxhetit, aktivitetet e mëposhtme:

Në kuadrin e pasurimit të fondeve të Bibliotekës dhe nxitjen e veprimtarisë letrare e shkencore, me datë 22 Shkurt 2020, në Bibliotekën "Marin Barleti" u zhvillua veprimtaria për prezantimin e 3 librave me temë historike, të studiuesit Hajrullah Hajdari, nga Ulqini.

1. "Shqiptarët në Mal të Zi nga Kongresi i Berlinit deri me 1941".
2. "Ulqini në Dokumentet Malazeze (1880 - 1915)".
3. "Pronat Dypalëshe të Shqiptarëve në të dyja anët e kufirit Shqipëri - Mal i Zi".

Këto botime janë të një rëndësie të veçantë, pasi ekspozojnë për herë të parë dokumente nga arkivat malazeze, të cilat për shumë dekada kanë qënë të mbyllura, si dhe nga arkivat shqiptare.

Në kuadër të veprimtarive që u organizuan nga Bashkia Shkodër për Ditën Ndërkombëtare të Gruas, Biblioteka “Marin Barleti” zhvilloi aktivitetin “Gruaja në fokusin e letërsisë”. Në këtë aktivitet ishte e ftuar shkrimtarja Fatbardha Saraçi, e cila foli për veprimtarinë e saj letrare me tematikë nga historia e gruas shkodrane.

U organizua dhe ekspozita virtuale “Vlerat e intelektualëve shkodranë në libra” e cila përmbante rreth 150 foto dhe skanime me nënshkrime dhe vula në librat e fondeve të Bibliotekës “Marin Barleti”.

Me rastin e ditës Botërore të Librit, Biblioteka “Marin Barleti”, në bashkëpunim me studiues të letërsisë, zhvilloi një veprimtari virtuale (online), në përkujtim të pesë personaliteteve të shquar shkodranë në fushën e librit e letërsisë. Këto autorë të përzgjedhur u përkasin shkollave të ndryshme dhe kanë karakteristika të ndryshme të botëkuptimit dhe të stilit por, tipari i tyre i përbashkët është dashuria e madhe që ata patën për Shkodrën të cilës i kushtuan vepra brilante të krijimtarisë së tyre.

- “Pak fjalë përkujtuese për personalitetin letrar dhe njerëzor të Arshi Pipës”. Referues: z. Eduard Grishaj, studiues;
“Zef Zorba, artist shumëdimensional”. Referues: z. Zija Vukaj, shkrimtar, kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve e Artistëve;
- “Figura poliedrike e Camajt”. Referues: Prof. Dr. Alfred Capaliku, shkrimtar, studiues;
- “Skënder Drini, gur themeli në prozën moderne shqiptare”. Referues: z. Skënder Temali, shkrimtar, studiues;
- “Frederik Rreshpja, liriku i shquar i letrave shqipe”. Referues: z. Xhahid Bushati, shkrimtar, studiues.

Për shkak të pamundësisë të takimeve fizike, të shkaktuara nga Pandemia Globale Covid 19,të gjitha referatet mbi këtë aktivitet, janë publikuar online në rrjetet sociale të Bibliotekës “Marin Barleti”,.

Gjithashtu Biblioteka “Marin Barleti” zhvilloi veprimtarinë virtuale “Kolazh me krijime letrare të nxënësve të shkollave të mesme, me rastin e ditës botërore të librit (poezi, prozë, ese). Në këtë veprimtari morën pjesë 35 nxënës të shkollave të mesme të qytetit me krijime të reja.

Të gjitha Krijimet letrare mbi këtë aktivitet, janë publikuar online në rrjetet sociale të Bibliotekës “Marin Barleti”.

P08220.O2.A2 Administrimi dhe menaxhimi i Degës Ekonomike të Kulturës

Janë realizuar:

- Pagat e personelit dhe pagesat e sigurimeve shoqërore;
- shpenzime për shërbime nga të tretë (Energji,ujë);
- Është në proces tenderimi zëri - blerje pajisje për Bibliotekën,
- Jane blerë materiale sanitare/pastrimi, duke përfshirë edhe mjete dizifektuese dhe parandaluese ndaj Covid-19,
- Është në proces zbatimi kontrata për mjete kancelarie,
- Është realizuar procedura e siguracionit të ndërtesave të DEK,
- Është realizuar procedura e rimbushjeve të fikseve të zjarrit në të gjitha objektet e DEK (Galeria e Arteve, Biblioteka “Marin Barleti”, Muzeu Historik dhe Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës”).

P08220.O2.A3 Periodiku Gegnia

Per gjate gjithë vitit 2020 ka vazhduar procesi i mbledhjes, përzgjedhjes, redaktimit të artikujve duke realizuar botimin e 3 numrave te rinj te revistes Gegnia.

P08220.O2.A4: Festivali letrar i Shkodrës.

Biblioteka “Marin Barleti” Shkodër organizon prej 13 vitesh Festivalin Letrar të Shkodrës i cili synon krijimin e hapësirave të komunikimit të drejtpërdrejte të krijuesve me lexuesit e bibliotekës sonë e më gjërë.

Këtë vit për shkak të pandemisë këto takime u realizuan në oborrin e Muzeut Historik, banesa Oso Kuka, për të respektuar normat e distancimit social.

Me datë 24 tetor 2020, filloi takimi i parë i edicionit të XIII-të, ku pjesëmarrës ishte shkrimtari nga Prishtina, Ag Apolloni.

Takimin e dytë u mbajt me 25 tetor 2020 dhe i ftuar ishte shkrimtari Stefan Çapaliku.

Takimi i tretë u mbajt me 31 tetor 2020 dhe i ftuar ishte shkrimtari Durim Taçi.

Takimi i katërt dhe i fundit u mbajt me 1 nëntor 2020 dhe i ftuar ishte shkrimtari Rudolf Marku.

P08220.O2A5 Mbështetje për funksionimin e Galerisë së Arteve Shkodër

Përmirësimi i sistemit të aspirimit të fondeve të GASH ishte një emergjencë, e cila ka të bëjë me ruajtjen e fondeve tona. Për këtë arsye, këtë vit ishte parashikuar kjo fishe, e cila u realizua në muajin Gusht si investim. Sistemi i ri i aspirimit është vendosur në një pozicion të shkurtër komunikimi me zonën e ajruar jashtë godinës në respekt të dekorit të fasadës kryesore të godinës, në pjesën e pasme të saj. Cilësia e klimatizimit dhe ajrimit të fondeve sot është më e mirë, duke plotësuar kështu edhe disa standarte të reja të ruajtjes dhe koservimit të veprave të artit.

Jane realizuar blerje dhe vendosje e sistemit të ndriçimit për sallat e GASH, edhe kjo një nevojë urgjente, e cila përmirëson dukshëm funksionin kryesor të kësaj galerie, atë të aksesit nga ana e publikut në aktivitetet tona. Sistemi i vjetër i viteve '80 ishte Halogen dhe pësonte defekte të shpeshta me konsum material dhe energjie të madhe. Ndaj sot, është bërë zëvendësimi i ndriçuesve dhe përcjellësve të energjisë me shina dhe spote të tipit LED me sistem koke rrotulluese për funksione të ndryshme ekspozimi. Ndriçesit tip spot janë me fuqi 20Ë, 4000K

drite natyrale, me kënd ndriçimi 36 grad difuz. Tashmë, sallat kanë një ndriçim dinamik, të përshtatshëm për ekspozime të ndryshme, në kushte optimale.

P08220.O2A6: Të shkruajmë për fëmijë.

Një ndër projektet më të reja që Bashkia Shkodër kishte planifikuar për vitin 2020, ishte dhe projekti “Të shkruajmë për fëmijë”. Duke parë që vitet e fundit letërsia për fëmijët ishte zbëhur, lindi idea e promovimit të shkrimtarëve të rinj në këtë fushë.

Nisur nga situata pandemike, duke marrë parasysh që ky projekt do të realizohej me nxënës të shkollave të mesme dhe studentë të universitetit, nuk u realizua.

P08220.O3.A2: Mbështetje për Menaxhimin e Teatrit “Migjeni” :

- Janë paguar faturat e shpenzimeve utilitare: shpenzime për shërbime nga të tretë (Energji, ujë);
- Jane blerë materiale sanitare/pastrimi, duke përfshirë edhe mjete dizifektuese dhe parandaluese ndaj Covid-19.

P08220.O3.A3: Administrimi dhe Menaxhimi i Teatrit “Migjeni”

Institucioni i Teatrit “Migjeni” është një institucion varësie i Bashkisë Shkodër. Struktura e tij përbëhet prej 37 punonjësish. Jane paguar pagat dhe sigurimet shoqërore për të gjithë personelin e punësuar pranë Teatrit “Migjeni”.

P08220.O3.A4: Administrimi dhe menaxhimi i qendrës kulturore Pjetër Gaci.

Qendra e Kulturës “Pjetër Gaci” ka 4 punonjës, dhe janë paguar pagat dhe sigurimet shoqërore të tyre si dhe faturat e shpenzimeve utilitare.

P08220.O3.A5: Orkestra Frymore Honorare vjetore

Formacioni i Orkestrës Frymore është një nga vlerat e veçanta artistike unike që ka qyteti ynë i cili përbëhet prej 40 muzikantëve. Keto artiste janë mbështetur me honorare për muajt e parë të vitit. Situata pandemike ka penguar realizimin e aktivitetit të plotë të këtij formacioni.

P08220.O3.A6: Takim ndërkombëtar bandash frymore në Shkodër.

Gjatë dy viteve të fundit ky aktivitet ka mbledhur jo vetëm bandat frymore të Shqipërisë por edhe ato të Kosovës dhe Malit të Zi. Për shkak të pandemisë, këtë vit ky aktivitet nuk u realizua.

P08220.O3.A7 Çmimi “Pjetër Gaci”

Çmimi “Pjetër Gaci” këtë vit u zhvillua në muajin Maj, në kushte të pazakonta, të shkaktuara nga Pandemia globale Covid-19. Përmes sistemit online në faqen e dedikuar www.pjetergaci.com konkursi u zhvillua online, me pjesëmarrës nxënës dhe studentë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia etj. të cilët interpretuan programin e tyre, duke u vlerësuar nga një juri profesioniste e të gjitha disiplinave të këtij konkursi. Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë rreth 180 studentë dhe pritet që në vazhdim të realizohet edhe nata gala me finalistët dhe me fituesit e çmimeve të kategorive dhe disiplinave të ndryshme.

Z. Derek Han, vendosi që në Finale të jenë të përfshirë dhe kandidatët me pikët më të larta në disiplinat ku nuk kishte çmim absolut.

1. Artida Bakija Flaut
2. Megi Rexhepi Klarinet
3. Frederik Gjokaj Saxophon

- 4 Juri Dajani Violin
5. Puhiza Mustafa Violin
6. Matteo Guerze Kanto
7. Igli Rapaj Piano
8. Lis Mustafa Kitare
9. Onidi Jaupi Kitare

P08220.O3.A8: “Ahengu Shkodran”

Në ditën e trashëgimisë kulturore, me 29 shtator, u organizua aktiviteti tradicional “Ahengu Shkodran”. Ky aktivitet u mbështet nga Bashkia Shkodër, Qendra Kulturore “Pjetër Gaci” në bashkëpunim me Teatrin Migjeni dhe Muzeun Historik.

Qëllimi i këtij aktiviteti është ruajtja e origjinalitetit të këngës popullore shkodrane e krijuar ndër vite dhe transmetimi i saj tek artistët e rinj. Edhe këtë vit, në kushtet e vështira pandemike, ky aktivitet tradicional u realizua duke respektuar dhe ruajtur distancinim social dhe përdorimin e maskave neoborrin e Muzeut Histok.

Artistët pjesmarrës në këtë aktivitet ishin: Laorjan Ejlli, Leonora Luca, Glerdit Turmeta, Klodiana Vata, Xhuljana Pjetraj, Orjeta Kelaj, Ademir Fresku, Leonard Guga , Jolanda Gjeluci, Albert Naraçi, Blerta Cinaj, Savjana Vjerdha, Adelina Correj, Niki Mjeda, RezartaSmaja, Mukades Çanga, Klinsman Llazani, Marjana Begu.

P08220.O3.A9 “Honorare ” Grupi i Valleve”

Grupi i Valleve përbëhet prej 12 personash, të cilët janë mbështetur me honorare për muajt e parë të vitit. Gjate ketyre muajve ka shoqeruar disa aktivitete te qendres Kulturore Pjeter Gaci, si Ahengu Shkodran si dhe performuar ne javen e trashegimise kulturore dhe gjate festes se karnavaleve.

P08220.O3.A10: Festivali i Këngës Qytetare “Luleborë”.

Këtë vit festivali u realizua me datën 10 Tetor 2020, në oborrin e Teatrit Migjeni. Për shak të pandemisë, festivali u zhvillua vetëm një natë dhe pjesmarrja e publikut ishte e reduktuar, vetëm me ftesa. Në këtë edicion konkuruan 20 këngë.

Në përfundim të festivalit, juria vendosi të vlerësoj me çmim të parë këngën: "Ke shku" Muzika dhe orkestrimi: Enis Mullaj; Teksti: Erjona Rushiti, Interpretoi: Saviana Vjerdha.

Me çmimin e dytë u vlerësua kënga "Kadalë" Muzika, teksti dhe orkestrimi: Shkodra Elektronik

Interprettoi: Silvia Kacarosi.

Me çmimin e tretë këngën:"Kam rrit shtatin tek ti Shkodër" Interpretoi: Mukades Çanga " Mjeshtër i Madh" Muzika: Mukades Çanga; Teksti: Ramazan Çeka;

P08220.O3.A11: “Koncert – Premierë i Orkestrës Frymore”

Çdo vit Orkestra Frymore e qytetit të Shkodrës organizon koncerte premierë. Këtë vit për shkak të pandemisë, COVID-19 shume aktivitete u zhvilluan ne ambjente te hapura.

P08220.O3.A12: “Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Këngës Qytetare”

Me dt.20-21 tetor 2020 u organizua në qytetin e Elbasanit, Edicioni XVI –të. Është një aktivitet tashmë i kthyer në traditë(një herë në dy vjet) organizuar nga Ministria e Kultures dhe Bashkia Elbasan ku promovohen vlerat më të mira interpreuese dhe egzekutuese të këngës popullore qytetare.

Grupi i Shkodres bëri dallimin në shumë element të paraqitjes së tij artistike duke u vlersuar në fund nga juria me kryetar Zina Zdrava (këngëtare dhe pedagoge e kantos) me tre çmime;
Çmimi i dytë “Shyqyri Fuga” – grupi më i mirë pjesmarres.
Çmimi i parë – orkestra më e mirë e festivalit
Çmimi – këngëtari më i mirë i festivalit -Laorjan Ejlli

P08220.O3.A14: Festival burimor

Ky aktivitet, ishte i parashikuar të realizohej në dhjetor në Teatrin Migjeni, por për shkak të situatës pandemike nuk u realizua.

P08220.O3.A15: Dita ndërkombëtare e Jazz-it.

Dita ndërkombëtare e Jazz-it, feston ditën e saj me 30 Prill dhe prej disa vitesh është kthyer në një aktivitet traditë në qytetin e Shkodrës. Këtë vit, për shkak të pandemisë nuk u realizua.

P08220.O3.A16 : Pjesë Teatrore 1: “Black Box/ Kutia e zezë”

“Black Box/ Kutia e zezë” u shfaq me datën 10 Korrik, e adaptuar për skenë nga Fatos Berisha e “Perfect Strangers” e Paolo Genovese. Premiera kishte një publik të zgjedhur, për shkak të ruajtjes së distancave në përmbushje të protokolleve shëndetësore të parashikuara për shkak të Covid-19.

P08220.O3.A17: Pjesë Teatrore 2: “Nata e trokitjeve në xhama”.

Me 22 Gusht u shfaq premiera e mbyllur e dramës “Nata e trokitjeve në xhama” e Dhimitër Anagnostit, me regjizor Kushtrim Bekteshi. Premiera kishte një publik të zgjedhur, për shkak të ruajtjes së distancave në përmbushje të protokolleve shëndetësore të parashikuara për shkak të Covid-19.

Që nga data 10 Prill e në vazhdim, aktorët e trupës së Teatrit “Migjeni”, teatrit të kukullave dhe orkestrantët e këngëtarët e estradës, kanë performuar online përmes faqes së dedikuar në youtube dhe faqeve të Teatrit “Migjeni” në rrjetet sociale.

Aktorët: Rita Gjeka, Rajmonda Marko, Merita Smaja, Drande Xhaj, Jozef Shiroka, Simon Shkreli, Pjerin Vlasi, Kristi Lleshi, Linda Jarani, Vladimir Doda, Fritz Selmani si dhe aktorët veteran Ymer Bala, Fritz Fistani dhe Mirjam Bruçeti, kanë realizuar pjesë të ndryshme individuale të cilat janë publikuar për spektatorin online gjatë gjithë Pandemisë. Gjithashtu, janë realizuar tre mini komedi të krijuara dhe të interpretuara nga aktorët e rinj të humorit “Mbrëmja e maturës”, “Frikë jo, prova po”, “Shkodra’s Got talent Meritokracia”, të interpretuara nga Fritz Selmani, Ketlin Pjalmi, Klodiana Vata, Lusi Bregu, Ergys Saraçi, Arben Bala, Silvia Kacarosi dhe Stanislava Logaj.

Në kushtet e pandemisë, janë realizuar edhe dy këngë nga orkestra dhe këngëtarët profesionist të Estradës: “Pranvera filloj me ardhë” dhe “E amël si loti”. Në orkestër: Ilir Zoga, Namik Jahja, Fatmir Mesi, Bledi Doçi, Indrit Kodraliu, Dritan Mlika me këngëtarët: Mukades Çanga, Rezarta Smaja dhe Laorjan Ejlli.

P08220.O3.A18: Pjese Teatrorë 3

Për shkak të situatës pandemike, COVID-19 nuk u realizua.

P08220.O3.A19: Variete

Për shkak të situatës pandemike, COVID-19 nuk u realizua.

P08220.O3.A20: Shfaqje për fëmijë+Teatri i kukllave

Me 12 Tetor në Teatrin “Migjeni” u shfaq premiera e teatrit të kukullave. Përralla e njohur e H.K.Andersen, “Gishtëza”, u përshtat nga Shegushe Bebeti " Mjeshtër i Madh"; Skenografia dhe kukullat nga Merita Spahija; Muzika nga Gazmend Mullahi; Regjia: Merita Smaja. Interpretuan aktorët e Teatrit “Migjeni”. Drande Xhaj " Mjeshtër i Madh", Merita Smaja, Astrit Fani, Marviks Shantoja dhe Gjovalin Kolaj.

E veçanta e këtij rikthimi të shfaqjeve teatrit të kukullave në Shkodër, është se pjesa “Gishtëza” u përzgjedh nga vetë fëmijët. Gjatë shfaqjes së saj, vogëlushët e ndoqën me shumë ëndje ndërsa në fund, fotografitë me personazhet e përrallës dhe aktorët, shënuan suksesin e “Gishtëzës”.

Gjatë muajit tetor dhe nëntor shfaqjet u performuan në bashkëpunim me bizneset e hotelerisë në Shkodër duke shfrytëzuar hapsirat e tyre të jashtme.

P08220.O3.A21: Pranverë me këngë.

Këtë vit për shkak të Pandemisë, koncerti u spostua në muajin korrik, duke u realizuar në një ambient të hapur, në Pedonalen e Shirokës me datën 1 Korrik. Me një pjesëmarrje të gjërë të publikut, duke respektuar distancën dhe rregullat anti-covid, në skenë interpretuan këngëtarët Mukades Çanga, Rezarta Smaja, Laorjan Ejlli, Orjeta Kelaj, Leonard Guga, Blerta Cina, Ylber Tahiri, Leonora Luca, Ademir Fresku, Glerdit Turmetaj, Silva Kacarosi dhe grupi “Karajfilat që ka Shkodra”, me udhëheqës artistik Ilir Zoga.

P08220.O3.A22: Fjala artistike me nxënësit e shkollave të mesme në nderim të figurave të shquara.

Aktiviteti u zhvillua në Shkurt 2020. Ky aktivitet i dedikohet nxënësve të shkollave të mesme, të cilët në bashkëpunim me aktorë të përzgjedhur të Teatrit “Migjeni” realizuan shfaqje të mirëfillta artistike. Këtë vit morën pjesë 7 shkolla, ndër më kryesoret ishin “Jordan Misja”, “28 Nëntori”, “Oso Kuka” dhe Shejnaze Juka”. Aktoret e rinj që morën pjesë ishin 74 vete, nga të cilët 44 femra. Numri i spektatorëve që ndoqën shfaqjet përgjate gjithë javës ishte rreth 950, prej të cilëve ishin rreth 690 vajza.

P08220.O3.A23. Honorare aktorë të teatrit të kukullave.

Teatri i kukullave me rikthimin e tij, shihet me shumë interes në qytetin tonë. Në këtë aktivitet janë paguar honoraret e një grupi prej 5 aktorësh të rinj amatorë që punojnë për këtë teatër. Keto aktorë kanë punuar on line për përgatitjen e shfaqjeve të reja të teatrit të kukullave, që do të shfaqen për spektatorin e vogël sapo të fillojnë shkollat, por duke respektuar protokollin anti covid.

P08220.O3.A24 Dita e Luleve 6 Maj

Dita e Luleve këtë vit u realizua nga Drejtoria e Kulturës dhe institucionet e saj të varësisë, në kushte të pazakonta, shkaktuar nga Pandemia.

Për të kujtuar këtë ditë, drejtoria realizoi një klip në kushte online me fëmijë të shkollave 9 vjeçare dhe të kopshteve, me krijime letrare, piktura dhe butafori dedikuar luleve. Pjesë e këtij klipi u bënë edhe familje qytetare, të cilët paraqiten oborret tipike shkodrane të mbushura me

ngjyrat e luleve. Për të krijuar këtë klip, u dërguan dhe u perpunuan 53 video amatore të fëmijëve të shkollave të ndryshme të realizuara në kushte shtëpie.

Ky klip u transmetua dhe nga tv lokale si urim optimizmi në ditët e veshitira që po kalonte vendi.

Galeria e Arteve zhvilloi një ekspozitë të veçantë online, ku u paraqiten piktura të autoreve shkodranë me temë natyrat e qeta dhe oborret shkodrane, të gjitha pjesë e fondit të galerisë.

Muzeu Historik i dedikoi kësaj dite ekspozitën me elementë të odave shkodrane, ku vihen në pah punimet e drurit me ornamente lulesh, tradicionale në qytetin tonë.

Biblioteka “Marin Barleti” organizoi një takim online me nxënës të shkollave 9 vjeçare dhe të mesme me krijime letrare. Moren pjesë 65 nxenes, prej të cilëve 45 vajza.

Video-ja e publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër, pati një impakt të madh tek qytetarët me një shikueshmëri prej 5016 vete.

<https://www.facebook.com/bashkiashkodres/videos/250142932770538/>;

Të gjitha aktivitetet u realizuan në kushte shtëpie përmes rrjeteve online dhe u paraqiten për publikun si një mesazh optimizmi dhe shprese.

P08220.O3.A25: Ndërmendje

Koncerti i fundvitit “Ndërmendje”, i parashikuar të zhvillohej me 27 dhjetor në Teatrin Migjeni, për shkak të kushteve të krijuara nga Pandemia, Covid-19, nuk u realizua. Kontrata me shoqatën kulturore fituese për ta zhvilluar këto aktivitet është zgjatur deri në krijimin e kushteve për këto koncert.

P08220.O3.A26: Aktivitete me rastin e 2 Prillit.

Në këtë ditë perkujtimore për dëshmorët e demokracisë u vendosën kurora me lule pranë memorialit të tyre duke zbatuar rregullat e distancës dhe të protokollit anti covid.

P08220.O3.A27: Festival Jazz-i.

Projekt i fituar nga Shoqata Kulturore “Rrok Jakaj”, realizoj “Shkodra jazz festival” për të katërtin vit me radhë. U prezantua i integruar brenda dhe “Rrok Academy”, i cili ka si synim edukimin e brezave të rinj me muzikën jazz dhe klasike, përmes leksioneve intensive të drejtura nga profesionistë të fushës. Përveç degëve Jazz, Klasike, Fizarmonikë, këtë vit risia në “Rrok Academy” ishin hapja e degëve të klarinetës e cila u drejtua nga klarinetisti me famë ndërkombëtare Francesco Django Barbieri dhe dega “Neë Technology” e cila u nda në dy pjesë: kurset e para të kësaj degë i referohen Shkrimit Muzikor digital, ndërsa kurset e dyta Fotografisë artistike.

“RROK ACADEMY” filloi në datat 16-24 Korrik me degën e re “Neë Technology” mbi teknikat e Shkrimit Muzikor. Kurset u mbajtën nga Markelian Kapidani në ambjentet e Qendrës Rinore “Atelie”.

10 - 31 gusht 2020 në ambjentet e Qendrës Rinore “Atelie”, u zhvilluan degët Klasike drejtuar nga Paçalin Pavaci, Jazz drejtuar nga Markelian Kapidani, Fizarmonikë, i drejtuar nga Bardh Jakova, Klarinetë Francesco Django Barbieri, ndërsa në ambjentet e Galerisë së Arteve, u zhvilluan kurset e “Neë Technology”, dega Fotografi nga Orestia Kapidani.

Jane realizuar plot 10 koncerte gjatë muajit gusht, në pikat kryesore të qytetit, me artistë me famë ndërkombëtare, duke i dhënë gjallëri dhe argëtim qytetit dhe qytetareve pas shumë muajsh të vështirë.

P08220.O3.A28: Koncertet e Verës.

Të kthyer tashmë në traditë, “Koncertet e Verës” organizohen çdo vit nga Bashkia Shkodër gjatë muajve korrik-gusht. Ky aktivitet ka për qëllim promovimin e grupeve dhe artistëve të rinj të qytetit tonë. Këtë vit, për shkak të pandemisë, keto koncerte nuk u realizuan.

P08220.O3.A29: Karnavalet.

“KARNAVALE 2020”, u zhvilluan në datat 21 dhe 22 Shkurt 2020 në sheshin para Bashkisë Shkodër dhe në sheshin “Nënë Tereza”. Karnavale 2020, të titulluara “Kur të mbet dopiogjashta”, u konceptuan të ndara në dy ditë:

Data 21.02.2020 – Dita e parë e Karnavaleve nisi me shkollat e sistemit 9-vjeçar të territorit të Bashkisë Shkodër. Marshimi karnavalesk i shkollave nisi në orën 10:00 nga sheshi “Nënë Tereza” drejt rrugës “13 dhjetori”, sheshi para Bashkisë Shkodër, ku edhe ishte vendosur skena e kontraktuar nga subjekti për zhvillimin e aktivitetit. Në orën 10:30 në sheshin para Bashkisë Shkodër nisi spektakli i dedikuar konkurimit mes shkollave.

Këto shkolla, përmes performancave të tyre, përcollën për publikun mesazhe sensibilizuese sociale. Tri ishin shkollat fituese në këtë konkurs.

Data 22.02.2020 – Festa e Karnavaleve. Kjo ditë filloi në orën 10:00 me grumbullimin e karvanit karnavalesk, i cili përbëhej nga Orkestra Frymore e Bashkisë Shkodër, tre shkollat fituese, makina e dordolecit të përgatitur për këtë ditë dhe qytetarë të thjeshtë. Të gjithë bashkë u nisën në orën 10:20 drejt skenës të vendosur në sheshin para Bashkisë Shkodër, ku edhe u mbajt aktiviteti kryesor. Aktiviteti ishte konceptuar në formën e spektaklit, ku u paraqitën shkollat fituese, këngëtarë të ftuar, grupi i valleve të fëmijëve të Qendrës Kulturore të Fëmijëve, si dhe grupi i humoristëve. Element tjetër që karakterizon Karnavalet e Shkodrës, janë edhe butaforitë e ndryshme. Vënia në dukje e dobësive dhe të metave të shoqërisë shqiptare në aspektin social dhe politik, përmes satirës të shfaqur në formën e karikaturës, është një element shumë interesant i cili përceptohet shumë shpejt dhe shumë thjeshtë nga çdo lloj publiku. I gjithë aktiviteti u transmetua live nga të gjitha mediat lokale.

P08220.O3.A30: Shkodra n'fest.

Shkodra n'fest, është aktiviteti i cili zhvillohet çdo vit përgjatë gjithë muajit dhjetor. Ato sjellin atmosferë festive gjatë gjithë muajit dhe kontribuojnë në pasurimin e jetës kulturore dhe promovimin e territorit. Këtë vit, për shkak të situatës pandemike ,COVID-19, nuk u realizua.

P08220.O3.A31: Festa e Muzikës

“Festa e Muzikës” i dedikohet një elementi që është pjesë e pandashme e jetës sonë, një element që na ndjek në çdo moment. Duke qenë diçka kaq e rëndësishme duhet të ketë dhe një festë që i dedikohet posaçërisht asaj. Këtë vit për shkak të pandemisë, nuk u realizua.

P08220.O3.A32: Festa e Trashëgimisë Kulturore

Za fest këtë vit, u organizua nën masat e kufizimit për shkak të pandemisë Covid 19, me prezencë minimale spektatorësh dhe u përpunua për transmetim online dhe në mediat visive. Za Fest u vendos në dy lokacione të rëndësishme të Shkodrës, konkretisht në Kalanë e Rozafës dhe në Theth.

Data 15 Gusht 2020 – Kalaja e Rozafës, e cila me peisazhin e saj të mrekullueshëm, mori jetë me muzikë frymëzuese nga “Shkodra Elektronike”, “Sytë” dhe Vlashent Sata.

Në pika të ndryshme të kalasë së Rozafës u regjistruan dhe performancat “a capella” të artisteve.

Data 16 Gusht 2020- THETH Logu i Za Fest me Nebi Bardhoshin “Takim ne Muzeun Etnografik te Dukagjinit”, u titullua biseda e organizuar nga Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit në bashkëpunim me Zâ Fest me pjesëmrrjen e banorëve të zonës.

Date 17Gusht – U bënë regjistrimet e performancave të artistëve tek: Syri i Kaltër, Ujvara e Thethit, Kulla e Ngujimit, Shtëpia e Rrenume

P08220.O3.A33 : Honorare anëtarët e këshillit kulturor artistik të Bashkisë Shkodër.

Bazuar në VKM nr.540, datë 21.12.1992 “Për krijimin e këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre”, i ndryshuar me VKM nr. 121, datë 25.02.2005, Udhëzimit të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve nr. 1, datë 24.05.2005 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këshillave artistiko – kulturor”: VKB nr.27, datë 01.06.2016 “Për ngritjen e këshillit artistiko-kulturor, shpërblimin e anëtarëve të tij dhe miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistike, sportive dhe rinore në Bashkinë Shkodër” ; Bashkia Shkodër ka Këshillin Artistiko Kulturor, i cili përbëhet prej 7 anëtarësh dhe merr në shqyrtim në bazë të një procedure të parashikuar në ligj, të gjithë projektet kulturore, artistike, rinore dhe sportive të Bashkisë Shkodër. Ky këshill paguhet në bazë të ligjit me honorare për 6 mbledhje në vit.

P08220.O3.A34 : Lëvizja e Postribës

“Lëvizja e Postribës” e njohur si lëvizja e parë antikomuniste në Shqipëri, e ndodhur më 9 shtator 1946, ishte lëvizja e atyre që nuk besuan kurrë tek komunizmi internacionalist shqiptar. Qytetarë të ndërgjegjshëm dhe të përgjegjshëm, të cilët patën vetëdijen dhe e parashikuan se komunizmi do të sillte vetëm regres në vendin tonë, u ngritën kundër forcës së madhe të diktatorit më të egër që njohu Europa.

Bashkia Shkodër edhe këtë vit organizoi aktivitetin përkujtimor të kësaj ngjarje të rëndësishme duke respektuar rregulloren dhe masat e distancimit social anti covid.

P08220.O3.A35: Ekspozita Salloni i Vjeshtës

Galeria e Arteve Shkodër me mbështetjen e Bashkisë Shkodër, organizoi edicionin e XIV-të “Salloni i Vjeshtës” 2020. Ky edicion me temën “çojë vështrimin pak më lart...”, u kurua konceptualisht nga Dr. Ermir Hoxha dhe Eros Dibra.

Puna e kuratorëve konsistoi në përzgjedhjen, grumbullimin dhe kurimin (shpërndarjen konceptuale, estetike dhe formale të punimeve të ardhura) gjatë një muaji për konkurim në këtë edicion të XIV-të të Sallonit të Vjeshtës, aktivitet ndër më të rëndësishmit që zhvillon GASH.

Merita e rezultantes së punës së këtyre dy kuratorëve qëndron në faktin se ato arritën shumë mirë dhe u vlersuan nga gjykimi i specialistëve si; Katërcipërisht bashkëkohore, moderniste dhe esenciale në përshfaqjen e idesë dhe temës së këtij viti “çojë vështrimin pak më lart...”

GASH bëri një ftesë të hapur për të gjithë artistët në mediumet e pikturës, skulpturës, grafikës/vizatimit, fotos, videos dhe instalacionit.

Çdo autor u paraqit me një vepër të paeksponuar më parë në GASH dhe punimet e ekspozuara u publikuan në katalogun shoqërues të aktivitetit.

Ekspozita u zhvillua në ambjentet e GASH nga data 24 Nëntor – 31 Dhjetor 2020 me pjesëmarrjen e 51 artistëve.

Një juri e përbërë nga tre profesionistë të fushës; Z.Helidon Haliti, Znj. Ormira Lulani dhe Z. Ergys Zhabjaku përzgjodhi çmimet fituese të këtij edicioni përkatësisht : **Vepra më mirë**, akorduar Znj. Merita Selimi diptik në vizatim trekëndor me emërtimin: “Pa titull”

Artisti i ri më i mirë, akorduar Z. Klevis Baja, videoinstalacion me titullin: “Na”.

Gjithashtu, gjatë muajit Mars në Galerinë e Arteve u organizua dhe “*Ekspozita e gruas*”. Ekspozita u hap më 8 Mars, me fondet e arkivës së Galerisë së Arteve, të përzgjedhura me kujdes nga kuratori Fatmir Juka. Ekspozita kishte në fokus figurën e gruas në pikturë nga autorë të ndryshëm, kryesisht shkodranë. Vizitorët e kësaj ekspozite ishin rreth 120 vetë.

P08220.O3.A36: Cmimi Idromeno. Për arsye të pandemisë, nuk u arrit grumbullimi i punimeve nga artistet e rinj nga trevat shqipëtare dhe aktiviteti nuk u zhvillua.

P08220.O3.A37: “Personazh i ftuar”- Ekspozitë personale e një personaliteti të artit pamor shqiptar të ftuar nga Galeria e Arteve e Shkodrës.

Me 24 tetor, në Galerinë e Arteve të Bashkisë së Shkodrës u çel ekspozita personale e artistit Theo Napoloni me titull: "Përkohësi e Vazhdueshme". Ekspozita pati shumë interes por të detyruar nga kushtet e vështira të pandemisë, u limitua hyrja e shumë personave njëheri në galeri, duke i ndarë në grupe të vogla dhe gjithmonë të pajisur me maskat mbrojtëse.

P08220.O3.A38 Takimet publike - bisedat publike mbi artin dhe ëorkshop me artistë të rinj.

Aktiviteti u zhvillua gjatë muajit Gusht dhe u kurua nga artistja Orestia Kapidani. Ekspozita dhe ëorkshopi i trajtuar si një ripërtëritje dhe mesazh shprese pas mbylljes së gjatë të shkaktuara nga

Pandemia globale, pati interes tek publiku dhe tek studentët pjesëmarrës. Ëorkshop me titull "Rrëfime fotografike" u zhvillua në datat 24- 29 /08/2020.

Ekspozita “Me synin“ u hap me datë 17/08/2020 deri me 31/08/2020 .Kjo ekspozitë vendosi përballë piktura e portretit që na veshtron, me vepra nga fondi i Galerisë së Shkodrës, dhe portretin fotografik, me citime nga seria e portreteve „the magic 3“. Për të përfunduar me një „histori fotografike“ te lindur për të qëndruar afër veprës muzikore.

P08220.O3.A39: Aktivitete artistike në partneritet individ dhe shoqata kulturore.

Edhe këtë vit në Galerinë e Arteve, me mbështetjen e Bashkisë Shkodër, u organizua aktiviteti i titulluar: "Forma prej dheut..." E udhëhequr nga skulptori Petrit Bilali.

Ky aktivitet filloi me datë 2 / 11 deri me 6 / 11 2020. Çdo seancë e aktivitetit zgjati rreth 2 orë. Dita e parë e aktivitetit filloi me prezantimin mes artistit dhe pjesëmarrësve, duke vijuar më tej me ndarjen e materialeve të punës dhe fillimin e skicimit të ideve artistike.

Ditët në vazhdim, puna vazhdoi me konkretizimin e skicimeve në materien e dheut, ku secili nga pjesëmarrësit realizoi krijimin e tij me baltë. Ditën e fundit, krijimet prej dheu u finalizuan dhe u dërguan për procesin e pjekjes.

Me datë 12 nëntor, në ambientet e Galerisë së Arteve, u bë hapja e ekspozitës: "Forma prej dheut...". Pavarësisht nga situata atipike e shkaktuar nga pandemia COVID-19, kërkesa për pjesëmarrje në këtë aktivitet ishte e madhe, duke na detyruar që të refuzonim disa nga pjesëmarrësit për arsye të respektimit të normave të distancimit social.

FUNKSIONI 09: ARSIMI

Programi 09120: Arsimi baze parashkollor

Programi 09120 : Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor.

Ky program përfshin institucione dhe konkretisht:

- 1- Drejtorinë Ekonomike të Arsimit.
- 2- Drejtorinë e Çerdheve dhe Kopshteve.

1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit P 9120.

Arsimi parauniversitar:

Qëllimi i programit të Planifikimit, Menaxhimit dhe Administrimit për Drejtorinë ekonomike të Arsimit është:

1. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar;

2. Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar e lokal, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtyre funksioneve për vitin 2020 janë:

1.1. Ofrimi i shërbimeve cilësore për zhvillimin e procesit mësimor edukativ në kushte të pershtatshme në gjithë territorin administrativ të Bashkisë së Shkodrës.

1.2. Sigurimi i mjediseve dhe objekteve cilësore për zhvillimin e procesit mësimor në sistemin parauniversitar dhe parashkollor.

1.3. Nxitja dhe promovimi i aktiviteteve kulturore, sportive dhe argëtuese për fëmijë.

Realizimi i te ardhurave të planifikuara:

mijë lekë

	LLOJET E TE ARDHURAVE	Plan 2020	Realizimi 2020	% e realizimit
1	Qendra Kulturore e fëmijëve	170	0	0%
2	Te ardhura nga kopshtet	11 100	5 927	54%

Realizimi i Buxhetit të planifikuar:


mijë lekë

Programi P 09120	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Transferta	Investime	TOTALI
Plani fillestar	213,119	59,873	2,400	8,305	283,697
Plani i korigjuar	212,636	61,473	1,283	8,305	283,697
Realizimi Vitit	198,934	41,546	483	5,842	246,805
% e realizimit	94%	68%	38%	70%	87 %

Realizimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është në total 87%, sipas zërave kryesorë më poshtë:

Shpenzimet korrente (paga+sigurime, shpenzime operative, transferime) **98%**

Shpenzimet kapitale **2%**



ANEKSI 4.

Kodi i Programit	9120	Emertimi i programit:	Arsimi baze parashkollor						Komente
Qellimi 1	Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar;							
			**Treguesit e performancës/Produktet:					
Objektivat e politikës:	Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhes	Niveli i planifikuar ne vitin korent	Niveli i rishikuar ne vitin korent	Niveli faktik ne fund te vitit korent	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit		
Objektivi 1.1	1	Nr I punonjesve mbeshtetes ne arsimin 9-vjecar;	130	165	165	157	95%	
	2	Numrin i shkollave ne qe pefitojne mbeshtetje arsimin 9-vjecar;	69	78	78	15	100%	
	3	Nr I shkollave qe ngrohen me dru zjarri	45	50	50	50	100%	
	4	Nr I shkollave qe ngrohen me kaldaja me naftë	2	1	1	1	100%	
	5	Nr I mjeteve te transportit ne sherbim	1	1	1	1	100%	
	6	Nr I objekteve qe do te nderhyhet	13	15	15	1	100%	
	7	Nr I objekteve qe do te sigurohen	9	9	9	9	100%	
	8	Numrin i shkollave qe I sherbejne femijeve me aftesi te veçanta	1	1	1	1	100%	
	9	Nr I shkollave me sherbim sigurije		78	78	78	100%	
Objektivi 1.2	10	Nr I shkollave qe do te rikonstruktohen	1 shkolle NjA, 112 nxenes	1 shkolle NjA, 279 nxenes	1 shkolle NjA, 279 nxenes	1 shkolle NjA, 279 nxenes	100%	
Objektivi 1.3	11	Nr nxenesve qe perfitojne nga aktivitetet e Q.K.F	3800 nx, 2200 vajza	4200 nx, 2300 vajza	4200 nx, 2300 vajza		0%	

		12		200 nx, 160 vajza	200 nx, 160 vajza	200 nx, 160 vajza	200 nx, 160 vajza	100%
		13		3800 nx, 2200 vajza	4200 nx, 2300 vajza	4200 nx, 2300 vajza	4200 nx, 2300 vajza	100%
		14		3800 nx, 2200 vajza	4200 nx, 2300 vajza	4200 nx, 2300 vajza		0%
		15		300 nx, 200 vajza	300 nx, 200 vajza	300 nx, 200 vajza	100 nx, 50 vajza	0%
Objektivi 1.4	Ofrimi i sherbimeve cilesore per zhvillimin e procesit mesimor edukativ ne kushte te pershtatshme ne gjithe territorin administrativ te Bashkise se Shkodres ne arsimin baze parashkollor	16	Nr. Kopshteve	58	58	55	55	100%
		17	Nr foshnjeve qe frekuentojne kopshtet	2118	1978	1862	1862	100%
		18	Nr. i femijëve (vajza) që frekuentojnë kopshtet	1023	969	969	969	100%
		19	Numri i stafit për fëmijët	172	172	172	172	100%

ANEKSI 3.

Programi	Arsimi baze parashkollor	Kodi i Programit	9120				I			II			III			IV	Luhatjet ne Koston per Njesi			Komente
	ne 000/leke																			
Kodi	Emertimi i Treguesit te Performances/ Produktit	Njësia matese	Sasia Faktike (sipas vitit paraardhes)	Shpenzimet (sipas vitit paraardhes)	Kosto per Njesi (sipas vitit paraardhes)	Sasia (sipas planit te vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te vitit korent)	Sasia (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Sasia Faktike (ne fund te vitit korent)	Shpenzimet Faktike (ne fund te vitit korent)	Kosto per Njesi Faktike (ne fund te vitit korent)	V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III			
1	Nr I punonjesve mbeshtetes ne arsimin 9-vjecar;	Nr Punonjesish	130	69,645	536	165	75,773	459	165	75,773	459	157	75294	480	-56	20	20			
2	Numrin i shkollave ne qe pefitojne sherbime mbeshtetese ne arsimin 9-vjecar;	Nr Shkollash	69	6,021	87	78	7,253	93	78	9,791	126	78	8489	109	22	16	-17			
3	Nr I shkollave qe ngrohen me dru zjarri	Nr Shkollash	45	10,720	238	50	12,000	240	50	12,000	240	50	12000	240!	2	0	0			
4	Nr I shkollave qe ngrohen me kaldaja me nafte	Nr Shkollash	2	668	334	1	2,000	2,000	1	97	97	1	97	97	-237	-1,903	0			
5	Nr I mjeteve te transportit ne sherbim	Nr Mjete	1	149	149	1	250	250	1	250	250	1	80	80	-69	-170	-170			
6	Nr I objekteve qe do te nderhyhet	Nr Shkollash	13	5,005	385	15	4,063	271	15	3,428	229	15		0	-385	-271	-229	Kontrate e nenshkruar per likujdim		
7	Nr I objekteve qe do te sigurohen	Nr Shkollash	7	504	72	9	500	56	9	500	56	9	500	56	-16	0	0			

8	Numrin i shkollave qe I sherbejne femijeve me aftesi te vecanta	Nr Shkollash	1	2,640	2,640	1	4,200	4,200	1	4,200	4,200	1	1259	1259	-1381	-2941	-2941
9	Nr I shkollave me sherbim sigurije	Nr Shkollash				78	4,603	59	78	4,603	59	78	644	8	8	-51	-51
10	Nr I shkollave qe do te rikonstruktohen	Nr Shkollash	1	3,597	3,597	2	2,505	1,253	1	2,505	2,505	1	1880	1880	-1717	628	-625
11	Nr nxenesve qe perfitojne nga aktivitetet e Q.K.F	Nr nxenesish	3800	408	2	4200	418	2	4200	418	2			#DI V/0!	#DI V/0!	#DI V/0!	#DI V/0!
12	Nr nxenesve qe perfitojne nga aktivitetet e Festivali te femijeve	Nr nxenesish	200	4,375	1	200	4,710	1	200	4,710	1	200	1996	0	-22	-024	-24
13	Nr nxenesve qe perfitojne nga aktivitetet e Q.K.F	Nr nxenesish	3800	130	0	4200	280	1	4200	280	1	4200	275	0	0	0	0
14	Mbremja tradicionale e vitit te ri per nxenesit e shkollave 9 vjecare.	Nr nxenesish	300	388	1	300	445	1	300	445	1	0	0	0	-1	-1	-1
15	Nr. Kopshteve	Nr. Kopshteve	58	3000	418	58	3,000	453	58	3,000	453	55	2,359	41	-378	-412	-412
16	Nr. femijeve qe frekuentojne kopshtet	Nr. Femijëve	2118	21260	70	1978	23,269	83	1978	23,269	83	1862	17809	3	-67	-80	-80
17	Nr. i femijëve, vajza, që frekuentojnë kopshtet	Nr. I vajzave	1023		0	969		0	969		0	969		0	0	0	0
18	Numri i stafit për femijë	Nr. Stafit	172	123744	719	172	137,346	799	172	137346	808	172	124123	487	-233	-312	-321

Drejtoria Ekonomike e Arsimit ka si **objektiv**:

O1. Ofrimi i shërbimeve cilësore për zhvillimin e procesit mësimor edukativ në kushte të përshtatshme në të gjithë territorin administrativ të Bashkisë Shkodër.

Për Vitin 2020 janë planifikuar dhe realizuar produktet e mëposhteme:

P09120.O1 .A1. Pagat dhe sigurime shoqërore për punonjësit e arsimit baze

Sistemi arsimor ka rëndësi të madhe në rritjen e zhvillimit ekonomik dhe social të komunitetit tonë. Shkolla duhet ti mundësojë të gjithë fëmijëve që të kenë rezultate në mësim, të jenë të urtë, të shëndetshëm dhe aktivë në jetën komunitare.

Duke përfshirë 149 punonjes mbështetës, 16 punonjës zyre në Total 165 punonjës në një kohe që nr faktik I punonjësve është 157

P09120.O1 .A2. Mbështetje për infrastrukturen dhe shërbimet mbështetës.

Ky zë është realizuar duke patur parasysh edhe ato shpenzime që janë lejuar nga Dega e Thesarit Shkodër, siç janë Shpenzimet për Dezinfektim të mjediseve shkollore dhe Blerje Xham duke vazhduar me Blerje Materiale hidraulike elektrike boje realizuar

P09120.O1 .A3. Blerje dru zjarri për ngrohje për sistemin e arsimit bazë dhe parashkollor eshte realizuar

P09120.O1 .A4. Blerje lëndë djegëse karburante për ngrohje dhe për mjete transporti (naftë dhe benzinë). Është realizuar dhe është likuiduar ..

P09120.O1 .A5. Mirëmbajtje e mjeteve të transportit për shërbimet mbështetëse të sistemit arsimor bazë dhe parashkollor.

Jane kryer shërbimet për mjetin me targë SH 3154E, dhe është bërë kolaudimi I tij.

P09120.O1 .A6. Mirëmbajtje e zakonshme e objekteve arsimore.

Bashkia Shkodër çdo vit bën ndërhyrje dhe mirëmbajtje në shkolla. Rregullimi dhe riparimi i ambjentëve shkollore, për të krijuar kushte normale në institucionet arsimore është bërë duke vlerësuar kërkesat e paraqitura nga shkollat në njësitë administrative dhe atyre në qytet.

Për vitin 2020 është menduar për të ndërhyrë në ato objekte që kanë nevojën më të madhe dhe numrin më të konsiderueshëm të nxënësve. Mirëmbajtja e zakonshme është realizuar.

P09120.O1 .A7. Sigurimi i objekteve për raste të ngjarjeve të jashtëzakonshme si zjarr dhe tërmete.

Çdo vit është planifikuar për të bërë sigurimin e objekteve, dhe shkollat e arsimit bazë që kanë numër më të madh nxënësish. Sigurimi i objekteve është bërë për raste ngjarjeve të jashtëzakonshme si për zjarr dhe tërmete, Synohet që të kemi parashikuar sigurimin që për çdo ngjarje të jashtëzakonshme të përfitojmë këtë shërbim i cili është realizuar.

P09120.O1 .A8. Trajtimi ushqimor për arsimin bazë dhe parashkollor.

Ky zë është planifikuar të kryhet në bashkëpunim me Bashnië Shkodër. Është realizuar në përputhje me numrin e fëmijëve

P09120.O1 .A9. Shërbim i sigurisë në objekte. Është realizuar.

P09120.O2 .A2. Rikonstruksion Fasada Shkolla Seit Tagani, Trush.

Ky rikonstruksion konsiston në riparimin e fasadës së shkollës Seit Tagani, Trush. Është realizuar në muajin Dhjetor

P09120.O3 .A1. Bilbilat e vegjël të Shkodrës këndojnë.

Aktiviteti nuk u realizua për shkak të pandemisë Covid 19.

P09120.O3 .A2. Festivali i 58-te mbarëkombëtar për femije.

Aktiviteti, për shkak të pandemisë, u realizua në sheshin e Shirokës, në muajin Nëntor. Në këtë aktivitet u aktivizuan 200 femije dhe u performuan 18 kënge të reja për femije nga shkrimtare, kompozitore të njohur në krijimtarinë për femije.

P09120.O3 .A3. “Veprimtari masive” (sportive, artistike e shkencore) të Qendrës Kulturore të Fëmijëve nuk janë realizuar për shkak të pandemisë.

P09120.O3 .A4. “Veprimtari me rrethet artistike, sportive e shkencore për vitin 2020”

U planifikuan dhe u realizuan në gjashtë muajin e dytë të vitit 2020. Në këto aktivitete morën pjesë 450 femije ku 290 ishin vajza.

P09120.O3 .A5. Mbrëmja Tradicionale e Vitit të Ri për nxënësit e shkollave 9 vjeçare.

Aktiviteti është planifikuar të zhvillohet në fundviti, por nuk është realizuar për shkak të pandemisë.

P09120.O4.A1 . Mbështetja personelit edukator dhe të shërbimit të sistemit parashkollor.

Me ligjin e buxhetit të shtetit të vitit 2018, janë akorduar fondet për mbulimin e shpenzimeve për personelin për pagat e punonjësve që transferohen nga Ministria Arsimit e Sportit të Njësitë e Qeverisjes Vendore (bashkitë e reja) për vitin 2020, të parashikuara me transfertë specifike. Numri i personelit gjithsej pranë Drejtorisë Kopshte dhe Çerdhe është 172 (njëqind e shtatëdhjetë e dy) punonjës. Me transfertë specifike, numri i punonjësve të transferuar është 163 (njëqindgjashtëdhjetë e tre), me të ardhurat e bashkisë 9 punonjës.

P09120.O4.A2. Furnizim me ushqime për kopshtet në Bashkinë e Shkodrës:

Në 7 kopshtet me drekë (“Bep Tusha”, “Ton Alimhilli”, “I.S.Bruçaj”, “Guerilie”, “1 Qershori”, “Edit Durham”) dhe kopshti ri “Njomzat”) frekuentojnë mesatarisht 350 femije. Për furnizimin me ushqime të këtyre kopshteve bazuar në fondin e planifikuar për shpenzime për ushqime është lidhur kontrata me operatorin ekonomik fitues e cili ka furnizuar me artikuj të ndryshëm ushqimorë sipas dietave ushqimore të kërkuara. Kjo kontratë është lidhur në muajin korrik dhe likuidimi bëhet çdo muaj në bazë të frekuentimit të femijeve në Kopshte. Nga Janari-Mars 2020 Kopshtet janë furnizuar me ushqime me kontratën e vitit 2019 pasi është bërë Amendamenti për zgjatje kontrate për 3 muajin e vitit 2020, dhe fakti për këtë zë në matricë është pasqyruar tek të trashëguarat.

P09120.O4.A3 Mbeshtetje me materiale kancelarie, pastrimi dhe paisje orendi për kopshte.

Blerje Materialet e Pastrimit është realizuar dhe likuiduar, janë blerë detergjente dhe mateliare për pastrim dhe materiale higjieno-sanitare anti-covid si dizinfektat, maska, doreza, termometer etj. Blerje materiale kancelarie është realizuar, si dhe blerje paisje orendi si stufa me dru për kopshtet “Veli Tela”, Öblike”, “Golem”, Azem Hajdari”, shporet gatimi profesional për kopshtin “Ismet Sali Bruçaj”, 3 kondicioner dhe 1 bulier uji 1 fshese me korent për kopshtin Njomzat. Furnela për ngrohje për Kopshtet, “Ismail Qemali”, “Gjuhët e huaja” dhe “Njomzat”.

P09120.O4.A4 Ngrohje me lëndë djegëse (dru zjarri, naftë dhe gaz) për arsimin parashkollor.

Për ta bere sa me të favorshem qendrimin e femijeve ne kopshte është bërë “Blerje dru zjarri” 416 m³ per arsimin parashkollor për te gjitha kopshtet qe perdorin shporeta me dru per ngrohje. Eshtë bere blerje karburant naftë për kaldajen e kopshtit Bep Tusha dhe për automjetin që furnizon kopshtet me ushqime. Blerje gaz është bërë ndryshim rregjistri me vendim Nr 177 Dt 03.08.2020 për Blerje lëndë djegëse Pelet për kaldajen e Kopshtit Ngjyrat.

P09120.O4 .A5 Sigurimi i objekteve të arsimit parashkollor, -

Eshtë realizuar sigurimi i ndertesave ne 5 kopshte: “Ismet Sali Bruçaj”, “Bep Tusha”, “Ton Alimehilli”, “1 Qershori” dhe Guerrile.

P09120.O4.A6. Dezinfektim i mjediseve të objekteve në arsimin parashkollor.

Për të pasur ambjente sa me higjienike, dhe te mbrojtura ndaj infektiveve te ndryshme eshte realizuar dizinfektimi e ambjenteve të të gjithë godinave të kopshteve.

P09120.O4.A7.Mirembajtje e zakonshme për ndertesat e arsimit parashkollor.

Ndertesat e sistemit arsimor parashkollor për të qënë sa me të pershtatshme dhe komode për arsimimin dhe edukimin e femijeve kane nevojë per mirembajtje, si lysterje me boje dhe riparime të ndryshme. Riparime suvatime të brendshme 150 m², prishje suva solte e brendshme 150 m². Lysterje me boje hidroplastike 2679 m², ndersa boje hidroplastike importi cilesi e pare 4513 m².

P09120.O4 .A8 Materiale mbeshtetese për arsimin parashkollor

Sigurimi i bazes materjale në kopshte është domosdoshmeri për mbarevajtjen e punes. Për këtë arsye duke konstatuar situaten në kopshte është bërë e mundur blerja me karrige dhe tavolina per Kopshtin “Golem”, karrige per kopshtet “Dobrac” dhe “Bardhaj”, rafta dhe karrige për per kopshtin “Qazim Mehja”, peshqire për kopshtin “Ismet Sali Bruçaj”.

P09120.O4.A9: Sigurimi i transportit për sherbimet e arsimit parashkollor.

Eshtë realizuar sipas planit kolaudimi, taksat, dhe siguracioni i automjetit që furnizon me ushqime cerdhet dhe kopshtet.

Për kete mjet është shpenzuar dhe për blerje e karburantit.

P09120.O4.A10 Furnizim me EE dhe uje per arsimin parashkollor,

Faturat e furnizimit me energji elektrike dhe uje për godinat e kopshteve si me poshte:” 16 Shtatori”, ”Bep Tusha ,”Ton Alimhilli”, ”Ismet Sali Bruçaj”, tek ”Veterinarja”, ”Ngjyrat”, Isa Jakupi”, dhe ”Mati Logoreci” te cilat jane me linje dhe mates te veçante jane ne likuidim në vazhdim. Cdo muaj kryejme likujdim sipas faturave te ardhura.

P09120.O4.A11 Shpenzime per mirembajtjen e aparateve teknike - Shpenzimet për mirembajtjen e aparateve dhe paisjeve teknike eshte realizuar mirmbajtje, pastrim dhe mbushje me gaz kondicioner ne kopshtin Bep Tusha dhe Administrates.

P09120.O4 .A13.Rikonstruksion i pjesshem i kopshtit " Haxhi Hajdari" Golem. – Eshtë realizuar Rikonstruksion I pjesshem I kopshtit " Haxhi Hajdari" Golem

Ne kete investim janë nderruar komplet catia dhe tavanet, jane zevendesuar dhe vendosur dyer dhe dritare te reja, janë sovatuar dhe lyer muret e brendshme dhe të jashtme, eshte realizuar rikostruksion i plote I dy banjove, sheshim oborri, hidroizolim për lageshtiren.

Aktiviteti	Përshkrimi	Buxheti fillestar 000/lekë	Buxheti i korigjuar 000/lekë	Realizimi Viti 2020 000/lekë
P09120.O1 .A1	Mbështetja për punonjësit e arsimit parashkollor dhe bazë.	75,773	75,773	75,294
P09120.O1 .A2	Mbeshetje per infrastrukturen dhe sherbimet mbeshetese arsimit baze dhe parashkollor	7,253	9,791	8,489
P09120.O1 .A3	.Ngrohje me dru zjarri për sistemin e arsimit baze dhe parashkollor	12,000	12,000	12,000
P09120.O1 .A4	Ngrohje me lende djegese karburante për sistemin e arsimit baze dhe parashkollor dhe furnizim për mjetet transporti (naftë + benzine)	2,000	97	97
P09120.O1 .A5	Mirembajtje e mjeteve te transportit per sherbimet mbeshetese te sistemit arsimor baze dhe parashkollor	250	250	80
P09120.O1 .A6	Mirembajtje e zakonshme e objekteve arsimore	4,063	3,428	-
P09120.O1 .A7	Sigurimi i objekteve per raste te ngjarjeve te jashtezakonshme si zjarr dhe termete.	500	500	500
P09120.O1 .A8	Trajtimi ushqimor për arsimin bazë dhe parashkollor	4,200	4,200	1,259
P09120.O1 .A9	Sherbim I sigurise ne objekte	4,603	4,603	644
P09120.O2 .A1	Vendosja e rrjetit dhe instalim kaldaje shkolla Martin Camaj	-	-	-
P09120.O2 .A2.	Rikonstruksion fasada shkolla Seit Tagani Trush	2,505	2,505	1,880
P09120.O2 .A3.	Rikonstruksioni pjesshem shkolla Azem Hajdari	-	-	-
P09120.O2 .A4.	Instalim I ngrohjes ne ndertesen e Shkolles Ismail Qemali	-	-	-
P09120.O3 .A1	Bilbilat e vegjël të Shkodrës këndojnë	418	418	-
P09120.O3 .A2	Festivali i 58-te mbarëkombëtar për femije	4,710	4,710	1,996
P09120.O3 .A3.“	“Veprimtari masive” (sportive, artistike e shkencore) te Qendres Kulturore te Femijeve.	280	280	275
P09120.O3 .A4.	“Veprimtari me rrethet artistike, sportive e shkencore per vitin 2020”	1,082	1,082	-
P09120.O3 .A5.	Mbrëmja Tradicionale e Vitit të Ri per nxenesit e shkollave 9 vjeçare.	445	445	-
P09120.O4.A1	Mbështetja e personelit edukator dhe të shërbimit të sistemit parashkollor	137,346	137,346	124,123

P09120.O4 .A2	Furnizim me ushqime për kopshtet në Bashkinë e Shkodrës	11,100	11,100	6,396
P09120.O4 .A3	Mbeshtetje me materiale kancelarie, pastrimi dhe pajisje orendi per kopshte.	1,500	1,500	1,339
P09120.O4 .A4	Ngrohje me lende djegese (dru zjarri, nafte dhe gaz) per arsimin parashkollor.	3,400	3,400	3,227
P09120.O4 .A5	Sigurimi i objekteve te arsimit parashkollor	80	80	80
P09120.O4 .A6	Dezinfektim i mjediseve te objekteve ne arsimin parashkollor.	150	150	137
P09120.O4 .A7	Mirembajtje e zakonshme per ndertesat e arsimit parashkollor.	4,069	4,069	3,880
P09120.O4 .A8	Materiale mbeshtetese per arsimin parashkollor.	820	820	789
P09120.O4 .A9	Sigurimi i transportit për shërbimet e arsimit parashkollor.	300	300	252
P09120.O4.A10	Furnizim me EE dhe uje per arsimin parashkollor	1,800	1,800	1,659
P09120.O4.A11	Shpenzime per mirembajtjen e aparateve teknike	50	50	50
P09120.O4 .A12.	Rikonstrukcion i pjesshem i kopshteve.	-	-	-
P09120.O4 .A13	Rikonstrukcion i pjesshem i kopshtit" Haxhi Hajdari" Golem.	3,000	3,000	2,359
	Totali	283,697	283,697	246,805

Programi 09230: Arsimi i mesem i pergjithshem

PROGRAMI 9230 Arsimi i mesëm i përgjithshëm.

Qëllimi i programit dhe objektivat e politikës së programit:

I. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar në arsimin e mesëm të përgjithshëm;

O1. Ofrimi i shërbimeve cilësore për zhvillimin e procesit mësimor edukativ në kushte të përshatshme në gjithë territorin administrativ të Bashkisë së Shkodrës në arsimin e mesëm të përgjithshëm.

O2. Sigurimi i mjediseve dhe objekteve cilësore për zhvillimin e procesit mësimor në arsimin e mesëm të përgjithshëm.


Realizimi i shpenzimeve për programin P 09230 Arsimi parauniversitar 000/lekë për Vitin 2020.

Programi P9230	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Transferta	Investime	TOTALI
Plani fillestar	23,461	11,065	1,138	18,400	54,064
Plani i korigjuar	23,253	13,365	208	18,400	55,226

Realizimi Vitit	22,773	5,656	208	18,332	46,969
% realizimit	98 %	42.32 %	100 %	99.6 %	85 %

Realizimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është në total 85%, sipas zërave kryesorë më poshtë:

Shpenzimet korrente (paga+sigurime, shpenzime operative, transferime) **61%**
Shpenzimet kapitale **39%**



P09230.O1.A1 Mbështetje për punonjësit e shërbimit në arsimin e mesëm të përgjithshëm.

Sistemi arsimor ka rëndësi të madhe në rritjen e zhvillimit ekonomik dhe social të komunitetit tonë. Shkolla duhet ti mundësojë të gjithë fëmijëve që të kenë rezultate në mësim, të jenë të sigurtë, të shëndetshëm dhe aktivë në jetën komunitare.

Nr i punonjësve mbështetës në arsimin e mesëm është **43**. Për sa i perket numrit të punonjësve është i barabartë me **37** punonjës mbështetës .Ky ze eshte ne proces realizimi.

P09230.O1.A2. Mbështetje për infrastrukturën dhe shërbimet mbështetëse.

Në sistemin arsimor të mesëm të përgjithshëm të Bashkisë Shkoder ndodhen 13 shkolla nga të cilat 6 shkolla të mesme në qytet dhe 7 shkolla të mesme në njesitë Administrative. Me një nr nxënësish rreth 3 872 nxënës nga të cilët 2 073 janë vajza.Ky ze eshte realizuar.

P09230.O1.A3. Ngrohje me dru zjarri për arsimin e mesëm të përgjithshëm .Eshte realizuar ne muajin Nentor Sasia e parashikuar është bërë mbi bazën e një kuotë mujore që shkon mesatarisht 0.8-1 m3 në muaj për një ambjent/klasë dhe është llogaritur sasia për katër muaj në vit

Jane furnizuar 6 shkolla në Njesitë Administrative.

P09230.O1.A4. Ngrohje me gaz të lëngshem për arsimin e mesëm të përgjithshëm eshte prokuruar dhe realizuar.

Jane furnizuar 6 shkolla të mesme ne NJA , 5 shkolla të mesme në qytet me rreth 1 098 nxënës dhe 1 shkollë të mesme në Njesitë Administrative me 481 nxënës.

P09230.O1.A5. Ngrohje me lëndë djegëse, karburant (naftë), për arsimin e mesëm të përgjithshëm realizuar.

Burimi tjetër alternativ që Bashkia Shkoder Ofron shërbimn e ngrohjes është ai me naftë për kaldajat. Bashkia Shkoder ofron shërbimn e ngrohjes nëpërmjet sistemit të kaldajes për 4 shkolla te arsimit te mesem te pergjithshem. Nga te cilat 4 shkolla në qytet . Përfitues 1 993 nxënës , 1 088 vajza.

Shkolla e mesme Oso Kuka me 670 nxënës , 305 vajza.

Shkolla e Mesme 28 Nentori me 666 nxënës, 444 vajza.

Shkolla e Mesme Shejnaze Juka me 471 nxënës me 250 vajza.

Shkolla e Mesme Prenk Jakova me 186 nxënës , 89 vajza.

Për institucionët e cituara më sipër është marrë në konsideratë konsumi orar I kaldajave dhe gjithashtu kohën e domosdoshme për ngrohje 3-4 ore në ditë të shkollave për periudhen 4 mujore.

P09230.O1.A6. Mirëmbajtje e zakonshme e objekteve arsimore për arsimin e mesëm të përgjithshëm.

Rregullimi dhe riparimi I ambjenteve shkollore, për të krijuar kushte normale në institucionet arsimore janë vlersuar kërkesat e paraqitura nga shkollat e njësite administrative dhe atyre në qytet. Mirëmbajtja e ambjenteve shkollore, për të krijuar kushte normale në institucionët arsimore janë vlerësuar kërkesat e paraqitura nga dëgjesat publike për shkollat e njësitë administrative dhe atyre në qytet. Për vitin 2020 është menduar për të ndërhyrë në ato objekte që kanë nevojën më të madhe dhe nr më të konsiderueshem të nxënësve. Eshte realizuar,per 4 shkolla në qytet dhe 6 shkolla në njësitë adminiatrative.

P09230.O1.A7. Sigurimi i objekteve për raste të ngjarjeve të jashtezakonëshme si zjarr dhe tërmete për arsimin e mesëm të përgjithshëm.

Cdo vit është planifikuar per te bërë sigurimin e objkteve, për shkollat që janë me numër më të madh nxënësish. Për vitin 2020 jane siguruar 6 shkolla në qytet dhe 2 në Njësitë Administrative.

P09230.O1.A8. Shërbim i sigurisë në objekte për arsimin e mesëm të përgjithshëm.

Për vitin 2020 jane siguruar 7 shkolla në qytet dhe 6 në Njësitë Administrative,

P09230.O1.A8. Transferim i kuotës financiare, bursa për arsimin e mesëm të përgjithshëm (ose trajtim ushqimor).

Parashikohet të realizohet ne vazhdimsi në bashkëpunim me bashkinë Shkodër.Ky ze eshte realizuar ne muajin Nentor dhe Dhjetor

P09230.O2.A1. Rikonstruksion Shkolla Jordan Misja Faza I.

Është realizuar dhe konsiston në përmirësimin e kushteve të mësimdhënies të kësaj shkolle me sipërfaqe 4 634 m2, 23 klasa dhe 689 nxënës.

ANEKSI 3

Programi	Arsimi i mesem i pergjithshem	Kodi i Programit	9230
-----------------	-------------------------------	-------------------------	-------------

Kodi	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Njësia matese	Sasia Faktike (sipas vitit paraardhes)	Shpenzi met (sipas vitit paraardhes)	I		II			III			IV			Luhatjet ne Koston per Njesi			Komete
					Kosto per Njesi (sipas vitit paraardhes)	Sasia (sipas planit te vitit korent)	Shpenzi met (sipas planit te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Sasia Faktike (ne fund te vitit korent)	Shpenzi met Faktike (ne fund te vitit korent)	Kosto per Njesi Faktike (ne fund te vitit korent)	V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III					
1	Nr I punonjesve mbeshtetes ne arsimin e mesem te pergjithshem	Nr punonjesish	51	29,506	579	43	23,461	546	43	23,461	546	37	22981	621	43	76	76		
2	Numrin i shkollave te mesme te pergjithshme qe perfitojne sherbime mbeshtetese	Nr shkollash	12	931	78	12	4,958	413	10	5073	507	8	4159	520	442	107	13		
3	Nr I shkollave qe ngrohen me dru zjarri	Nr shkollash	4	2,487	622	4	2,000	500	4	2,000	500	4	1560	390	-232	-110	-110		
4	Nr I shkollave qe ngrohen me gaz	Nr shkollash	9	0	0	9	1,000	111	9	885	98	9			0	-111	-98		
5	Nr I shkollave qe ngrohen me kaldaja me naftë	Nr shkollash	5	0	0	5	65	13	5	65	13	5			0	-13	-13		
6	Nr I shkolla ve qe do te nderhyhet	Nr shkollash	5	3,000	600	5	1,537	307	5	1,537	307	5	1231	246	-354	-61	-61		
7	Nr I shkollave qe do te sigurohet per ngjarjet e	Nr shkollash	5	180	36	5	280	56	5	280	56	5	280	56	20	0	0		

	jashtezakonshme,z jarr etj																	
8	Nr I shkollave qe kane sherbimin e ruajtjes	Nr shkollash				8	3,225		8	3,225	403	8			0	- 403	- 403	
9	Nr nxenesve qe mbeshtetin me bursa	Nr nxenesish	19	3,480	183	19	1,138		19	2,300	121	8	386	48	- 135	-12	-73	
10	Nr I shkollave qe do te rikonstruktohet	Nr shkollash	1	14,054	14,054	1	16,400	16,400	1	16,400	16,400	1	16372	16372	2318	-28	-28	

ANEKSI 4

Realizimi i produkteve:

Kodi i Programit	9230	Emertimi i programit:	ARSIMI MESEM I PERGJITHSHEM					Komente
Qelimi 1	Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar ne arsimin e mesem te pergjithshem;						
	**Treguesit e performancës/Produktet:						
Objektivat e politikës:	Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhes	Niveli i planifikuar ne vitin korent	Niveli i rishikuar ne vitin korent	Niveli faktik ne fund te vitit korent	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit
Objektivi 1.1 02 Ofrimi i sherbi meve cilesor e per zhvillimin e procesit mesimor edukativ ne kushte te pershtatshme ne gjithe territorin administrativ te Bashkise se Shkod	1	Përmirësimi i shërbimit në procesin edukativ dhe mësimor -nr I punonjesve mbeshtetes ne arsimin e mesem te pergjithshem	51	43	43	37	86%	
	2	Numri i shkollave te mesme te pergjithshme	12	13	13	8	62%	
	3	Nr I shkollave qe ngrohen me dru zjarri	4	6	6	6	100%	
	4	Nr I shkollave qe ngrohen me gaz	9	5	5	5	100%	
	5	Nr I shkollave qe ngrohen me kaldaja me nafte	4	1	1	1	100%	
	6	Nr I shkolla ve qe do te nderhyhet	5	10	10	10	100%	

	res ne arsimi n e mese m te pergjit hshem							
		7	- Nr. objekteve të siguruara për raste të ngjarjeve të jashtëzakonëshme si zjarr dhe	8	8	8	8	100%
		8	- <i>Nr i shkollave qe kanë shërbimin e ruajtjes</i>		13	13	13	100%
		9	Nr i nxenesve qe mbështeten me bursë financiare	19	19	19	19	100%
Objektivi 1.2	O2 Siguri mi i mjedis eve dhe objekt eve cilesor e per zhvillim in e proces it mesim or ne ne arsimi n e mese m te pergjit hshem	7	Nr I shkollave qe do te rikonstruktohet - Raporti i shpenzimeve operative për mirëmbajtjen dhe investimet në institucionin e arsimit të mesëm të përgjithshëm (mijë leke/institucion)	1 shk qytet, 4634 m2 , 23 kla. 689 nx	1 shk qytet, 4634 m2 , 23 kla. 689 nx	1 shk qytet, 4634 m2 , 23 kla. 689 nx	1 shk qytet, 4634 m2 , 23 kla. 689 nx	100%

Aktiviteti	Përshkrimi	Buxheti fillestar 000/lekë	Buxheti i korigjuar 000/lekë	Realizimi Viti 2020 000/lekë
P09230.O1 .A1	Mbështetje për punonjësit e shërbimit në arsimin e mesëm të përgjithshëm.	23,461	23,461	22,981
P09230.O1 .A2	Mbështetje për infrastrukturen dhe shërbimet mbështetëse.	4,958	5,073	4,159
P09230.O1 .A3	Ngrohje me dru zjarri për arsimin e mesëm të përgjithshëm.	2,000	2,000	1,560
P09230.O1 .A4	Ngrohje me gaz të lengshëm për arsimin e mesëm të përgjithshëm.	1,000	885	-
P09230.O1 .A5	Ngrohje me lënde djegëse, karburant (naftë), për arsimin e mesëm të përgjithshëm.	65	65	-
P09230.O1 .A6	Mirëmbajtje e zakonshme e objekteve arsimore për arsimin e mesëm të përgjithshëm.	1,537	1,537	1,231
P09230.O1 .A7	Sigurimi i objekteve për raste të ngjarjeve të jashtëzakonshme si zjarr dhe tërmete për arsimin e mesëm të përgjithshëm.	280	280	280
P09230.O1 .A8	Sherbim I Sigurisë në objekte.	3,225	3,225	-
P09230.O1 .A9	Transferim I kuotes financiare bursa për arsimin e mesëm të përgjithshëm(ose trajtim ushqimor).	1,138	2,300	386
P09230.O2 .A1	Rikonstruksion Shkolla Jordan Misja Faza I.	16,400	16,400	16,372
P09230.O2 .A2	Ndërtimin e fushës të oborrit të Shkollës së mesme të bashkuar "Adem Haxhija"	-	-	-
P09230.O2 .A3	Rikonstruksion shkolla "Kol Idromeno"	-	-	-
	Totali	54,064	55,226	46,969

Programi 09240: Arsimi mesem Profesional

Realizimi i qëllimit dhe objektivat e politikës së programit:

1. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar në arsimin e mesëm profesional;

Objektivat e programit:

O1. Ofrimi i shërbimeve cilësore për zhvillimin e procesit mësimor edukativ në kushte të përshtatshme në gjithë territorin administrativ të Bashkisë së Shkodrës në arsimin e mesëm profesional.

Realizimi i te ardhurave te planifikuara:

	LLOJET E TE ARDHURAVE	Plan 2020	Realizimi 2020	% e realizimit
1	Nga mensat (konviktet)	30	63	211 %


Realizimi i shpenzimeve për programin P 09240. Arsimi profesional 000/lekë për Vitin 2020.

Programi P9240	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Transferta	Investime	TOTALI
Plani fillestar	24,364	37,294	11,101	100	61,758
Plani i korrigjuar	24,364	36,068	11,101	25,915	97,448
Realizimi Vitit	20,597	29,982	9,787	1,565	61,931
% e realizimit	85 %	83 %	88%	6 %	64 %

Realizimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është në total 64%, sipas zërave kryesorë më poshtë:

Shpenzimet korrente (paga+sigurime, shpenzime operative, transferime) 97%

Shpenzimet kapitale 3%



ANEKSI 3.

Programi	Arsimi i mesem profesional	Kodi i Programit	9240															Komente
	ne 000/leke				I			II			III			IV		Luhatjet ne Koston per Njesi		
Kodi	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Njësia matese	Sasia Faktike (sipas vitit paraardhes)	Shpenzi met (sipas vitit paraardhes)	Kosto per Njesi (sipas vitit paraardhes)	Sasia (sipas planit te vitit korent)	Shpenzi met (sipas planit te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te vitit korent)	Sasia (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Shpenzi met (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Sasia Faktike (ne fund te vitit korent)	Shpenzi met Faktike (ne fund te vitit korent)	Kosto per Njesi Faktike (ne fund te vitit korent)	V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III	
1	N I punonjesve qe sherbejne ne konviktet e arsimit te mesem profesional	Nr punonjesish	41	19,938	486	41	24,364	594	41	24,364	594	32	20597	644	157	49	49	
2	Nr i shkollave profesionale qe perfitojne sherbime mbeshtetese .	Nr shkollash	5	159	32	5	623	125	5	578	116	5	336	67	35	-57	-48	
3	Nr shkollave profesionale qe ngrohen me gaz	Nr shkollash	2	0	0	2	3,000	1,500	2	760	380	2	750	375	375	-1,125	-5	
4	Trajtim ushqimore per konviktet dhe pagesat financiare	Nr nxenesish	10			10	3,870	387	10	13,745	1,375	10	10350	1,035	1,035	648	-340	
5	Nr konvikte me ngrohje me kaldaje	Nr shkollash	1	5,280	5,280	1	5,280	5,280	1	5,280	5,280	1	5,280	5280	0	0	0	
6	Materiale ne sherbim te konvikteve	Nr konviktesh	2			2	160	80	2	160	80	1	60	60	60	-20	-20	
7	Sasia e KË energji elektrike: sasia m3 uje I perdorur; nr koli postare, shpejtesia e internetit MB/s	Nr shkollash	714000	20,214	0	714000	19,701	0	714000	21,986	0	278500	21564	0	0	0	0	
8	Nr I shkollave dhe konvikteve ku do te nderhyhet me punime mirembajtje.	Nr shkollash	5	1,653	331	5	4,550	910	5	4,550	910	5	1519	304	-27	-606	-606	
9	Permiresim I sherbimit dhe kapaciteteve te konvikteve dhe shkollave profesionale.	Nr shkollash	1	121	121	1	210	210	1	210	210	1	10	10	-111	-200	-200	
10	Rritja e efieneses se menaxhimit te shkollave.	Nr shkollash	1	0	0	0	-	0	1	25915	25915	1	1464	1465	1465	1465	-24451	

ANEKSI 4.

<u>Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit</u>		-	-					Komente
Periudha e Raportimit: 01.12.2020-31.12.2020								
ARSIMI PROFESIONAL			9240	**Treguesit e performancës/Produktet:				
Kodi i Programit	9240	Emertimi i programit:	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhes	Niveli i planifikuar ne vitin korent	Niveli i rishikuar ne vitin korent	Niveli i faktik ne fund te vitit korent	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	
Qellimi 1	Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar ne arsimin e mesem profesional;								
								
Objektivat e politikës:		Kodi i Treguesit te Performances/Produktit						
Objektivi 1.1	O1. Ofrimi i sherbimeve cilesore per zhvillimin e procesit mesimor edukativ ne kushte te pershtatshme ne gjithe territorin administrativ te Bashkise se Shkodres ne arsimin e mesem profesional	1	nr I punonjesve qe sherbejne ne konviktet e arsimit te mesem profesional	41	41	41	32	78%	
		2	nr i godinave qe i sherbejne shkollave profesionale	5	4	4	4	100%	
		3	nr shkollave profesionale qe ngrohen me gaz	2	3	3	3	100%	

		4	nr I nxenesve ne konvikte -- Ndryshimi në % i numrit të nxënësve të akomoduar në konvikte	0	-34	0	0	0%	
		5	nr konvikte me ngrohje me kaldaje	1	1	1	1	100%	
		6	sasia e KËH energji elektrike: sasia m3 uje I perdorur; nr koli postare, shpejtesia e internetit MB/s	714000 kë, 82 000 m3, 15 koli, 4mbps	714000 kë, 82 000 m3, 15 koli, 4mbps	714000 kë, 82 000 m3, 15 koli, 4mbps	278500	25%	
		7	Nr I shkolla ve dhe konvikteve qe do te nderyhet me punime mirembajtje	2	1	1	1	100%	
		8	Përmirësimi i shërbimit dhe kapacitetit të konvikteve në shkollat profesionale - - Ndryshimi në % i numrit të konvikteve funksionale kundrejt vitit të kaluar	5	5	5	5	100%	
		9	Rritja e efijencës së menaxhimit të shkollave	0%	0%	0%	0%		
		10	Rritja e efijencës së menaxhimit të konvikteve	0	0	0	0		

P09240.O1.A1. Mbështetje për punonjësit e arsimit të mesëm profesional.

Sistemi arsimor ka rëndësi të madhe në rritjen e zhvillimit ekonomik dhe social të komunitetit tonë. Shkolla duhet ti mundësojë të gjithë fëmijëve që të kenë rezultate në mësim, të jenë të sigurtë, të shëndetshëm dhe aktivë në jetën komunitare. Numri i punonjësve faktik është i barabartë me 32 punonjës. Ky zë është në proces realizimi.

Punonjës mbështetës arsimit profesional janë **41**.

P09240.O1.A2. Mbështetje për infrastrukturen dhe shërbimet mbështetëse.

Në sistemin arsimor të mesëm të Bashkisë Shkodër përfshihen 2 shkolla të mesme profesionale dhe 2 konvikte.

Për administrimin e funksionimin e shkollave të arsimit të mesëm profesional kërkohet mbështetja dhe financimi për shërbimet dhe mirëmbajtjen.

P09240.O1.A3. Ngrohje dhe gatim me gaz të lëngshëm për arsimin e mesëm profesional dhe konviktet. Sasia e llogaritur është bazuar në një konsum mujor për ngrohje çdo ambient mësimor, me 15 kg (një bombulë gaz) për 4 muaj në vit. Ndërsa për gatim është llogaritur 4 bombula për 9 muaj . Është realizuar blerja e gazit të lëngshëm.

P09240.O1.A4. Trajtim ushqimor për konviktet dhe pagesa kuotë financiare (Bursa).

Ky zë do të realizohet në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër dhe është realizuar

P09240.O1.A5. Materiale në shërbim të konvikteve.

Në këtë kontekst është edhe sigurimi i bazës materiale për disa institucione që ka në varësi Drejtoria Ekonomike e Arsimit.

Këto mallra janë pjesë e furnizimit për konviktet. Është realizuar blerja e enëve të kuzhines.

P09240.O1.A6. Ngrohje dhe transport me lëndë djegëse e karburante.

Përsa i përket blerjes së lëndës djegëse e karburante për ngrohje dhe transport është realizuar prokurimi, lidhur kontrata dhe likuiduar në muajin Maj 2020 me firmën Kastrati SH.P.K.

P09240.O1.A7. Furnizim me energji elektrike, ujë, shërbime postare, hostim Web, internet.

Në sistemin arsimor të mesëm profesional të Bashkisë Shkodër ndodhen 2 shkolla të mesme profesionale dhe 1 konvikt.

Për administrimin e funksionimin e shkollave të arsimit të mesëm profesional kërkohet mbështetja dhe financimi për shpezimet për energji elektrike dhe ujë.

Është bërë pagesa në vazhdim për të gjitha shpenzimet e energjisë elektrike dhe ujit. Ky zë është realizuar

P09240.O1.A8. Mirëmbajtje e zakonshme e objekteve arsimore është realizuar.

P09240.O1.A9. Dezinfektimi dhe sigurimi i ndërtesave.

Dezinfektimi i ndërtesave është realizuar që në periudhën Mars-Prill 2020, me firmën Grifin Albania SH.P.K, dhe është realizuar sigurimi i ndërtesave.

P09240.O1.A9. “Rikonstruksioni i objektit të ish-shkollës “Veterinare”:

Në kuadër të zbatimit të projektit P09240.O1.A9. “Për rikonstruksionin e objektit të ish-shkollës “Veterinare”” të parashikuar në buxhetin e vitit 2019 me vlerë 15,000,000 Lek, Bashkia Shkodër ka aplikuar në thirrjen e IADSA II Nr. Ref: IADSAII/2019/01 (Marrëveshja Italo-Shqiptare e Konvertimit të Borxhit për Zhvillim) me afat aplikimi deri më 31.01.2020, me projektin “Shkodra Multi-Functional Services – Model of social inclusion and development of the community”

(“Shërbimet Multi-Funksionale të Shkodrës – Model i përfshirjes sociale dhe zhvillimit të komunitetit”).

Me datën 08.07.2020 është lidhur Kontrata me Nr. Ref: IADSAII/2020/02 ndërmjet Komitetit të Menaxhimit të IADSA-s e përfaqësuar nga Ministri i Financave dhe Ambasadori Italian në Shqipëri, dhe Bashkisë Shkodër të përfaqësuar nga Kryetarja e Bashkisë.

Projekti drejtohet nga Bashkia Shkodër në rolin e Liderit të Projektit dhe ka afat zbatimi 24 muaj që nga nënshkrimi i kontratës. Me partneritet prej 2 organizatash: Terres des Hommes dhe Rajoni Emilia-Romagna, qëllimi i përgjithshëm i projektit është të rikonstruktojë dhe të kthejë godinën e ish-shkollës “Veterinare” në një qendër multi-funksionale për komunitetin duke ofruar shërbime të tilla si qendër shëndetësore, kopsht, çerdhe, ambjente të përbashkëta për aktivitete apo zyra administrative.

Bashkia Shkodër ka nisur zbatimin e projektit sipas planit të punës dhe buxhetit përkatës të nënshkruar me IADSA. Gjatë periudhës së raportimit në fjalë, janë realizuar të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe bankare dhe është kryer me sukses transferata e këstit të parë me vlerë 10,814,510 Lek, nga të cilat është detyrë e Liderit të Projektit të bëjë shpërndarjen e fondit drejt partnerëve. Janë transferuar drejt partnerit Terres des Hommes 465,540.00 (katërqind e gjashtëdhjetë e pesëmijë e pesëqind e dyzet) Lek. Aktivitetet e projektit kane vazhduar sipas planit të punës, dhe deri më tani: i) është kryer procedura e prokurimit dhe është lidhur kontrata me projektuesin e projekt-zbatimit të rikonstruksionit të godinës; ii) ka përfunduar përkthimi i dokumentacionit të projektit (kontrata, buxheti dhe udhëzimi për implementimin e projektit) nga anglisht në shqip dhe u është shpërndarë drejtorive përkatëse; iii) është bërë publikimi në gazetën “Panorama” dhe në faqen web të Bashkisë Shkodër i njoftimit për hapjen e ofertave për rikonstruksionin e objektit.

Aktiviteti	Përshkrimi	Buxheti fillestar 000/lekë	Buxheti i korigjuar 000/lekë	Realizimi Viti 2020 000/lekë
P09240.O1 .A1	Mbështetje për punonjësit e arsimit të mesëm profesional.	24,364	24,364	20,597
P09240.O1 .A2	Mbështetje për infrastrukturen dhe shërbimet mbështetëse.	623	578	336
P09230.O1 .A3	Ngrohje dhe gatim me gaz të lëngshëm për arsimin e mesëm profesional dhe konviktet	3,000	760	750
P09240.O1 .A4	Trajtim ushqimor për konviktet dhe pagesa kuotë financiare (Bursa).	3,870	13,745	10,350
P09240.O1 .A5	Materiale në shërbim të konvikteve.	160	160	60
P09240.O1 .A6	Ngrohje dhe transport me lëndë djegëse e karburante.	5,280	5,280	5,280

P09240.O1 .A7	Furnizim me energji elektrike, ujë, shërbime postare, hostim Web, internet.	19,701	21,986	21,564
P09240.O1 .A8	Mirëmbajtje e zakonshme e objekteve arsimore.	4,550	4,550	1,519
P09240.O1 .A9	Dezinfektimi dhe sigurimi i ndërtesave.	210	210	10
P09240.O1 .A10	Rikonstruksioni i objektit të ish shkollës veterinare	-	25,815	1,464
P09240.O2.A1.	Rikonstruksioni i konvikteve.	-	-	-
	Totali	61,758	97,448	61,930

FUNKSIONI 10: MBROJTJA SOCIALE

Programi 10140: Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara

Ky program është pjesë e programeve të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik.

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit.

Qëllimi i programit të “Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara”.

- Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuar, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtyre funksioneve për vitin 2020 kanë qenë:

- O1.Partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurëse, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti për ofrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë.
- O2.Krijimi i fondit të dedikuar për mbështetjen e personave me AK në bashkërendim me shoqërinë civile.

Në funksion të krijimit dhe administrimit të shërbimeve sociale për shtresat në nevojë në partneritet të ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurëse, biznesin privat dhe biznesin social janë parashikuar realizimi i disa aktiviteteve dhe mbështetjeve për ofrimin e shërbimeve alternative për personat me aftësi të kufizuar, të cilët janë pa asnjë përkujdes dhe interesim familjar dhe me problematika të ndryshme. Sigurohet mbështetje financiare si një domosdoshmëri, për të ofruar shërbimin sipas standarteve të përcaktuara në ligj për personat me aftësi të kufizuar dhe përmbushjen e nevojave sipas rasteve specifike.


Realizimi i Buxhetit të planifikuar

Programi: “Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara”.

Programi 10140	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Subvensioni	Transferta	Investime	Totali
Plani fillestar 2020	-	469	-	-	-	469
Plani i rishikuar 2020	-	469	-	-	-	469
Realizimi viti 2020	-	277	-	-	-	277
% e realizimit	-	59%	-	-	-	59%

Realizimi i shpenzimeve korrente për këtë program, është realizuar në masën 59% të buxhetit të planifikuar sipas zërave më poshtë:

Shpenzimet korrente (paga+sigurime shoqërore, shpenzime operative, transferime) **59%**
Shpenzimet kapitale **0%**



Aktiviteti ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për Personat me Aftësi Ndryshe, më 3 Dhjetor është realizuar në respektim të masave ndaj pandemisë Covid – 19 dhe është realizuar pa kosto financiare të planifikuar në buxhet.

Realizimi i treguesve të performancës

Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

Periudha e Raportimit: Janar - Dhjetor 2020

Kodi i Programit	10140	Emertimi i programit:	Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara						Komente
Qellimi	Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.								
			**Treguesit e performancës/Produktet:					
Objektivat e politikës:		Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhes	Niveli i planifikuar ne vitin korent	Niveli i rishikuar ne vitin korent	Niveli faktik ne fund te vitit korent	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	
<i>Objektivi specifik 1</i>	O1.Partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurese, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti për ofrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë.								
		1	Nr. i aktiviteteve ndërgjegjësuere;	3	5	3	2	67%
		2	Nr. i fëmijëve dhe familjeve përfitues të shërbimeve ekzistuese dhe atyre alternative;	200	230	230	100	43%
		3	Nr. partneriteteve me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurese,	7	7	7	7	100%
<i>Objektivi specifik 2</i>	O2.Krijimi i fondit te dedikuar per mbeshtetjen e personave me AN në bashkerendim me Shoqerine Civile.								
		4	Nr. i fëmijëve në nevojë që marrin pjesë dhe performojnë në aktivitetin artistiko-kulturor.	25	25	25	25	100%

Realizimi i produkteve

ANEKSI nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit te treguesve te performances/produkteve te programit"

Emri i Grupit	Bashkia Shkoder	Kodi i Grupit	141
Programi	Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara	Kodi i Programit	10140

Kod i	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Njësia matese	Sasia Faktike (2019)	Shpenzimet (sipas vitit 2019)	ne 000/leke			I	II	III	IV	Luhatjet ne Koston per Njesi			Komete		
					Kosto per Njesi (sipas vitit 2019)	Sasia (sipas planit te vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit te vitit korent)					Kosto per Njesi (sipas planit te vitit korent)	Sasia Faktike (ne fund te vitit korent)	Shpenzimet Faktike (ne fund te vitit korent)		V = IV - I	V = IV - II
1	Nr. i aktiviteteve ndërgjegjësuere;	Nr. aktiviteteve	3		0	5	100	20	3	100	33	2	0	0	-20	-33	
2	Nr. i fëmijëve dhe familjeve përfitues të shërbimeve ekzistuese dhe atyre alternative;	Nr. Përfituesve	200		0	230		0	230		0	100		0	0	0	
3	Nr. partneriteteve me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurese,	Nr. Partneriteteve	7		0	7		0	7		0	7		0	0	0	
4	Nr. i fëmijëve në nevojë që marrin pjesë dhe performojnë në aktivitetin artistiko-kulturor.	Nr. femijesh	25	362	14.48	25	369	15	25	369	15	25	277	11.079	3.401	3.681	3.681

Aktiviteti	Buxheti fillestar 000/Lekë	Buxheti i korigjuar 000/Lekë	Realizimi Viti 2020 000/Lekë
P10140.O1.A1. Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për Personat me Aftësi Ndryshe, më 3 Dhjetor.	100	100	Realizuar pa kosto financiare
P10140.O2.A2. Mbështetja e trupës muzikore të Personave me Aftësi Ndryshe”	369	369	277

“Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara”, në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjes së objektivave të përcaktuara, janë parashikuar 2 aktivitete.

- **P10140.O1.A1.** Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për Personat me Aftësi Ndryshe, më 3 Dhjetor.

3 Dhjetori - Dita Botërore e Personave me Aftësi të kufizuar, synon ndërgjegjësimin e institucioneve, shoqërisë civile, donatorëve, por edhe të mbarë komunitetit për t’u bërë pjesë dhe për t’u përfshirë në procesin e integritit të personave me aftësi të kufizuar në jetën politike, sociale, ekonomike e kulturore. Në kuadër të ditës ndërkombëtare për personat me aftësi të kufizuar si pasojë e përhapjes së pandemisë COVID-19 dhe në bazë të urdhrave dhe protokolleve të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk janë organizuar aktivitetet masive. Është realizuar një shpërndarje e pakove ushqimore derë më derë për disa persona me aftësi të kufizuar dhe një marshim sensibilizues në sheshin para Bashkisë Shkodër. Qëllimi ynë është mposhtja e të gjitha barrierave, jo vetëm barrierat fizike të betonit, por ato kulturore dhe sociale të cilat pengojnë integrimin e personave me aftësi të kufizuara në fusha të ndryshme të jetës.

P10140.O2.A2. Mbështetja e trupës muzikore të Personave me Aftësi Ndryshe”.

Që nga viti 2005 në qytetin e Shkodrës zhvillon veprimtarinë e saj trupa muzikore The DOOR Albania, e vetmja në rajonin e Ballkanit. “Trupa muzikore e PAN-ve” përbëhet nga një grup të rinjsh me aftësi të kufizuara, të gjithë ish nxënës të shkollës speciale “3 Dhjetori”. Kjo trupë muzikore angazhohet në aktivitete të ndryshme që realizohen në territorin e bashkisë Shkodër, por jo vetëm. Kursi synon integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar, të cilët janë shumë të aftë në veglat frymore dhe përmes angazhimit përcjellin mesazhin: Mundësi integrimi për të gjithë. Trupa Muzikore përbëhet nga 25 të rinj me aftësi të kufizuar. Gjatë këtij viti kjo bandë ka punuar dhe vazhduar provat dhe ka arritur të marrë pjesë dhe të performojë në aktivitete të ndryshme. Si pasojë e përhapjes së pandemisë COVID-19 dhe në bazë të urdhrit Nr.132; dt.08.03.2020 “Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura.” nuk janë arritur të realizohen disa nga aktivitetet e parashikuara për këtë vit.

Programi 10220: Sigurimi shoqëror

Ky program është pjesë e programeve të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik.

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit.

Qëllimi i programit të “Sigurimi shoqëror”

- Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuar, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtyre funksioneve për vitin 2020 kanë qenë:

- O1.Partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurese, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti për ofrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë.

Me qëllim mbështetjen për të moshuarit si një ndër kategoritë në nevojë, në partneritet të ngushtë me shoqërinë civile ofrohen shërbime ditore, të cilat konsistojnë në: informim, këshillim për problemet shëndetësore kryesore që prekin moshën e tretë, mundësi për kohën e lire, ofrim çaji, kafeje, shtyp i ditës, pjesëmarrje në aktivitete social-kulturore, etj.

Realizimi i Buxhetit të planifikuar

Programi:“Sigurimi shoqëror”.

Programi 10220	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Subvensioni	Transferta	Investime	Totali
Plani fillestar 2020	-	-	-	-	-	-
Plani i rishikuar 2020	-	-	-	-	-	-
Realizimi viti 2020	-	-	-	-	-	-
% e realizimit	-	-	-	-	-	-

Në këtë program nuk ka të planifikuar shpenzime .

Realizimi i treguesve të performancës.

Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

Periudha e Raportimit: Janar - Dhjetor 2020

Kodi i Programit	10220	Emertimi i programit:	“Sigurimi shoqëror”					Komente
Qellimi	Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.							
			**Treguesit e performancës/Produktet:				
Objektivat e politikës:	Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhes	Niveli i planifikuar ne vitin korent	Niveli i rishikuar ne vitin korent	Niveli faktik ne fund te vitit korent	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	
<i>Objektivi specifik 1</i>	O1.Partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurese, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti për ofrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë.							
	1	Nr. i aktiviteteve ndërgjegjësuese;	8	5	5	3	60%	
	2	Nr. i të moshuarve dhe familjeve përfituesë të shërbimeve;	100	100	100	50	50%	
	3	Nr. partneriteteve me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurese,	7	7	7	7	100%	

Realizimi i produkteve :

ANEKSI nr.3 "Raporti përmblledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"

Emri i Grupit	Bashkia Shkoder	Kodi i Grupit	141
----------------------	-----------------	----------------------	-----

Programi	"Sigurimi shoqëror"	Kodi i Programit	10220
-----------------	---------------------	-------------------------	-------

Kodi	Emertimi i Treguesit të Performancës/Produktit	Njësia matëse	Sasia Faktike (2019)	Shpenzi met (sipas vitit 2019)	I		II			III			IV			Luhatjet në Kostot për Njësi			Komentet
					Kosto për Njësi (sipas vitit 2019)	Sasia (sipas planit të vitit korent)	Shpenzi met (sipas planit të vitit korent)	Kosto për Njësi (sipas planit të vitit korent)	Sasia (sipas planit të rishikuar të vitit korent)	Shpenzi met (sipas planit të rishikuar të vitit korent)	Kosto për Njësi (sipas planit të rishikuar të vitit korent)	Sasia Faktike (në fund të vitit korent)	Shpenzi met Faktike (në fund të vitit korent)	Kosto për Njësi Faktike (në fund të vitit korent)	V = I - I	V = I - II	V = I - II		
1	Nr. i aktiviteteve ndërgjegjësuëse;	Nr. aktiviteteve	8		0	9		0	5		0	3		0	0	0	0		
2	Nr. i të moshuarve dhe familjeve përfituesë të shërbimeve;	Nr. Përfituesve	100		0	160		0	100		0	50		0	0	0	0		
3	Nr. partneriteteve me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurëse,	Nr. Partneriteteve	7		0	7		0	7		0	7		0	0	0	0		

Për vitin 2020 në Programin “**Sigurimi shoqëror**”, në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjes së objektivave të përcaktuara, është parashikuar 1 aktivitet.

Aktiviteti	Buxheti fillestar 000/Lekë	Buxheti i korigjuar 000/Lekë	Realizimi Viti 2020 000/Lekë
P10220.O1. A1. Dita ndërkombëtare e të moshuarve	-	-	Realizuar

P10220.O1. A1. Dita ndërkombëtare e të moshuarve.

Dita Ndërkombëtare e të Moshuarve është një ditë e veçantë për personat e moshës së tretë në të gjithë botën. Pleqëria është një prej rregullave të pandryshueshme të krijimit dhe një nga periudhat e rëndësishme të ciklit të jetës. Diskutimet janë përqëndruar në tema të tilla si: plakja e popullsisë dhe ofrimi i kujdesit shëndetësor për personat e kësaj moshe, puna vullnetare, kujdesi social dhe gjetja e mënyrave sa më përfshirëse për personat e moshuar, në fuqinë punëtore. Një problem shqetësues në vendin tonë është ndryshimi i dinamikave brenda familjes shqiptare, ku si pasojë e ndryshimeve dhe zhvillimeve social-ekonomike, kulturore, etj, fëmijët kanë prirje për të jetuar vetëm, për të emigruar dhe për t’u shkëputur nga familja. Një ndryshim i tillë në konceptin dhe traditën e familjes shqiptare, ka bërë që të kemi një rritje të të moshuarve që jetojnë vetëm, pa përkujdesjen dhe vëmendjen e nevojshme. Nuk ka të dhëna mbi numrin e saktë të moshuarve që jetojnë në territorin e bashkisë së Shkodrës. Një pjesë e madhe e kësaj kategorie jetojnë në shtëpi, vetëm, shpesh pa përkujdesje të veçantë dhe në varfëri e në kushte shumë të papërshtatshme. Pranë qendrës komunitare “Për Familjen” Nr.4, Bashkia e Shkodrës në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar ofron shërbime ditore, të cilat konsistojnë në: informim, këshillim për problemet shëndetësore kryesore që prekin moshën e tretë, mundësi për kohën e lirë, ofrim çaji, kafeje, shtyp i ditës, pjesëmarrje në aktivitete social-kulturore, etj. Të moshuarit marrin rregullisht këshilla mjekësore dhe bëjnë vizita periodike për matjen e presionit të gjakut dhe të glicemisë në gjak. Festojnë rregullisht ditëlindjen duke organizuar festa ose dreka në ambjentet e qendrës dhe jashtë saj. Gjatë kësaj periudhe janë organizuar dhe disa aktivitete me të rinjtë e Qendrës Rinore Atelie. Qëllimi i këtyre aktiviteteve ka qënë bashkëveprimi mes tyre, dhënia e shembullit nga të moshuarit tek të rinjtë dhe dhënia e pozitimitit dhe energjisë së të rinjve tek të moshuarit. Në kuadër të kësaj dite janë shpërndarë broshura dhe fletëpalosje me qëllim rritjen e informimit dhe masave të kujdesit ndaj COVID-19. Gjithashtu nën masa kujdesi u realizua edhe shpërndarja e disa pakove ushqimore derë më derë, për disa të moshuar të vetëm dhe në vështirësi të theksuar social-ekonomike.

Programi 10430: Kujdesi social për familjet dhe fëmijët

Ky program është pjesë e programeve të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik dhe konkretisht përfshin:

1. Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik,
2. Drejtorinë e Ndihmës Ekonomike,
3. Drejtorinë e Kopshte-Çerdheve.

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit.

Qëllimi i programit të **“Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”**.

- Mbulimi sa më i plotë i territorit me Shërbime Sociale duke u harmonizuar me nevojat dhe interesat e komunitetit. Gjithëpërfshirja, pjesëmarrja, krijimi i mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimi për shkak të aftësive ndryshe, gjinisë, origjinës, minoritetit etj. Partneriteti i ngushtë ligjor me shoqërinë civile, organizata jo-fitimprurëse, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti.

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtyre funksioneve për vitin 2020 kanë qenë:

- O1. Mbulimi sa më i plotë i territorit të Bashkisë, me shërbime sociale duke u harmonizuar me interesat dhe nevojat e komunitetit.
- O2. Bashkërendimi dhe harmonizimi i aktiviteteve lokale me strategjitë dhe politikat kombëtare, me institucionet në varësi të pushtetit qendror, bashkitë fqinje dhe shtetet kufitare.
- O3. Partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurëse, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti për ofrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë.
- O4. Gjithëpërfshirja, pjesëmarrja, krijimi i mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimi për shkak të aftësive ndryshe, gjinisë, moshës, origjinës, minoritetit.
- O5. Fuqizimi i institucioneve që ofrojnë shërbime sociale me orientim promovimin dhe zhvillimin e shërbimeve alternative.
- O6. Krijimi i qendrës komunitare rinore për nxitjen dhe promovimin e pjesëmarrjes aktive në formim profesional e edukim, aktivitete artistike, kulturore dhe sociale për të rinjtë e Bashkisë Shkodër.
- O7. Krijimi i fondit të dedikuar për mbështetjen e personave me AN në bashkërendim me shoqërinë civile.
- O8. Bashkërendimi dhe harmonizimi i aktiviteteve lokale me strategjitë dhe politikat kombëtare, me institucionet në varësi të pushtetit qendror, bashkitë fqinje dhe shtetet kufitare.
- O9. Fuqizimi i institucioneve që ofrojnë shërbime sociale me orientim promovimin dhe zhvillimin e shërbimeve alternative.

Në kuadër të mbulimit sa më të plotë të territorit me shërbime sociale duke siguruar gjithëpërfshirjen, pjesëmarrjen, krijimin e mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimin për shkak të aftësive të kufizuara, gjinisë, origjinës, minoritetit etj., Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik ka planifikuar dhe zbaton një sërë aktiviteteve të shpërndara përgjatë të gjithë vitit.

Realizimi i të ardhurave të planifikuara:

mijë lekë

	Llojet e të ardhurave	Plan viti 2020	Realizim viti 2020	% e realizimit
1	Dhënie përdorim salle- Qendra Komunitare		9,5	100%
2	Sponsorizime nga OJF - Unicef / Tirana, - UNDP / LNB, - Projekti Dear – “Modelimi i qyteteve të drejta.	0 1,000 2,303 Totali : 3,303	2,333.6 799.656 1,067.4045 Totali: 4,200.6605	100% 80% 46.35% Totali: 127.2%
3	Tarifë e çerdheve	5300	2,973.396	56%


Realizimi i Buxhetit të planifikuar

Programi: “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”.

Programi 10430	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Subvensioni	Transferta	Investime	Totali
Plani fillestar 2020	43,916	15,558	-	986,648	445	1,046,567
Plani i rishikuar 2020	43,857	15,558	-	1,039,853	445	1,099,713
Realizimi viti 2020	37,562	9,371	-	1,035,733	442	1,083,108
% e realizimit	85,7%	60,23%	-	99,6%	99,33%	98,5%

Realizimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është në total 98,5%, sipas zërave kryesorë më poshtë:

Shpenzimet korrente (paga+sigurime shoqërore, shpenzime operative, transferime) **99,96%**
Shpenzimet kapitale **0,04%**



Realizimi i treguesve të performancës:

Periudha e Raportimit: Janar - Dhjetor 2020

Kodi i Programit	10430	Emertimi i programit:	"Kujdesi social për familjet dhe fëmijët".						Koment e
Qellimi 1	Mbulim sa më të plotë të territorit me Shërbime Sociale duke u harmonizuar me nevojat dhe interesat e komunitetit. Gjithëpërfshirja, pjesëmarrja, krijimi i Mundësive të Barabarta dhe Mosdiskriminimi për shkak të aftësive ndryshe, gjinisë, origjinës, minoritetit etj.:Partneriteti i ngushtë ligjor me shoqërinë civile, organizata jo-fitimprurëse, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti.							
		**Treguesit e performancës/Produktet:						
Objektivat e politikës:		Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhës	Niveli i planifikuar ne vitin korent	Niveli i rishikuar ne vitin korent	Niveli faktik ne fund te vitit korent	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	
Objektivi Specifik 1	O1.Mbulimi sa më i plotë i territorit, të Bashkisë, me shërbime sociale duke u harmonizuar me interesat dhe nevojat e komunitetit.	
		1	Fuqizimi i familjeve dhe qëndrueshmeri e shërbimeve të ofruara Plan Lokal Veprimi për fëmijët në situatë rruge	1	1	1	1	100%	
		2	Numri i fëmijëve të trajtuar në situatë rruge	120	70	70	70	100%	
		3	Numri i familjeve në situatë rruge të mbështetura;	64	25	50	50	100%	
Objektivi Specifik 2	O2 Bashkërendimi dhe harmonizimi i aktiviteteve lokale me Strategjitë dhe politikat kombëtare, me institucionet në varësi të pushtetit qendror, bashkitë fqinje dhe shtetet kufitare	
		4	Numri i rasteve të referuara të dhunës në familje	61	85	80	121	151%	

		5	Nr i përfituesve nga funksionimi i sistemit të referimit.	61	213	170	200	118%	
		6	Nr i takimeve të organizuara të Grupit Teknik i Punës (GTP)	8	9	9	6	67%	
		7	Nr. i aktiviteve ndërgjegjëse.	90	40	50	50	100%	
		8	Nr i pjesmarrësve në aktivitete.	350	1000	1000	500	50%	
		9	Nr I organizatave pjesmarrese.	25	25	25	25	100%	
		10	Numri i studentëve që zhvillojnë praktikën mësimore në Bashki.	12	10	25	13	52%	
Objektivi Specifik 3	O3.Partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurese, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti për ofrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë.							
		11	Nr. i takimeve periodike të tryezës konsultative.	11	12	12	12	100%	
		12	Nr. partneriteteve me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurese,	18	18	18	18	100%	
		13	Hartimi I planit lokal për lokalizimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm	0	1	1	1	100%	
		14	Mbështetje financiare për familjet në vështirësi në kushtet e pandemisë së shkaktuar	0	0	553	553	100%	
Objektivi Specifik 4	O4. Gjithpërfshirja, Pjesëmarrja, krijimi i Mundësive të Barabarta dhe Mosdiskriminimi për shkak të aftësive ndryshe, gjinisë, moshës, origjinës, minoritetit							
		15	Nr. I personave që do të marrin shërbime pranë Qendrës Komunitare për Rom dhe Egjiptian	500	500	600	600	100%	
		16	Nr. i Qendrave sociale komunitare funksionale;	47	50	49	43	88%	
		17	Numri I përfituesve të shërbimeve në qendrat.	0	30	30	15	50%	

		18	Nr. i Sherbimeve Alternative te ofruara.	0	5	5	4	80%	
		19	Numri I femijeve dhe familjeve perfituese.	0	5430	500	800	160%	
		20	Nr. i shërbimeve ditore të ofruara.	0	6	6	0	0%	
		21	Plani i Zhvillimit lokal për komunitetin rom dhe egjiptian i miratuar dhe pjesë e dokumenteve strategjike të Bashkisë së Shkodrës	1	1	1	1	100%	
Objektivi Specifik 5	O5.Fuqizimi i Institucioneve qe ofrojne Sherbime Sociale me orjentim Promovimin dhe Zhvillimin e Sherbimeve Alternative.							
		22	Nr. i Qëndrave sociale komunitare funksionale;	12	12	12	12	100%	
		23	Numri I perfituesve te sherbimeve ne qendrat.	6500	5200	6600	6600	100%	
		24	Nr. i Sherbimeve Alternative te ofruara.	5	5	5	5	100%	
		25	Numri I femijeve dhe familjeve perfituese.	50	50	50	40	80%	
		26	Nr. I parqeve te lodrave te ndertuara ne qytetin e shkodres	3	0	0	0	#DIV/0!	
Objektivi Specifik 6	O6 Krijimi i qendres komunitare rinore per nxitjen dhe promovimin e pjesemarrjes aktive ne formim profesional e edukim, aktivite artistike, kulturore dhe sociale për të rinjtë e Bashkisë Shkodër.							
		27	Nr. i të rinjve përfitues në shërbimet e Qendrës Rinore.	1200	1200	500	400	80%	
		28	Nr. i shërbimeve të ofruara në qendër për të rinjtë.	6	6	6	6	100%	
Objektivi Specifik 7	O7.Krijimi i fondit te dedikuar per mbeshtetjen e personave me AN në bashkerendim me Shoqerine Civile.							
		29	Nr. i fëmijëve në nevojë që marrin pjesë dhe performojnë në aktivitetin artistiko-kulturor.	0	25	25	0	0%	

		30	Nr. i shtëpive familje funksionale dhe në shërbim të PAN. Shërbimet e ofruara për PAN-të në shtëpi-familje;	7	25	8	8	100%	
		31	Nr. i rasteve të parandaluara drejt institucionalizimit të personave me AN.;	8	8	8	0	0%	
		32	Nr. i klientëve të mbështetur me shërbime;	62	79	77	77	100%	
Objektivi Specifik 8	O8 Bashkëndimi dhe harmonizimi i aktiviteteve lokale me Strategjitë dhe politikat kombëtare, me institucionet në varësi të pushtetit qendror, bashkitë fqinje dhe shtetet kufitare
		33	Numri i personave të asistuar me pagese paaftesie	4234	4400	4400	3928	89%	
		34	Numri i personave të asistuar me pagese invaliditeti;	3363	3500	3500	3377	96%	
		35	Numri i familjeve me kryefamiljarë gra/burra të asistuar me ndihme ekonomike	2018	2350	2350	1972	84%	
Objektivi Specifik 9	O9.Fuqizimi i Institucioneve që ofrojnë Shërbime Sociale me orientim Promovimin dhe Zhvillimin e Shërbimeve Alternative.
		36	Nr. I çerdheve	5	7	7	6	86%	
		37	Numri i fëmijëve përfitues të shërbimit	172	310	180	190	106%	
		38	Nr. i fëmijëve (vajza/djem që frekuentojnë çerdhet.	79	150	85	99	116%	
		39	Numri i stafit për fëmijë	66	67	67	67	100%	

Realizimi i produkteve:

ANEKSI nr.3 "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performances/produkteve të programit"

Emri i Grupit	Bashkia Shkoder	Kodi i Grupit	141
----------------------	-----------------	----------------------	-----

Programi	Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	Kodi i Programit	10430
-----------------	---	-------------------------	-------

Kod i	Emertimi i Treguesit të Performances/Produktit	Njësia matese	Sasia Faktike (2019)	Shpenzi met (sipas vitit 2019)	I			II			III			IV			Luhatjet ne Koston per Njesi	Koment e
					Kosto per Njesi (sipas vitit 2019)	Sasia (sipas planit te vitit korent)	Shpenzim et (sipas planit te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te vitit korent)	Sasia (sipas planitte rishiku ar te vitit korent)	Shpenzim et (sipas planit te rishiku ar te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te rishiku ar te vitit korent)	Sasia Faktik e (ne fund te vitit korent)	Shpenzim et Faktike (ne fund te vitit korent)	Kosto per Njesi Faktike (ne fund te vitit korent)	V = IV - I	V = IV - II		
1	Fuqizimi i familjeve dhe qëndrueshmeri e shërbimeve të ofruara Plan Lokal Veprimi për fëmijët në situatë rruge	Plan lokal veprimi	1		0	1		0	1		0	1		0	0	0	0	
2	Numri i fëmijëve të trajtuar në situatë rruge	Nr. Femejeve	120	90	1	70	100	1	70	100	1	70	-	0	-1	-1	-1	
3	Numri i familjeve në situatë rruge të mbështetura;	Numer familjesh	64		0	25		0	50		0	50		0	0	0	0	
4	Numri i rasteve të referuara të dhunës në familje	Nr. Rastesh	61		0	85		0	80		0	121		0	0	0	0	
5	Nr i përfituesve nga funksionimi i sistemit të referimit.	Nr. Perfituesish	61		0	213		0	170		0	200		0	0	0	0	
6	Nr i takimeve të organizuara të Grupit Teknik i Punës (GTP)	Nr. Takimesh	8		0	9		0	9		0	6		0	0	0	0	
7	Nr. i aktiviteteve ndërjegjësuere.	Nr. Aktivitetesh	90	781	9	40	850	21	50	850	17	50	607	12	3	-9	-5	
8	Nr i pjesmarrësve në aktivitete.	Nr. Pjesemarresish	350		0	1000		0	1000		0	500		0	0	0	0	
9	Nr I organizatave pjesmarrese.	Nr. Organizatash	25		0	25		0	25		0	25		0.0	0.0	0	0	

10	Numri i studentëve që zhvillojnë praktikën mësimore në Bashki.	Nr. Studentesh	12		0	10		0	10		0	13		0	0	0	0
11	Nr. i takimeve periodike të tryezës konsultative.	Nr. takimesh	11		0	12		0	12		0	12		0	0	0	0
12	Nr. partneriteteve me shoqëri të civile, organizatat jo-fitimprurëse.	Nr. Partneriteteve	18		0	18		0	18		0	18		0	0	0	0
13	Hartimi I planit lokal për lokalizimin e objektivave të zhvillimit të qendrueshem	Nr. Plani		1592	#DIV/0!	1	2303	2303	1	2303	2303	1	610	610	#DIV/0!	-1693	-1693
14	Mbështetje financiare për familjet në vështirësi në kushtet e pandemisë së shkaktuar	Nr i familjeve			#DIV/0!			#DIV/0!	553	2334	4	553	2,334	4.2	#DIV/0!	#DIV/0!	0.0
15	Nr. I personave që do të marrin shërbime pranë Qendrës Komunitare për Rom dhe Egjiptian	Nr. personash	500		0.0	500		0	600		0	600		0	0	0	0
16	Nr. i jetimëve të mbështetur me rastin e festave të fundit të vitit;	Nr. I perfituesve	47	400	8.5	50	400	8	49	400	8	43	351	8	0	0	0
17	Nr. I femijeve dhe familjeve që marrin shërbim në qendrën e specializuar për diagnostimin e hershem të fëmijëve me autizem.	Nr. I perfituesve			#DIV/0!	30		0	30		0	15		0	#DIV/0!	0	0
18	Nr. I fushatave ndërgjegjëse e informuese të realizuara me aktorët e sektorit dhe prindërit.	Nr. I fushatave			#DIV/0!	5		0	5		0	4		0	#DIV/0!	0	0
19	Nr. I aktorëve të sektorit të informuar, prindërve dhe publikut të gjerë	Nr. I aktorëve të sektorit të informuar			#DIV/0!	5430	1999	0	500	1999	4	800	618	0.7725	#DIV/0!	0.40436	-3.2255
20	Nr. i shërbimeve ditore të ofruara.	Nr. i shërbimeve			#DIV/0!	6		0	6		0			#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!
21	Plani i Zhvillimit lokal për komunitetin rom dhe egjiptian i miratuar dhe pjesë e dokumenteve strategjike të Bashkisë së Shkodrës	hartimi i planit	1		0	1		0	1		0	1		0	0	0	0
22	Nr. i Qendrave sociale komunitare funksionale;	Nr. I qendrave	12	8023	669	12	11468	956	12	11468	956	12	8,616	718	49	(238)	(238)
23	Numri I perfituesve të shërbimeve në qendrat.	Nr. I perfituesve	6500		0	5200		0	6600		0	6600		0	0	0	0

24	Nr. i Shërbimeve Alternative te ofruara.	Nr. shërbimesh	5	131	26.2	5	148	30	5	148	30	5	46	9.12	-17.08	-20.48	-20.48
25	Numri I femijeve dhe familjeve perfituese.	Nr. familjeve	50		0	50		0	50		0	40		0.0	0.0	0.0	0.0	
26	Nr. I parqeve te lodrave te ndertuara ne qytetin e shkodres	Nr. I parqeve	3	1582	527			#DIV/0!			#DIV/0!			#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	
27	Nr. i të rinjve përfitues në shërbimet e Qëndrës Rinore.	Nr. I te rinjve	1200	1001	1	1200		0	500		0	400		0.0	-0.8	0.0	0.0	
28	Nr. i shërbimeve të ofruara në qëndër për të rinjtë.	Nr. I shërbimeve	6		0	6		0	6		0	6		0.0	0.0	0.0	0.0
29	Nr. i fëmijëve në nevojë që marrin pjesë dhe performojnë në aktivitetin artistiko-kulturor.	Nr. i fëmijëve			#DIV/0!	25	271	11	25	271	11	0	-	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!
30	Nr. i shtëpive familje funksionale dhe në shërbim të PAN. Shërbimet e ofruara për PAN-të në shtëpi-familje;	Nr I shtëpive	7	19564	2795	8	36164	4521	8	36164	4521	8	34,224	4278	1483	-243	-243	
31	Nr. i rasteve të parandaluara drejt institucionalizimit të personave me AN.;	Nr. rastesh	8		0	8		0	8		0			#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	
32	Nr. i klientëve të mbështetur me shërbime;	Nr. Klientesh	62		0	79		0	77		0	77		0.0	0.0	0.0	0.0	
33	Numri i personave te asistuar me pagese paaftesie	Nr. Personash	4234	601952	142	4400	709980	161	4400	716,060	163	3,928	670,742	170.8	28.6	9.4	8.0	
34	Numri i personave te asistuar me pagese invaliditeti;	Nr. Personash	3363	118949	35	3500	105020	30	3500	136,392	39	3,377	180,317	53.4	18.0	23.4	14.4	
35	Numri i familjeve me kryefamiljarë gra/burra te asistuar me ndihme ekonomike	Nr. Familjesh	2018	118670	59	2350	135000	57	2350	148360	63	1,972	147,709	74.9	16.1	17.5	11.8	
36	Nr. I çerdheve	Nr. Çerdheve	5	7874	1575	7	9975	1425	7	10008	1430	6	7,000	1166.7	-408.1	-258.3	-263.0	
37	Numri i fëmijëve përfitues të shërbimit	Nr. Fëmijëve	172		0	310		0	180		0	190		0.0	0.0	0.0	0.0	
38	Nr. i fëmijëve (vajza/djem që frekuentojnë çerdhet.	Nr. I femijeve vajza	79		0	150		0	85		0	99		0.0	0.0	0.0	0.0	
39	Numri i stafit për fëmijë	Nr. Stafit	66	27968	424	67	32889	491	67	32856	490	67	29,935	446.8	23.0	-44.1	-43.6	

Për vitin 2020 në Programin “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”, në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjes së objektivave të përcaktuara, janë parashikuar këto aktivitete.

Aktivitete/Projekte	Buxheti fillestar 000/Lekë	Buxheti i korigjuar 000/Lekë	Realizimi Viti 2020 000/Lekë
P10430.O1.A1 Zbatimi i Planit lokal të Veprimt për Identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge.	100	100	Realizuar pa kosto financiare
P10430.O2.A1. Zbatimi i sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje.	200	200	134
P10430.O2.A2. Dita ndërkombëtare për familjen – 15 maj	50	50	E parealizuar
P10430.O2.A3. Partneriteti me departamentin e psikologji-punës sociale dhe departamentin e infermierisë			Realizuar
P10430.O2.A4. Zbatimi i kartës evropiane për barazi gjinore.	200	200	140
P10430.O2.A5 DEAR – “Modelimi i qyteteve të drejta: Integrimi i Agjendës 2030 brenda politikave lokale, në kohën e flukseve të mëdha të migrimit dhe refugjatëve. Një projekt advokimi udhëhequr dhe zbatuar nga autoritetet lokale”, CSO-LA/2017/388-138.	2,303	2,303	610
P10430.O3.A1. Tryeza konsultative me organizatat që veprojnë në sektorin social në Bashkinë e Shkodrës;			Realizuar
P10430.O3.A2. Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 20 nëntori.	50	50	Realizuar pa kosto financiare
P10430.O3.A3. Dita ndërkombëtare e fëmijëve, "1 Qeshori"			Realizuar
P10430.O3.A4. Dita ndërkombëtare e gruas, 8 marsi	150	150	148
P10430.O3.A5. Bashkëpunimi me Fondacionin “Shpresë për botën”, për përmirësimin e cilësisë së jetesës për personat që jetojnë në institucionet rezidenciale dhe familjet në nevojë.			Realizuar

P10430.O3.A6. Bashkëpunimi me organizatën "Sos, Fshatrat e Fëmijëve."			Realizuar
P10430.O3.A7 "Çdo fëmijë në shkollë"	48	48	46
P10430.O3.A8 "Mbështetje financiare për familjet në vështirësi në kushtet e pandemisë së shkaktuar"		2,334	2,334
P10430.O4.A1 Fuqizimi socio – ekonomik i komunitetit rom dhe egjiptian			Realizuar
P10430.O4.A2 Shpërblim për jetimët me rastin e festave të fundvitit	400	400	351
P10430.O4.A3 . Shërbime mbështetëse dhe riaftësuese për integrimin e fëmijëve me aftësi ndryshe në sistemin edukativ			Realizuar
P10430.O4.A4 "Krijimi i shërbimit të specializuar ditor për fëmijët me çrregullime të spektrit autik në Bashkinë e Shkodrës".	1,999	1,999	618
P10430.O4.A5 . Plani I zhvillimit lokal per komunitetin rom dhe egjiptian	200	200	185
P10430.O5.A1. Ngritja dhe vendosja në funksion e Qendrave Komunitare "Për Familjen"	11,468	11,468	8,616
P10430.O5.A2. Shërbime alternative per femijet dhe familjen.	100	100	Realizuar pa kosto financiare
P10430.O5.A3. Ndërhyrje të integruara për përfshirjen dhe integrimin socio-ekonomik të fëmijëve dhe të rinjve pa përkujdes prindëror.			Realizuar
P10430.O6.A1 Qendra Rinore "Po të Ardhmes" (Atelie)			Realizuar
P10430.O7. A1. "Asnjë Fëmijë Jashtë"	271	271	E parealizuar
P10430.O7.A2. Projekti "Shpresa" për personat e braktisur dhe me aftësi ndryshe;	19,564	19,564	17,741
P010430 .O7.A3 Shtëpi Familje për persona me aftësi të kufizuar nga Opera Madonnina del Grappa	16,600	16,600	16,483
P010430.O8.A1. Pagesa PAK dhe Invaliditeti .	815,000	852,452	851,059

P10430.O8.A2. Ndihma ekonomike	135,000	148,360	147,709
P10430.O9.A1. Administrimi dhe funksionimi i cerdheve	42,864	42,864	36,935
A.3.1 Shpenzime për paga dhe sigurime të punonjësve	32,889	32,830	29,554
A.3.2 Kancelari	95	95	79
A.3.3 Materiale për pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndriçim	1000	600	600
A.3.4 Furnizime me ushqime	5300	5300	3,239
A.3.5 Materiale të tjera	150	150	127
A.3.6 Energji elektrike	950	950	950
A.3.7 Uji	850	850	532
A.3.8 Internet	46	46	43
A.3.9 Lëndë djegëse (dru zjarri)	300	700	600
A.3.10 Shërbime të tjera për dezinfektim	40	40	37
A.3.11 Shpenzime transporti	200	200	200
A.3.12 Mirëmbajtje e zakonshme (ndërtesa)	500	500	467
A.3.13 Mirëmbajtje e aparateve e paisjeve teknike	40	40	39
A.3.14 Mirëmbajtje të paisjeve të zyrës	30	30	24
A.3.15 Shpenzime për sigurimin e ndërtesave	40	40	39
A.3.16 Transferta buxhetore për individë	84	143	57
A.3.17 Blerje paisje dhe orendi	350	350	348

P10430.O1.A1 Zbatimi i Planit lokal të Veprimit për Identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge.

Në kuadrin e nënshkrimit të Marrëveshjes Bashkëpunimit midis MMSR, MAS dhe MPB “Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge dhe Planit Kombëtar të Veprimit “Ndihmë për Familjet dhe Fëmijët në situatë rruge”, është hartuar dhe vazhdon të zbatohet Plani lokal të veprimit, ku bashkia (NJMF), ka përgjegjësinë kryesore për të siguruar mbrojtjen e fëmijëve dhe koordinimin e punës ndërmjet institucioneve përgjegjëse, brenda territorit të qytetit. Vazhdojnë të funksionojnë skuadrat e terrenit me përfaqësues të Bashkisë Shkodër, stafi i qendrave komunitare, përfaqësues të Policisë dhe organizatave partnere të shoqërisë civile të cilët janë trajnuar, kanë

qenë dhe janë prezent në territor sipas një kalendari të paracaktuar. Në zbatim të ligjit 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, Bashkia Shkodër po koordinon Mbledhjet e Grupit Teknik Ndërsektorial me përfaqësues nga të gjitha institucionet publike vendore dhe organizatat partnere ku janë diskutuar rastet për çdo familje të fëmijëve në situatë rruge. Gjithashtu janë hartuar plane individuale ndërhyrjeje për fëmijët në situatë rruge me qëllim mbështetjen dhe përmirësimin e situatës së këtyre fëmijëve dhe familjeve të tyre. Nr. i fëmijëve të identifikuar në situatë rruge si dhe të mbështetur është 65 dhe numri i familjeve në situatë rruge të mbështetura është 45. Për secilën familje të identifikuar janë ofruar ndihma në veshmbathje, ushqime, asistencë ligjore, ndërmjetësim për punësim, ndihmë ekonomike, rregjistrim i fëmijëve në shkollë dhe kopshte, monitorim për frekuentimin dhe ecurinë e fëmijëve në shkollë sipas vlerësimeve dhe planeve individuale të ndërhyrjes. Këtë vit për shkak të situatës së krijuar nga Pandemia COVID-19 dhe në zbatim VKM nr.243, datë 24.3.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore” nuk janë zhvilluar aktivitetet e parashikuara me datë 8 dhe 12 prill në kuadër Ditës ndërkombëtare të Romëve dhe Ditës ndërkombëtare për fëmijët në situatë rruge. Ka vazhduar mbështetja e komunitetit rom dhe egjiptian me pako me ushqime dhe materiale higjienike si dhe janë marrë masa për dezinfektimin e vendbanimeve të tyre.

P10430.O2.A1. Zbatimi i sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje.

Njësitë e qeverisjes vendore, si autoritete përgjegjëse në luftën kundër dhunës në familje, kanë detyrim ligjor ngritjen dhe funksionimin e sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje. (ligji nr.9669 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, i ndryshuar me ligjin nr.47/2018 dhe VKM nr. 334, datë 17. 02. 2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit tij”). Në bashkinë e Shkodrës, që në shkurt të vitit 2017, nga drejtuesit e institucioneve vendore, rajonale dhe organizatave të shoqërisë civile që veprojnë me trajtimin e rasteve të dhunës në familje, është arritur firmosja e marrëveshjes së bashkëpunimit për riorganizimin dhe ngritjen e mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij. Në kuadër të ndërgjegjësimit të shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, Bashkia Shkodër ka realizuar një sërë aktivitete për ndërgjegjësimin e komunitetit në lidhje me dhunën me bazë gjinore gjatë vitit 2020. Janë planifikuar, organizuar dhe zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuëse në kuadër të 8 marsit, ditës ndërkombëtare të gruas dhe në zbatim të kartës evropiane për barazi mes burrave dhe grave, të nënshkruar në vitin 2017, sipas një kalendari të paracaktuar. Janë organizuar 16 aktivitete sensibilizuese, informuese, të shpërndara në Qendrat Komunitare “Për Familjen”, shkollat e Bashkisë Shkodër, Qendrën Rinore Atelie dhe institucionet kulturore të Bashkisë Shkodër si: Biblioteka “Marin Barleti”, Muzeu “Oso Kuka”, Teatri Migjeni, Galeria e Arteve etj. Në kuadër të 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore janë zhvilluar 10 aktivitete sensibilizuese, informuese nën moton “Heshtja nuk të mbron! Dëgjo, Beso, Mbështet!”. Aktivitetet janë organizuar nën mbështetjen e kujdesit të shtuar dhe në respektim të të gjithë masave për parandalimin e përhapjes së COVID-19. Aktivitetet janë zhvilluar si në qytet ashtu dhe në njësitë administrative. Gjatë aktiviteteve verore të organizuara me fëmijët në qendrat komunitare “Për Familjen” është folur për format e ndryshme të dhunës dhe mënyrat e raportimit të saj. Krahas

këtyre aktiviteteve, fushatat e komunikimit online, me qëllim rritjen e informimit dhe sensibilizimit të komunitetit për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, janë organizuar vazhdimisht përgjatë të gjithë kësaj periudhe me anë të postimeve në mediat sociale të Bashkisë Shkodër dhe Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik. Përgjatë gjendjes së emergjencës së shkaktuar nga COVID-19 janë shpërndarë poste me informacionin e nevojshëm se ku mund të kërkohet ndihmë dhe kontaktet e nevojshme dhe kujdesi i stafit ndaj viktimave të dhunës në familje ka qenë i shtuar. Në rastet e nevojshme, pas vlerësimit të situatës dhe nevojave është realizuar edhe mbështetja e rasteve me pako ushqimore dhe higjeno-sanitare. Në varësi të nevojave viktimat e dhunës në familje, kanë marrë mbështetjen e duhur psikologjike dhe ligjore nga stafi i Qendrave Komunitare “Për familjen” të Bashkisë Shkodër dhe organizatat partnere që ofrojnë të tilla shërbime në Bashkinë Shkodër.

P10430.O2.A2. Dita ndërkombëtare për familjen – 15 maj.

Në Ditën Ndërkombëtare të Familjes në gjithë botën organizohen aktivitete në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, që kanë në fokus familjen, duke e përqëndruar vëmendjen tek proceset shoqërore, ekonomike dhe demografike që prekin familjet. Gjithashtu fokusi i kësaj dite është promovimi i vlerave të familjes, nxitja e barazisë midis grave dhe burrave në familje, mbrojtja e familjes si njësi bazë e shoqërisë dhe mundësia për të ndihmuar familjet për të përmbushur përgjegjësinë e tyre për komunitetin ku bëjnë pjesë.

Në territorin e bashkisë së Shkodrës, ekziston një numër i madh familjesh në vështirësi të theksuara sociale e ekonomike. Situata në të cilën ndodhen këto familje vjen si shkak i ndikimit të një sërë faktorësh si: niveli i ulët arsimor, kulturor, ekonomik, etj. Si pasojë të faktorëve të lartpërmendur, këto familje shpesh herë kanë mungesë informacioni, nuk marrin interesim për shërbimet sociale që ofrohen në territor dhe jetojnë në kushte ekstreme varfërie. Duke qenë se Bashkia e Shkodrës që nga viti 2016, arriti ngritjen dhe vënien në funksion të qendrave komunitare të quajtura “Për Familjen”, duke parë familjen si qeliza bazë për zhvillimin e komunitetit, sivjet nëkuadër të ditës ndërkombëtare për familjen është realizuar një video me aktivitetet e organizuara përgjatë viteve në kuadër të kësaj dite. Si pasojë e përhapjes së pandemisë COVID-19 dhe në bazë të urdhrin Nr.132; dt.08.03.2020 “Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura.” nuk janë arritur të realizohen aktivitetet e planifikuara në kuadër të kësaj dite.

P10430.O2.A3. Partneriteti me departamentin e psikologji-punës sociale dhe departamentin e infermierisë.

Në universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në degët e psikologjisë, punës sociale, fizioterapisë dhe infermierisë, çdo vit regjistrohen rreth 50 studentë në secilën degë. Në vitin e tretë të studimeve bachelor, gjatë gjithë vitit akademik, studentët zhvillojnë lëndën e “Praktikumit”. Një lëndë e tillë është me shumë rëndësi për përfitimin e njohurive praktike në fushat përkatëse. Gjithashtu pas

përfundimit të studimeve në ciklin bachelor, ka shumë rëndësi praktika e njohurive të marra gjatë viteve të studimit. Bashkia e Shkodrës ka arritur një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, ku pjesë e kësaj marrëveshje ka qenë bashkëpunimi për ofrimin e një praktike sa më profesionale dhe të vlefshme për zhvillimin akademik e profesional të studentëve. 13 studentë; 12 të nivelit bachelor dhe 1 i nivelit master kanë zhvilluar praktikën profesionale pranë shërbimit social dhe kanë kontribuar në aktivitetet e planifikuara pranë qendrave komunitare “Për Familjen”. Një eksperiencë e tillë ka rezultuar shumë pozitive për të dyja palët. Nëpërmjet institucionalizimit të këtij bashkëpunimi, studentët ofrojnë njohuritë e tyre në shërbim dhe në përputhje me nevojat e komunitetit, duke filluar kështu të fitojnë aftësitë bazë të profesionit tyre.

P10430.O2.A4. Zbatimi i kartës evropiane për barazi gjinore.

Barazia e grave dhe burrave përbën një të drejtë themelore për të gjithë dhe një vlerë thelbësore për çdo demokraci. Për t’u arritur kjo e drejtë, duhet që ajo jo vetëm të njihet me ligj, por edhe të zbatohet me efektivitet në të gjitha sferat e jetës: politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore. Me gjithë rastet e shumta të njohjes zyrtare dhe përparimin e bërë, barazia e grave dhe burrave në jetën e përditshme ende nuk është bërë realitet. Gratë dhe burrat nuk gëzojnë të drejta të njëjta në praktikë. Ende vazhdojnë të ekzistojnë pabarazitë shoqërore, politike, ekonomike dhe kulturore. Këto pabarazi janë rezultat i disa nocioneve shoqërore të ndërtruara mbi bazën e stereotipave të shumta të pranishme në familje, arsim, kulturë, mjetet e komunikimit, në botën e punës, në organizimin e shoqërisë. Janë aq të shumta fushat e jetës në të cilat mund të veprohet, përmes përdorimit të një qasjeje të re dhe realizimit të ndryshimeve strukturore. Për këtë, Bashkia e Shkodrës, pas nënshkrimit të kartës evropiane për barazi gjinore, është angazhuar në hartimin dhe miratimin e planit vendor gjinor si një mjet i rëndësishëm i zbatimit në praktikë të angazhimeve publike të ndërmarra nga Bashkia Shkodër në lidhje me parimet e barazisë, planifikimit dhe zbatimit të nevojave dhe të të drejtave të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, si dhe vajzave dhe djemve, nga të gjitha grupet e shoqërisë. Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore 2018-2020, mbulon një tërësi fushash dhe në të parashikohen veprime që synojnë: respektimin e të drejtës themelore të barazisë ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve; trajtimin e çështjeve të pabarazive dhe diskriminimit; veprime për eliminimin e stereotipeve gjinore; pjesëmarrjen e balancuar të grave dhe burrave në vendim-marrjen politike e publike; aksesin në shërbime të ndryshme të hartuara sipas nevojave të veçanta të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, si dhe ofrimin e këtyre shërbimeve me cilësi e në respektim të parimeve të barazisë; integrimin e këndvështrimit gjinor në të gjitha planet dhe fushat për zhvillim të qëndrueshëm; planifikimin e mbështetur në burimet e duhura, etj.

Gjatë kësaj periudhe janë planifikuar, organizuar dhe zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuese në kuadër të 8 marsit, ditës ndërkombëtare të gruas dhe në zbatim të kartës evropiane për barazi mes burrave dhe grave, të nënshkruar në vitin 2017, sipas një kalendari të paracaktuar. Janë organizuar 16 aktivitete sensibilizuese, informuese, të shpërndara në Qendrat Komunitare “Për Familjen”, shkollat e Bashkisë Shkodër, Qendrën Rinore Atelie dhe institucionet kulturore të Bashkisë Shkodër si: Biblioteka “Marin Barleti”, Muzeu “Oso Kuka”, Teatri Migjeni, Galeria e Arteve etj. Në kuadër të 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore janë zhvilluar 10 aktivitete sensibilizuese, informuese nën moton “Heshtja nuk të mbron! Dëgjo, Beso, Mbështet!”. Aktivitetet janë organizuar nën masa të kujdesit të shtuar dhe në respektim të të gjithë masave për

parandalimin e përhapjes së COVID-19. Aktivitetet janë zhvilluar si në qytet ashtu dhe në njësitë administrative.

Projekti: P10430.O2.A5 DEAR – “Modelimi i qyteteve të drejta: Integrimi i Agjendës 2030 brenda politikave lokale, në kohën e flukseve të mëdha të migrimit dhe refugjatëve. Një projekt advokimi udhëhequr dhe zbatuar nga autoritetet lokale”, CSO-LA/2017/388-138.

(DEAR - "Shaping fair cities: integrating Agenda 2030 ëithin local policies in times of great migration and refugees floës. A campaign and advocacy project led and implemented by LAs", CSO-LA/2017/388-138.).

Në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak VKB Nr. 25, datë 18.04.2019 “Për shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Shkodër” dhe marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Rajonit Emilia-Romanja dhe Bashkisë Shkodër, po zbatohet Projekti DEAR – “Modelimi i qyteteve të drejta” CSO-LA/2017/388-138, i cili financohet nga Komisioni Evropian, në kuadër të Programit Programi DEAR - EuropeAid/151103/DH/ACT/Multi. Projekti drejtohet nga Rajoni Emilia-Romanja në rolin e Liderit të Projektit dhe zbatohet në 10 shtete (8 shtete anëtare të Unionit dhe 2 shtete jo anëtarë), në një partneritet prej 18 entesh publike e private të përfshira. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në promovimin e të kuptuarit kritik të roleve dhe përgjegjësive të autoriteteve lokale dhe të qytetarëve në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) të Agjendës 2030, si dhe rëndësinë e lokalizimit të Agjendës 2030 nga bashkitë dhe autoritetet vendore në hartimin e politikave lokale. Bashkia Shkodër, si partnere e projektit të sipërpërmendur, ka nisur zbatimin e projektit sipas planit të punës të dakordësuar me liderin e projektit dhe bazuar në buxhetin përkatës të vënë në dispozicion për këtë qëllim. Gjatë periudhës së raportimit në fjalë, janë realizuar të gjithë procedurat e nevojshme administrative për vijimësinë e aktiviteteve të projektit. Këto aktivitete përfshijnë: i) implementimin dhe zbatimin e fushatës lokale të komunikimit për Agjendën 2030 ku si objektiv kryesor i saj është rritja e ndërgjegjësimit dhe angazhimit të qytetarëve dhe komunitetit lokal në Bashkinë Shkodër mbi OZHQ-të, si dhe nxitja e ndjenjës së pjesëmarrjes së tyre në arritjen e këtyre objektivave në jetën e përditshme; ii) Ndërkohë, aktivitetet e zhvilluara në kuadër të shërbimit të Ekspertizës së Jashtme për Agjendën 2030 përfshijnë realizimin e një trajnimit me 15 nëpunës civile të Bashkisë Shkodër mbi OZHQ-të; organizimin e konsultimeve dy-palëshe me Drejtorinë Rajonale të Punësimit Shkodër, Drejtorinë e Operatorit të Kujdesit Shëndetësor të Qarkut Shkodër, Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, zyrën e Prefekturës, zyrën e Qarkut, Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit, Drejtorinë e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit; iii) Si produkt i trajnimit dhe konsultimeve të përmendura me institucione lokale apo rajonale, është hartimi i një Plani Lokal për integrimin dhe për lokalizimin e objektivave të Agjendës 2030 në Bashkinë e Shkodrës. Ky Plan Lokal është hartuar nga shërbimi i kontraktuar “Ekspertizë e Jashtme për Agjendën 2030” dhe përfshin një plan pune dhe strategjinë për zbatimin e këtij plani (road-map). Një abstrakt i planit është përkthyer në anglisht, me qëllim shpërndarjen e tij me partnerët e projektit dhe në nivel ndërkombëtar.

P10430.O3.A1.Tryeza konsultative me organizatat që veprojnë në sektorin social në Bashkinë e Shkodrës.

Në qytetin e Shkodrës, ndodhen e funksionojnë një sërë organizatash të shoqërisë civile që ofrojnë shërbim në mbështetje të grupeve sociale në nevojë; fëmijëve, të rinjve, grave e burrave, personave me aftësi ndryshe, komunitetit rom dhe egjiptian, moshës së tretë, etj. Viti 2016 ishte një vit i rëndësishëm i fillimit të bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile dhe institucionalizimit të partneritetit me to. Gjatë këtyre viteve është konsoliduar aktiviteti i tryezave konsultative dhe zhvillimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile. Me synim koordinimin e aktiviteteve dhe shërbimeve në territorin e Bashkisë së Shkodrës, janë planifikuar dhe organizuar tryeza konsultative me shoqërinë civile. Gjatë këtij viti tryezat konsultative janë organizuar për planifikimin e aktiviteteve në kuadër të zbatimit të kartës evropiane për barazinë gjinore, 8 marsit dhe në zbatim të projekteve të reja që do zbatohen në Bashkinë e Shkodrës nga organizatat partnere. Për shkak të situatës së shkaktuar nga COVID-19 një pjesë e këtyre takimeve janë organizuar ndërmjet metodave të komunikimit online, me qëllim ruajtjen e shëndetit të secilit dhe sigurimin e mbarëvajtjes së punës. Tashmë ka një proces të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të konsultimit përmes takimeve ku qëllimi i këtyre tryezave ka qenë ndërhyrja e integruar në ofrimin e shërbimeve, përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dhe mbulimi i territorit me shërbime.

P10430.O3.A2. Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 20 nëntori.

20 Nëntori “Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve” synon të promovojë mirëqenien e fëmijëve, të parandalojë çdo formë dhune apo abuzimi ndaj fëmijëve. Në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, është realizuar një aktivitetet ndërgjegjësues me fëmijët dhe për fëmijët. Këto aktivitete ndërgjegjësuese kanë qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi të drejtat e fëmijëve. Aktiviteti i zhvilluar në sheshin para Bashkisë duke respektuar masat diktuar nga situata e shkaktuar nga COVID-19, përfshiu përfaqësues të organizatave lokale, institucioneve publike dhe qendrave komunitare që ofrojnë shërbime për fëmijët në nevojë në territorin e bashkisë.

P10430.O3.A3. Dita ndërkombëtare e fëmijëve, "1 Qershori".

Një Qershori është dita ndërkombëtare e fëmijëve. Këtë ditë fëmijët e të gjitha moshave kërkojnë që të jenë të lumtur e të festojnë me familjen, me prindërit, me vëmendjen dhe përkujdesjen e nevojshme për realizimin e dëshirave tyre. Është dita kur vetë fëmijët ngrenë zërin për të drejtat e tyre, por në ndryshim nga të rriturit, protesta e tyre bëhet me lojra festive. Kjo ditë përveç se është një ditë festive, duhet të jetë një ditë sensibilizimi për promovimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve. Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19 dhe në zbatim VKM nr.243, datë 24.3.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, këtë vit aktiviteti ndërgjegjësues i parashikuar në ditën ndërkombëtare të fëmijëve, 1 Qershor është konceptuar ndryshe. Ky aktivitet është realizuar në bashkëpunim me fëmijët që frekuentojnë Qendrën Multifunkionale Komunitare “Për familjen” dhe Qendrën Komunitare “Për familjen” nr. 5. Fëmijët përmes një video kanë realizuar performancat e tyre, me anë të të cilave kanë përcjellur mesazhe sensibilizuese për të drejtat e tyre. Zhvillimi i këtyre aktiviteteve ka si qëllim të rrisë vëmendjen në drejtim të mirëqenies së fëmijëve.

P10430.O3.A4. Dita ndërkombëtare e gruas, 8 marsi.

8 Marsi njihet si "Dita e Gruas", në të gjithë botën. Në këtë ditë reflektohet mbi kurajon dhe veprimet e grave të thjeshta të cilat luajtën një rol të rëndësishëm në historinë e të drejtave të grave. Në Ditën Botërore të Gruas, në ditët e sotme, ashtu si në të shkuarën, punohet për barazinë gjinore

të gruas, pavarësinë e saj, eliminimin e padrejtësive politike, për kushte më të mira pune dhe jetese. Për herë të parë 8 Marsi në Shqipëri u kremtua në vitin 1942 të shekullit të XX-të në grupe të vogla grash. Në kuadër të 8 marsit, Ditës Ndërkombëtare të gruas u realizua një fushatë ndërgjegjësuere e shtrirë përgjatë të gjithë javës nën moton “ TI je Shembull”. Janë organizuar 16 aktivitete sensibilizuese, informuese, të shpërndara në Qendrat Komunitare “Për Familjen”, shkollat e Bashkisë Shkodër, Qendrën Rinore Atelie dhe institucionet kulturore të Bashkisë Shkodër si: Biblioteka “Marin Barleti”, Muzeu “Oso Kuka”, Teatri Migjeni, Galeria e Arteve etj. Aktivitetet janë zhvilluar si në qytet ashtu dhe në njësitë administrative. Synimi i kësaj fushate ishte promovimi i rolit të gruas në shoqëri.

P10430.O3.A5. Bashkëpunimi me Fondacionin “Shpresë për botën”, për përmirësimin e cilësisë së jetesës për personat që jetojnë në institucionet rezidenciale dhe familjet në nevojë.

Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit me organizatën “Shpresë për botën”, që ka si qëllim mbështetjen e 3 institucioneve rezidenciale; Shtëpisë së foshnjës, Shtëpisë së fëmijës shkollor dhe Qendrës së zhvillimit, është arritur që të përmirësohet cilësia e jetës së fëmijëve dhe të rinjve që jetojnë në institucionet rezidenciale, si dhe është rritur pjesëmarrja e fëmijëve në aktivitete të ndryshme sociale, kulturore dhe sportive, me qëllim integrimin e tyre. Gjatë kësaj periudhe janë organizuar një sërë aktiviteteve social kulturore me fëmijët në raste festash si dhe janë organizuar festime për ditëlindjet për fëmijët në këto institucione. Vazhdon të ofrohet mbështetje me transport për të mundësuar takimet e fëmijët me prindërit biologjikë me qëllim mbajtjen dhe fuqizimin e lidhjeve afektive mes tyre. Këto aktivitete janë organizuar gjatë gjithë vitit në të tre institucionet rezidenciale të Bashkisë Shkodër.

P10430.O3.A6. Bashkëpunimi me organizatën "Sos, Fshatrat e Fëmijëve".

Ndër politikat vendore sociale të Bashkisë së Shkodrës është mbulimi dhe shtrirja e shërbimeve në të gjithë territorin, me qëllim përmirësimin e situatës social – ekonomike të familjeve në kushte shumë të vështira. Për zbatimin e këtyre politikave, Bashkia e Shkodrës, që nga viti 2016 dhe në vijim ka ngritur dhe vënë në funksion qendrat komunitare “Për familjen”. Këto qendra mbulojnë me shërbime çdo lagje të qytetit dhe në njësitë administrative. Me qëllim fuqizimin e shërbimeve pranë qendrave tona komunitare bashkia Shkodër ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me organizatën “Sos Fshatrat e Fëmijëve”. Falë këtij bashkëpunimi janë zhvilluar aktivitete edukuese, formuese dhe ndërgjegjësuere me synim fuqizimin e familjes së fëmijëve në rrezik institucionalizimi dhe fëmijëve të institucionalizuar për parandalimin dhe deinstitutionalizimin e tyre. Organizata "Sos, Fshatrat e Fëmijëve", ka bashkëpunuar dhe ka qenë pjesë e fushatave ndërgjegjësuere të zhvilluara nga bashkia Shkodër gjatë kësaj periudhe. Ka vazhduar bashkëpunimi për mbështetjen dhe fuqizimin e familjeve dhe realizimin e ndërhyrjeve konkrete në zbatim të planeve të ndërhyrjes të hartuara në bashkëpunim me anëtare të tjerë të Grupit teknik Ndërsektorial për rastet e ndjekura. Gjithashtu ka vijuar bashkëpunimi për identifikimin e familjeve kujdestare dhe mbështetjen e tyre gjatë procesit të kalimit të kujdestarisë alternative.

P10430.O3.A9. "Çdo fëmijë në shkollë" .

Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet tri ministrive, protokolluar në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) me nr. 7522 prot., datë 12.07.2018, në Ministrinë e Brendshme (MB) me nr. 8649 prot. datë 22.10.2018 dhe në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) me nr. 6084 prot., datë 23.10.2018, “Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor” dhe në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimi me “Observatorin e për të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve”, në kuadër të projektit “Çdo fëmijë në shkollë”, i cili mbështetet nga UNICEF, vijon zbatimi i fazës së dytë të këtij projekti që ka si qëllim identifikimin dhe mbështetjen e fëmijëve në moshë për arsimin e detyrueshëm që janë jashtë sistemit shkollor. Në sajë të këtij projekti vazhdon mbështetja e dy fëmijëve të identifikuar dhe të regjistruar në sistemin arsimor për integrimin e tyre në shkollë sipas nevojave të identifikuara nga strukturat e shërbimeve sociale të bashkisë. Identifikimi dhe përzgjedhja e fëmijëve është realizuar nga Njësia e mbrojtjes së Fëmijëve në bashkëpunim me stafin e Qendrës Komunitare Multifunkionale “Për familjen” dhe ZVA Shkodër. Familja dhe fëmijët janë përfshirë edhe në shërbimet sociale integruese si klasa passhkollore, seanca këshillimi dhe prindërimi si dhe aktivitetet ndërgjegjësuëse që ofrohen në Qendrën Komunitare Multifunkionale me qëllim fuqizimin social ekonomik dhe sigurimin e qëndrueshmërisë dhe vijueshmërinë e fëmijëve në sistemin shkollor. Gjatë periudhës së fatkeqësisë për shkak të pandemisë COVID -19 ka vazhduar mbështetja për fëmijët dhe familjen e tyre. Në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.49 datë 24.06.2019, “Për Shtesë Plani në Buxhetin e Bashkisë Shkodër në shumën 88,000”, të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe Observatori për të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve, nr. Prot. 5750 datë 08.04.2019, mbështetja e dhënë konsiston në: Shpenzime për shërbime mbështetëse (veshmbathje, ushqime, materiale didaktike) për këto dy fëmijë që është shtrirëgjatë vitit shkollor 2019-2020.

P10430.O3.A8 “Mbështetje financiare për familjet në vështirësi në kushtet e pandemisë së shkaktuar”.

Me përhapjen e COVID-19 i cili mori përmasat e një pandemie në mesin e muajit mars 2020 u morën disa vendime në formën e Akteve Normative, VKM, etj të cilat sollën kufizim të lëvizjes, kufizim dhe ndalim të shumë aktiviteteve ekonomike dhe sociale në vendin tonë. Këto masa sollën mbylljen e shumë aktiviteteve ekonomike e sociale, humbjen e shumë vendeve të punës dhe pasoja veçanërisht të rënda solli për familjet dhe individët që punojnë në tregun informal, ditor dhe pa të ardhura të qëndrueshme. Për të ardhur në ndihmë dhe mbështetje të këtyre familjeve dhe individëve Bashkia e Shkodrës ka siguruar mbështetjen e shumë organizatave, donatoreve dhe ka financuar nga buxheti i saj, pako ushqimore, higjienike, mbështetje të moshuarve në shtëpi, mbështetje psikologjike, etj. Bashkia Shkodër në kuadër të masave që po merr për përballimin e situatës së krijuar për shkak të situatës së shkaktuar nga COVID-19, me mbështetjen e UNICEF ka siguruar mbështetje financiare për të ndihmuar disa familje në vështirësi social-ekonomike. Familjet të cilat janë mbështetur janë familje, të cilave iu është refuzuar ndihma ekonomike për muajin mars 2020, familje pa të ardhura të komunitetit rom dhe egjiptian që jetojnë në kushte të vështira social - ekonomike. Komuniteti rom dhe egjiptian, është ndër grupet më të varfra dhe më të

margjinalizuara dhe më të përjashtuara që jetojnë në të gjithë Shqipërinë, përfshi edhe në qytetin e Shkodrës. Në këtë ndërhyrje janë mbështetur 553 familje që përbëhen nga 1-4 anëtarë, me masë përfitimi 4000 lekë/familje si dhe familje të përbëra nga 5 anëtarë e më shumë me masë përfitimi 4800 lekë/familje. Identifikimi dhe përzgjedhja e familjeve është realizuar nga drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe stafi i qendrës komunitare Multifunkionale "Për familjen". Buxheti i kësaj ndërhyrje për Bashkinë Shkodër ka qenë donacion nga UNICEF.

P10430.O4.A1 Fuqizimi socio – ekonomik i komunitetit rom dhe egjiptian.

Ka vazhduar ofrimi i shërbimeve sociale, integruese dhe mbështetëse pranë qendrës komunitare multifunkionale, për komunitetin rom dhe egjiptian. Qendra Komunitare Multifunkionale "Për Familjen" për komunitetin rom dhe egjiptian është vënë në funksion të plotë dhe ofron shërbime specifike për komunitetin rom dhe egjiptian. Numri i përfituesve të shërbimeve: 37 janë nevoja administrative. 77 kanë marrë shërbim mjekësor (35 rimbursim medikamentesh, 41 vizita të përgjithshme në qendrat shëndetësore, në spital dhe poliklinikë, 1 elektrocenfalogram e kokës dhe vizita ortopedi.), 13 fëmijë janë pajisur me kartela personale vaksinimi, 13 persona janë vaksinuar në qendër dhe pajisur me kartela vaksinimi, 133 fëmijë janë përfitues të përkujdesjes sociale, mbështetje në qendër me vakte ushqimore, shërbimin e higjenes, klasa passhkollore (përforcuese edhe përgatitore), aktivitete të shëndetit, këshillime, lojëra psiko-sociale dhe aktivitete verore. Gjatë periudhës së COVID-19, 140 familje rom dhe 441 familje të komunitetit egjiptian të Bashkisë Shkodër janë mbështetur me pako ushqimore, pako higjenike, ushqime të freskëta dhe ushqime të shëndetshme. Gjithashtu është ofruar mbështetje financiare për 330 familje të komunitetit rom dhe egjiptian që i përkasin Bashkisë Shkodër, si dhe sesione informimi, takime me gra dhe nëna, sesione edukative dhe psiko-sociale me fëmijë.

1-Takime informimi me gra, 6 takime ku janë të përfshira 40 gra, nëna rom dhe egjiptiane. 2-Sesione mësimore edukative dhe lojra psiko-sociale për fëmijë në vendqendrimet rom gjatë periudhës COVID-19, në të cilat janë të përfshirë 60 fëmijë të kampeve Tophanë e Prokurori, Dubai dhe Zalli Kirit. Aktivitetet janë realizuar në përputhje të plotë me masat dhe protokollet e miratuara nga ministria e linjës. Shërbim i ri, i shtuar që nga muaji janar 2020 në ambjentet e Qendrës Komunitare Multifunkionale "Për Familjen" është edhe Libraria e Lodrave. Ky shërbim i ri konsiston në nxitjen dhe bashkëveprimin e prindërve dhe fëmijëve nëpërmjet lodrave dhe lojës.

P10430.O4.A2 Shpërblim për jetimët me rastin e festave të fundvitit.

Në territorin e Bashkisë së Shkodrës ofrojnë shërbim rezidencial për fëmijë pa përkujdes prindëror 3 institucione të ndryshme të ndara sipas grupmoshave. Këto institucione ofrojnë shërbime për të rinjtë deri në moshën 18 vjeçare. Bashkia e Shkodrës në vitin 2017 ka aplikuar, fituar dhe zbatuar projektin për ristrukturimin e godinës së ish konviktit të shkollës pyjore, pranë MZHU, me qëllim strehimin dhe ofrimin e kushteve sa më të mira banimi për jetimët e dalë nga strukturat rezidenciale dhe që jetojnë në konviktet e shkollave të mesme të qytetit. Aktualisht janë të gatshme dhe janë duke u vënë në funksion 26 apartamente sociale për strehimin e jetimëve dhe grave kryefamiljare. Gjithashtu, në ndihmë të kësaj shtrese është shpërndarë ashtu si vitet parardhëse shpërblimi i jetimëve të dalë nga strukturat rezidenciale dhe jo vetëm, banorë të qytetit të Bashkisë Shkodër,

me rastin e festave të fundvitit. Qëllimi i kësaj ndihme është lehtësimi i situatës së tyre ekonomike dhe krijimi i një atmosfere sa më të mirë festive.

P10430.O4.A3. Shërbime mbështetëse dhe riaftësuese për integrimin e fëmijëve me aftësi ndryshe në sistemin edukativ.

Autizmi është një sëmundje e cila karakterizohet nga çrregullime të marrëdhënieve sociale, të komunikimit dhe sjellje e lëvizje stereotipike. Autizmi po përhapet në mënyrë të shpejtë duke u shndërruar në një sfidë për shëndetin publik në mbarë botën për shkak të kostove shoqërore dhe ekonomike. Njohuritë për autizmin në shërbimin shëndetësor e më tepër në popullatën shqiptare janë shumë të pakta dhe nuk është e qartë se rritja e rasteve është rezultat i shtimit real të rasteve apo diagnostikimit më të mirë. Në Shqipëri shifrat janë në rritje, por nuk ka të dhëna të sakta. Specialistët e shëndetësisë bëjnë thirrje për sensibilizimin e opinionit publik për diagnostikimin e hershëm, përkrahjen ndaj fëmijëve autikë dhe integrimin e tyre në shoqëri. Aktualisht në Shkodër nuk kemi një shërbim të specializuar për trajtimin e fëmijëve me autizëm që të mundësojë mbështetjen dhe ofrimin e shërbimeve integruese në moshë sa më të hershme në shërbimet edukuese parashkollore dhe shkollore. Për këtë arsye janë vlerësuar ambjentet e mundshme për përshtatjen dhe ngritjen e shërbimit integrues për fëmijët me autizëm e cila do të ofrojë shërbime informuese, rehabilituese me synim integrimin e tyre në kopësht dhe në shkollë si moshatarët e tyre. Ka përfunduar faza e parë e punimeve për përshtatjen e ambjenteve fizike për ofrimin e shërbimeve. Gjatë vitit 2019, Bashkia Shkodër është shpallur fituese me projektin “Krijimi i shërbimit të specializuar ditor për fëmijët me çrregullime të spektrit autik në Bashkinë e Shkodrës” në kuadër të thirrjes për projekte “Askush të Mos Mbetet Pas”, një program i përbashkët i Kombeve të Bashkuara, i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Përgjatë kësaj periudhe është siguruar mobilimi i ambjenteve, përzgjedhja e stafit dhe trajnimi i tij nga Fondacioni “Fëmijët Shqiptarë”, si enti më me eksperiencë në ofrimin e një ekspertizë të tillë. Qendra Harmonia është tashmë ka filluar punën dhe ofron shërbime për spektrin e autizmit.

P10430.O4. A4 “Krijimi i shërbimit të specializuar ditor për fëmijët me çrregullime të spektrit autik në Bashkinë e Shkodrës”.

Bashkia Shkodër është shpallur fituese me projektin “Krijimi i shërbimit të specializuar ditor për fëmijët me çrregullime të spektrit autik në Bashkinë e Shkodrës” në kuadër të thirrjes për projekte “Askush të Mos Mbetet Pas”, një program i përbashkët i Kombeve të Bashkuara, i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Nëpërmjet këtij projekti synohet të financohet nisja e ofrimit të shërbimeve dhe vënia në funksion e ambienteve të rikonstruara. Projekti do të mbështesë zbatimin e vizionit të sapo- hartuar të sektorit social në Shqipëri, në përputhje me Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm (SDG-të) dhe aspiratat e vendit drejt integritimit evropian. Projekti adreson përfshirjen sociale të personave me AK, në këtë rast të fëmijëve me çrregullime të spektrit autik, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror të specializuara, që synojnë fuqizimin dhe pjesëmarrjen efektive të tyre në shoqëri. Gjithashtu, ky projekt propozohet në përputhje me Planin Social Vendor të Bashkisë Shkodër, në mënyrë

konkrete për sa i përket “Objektivit Strategjik 1” për sa lidhet me standardizimin, konsolidimin dhe shtrirjen e shërbimit komunitar në territor; si dhe në përputhje me “Objektivin Strategjik 5” për sa lidhet me ofrimin e shërbimeve mbështetëse dhe riaftësuese për integrimin e fëmijëve me aftësi ndryshe (autikë) në sistemin edukativ. Gjatë kësaj periudhe janë ridizenjuar hapësirat në përshtatje me shërbimet që do të ofrojë Qendra. Është siguruar me financimin e Bashkisë Shkodër një pjesë e mobilitetit të ambjenteve të qendrës, si dhe janë realizuar ndërhyrjet e duhura infrastrukturore të objektit për rehabilitimin e dëmtimeve të shkaktuara nga termeti i 26 nëntorit 2019. Gjatë kësaj periudhe janë kryer procedurat e prokurimeve përkatëse dhe organizuar aktivitetet e parashikuara. Në organigramën e Bashkisë Shkodër për vitin 2020 është parashikuar dhe krijuar struktura e stafit me figurat profesionale të nevojshme për ofrimin e shërbimit. Është realizuar përzgjedhja dhe trajnimi i stafit që do të merret me ofrimin e shërbimeve dhe është bërë punësimi i tyre. Qendra Harmonia është bashkëpunuese ka filluar punën dhe ofron shërbime të specializuara për spektrin e autizmit.

P10430.O4.A4. Plani i zhvillimit lokal për komunitetin rom dhe egjiptian.

Në zbatim të planit të zhvillimit janë realizuar dhe ofrohen shërbimet në mbështetje dhe fuqizim të komunitetit rom dhe egjiptian. Njëkohësisht është punuar për hartimin e raportit të parë mbi ecurinë e zbatimit të Planit të Zhvillimit të Komunitetit (PZHK) Rom dhe Egjiptian të Bashkisë së Shkodrës për periudhën 2017-2020. Raporti ofron një analizë të evidencave ekzistuese në lidhje me ndryshimet në jetët e anëtarëve të dy komuniteteve, rom dhe egjiptianë, sipas gjashtë fushave prioritare të planit të veprimit, përkatësisht: regjistrimi civil dhe aksesin në sistemin e drejtësisë; arsimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor; punësimi dhe arsimi dhe formimi profesional; kujdesi shëndetësor, strehimi dhe integrimin urban; si dhe mbrojtja sociale. Duke marrë në konsideratë që monitorimi ndihmon aktorët vendor për të bërë ndryshimet e nevojshme në PZHK, ai ndër të tjera synon të ofrojë edhe rekomandimet e nevojshme për adresimin e sfidave dhe problemeve të identifikuar. 59 fëmijë rom të shkollave Salo Halili, Martin Camaj dhe Isuf Tabaku janë të përfshirë në klasa përforcuese për vitin 2019-2020 në ambjentet e Qendrës Komunitare Multifunkionale, ndërsa 55 të tjerë të cilët janë më të rritur se moshë shkollare, janë të përfshirë në arsim të pjesshëm dhe asistohen nga Qendrën Komunitare Multifunkionale ‘Për Familjen dhe Qendra Komunitare “Për familjen” nr 5. Gjithashtu në Qendrën Multifunkionale zhvillohen klasa përgatitore për 30 fëmijë të kopshteve 1 Qershori dhe Ajasëm, përkatësisht kampet Tophanë, Prokurori dhe Dubai për vitin shkollor 2019-2020. Klasa prindërimi ku përfitojnë 40 prindër rom dhe egjiptian. Këshillime psikologjike për 45 fëmijë romë (kampet Tophanë, Prokurori) dhe secili prej fëmijëve përfitues ka dosjen përkatëse të këshillimit. Ndërsa klasën e analfabetizimit për vitin 2019-2020 e kanë përfunduar 8 të rritur romë dhe egjiptian.

P10430.O5.A1. Ngritja dhe vendosja në funksion e Qendrave Komunitare “Për Familjen”.

Në vitin 2016 filloi krijimi i rrjetit të shërbimit social në komunitet. Për herë të parë u ngritën qendrat komunitare “Për familjen”, të cilat ofrojnë shërbime sociale si informim, orientim,

këshillim, shërbim në familje, mbështetje psikosociale, etj. Në vazhdim të krijimit dhe zgjerimit të rrjetit për ofrimin e shërbimit social në territor, janë ngritur dhe vënë në funksion në total 12 qendra komunitare “Për Familjen”, të shtrira në territorin e Bashkisë së Shkodrës. Gjatë kësaj periudhe, sa i përket konsolidimit të shërbimit komunitar në qendrat komunitare “Për Familjen”, janë rritur shërbimet e ofruara, aktivitetet dhe përfituesit, pranë këtyre qendrave. Duke u mbështetur në shërbimet e ekzistuese, eksperiencën e krijuar dhe nevojat sociale në komunitet, Bashkia e Shkodrës synon të mbështesë zhvillimin e integruar dhe të vazhdueshëm të mirëqenies sociale të familjes si qeliza bazë e komunitetit tonë të shtrirë në të gjithë territorin.

P10430.O5.A2. Shërbime alternative për fëmijët dhe familjen.

Sigurimi i mbrojtjes shoqërore për fëmijët pa kujdes prindëror dhe i të drejtave të tyre është një ndër sfidat më të rëndësishme për Bashkinë e Shkodrës, por edhe për shoqërinë civile, duke kërkuar një vëmendje më të veçantë për këtë target grup. Gjatë kësaj periudhe, në bashkëpunim me organizatën Nisma për ndryshim shoqëror janë identifikuar familje në rrezik institucionalizimi dhe po punohet për fuqizimin e tyre dhe paralelisht po punohet me fuqizimin e familjeve që kanë fëmijë në institucione rezidenciale, me synim deinstitutionalizimin e tyre. Sa i përket promovimit të shërbimit të kujdestarisë familjare, janë realizuar disa materiale promociionale si fletëspallosje me informacione praktike në lidhje me ofrimin e këtij shërbimi në bashkinë Shkodër. Është realizuar në bashkëpunim me Bethani një fushatë ndërgjegjësuese me aktorë të ndryshëm publik dhe jo publik, por edhe me komunitetin për të rritur ndërgjegjësimin dhe informacionin mbi shërbimin e kujdestarisë ligjore si mundësia më e mirë për fëmijët pa kujdes prindëror. Këto aktivitete janë zhvilluar on line si dhe në median lokale.

P10430.O5.A3. Ndërhyrje të integruara për përfshirjen dhe integrimin socio-ekonomik të fëmijëve dhe të rinjve pa përkujdes prindëror.

Me synim ofrimin e kushteve sa më të përshtatshme për mirërritjen dhe zhvillimin e fëmijëve, Bashkia e Shkodrës po implementon shërbimet alternative të kujdestarisë për fëmijët pa përkujdes prindëror; shërbimin e kujdestarisë familjare me lidhje gjaku dhe ofrimin e shërbimeve alternative pranë shtëpi – familje. Me synim parandalimin e institucionalizimit, po koordinohen shërbimet në territor për fuqizimin e familjeve në vështirësi socio-ekonomike pranë qendrave komunitare “Për Familjen”. Përveç kësaj, për të rinjtë të cilët tashmë kanë dalë nga strukturat rezidenciale janë planifikuar shërbime për mbështetjen e fuqizimin e tyre përmes përfshirjes në kurse profesionale me synim arritjen e autonomisë për kujdesin personal social, ekonomik, etj. Ka përfunduar dhe pritet të vihet në funksion modeli i ri i Komunitetit Edukativ të së Ardhmes ose Shtëpi Familje për fëmijët pa përkujdes prindëror të Bashkisë Shkodër, si model i parë në vendin tonë i shërbimit alternativ pranë shtëpi familje për fëmijët pa kujdes prindëror. Kjo strukturë është ndërtuar në kuadër të zbatimit të projektit “Komuniteti i të Ardhmes: ndërhyrje të përfshirjes sociale dhe në tregun e punës për jetimët e Shkodrës”, AID 10950, projekt i financuar nga Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (AICS), dhe që po zbatohet nga Shoqata IPSIA, në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër, CODE PARTNERS, SHIS, Universitetin e Bolonjës, Universitetin e Shkodrës dhe Kooperativën Lybra, në të cilin është parashikuar që të mbulohen kostot e shërbimit dhe të stafit gjatë vitit të parë. Gjatë thirrjes së parë për plotësimin e vendeve vakante pranë kësaj strukturë janë kualifikuar vetëm dy persona, në periudhën në vijim do të shpallet thirrja e dytë për plotësimin e vendeve vakante të mbetura. Sfidë mbetet financimi për të siguruar qëndrueshmërinë e këtij shërbimi inovativ në lidhje me kujdesin alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror.

P10430.O6.A1 Qendra Rinore "Po të Ardhmes" (Atelie).

Gjatë vitit 2020 pranë Qendrës Rinore Atelie u realizuan këto aktivitete:

Është realizuar ekspozita e artistit të rinj Nard Zajeti. Është realizuar vullnetarizëm pranë Shtëpisë së Fëmijës 0-5 vjeç në kuadër të programit të vullnetarizmit “Student Diversity Challenge” të Qendrës Rinore Atelie në bashkëpunim me Terre Des Hommes. Janë realizuar takime të Klubit të Librit ku pjesëmarrës ishin 15 të rinj. Është realizuar punishte skulpture ku ishin 10 të rinjë pjesëmarrës. Është bërë takim me të rinjtë e Bashkisë së Roskovecit dhe Urës Vajgurore për shkëmbim eksperiencash. Është realizuar takimi i koalicionit anti-drogë “Dua, Mund, Arrij” në bashkëpunim me CADCA dhe YËCA of Albania ku pjesëmarrës ishin mbi 30 persona. Është realizuar takimi në kuadër të “Javës për parandalimin e Kancerit të Qafës së Mitrës” në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik. Është realizuar aktivitetit të qendrës rinore Atelie, “Kafe me..” kryetarën e Bashkisë Shkodër, ku pjesëmarrës ishin mbi 20 veta. Është realizuar shfaqja komedia e artit “Princesha e Bizantit” 10-15 shkurt 2020 nga trupa teatrore eksperimentale e Qendrës Rinore Atelie. Është realizuar trajnimi me temë “Fuqizimi i Grupeve Komunitare” në bashkëpunim me Terre des Homes në kuadër të projektit IRMA. Organizata YEA në bashkëpunim me Qendrën Rinore Atele ka realizuar ëorkshopin për sipërmarrësit të rinj. Është zhvilluar takim konsultativ i Regional Youth Cooperation Office në Qendrën Rinore “Atelie”. Pjesëmarrës ishin mbi 15 të rinj. Janë realizuar takime organizative me presidentët e senatit të gjimnazeve. Janë realizuar takime informuese për karrieren universitare nga Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe nga universiteti European i Tiranës pranë qendrës Rinore Atelie. Pjesëmarrës ishin mbi 400 të rinj. Është realizuar vullnetarizëm nga të rinjtë e Qendrës Rinore Atelie pranë qendrës komunitare “për familjen” nr. 4 për të realizuar aktivitete me të moshuarit. Është realizuar aktivitet vullnetar i të rinjve të Qendrës Rinore “Atelie” pranë Qendrës Komunitare Multifunkionale “Për Familjën” ku realizuan aktivitete për fëmijët e komunitetit Egjiptian dhe Rom. U realizua prezantimi i projektit “AgRini – Young Agricultural Specialist Program” pranë qendrës rinore Atelie në kuadër të Programit të GIZ për Zhvillimin e Qëndrueshëm Rural (GIZ SRD). Është realizuar faza e dytë të eliminimeve të kampionatit të shahut dhe finalja “Çesk Jubani” për vajza dhe djemë të gjimnazeve të qytetit të Bashkisë Shkodër. Është realizuar takim informues mbi bursat ENGLANDES me studentët më të mirë të shkollave të mesme në Shkodër në Qendrën Rinore Atelie. Është realizuar ekspozitë personale e artistet Nereida Curri grafik dizajner në kuadër të javës së barazisë gjinore. Është realizuar konkursi i fotografisë dhe pikturës për të rinjtë shkodër dhe tiranë në bashkëpunim me Terre des Hommes. Janë realizuar video intepretuese të artistëve të rinj të trupës teatrore eksperimentale të Qendrës Rinore “Atelie” në bashkëpunim me Teatrin “Migjeni”. Është marrur pjesë në takimin për ligjin mbi vullnetarizmin në platformën ZOOM Online, realizuar nga Beyond dhe Barriers dhe Kongresi Rinor Kombëtar. Qendra Rinore Atelie ka bashkëpunuar në realizimin e projektit Shkodra Jazz Festival dhe Rrok Academy . Është zhvilluar trajnimi 3 ditor mbi startup nga organizata IDEA. Është zhvilluar trajnimi mbi Qeverinë e Nxënësve në kuader të projektit Manuali i qytetarisë Aktive nga Kongresi Rinor Kombëtar mbështetur nga Hanns Siedel Stiftung. Është realizuar ekspozita Open Art, e 15 artistëve të rinj të akademisë së arteve Tiranë në Qendrën Rinore Atelie në bashkëpunim me OJF Liburnetik.

P10430.O7.A1. “Asnjë Fëmijë Jashtë”.

“Asnjë fëmijë jashtë” është një aktivitet social-kulturor që organizohet që nga viti 2005, me rastin e festave të fundvitit. Protagonistë të këtij aktiviteti janë fëmijët e familjeve në vështirësi social-ekonomike. Ky aktivitet përfshin të gjitha kategoritë e fëmijëve të familjeve në vështirësi të theksuara social-ekonomike, gjithashtu përfshin aktivisht PAK-të, fëmijë të komunitetit rom dhe egjiptian, fëmijët e ngjuar, fëmijë të institucioneve rezidenciale, fëmijë në situatë rruge duke përfshirë edhe fëmijë nga të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Shkodër. Fëmijët përgatiten dhe performojnë në fusha të ndryshme artistike si: muzikë, recitim, vegla muzikore, teatër, etj duke synuar gjithëpërfshirjen e fëmijëve në fusha të ndryshme të artit duke qenë vetë ata protagonistët. Për shkak të masave kufizuese dhe ndalimit të aktiviteteve për shkak të COVID-19 ky aktivitetet nuk është arritur të realizohet.

P10430.O7.A2. Projekti “Shpresa” për personat e braktisur dhe me aftësi ndryshe.

Projekti Shpresa, është një organizatë e licënsuar që ofron shërbim të përkujdesit social të tipit shtëpi-familje, për PAK-të e braktisur nga familja dhe të deinstitutionalizuar. Kjo organizatë, është krijuar dhe vepron në qytetin e Shkodrës që prej vitit 1995. Projekti “Shpresa” ka 7 shtëpi-familje, të shpërndara në komunitet dhe aktualisht marrin shërbim 60 persona me aftësi të kufizuara. Projekti “Shpresa”, duke ofruar shërbime alternative për personat me aftësi të kufizuara, të cilët janë pa asnjë përkujdes dhe interesim familjar, dhe me problematika të ndryshme, ka nevojë për mbështetje financiare dhe vëmendje të shtetit. Mbështetja e projektit “Shpresa” është një domosdoshmëri, për të ofruar shërbimin sipas standarteve të përcaktuara në ligj për personat me aftësi ndryshe dhe përmbushjen e nevojave sipas rasteve specifike. Në këto qendra përfitojnë shërbime të përkujdesit shoqëror, rehabilituese dhe shëndetësore 60 individë me aftësi të kufizuara.

P010430.O7.A3 Shtëpi Familje për persona me aftësi të kufizuara nga Opera Madonnina del Grappa.

Opera Madonnina del Grappa, është një organizatë e licënsuar që ofron shërbim të përkujdesit social të tipit shtëpi-familje, për PAK të braktisur nga familja dhe të deinstitutionalizuar. Kjo organizatë, është krijuar dhe vepron në qytetin e Shkodrës që prej vitit 1992 ku filloi aktivitetin e saj në mbështetje të personave dhe familjeve më në nevojë. Në vitin 1994 filloj ristrukturimin i plotë i ish spitalit psikiatrik të fëmijëve në Shkodër, duke sjellë përmirësimin e kushteve të jetesës dhe trajtimit të fëmijëve, por në mënyrë të veçantë ky projekt realizoi krijimin për herë të parë në Shqipëri të Qendrës Ditore për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe të krijimit të Shtëpisë Familje. Aktualisht në shtëpinë familje të Opera Madonnina del Grappa marrin shërbim 17 persona me aftësi të kufizuara. Qëllimi i kësaj strukture është rehabilitimi dhe përfshirja në jetën sociale e komunitare nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme me karakter edukativ e integruar duke ju ofruar përfituesve të saj shërbim rezidencial konform standarteve të miratuara nga Ministria e Linjës. Mbështetja e shtëpive – familje të “Opera Madonnina del Grappa” është një domosdoshmëri, për të ofruar shërbimin sipas standarteve të përcaktuara në ligj për personat me aftësi të kufizuara dhe përmbushjen e nevojave sipas rasteve specifike. Me qëllim sigurimin e vazhdimësisë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve shoqata “Opera Madonnina del Grappa”, i është drejtuar vazhdimisht për mbështetje Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkisë Shkodër me kërkesën për financim të shërbimeve, në mbështetje të ligjit nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”. Në përgjigje të këtyre kërkesave Bashkia Shkodër, i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me kërkesën

për fonde për mbështetje të “Opera Madonnina del Grappa”, për fond për paga dhe sigurime shoqërore për punonjës, si kujdestar social dhe figura profesionale në fusha të ndryshme si: drejtor, ekonomist, psikolog, punonjës social, fizioterapist, infermier dhe kuzhinier, punëtor mirëmbajtës etj. Përveç pagesës për personelin, Bashkia Shkodër do të mbështesë “Opera Madonnina del Grappa” duke mbuluar kuotën ushqimore për personat me aftësi të kufizuar të sistemuar pranë “Opera Madonnina del Grappa”, energjinë elektrike, ujë, gaz, karburant, shpenzime mjekësore etj. sipas marrëveshjes së bashkëpunimit mes Bashkisë Shkodër dhe “Opera Madonnina del Grappa”.

P010430.O8.A1.Pagesë PAK dhe Invaliditeti.

Në zbatim të Ligjit Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr.8626 datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” të ndryshuar; Ligjit nr.8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit” i ndryshuar, Ligjit nr.7889 datë 14.12.1994 “Statusi i invalidit” të ndryshuar.

Numri i personave të trajtuar me pagesë paaftësie ka qenë: në muajin Janar 4199, në Shkurt 4296, në Mars 4363, në Prill 4385, në Maj 4382, në Qërshor 4364, në Korrik 4339, në Gusht 4327, në Shtator 4209, në Tetor 4168, në Nëntor 4145, në Dhjetor 4125.

Numri i invalidëve të punës të trajtuar me shtesë kempit ka qenë: në muajin Janar 3379, në Shkurt 3400, në Mars 3401, në Prill 3401, në Maj 3401, në Qershor 3412, në Korrik 3347, në Gusht 3376, në Shtator 3364, në Tetor 3357, në Nëntor 3357, në Dhjetor 3339.

Për kryerjen e këtyre pagesave mujore fondet e çelura nga Shërbimi Social Shtetëror janë si më poshtë:

PAK : Janar - Shkurt 198 900 000 Lekë, Mars - Prill 71 085 000 Lekë, Maj - Qershor 195 227 000 , Korrik - Gusht 132 015 000, Shtator - Tetor 132 746 000, Nentor - Dhjetor 122 479 000.

Duhet të theksojmë faktin se detyrimi i papaguar në muajin Dhjetor 2019 për mungesë fondi, në vlerën 62 708 614 Lekë, është paguar me çeljen e fondeve të reja të viti kalendarik 2020.

P10430.O8.A2. Ndhimë ekonomike.

Në zbatim të Ligjit Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr 597, datë 14.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.

Përfitues të skemës së ndihmës ekonomike kanë qenë:

Në muajin Janar 1864 familje, nga të cilat: 1673 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 191 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Shkurt 1856 familje, nga të cilat: 1663 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 193 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Mars 1824 familje, nga të cilat: 1639 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 185 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Prill 1916 familje, nga të cilat: 1724 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 192 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Maj 2048 familje, nga të cilat: 1841 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 207 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Qershor 2131 familje, nga të cilat: 1924 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 207 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Korrik 2052 familje, nga të cilat: 1853 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 199 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Gusht 2022 familje, nga të cilat: 1826 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 196 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Shtator 2020 familje, nga të cilat: 1813 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 207 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Tetor 1980 familje, nga të cilat: 1775 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 205 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Nentor 1984 familje, nga të cilat: 1779 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 205 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Dhjetor 1970 familje, nga të cilat: 1765 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 205 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Për kryerjen e këtyre pagesave mujore fondet e çelura nga Shërbimi Social Shtetëror janë si më poshtë:

Ndihma Ekonomike: Janar – Shkurt 23 300 000 Lekë, Mars-Prill 19 161 000 Lekë, Maj-Qershor 18 494 000 Lekë, Korrik -Gusht 20 677 000, Shtator - Tetor 20 565 000, Nentor-Dhjetor 20 197 000 .

Në zbatim të Vendimit Nr.254, datë 27.3.2020 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, ndihmës ekonomike e të pagesës të së ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, të shpallur si pasojë e COVID-19’,

Përfitues të pagës shtesë kanë qenë:

193 familje të trajtuara nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6% për muajin Shkurt dhe 1639 familje të trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar për muajin Mars.

193 familje të trajtuara nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6% për muajin Mars dhe 1639 familje të trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar për muajin Prill.

192 familje të trajtuara nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6% për muajin Prill dhe 1841 familje të trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar për muajin Maj.

Për kryerjen e këtyre pagesave mujore fondet e çelura nga Shërbimi Social Shtetëror janë: 25 966 000 Lekë nga të cilat janë realizuar: 26 033 580 Lekë.

P10430.O9.A1. Administrimi dhe funksionimi i çerdheve.

Është realizuar vlerësimi i nevojave për ndërhyrje me qëllim krijimin e kushteve sa më të favorshme për foshnjat që frekuentojnë këto çerdhe dhe gjithashtu familjet e tyre. Në bashkinë e Shkodrës, ofrojnë shërbim për foshnjat dhe familjet e tyre 6 çerdhe. Numri i foshnjave që frekuentojnë këto çerdhe është 194.

1. “Shpenzime për paga e sigurime”

Fondi i planifikuar për mbulimin e shpenzimeve për paga dhe sigurime është **32.857 mijë lekë** dhe realizimi i 12 mujorit paraqitet në vlerën **25.309 mijë lekë** dhe realizimi për sigurime paraqitet në vlerën **4.245 mijë lekë**, ndërsa vlera **33 mijë lekë** janë shpërblim për dalje në pension.

2. “Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të tjera”

Fondi i planifikuar për këtë zë është **9.541 mijë lekë** dhe realizimi i këtij artikulli paraqitet me vlerën **6.976 mijë lekë**.

Në zërin “**Materiale zyre dhe të përgjithshme**” fondi i planifikuar është **95 mijë lekë** për blerje kancelarie dhe është realizuar në vlerën **79 mijë lekë**.

Në zërin “**Materiale për pastrim, ngrohje dhe ndriçim**” fondi i planifikuar është **1000 mijë lekë** për të blerë materiale pastrimi, gaz për ngrohje e gatim. Për zërin “Blerje gaz” është bërë ndryshim regjistri me Vendimin Nr. 177 dt. 03.8.2020 në Blerje “Pelet”. Materiale për pastrim janë realizuar në vlerën **600 mijë lekë**, blerje Pelet është realizuar në vlerën **300 mijë Lekë**.

Në zërin “**Furnizime me ushqime**” për 6 Çerdhe, fondi i planifikuar është **5300 mijë lekë** dhe realizimi është në vlerën **3.239 mijë lekë**.

Në zërin “**Blerjeve të materialeve të tjera**” si batanije, dyshek etj, fondi i planifikuar është **150 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **127 mijë lekë**.

Në zërin “**Shërbime nga të tretë**” fondi i parashikuar është **1800 mijë lekë**. Kjo vlerë përfaqëson faturat e energjisë elektrike që janë realizuar për periudhën 12 mujore në shumën prej **950 mijë lekë**, faturat e konsumit të ujit në shumën prej **532 mijë lekë**. Për vlerën **46 mijë lekë** të parashikuar për intert realizimi është **43 mijë lekë** dhe likujdimi bëhet çdo muaj.

Në zërin “**Blerje e lëndëve djegëse**” dru zjarri, fondi i parashikuar prej **300 mijë lekë** është realizuar në vlerën **300 mijë lekë**.

Shërbimi për **dezinfektimin** e ambienteve të Çerdheve është parashikuar në vlerën prej **40 mijë lekë** dhe është realizuar për vlerën **37 mijë lekë**.

Në zërin “**Shpenzime Transporti**” fondi i parashikuar përfshin vlerën prej **200 mijë lekë**, në të cilën përfshihen shpenzimet që janë për blerje karburanti dhe është realizuar në vlerën **200 mijë lekë**.

Në zërin “**Mirëmbajtje e zakonshme**” fondi i planifikuar prej **570 mijë lekë** përfaqëson realizimin e mirëmbajtjes së ndërtesave (lyerjes me bojë) me shumën prej **500 mijë lekë** dhe vlerën prej **40 mijë lekë** që përfaqësojnë shpenzimet që janë realizuar në vlerën **39 mijë lekë** për mirëmbajtjen e aparateve dhe paisjeve teknike dhe **30 mijë lekë** për mirëmbajtje të paisjeve të

zyrës që është realizuar në vlerën **24 mijë lekë**. Lyerja me bojë është realizuar në vlerën **467 mijë lekë**.

Në zërin “**Shpenzime përsigurimin e ndërtesave**” fondi i planifikuar është **40 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **39 mijë lekë**.

Transferta Buxhetore për individë, fondi i planifikuar është **84 mijë lekë** dhe realizimi për 12 mujorin është **57 mijë lekë**, realizohet në rast shpërblimesh.

Në zërin “**Investime**” fondi i planifikuar është **350 mijë lekë**. Tek kjo vlerë përfshihet blerje paisje orendi si: shporet, lavatrice, kondicionerë etj. dhe është realizuar në vlerën **348 mijë lekë**.

Programi 10660: Strehimi social

Ky program është pjesë e programeve të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik.

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit.

Qëllimi i programit të “Strehimi social”.

- Ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtyre funksioneve për vitin 2020 kanë qenë:

- O1.Përmirësimi i kushteve të banimit për shtresat në nevojë.
- O2. Vlerësimi, planifikimi dhe sigurimi i kushteve të përshtatshme të banimit, për individët dhe familjet në nevojë, përmes ofrimit të alternativave për një strehim të gatshëm, të arritshëm, të përballueshëm dhe të përshtatshëm.

Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara.

Një nga faktorët e mosrealizimit në kohë është gjendja e emergjencës kombëtare shpallur për shkak të COVID-19 dhe në zbatim të VKM nr. 243, datë 24.3.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore” proçedurat e aplikimit janë pezulluar dhe janë rihapur me datë 01.06 2020.

Një tjetër arsye është dhe vonesa në shqyrtimin dhe miratimin nga K.B. i listës së përfituesve në programin e subvencionimit të interesave të kredisë.

Realizimi i Buxhetit të planifikuar
Programi “Strehimi social”.


Programi 10661	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Subvensioni	Transferta	Investime	Totali
Plani fillestar 2020	-	1,230	-	600	43,196	45,026
Plani i rishikuar 2020	-	1,230	-	600	78,724	80,554
Realizimi viti 2020	-	737	-	-	59,694	60,431
% e realizimit	-	59.92%	-	0%	75.8%	75%

Realizimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është në total 75%, sipas zërave kryesorë më poshtë:

Shpenzimet korrente (paga+sigurime shoqërore, shpenzime operative, transferime)
Shpenzimet kapitale

1.2%

98.8%



Realizimi i treguesve të performancës:

Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

Periudha e Raportimit: Janar - Dhjetor 2020

Kodi i Programit	10661	Emertimi i programit:	Strehimi social						Koment e
Qellimi 1	Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.							
		**Treguesit e performancës/Produktet:							
Objektivat e politikës:		Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhës	Niveli i planifikuar ne vitin korent	Niveli i rishikuar ne vitin korent	Niveli faktik ne fund te vitit korent	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	
<i>Objektivi Specifik I</i>	O1.Permiresimi i kushteve te banimit per shtresat në nevoje							
		1	Numri I apartamenteve sociale funksionale për jetimët dhe grate kryefamiljare pa asnjë përkrahje;	26	26	24	24	100%	
		2	Nr. I aplikimeve pranë Bashkisë për strehim social, bonus strehimi	38	218	233	163	70%	
		3	Nr I aplikimeve pranë qeverisë dhe donatorëve për programet sociale të strehimit në vit,	1	6	3	2	67%	
		4	Nr i banesave ne rrezik shembje	25	40	40	0	0%	
		5	Nr. I banorëve përfitues;	3000	3000	3000	3000	100%	
		6	Nr. I familjeve përfituese;	673	673	673	673	100%	
		7	Nr. I banesave sociale me qira 2+1 dhe 1+1 (kontenier);	28	28	28	28	100%	
		8	Nr I familjeve perfituese	0	33	33	0	0%	
		9	Nr I banoreve perfitues	0	142	142	0	0%	
		10	Nr. I banesave sociale prane ish konviktit të shkollës veterinare	0	0	28	28	100%	
		11	Nr. i familjeve përfituese	0	0	28	0	0%	

Realizimi i produkteve:

ANEKSI nr.3 "Raporti përmblidhes i realizimit të treguesve të performances/produkteve të programit"

Emri i Grupit	Bashkia Shkoder	Kodi i Grupit	141
Programi	Strehimi Social	Kodi i Programit	10661

Kodi	ne 000/leke	Njësia matese	Sasia Faktike (sipas vitit paraardhes)	Shpenzi met (sipas vitit paraardhes)	I	Kosto per Njesi (sipas vitit paraardhes)	Sasia (sipas planit të vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit të vitit korent)	II	Kosto per Njesi (sipas planit të vitit korent)	Sasia (sipas planit të rishikuar të vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit të rishikuar të vitit korent)	III	Kosto per Njesi (sipas planit të rishikuar të vitit korent)	Sasia Faktike (ne fund të vitit korent)	Shpenzimet Faktike (ne fund të vitit korent)	Luhatjet ne Koston per Njesi			Komente
																	IV	V = IV - I	V = IV - II	
1	Numri I apartamenteve sociale funksionale për jetimët dhe grate kryefamiljare pa asnjë përkrahje;	Nr. Apartamentesh	26	513	20	26	1,230	47	24	1,230	51	24	737	31	11	-17	-21			
2	Nr. I aplikimeve pranë Bashkisë për strehim social, bonus strehimi	Nr. Aplikimeve	38		0	218	600	3	233	600	3	163	0	0	-3	-3				
3	Nr I aplikimeve pranë qeverisë dhe donatorëve për programet sociale të strehimit në vit,	Nr. Aplikimeve	1		0	6		0	3		0	2	0	0	0	0				

4	Nr i banesave ne rrezik shembje	Nr. Banesash	25		0	40		0	40		0			#DI V/0!	#DI V/0!	#DI V/0!	#DI V/0!	
5	Nr. I banorëve përfitues;	Nr. Banoreve	3000	7,287	2	3000		0	3000		0	3000		0	-2	0	0	
6	Nr. I familjeve përfituese;	Nr. Familjeve	673		0	673		0	673		0	673		0	0	0	0	
7	Nr. I banesave sociale me qira 2+1 dhe 1+1 (kontenier);	Nr banesash	28	14,978	535	28	43,196	1,543	28	35,571	1,270	28	35,571	1,270	735	-272	0	
8	Nr I familjeve perfituese	Nr. Familjeve			#DIV/0!	33		0	33		0			#DI V/0!	#DI V/0!	#DI V/0!	#DI V/0!	
9	Nr I banoreve perfitues	Nr. Banoreve			#DIV/0!	142		0	142		0			#DI V/0!	#DI V/0!	#DI V/0!	#DI V/0!	
10	Nr. I banesave sociale prane ish konviktit të shkollës veterinare	Nr. I banesave sociale			#DIV/0!			#DIV/0!	28	43,153	1,541	28	24,123	862	#DI V/0!	#DI V/0!	-680	
11	Nr. i familjeve përfituese	Nr. I familjeve përfituese			#DIV/0!			#DIV/0!	28		0			#DI V/0!	#DI V/0!	#DI V/0!	#DI V/0!	

Për vitin 2020 në Programin “**Strehimi social**”, në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjes së objektivave të përcaktuara , janë parashikuar këto aktivitete.

P10661.O1.A1 Shërbime integruese & zhvilluese dhe administrimi i apartamenteve sociale, të krijuar për personat e dalë nga institucionet e përkujdesit rezidencial dhe gratë kryefamiljare me probleme social-ekonomike, pranë Qendrës Komunitare "Për Familjen".

Në funksion të vënies në zbatim të Shërbimeve integruese & zhvilluese dhe administrimin e apartamenteve sociale, të krijuar për personat e dalë nga institucionet e përkujdesit rezidencial dhe gratë kryefamiljare me probleme social-ekonomike, pranë Qendrës Komunitare "Për Familjen" nr 6 janë miratuar disa vendime mbi të cilat do të zbatohet dhe ky program strehimi si: Vendim i K.B nr. nr 14 datë 26.2 2020 "Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale tek (Ish konvikti i shkollës pyjore), Vendim "Për miratimin e rregullores së administrimit dhe mirembajtjes së banesave sociale me qira pranë qendrës komunitare nr.6".

Aktualisht kanë përfunduar të gjitha procedurat administrative dhe jemi në fazën përfundimtare të këtij programi. Pranë banesave sociale me qira pranë Qendrës komunitare "Për familjen" nr. 6 janë strehuar 16 jetimë të dalë nga institucionet rezidenciale dhe familje një prindërore, të miratuar me vendim të këshillit bashkiak. Apartamentet në këtë godinë sociale janë pajisur me pajisjet e domosdoshme.

P10661.O2.A1 Strehim social sipas programeve sociale të strehimit.

Për të filluar zbatimin e programeve të strehimi social, në përmbushje të detyrimeve ligjore, Bashkia Shkodër ka përgatitur dhe miratuar në Këshill Bashkiak një paketë vendimesh, të cilat rregullojnë veprimtarinë e strukturës përgjegjëse dhe Komisionit të Strehimit pranë Bashkisë gjatë zbatimit të programeve të strehimit social.

Me datë 02.03.2020 është shpallur Thirrja për aplikime për tre programe të strehimit social, e cila është bërë publike në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë. Për shkak të COVID-19 dhe në zbatim të VKM nr. 243, datë 24.3.2020 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore" procedurat e aplikimit janë pezulluar dhe janë rihapur me datë 01.06 2020.

Gjatë kësaj periudhe informacioni në lidhje me programet e strehimit në zbatim ka qenë i publikuar në faqen zyrtare të bashkisë si dhe janë shfrytëzuar mediat lokale për promovimin dhe shpërndarjen e këtij informacioni sa më shumë tek qytetarët. Gjithashtu specialisti i strehimit pranë Bashkisë ka qenë dispozion për ofrimin e informacionit dhe mbështetjes së nevojshme për qytetarët, çdo ditë pranë zyrës me një ndalesë.

Për instrumentin financiar “Subvencionimi i interesave të kredisë“, në fazën e parë kanë aplikuar 123 qytetarë, nga të cilët pas njoftimit për kualifikim në fazën e parë dhe plotësimit dokumentacioni, janë paraqitur për të plotësuar dokumentacionin 81 qytetarë.

Meqënëse bashkia Shkodër kishte në dispozicion 100 kuota për vitin 2020, u zgjat afati i aplikimeve dhe në përfundim të procedurave, shqyrtimit në Komisionin e Strehimit, në total u miratuan 103 përfitues, të cilët vijojnë procedurat me institucionet financiare.

Gjithashtu gjatë vitit 2020 është zbatuar instrumenti financiar për programin banesa sociale me qira “Subvencionimi i qirasë në treg të lirë”. Pas vlerësimit dhe shqyrtimit nga Komisioni i strehimit në varësi të fondit të parashikuar në buxhetin e bashkisë për këtë fond, u miratua në Këshill bashkiak lista me 3 përfitues në këtë program. Lista e aplikuesve të tjerë në këtë program është paraqitur për financim në ministrinë e linjës sipas parashikimeve ligjore.

P10661.O2.A2 Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitete të pafavorizuara Bashkia Shkodër. Përmirësim i shërbimeve bazë (Ndërtim rrjeti i ujit të pijshëm) .

Gjatë vitit 2020 është hartuar dhe kemi aplikuar për Rikonstruksionin e banesave sociale tek ish konvikti i shkollës veterinare, projekt i cili është miratuar dhe është në proces zbatimi. Nga ky projekt synohet të rikonstruktohen 28 banesa sociale dhe rreth 28 familje përfituese.

P6190.O2.A3. (Kodi i Ministrisë) P10661.O2.A3 Rikonstruksion i godinave në pronësi të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për strehim social, Bashkia Shkodër.

Projekti i strehimit social “Godina sociale” Rikonstruksion i godinave në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Ndërtim i ri, godina sociale, me kontinier 1+1 dhe 2+1)“, në Programin 10661 “Srehimi Social“, art. 231, zëri: Investime si dhe në Programin e Ministrisë së Financës nr. 6190, art. 231, është drejt përfundimit. Ky projekt synon të strehojë 142 banorë të komunitetit rom. Është hartuar dhe miratuar në këshill bashkiak sistemi i pikëzimit dhe kanë filluar procedurat e aplikimeve për individët/familjet rome të interesuar në bashkëpunim me Qendrën komunitare multifunktionale “Për familjen”, ku këto familje marrin shërbime.

P6190 (Kodi i Ministrisë) P10661.O2.A4 Rikonstruksion i godinave në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Rikonstruksioni i ish konviktit të shkollës veterinare)

Ky projekt është miratuar nga ministria e linjës dhe bashkëfinancohet nga bashkia Shkodër. Projekti është në proces zbatimi dhe synon përmirësimin e kushteve të banimit për disa familje në nevojë përmes rikonstruksionit të godinave ekzistuese në pronësi të bashkisë Shkodër për strehim social.

Aktivitete/Projekte	Buxheti fillestar 000/Lekë	Buxheti i korigjuar 000/Lekë	Realizimi Viti 2020 000/Lekë
P10661.O1.A1 Sherbime integrale & zhvilluese dhe administrimi i apartamenteve sociale, të krijuar për personat e dalë nga institucionet e përkujdesit rezidencial dhe gratë kryefamiljare me probleme social-ekonomike, prane Qendes Komunitare "Per Familjen" nr 6.	1230	1230	737
P10661.O2.A1 Strehim social sipas programeve sociale të strehimit.	600	600	Në proces zbatimi
P10661.O2.A2 Projekte qe synojne permiresimin e kushteve te banimit te komuniteteve te paforizuara			Realizuar
P6190.O2.A3. Rikonstruksion i godinave në pronësi të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Ndërtim i ri, godina sociale, me kontinier 1+1 dhe 2+1)	43,196	35,571	35,571
P 6190 Kodi i Ministrise			
P10661.O2.A4 Rikonstruksion i godinave në pronësi të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Rikonstruksioni i ish konviktit të shkollës veterinare)	-	43,153	24,123